



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 665 Akti

Nr. 758 Vendimi
Tiranë, më 16.4.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Etleđa Çiftja	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 16.4.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Madrid Kullolli**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli në seancë dëgjimore dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Madrid Kullolli, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Z. Madrid Kullolli, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 21.12.2020 vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 8.2.2024, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas ligjit nr. 84/2016 mbi të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të

¹ Email datë 13.1.2021, ora 12:35 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe, në datën 9.2.2024, përmes postës elektronike² t’i njoftojë subjektin e rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak. Subjekti i rivlerësimit u ftua të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit brenda datës 26.2.2024.

7. Subjekti i rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike³ paraqiti kërkesë për shtyrjen e afatit të paraqitjes së propësimeve/shpjegimeve dhe provave në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht. Sa rezulton, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e tyre deri në datë 29.2.2024 dhe me anë të postës elektronike⁴ njoftoi subjektin e rivlerësimit se me vendimin e datës 26.2.2024 vendosi ta ftojë për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 1.3.2024, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

8. Në datën 29.2.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 29.2.2024 dhe njëkohësisht paraqiti me anë të postës elektronike⁵ shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Në datën 3.3.2024, ora 12:28, pranë Komisionit u administrua në rrugë elektronike një denoncim, protokolluar në datën 4.3.2024 me nr. ***. Lidhur me këtë denoncim, pas diskutimit me trupin gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në datën 6.3.2024 u vendos që të merreshin disa hapa hetimor dhe të riçeljej hetimi për të analizuar pretendimet e denoncuesit ndaj subjektit të rivlerësimit.

10. Për rrjedhojë, trupi gjykues në datën 7.3.2024 përmes postës elektronike⁶ njoftoi subjektin mbi shtyrjen e seancës së planifikuar në datën 8.3.2024, si dhe riçeljen e hetimit administrativ kryesisht, bazuar në denoncimin e administruar pranë Komisionit.

11. Pasi kreu hetimin mbi këto denoncime dhe *indicie*-t e marra prej tyre, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit kryesisht shtesë në datën 27.3.2024 dhe përmes postës elektronike⁷ njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht shtesë; (ii) të drejtën për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet shtesë të hetimit brenda datës 8.4.2024.

12. Në datën 8.4.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2024 dhe njëkohësisht paraqiti me anë të postës elektronike⁸ shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit shtesë.

² Email datë 9.2.2024, ora 13:50 “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

³ Email datë 23.2.2024, ora 14:22.

⁴ Email datë 26.2.2024, ora 16:49.

⁵ Email datë 29.2.2024, ora 15:59.

⁶ Email datë 7.3.2024, ora 14:22 “Njoftim për shtyrje seance”.

⁷ Email datë 29.3.2024, ora 11:49.

⁸ Email datë 8.4.2024, ora 08:33.

13. Më tej, me vendimin datë 9.4.2024, Komisioni përmes postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit⁹ se trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit shtesë në datën 12.4.2024, ora 10:00.

II. SEANCAT DËGJIMORE

14. Në datën 1.3.2024 u zhvillua seanca e parë dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

15. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të seancës dëgjimore, në datën 1.3.2024, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

17. Më pas, në datën 12.4.2024 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit administrativ shtesë, në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

18. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ shtesë. Subjekti i rivlerësimit, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

19. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli. Në përfundim të seancës dëgjimore, në datën 12.4.2024, subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli kërkoi konfirmimin në detyrë.

20. Seanca dëgjimore e datës 12.4.2024 u ndërpre, për të rifilluar në datën 16.4.2024, ora 09:45, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁹ Email datë 9.4.2024, ora 13:21 “Ftesë për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me hetimin shtesë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

23. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

24. Referuar vendimit nr. 2/2017¹⁰ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

25. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

26. Subjekti i rivlerësimit, në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

➤ *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹⁰ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

27. Për efekt të procesit të rivlerësimit, është hetuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit shtetasi G. K. (vëllai i subjektit), referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin standard se ka marrë një dhurim në shumën 3.000 euro dhe një hua në shumën 1.000.000 lekë.

28. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI dhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklaratimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, gjatë seancave dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

29. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

30. Në deklaratën *Vetting*, subjekti dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuri dhe detyrime, me një total të pasurisë neto në shumën 28.642.686 lekë¹¹, si në vijim:

1. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga aktiviteti privat si avokate

1.1. Përpara se të vijohet me analizimin e pasurive të deklaruara, Komisioni shqyrtoi fillimisht një element të rëndësishëm të analizës financiare, konkretisht të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit si person fizik.

1.2. Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat, në vlerën totale 29.216.359 lekë, duke i detajuar për çdo vit kalendarik si në vijim: viti 2003 në shumën 2.250.000 lekë; viti 2004 në shumën 2.000.000 lekë; viti 2005 në shumën 1.500.000 lekë; viti 2006 në shumën 3.000.000 lekë; viti 2007 në shumën 2.000.000 lekë; viti 2008 në shumën 2.000.000 lekë; viti 2009 në shumën 1.950.000 lekë; viti 2010 në shumën

¹¹ Si diferencë midis pasurive (31.335.386 lekë) dhe detyrimeve (2.692.700 lekë). Për vlerësimin në monedhën lek janë përdorur kurset zyrtare të këmbimit, duke u bazuar në datën e pagesës/blerjes, sipas arsyetimit në këtë relacion dhe në metodikën e analizës financiare.

1.500.000 lekë; viti 2011 në shumën 1.605.440 lekë; viti 2012 në shumën 2.045.000 lekë; viti 2013 të ardhura nga aktiviteti privat si person fizik “Avokate”, në shumën 780.720 lekë; viti 2014 të ardhura nga studio ligjore “***”, në shumën 2.396.185 lekë; viti 2015 të ardhura nga studio ligjore “***”, në shumën 2.962.293 lekë; viti 2016 të ardhura nga studio ligjore “***” në shumën 3.226.721 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹².

1.3. Nga hetimi rezultoi se bashkëshortja e subjektit e ka kryer aktivitetin e saj që prej vitit 2003 e në vijim, regjistruar pranë organeve përkatëse me tri NIPT-e. Në vijim, Komisioni analizoi secilin prej tyre, për të evidentuar fitimin e realizuar në çdo vit kalendarik.

*a) Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti si person fizik “B. P.” me NIPT ***; Kavajë (periudha 25.3.2003 – 1.1.2005)*

1.4. Nga hetimi¹³ rezulton se me vendimin nr. ***, datë 13.3.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur regjistrimin e personit fizik “B. P.”, me aktivitet në fushën “Avokati dhe përkthim”.

1.5. Lidhur me të ardhurat e realizuara për vitin 2003, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shumën 2.250.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar shumën 2.150.000 lekë¹⁴. Për vitin 2004, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shumën 2.000.000 lekë, ndërsa në DIPP/2004 ka deklaruar shumën 2.100.000 lekë¹⁵.

1.6. Nga analizimi i informacionit të përcjellë nga DRT Durrës¹⁶, shtetasja B. K. (P.) figuron me NIPT ***, me objekt “Aktivitete juridike”, regjistruar në datën 25.3.2003 dhe çregjistruar më 1.1.2005. Gjatë vitit 2003 ka realizuar një qarkullim prej 2.250.000 lekësh dhe gjatë vitit 2004 një qarkullim prej 2.000.000 lekësh. Më tej, në këtë shkresë sqarohet se për këto vite nuk ka të dhëna për fitimin pasi sipas ligjit nuk deklarohet fitim, por vetëm xhiroja e realizuar.

1.7. Në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti bashkëlidhur procesverbaleve të mbajtura pranë ILDKPKI-së¹⁷, u administruan dy formularë me emërtimin “Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, për vitet 2003 dhe 2004, si dhe dokumentacioni për pagesën e detyrimeve tatimore, konkretisht për shumën 120.000 lekë në vitin 2003¹⁸ dhe shumën 130.000 lekë në vitin 2004¹⁹. Sa rezulton, Komisioni konstaton se për periudhën 2003 – 2004 disponohet informacion vetëm mbi qarkullimin dhe jo mbi fitimin e realizuar.

¹² Vendim nr. ***, datë 17.3.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për regjistrimin e personit fizik “B. P.”, me aktivitet në fushën “Avokate dhe përkthim”; vërtetim nr. ***, datë 25.1.2017, i DRT Durrës; vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, i Bashkisë Durrës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; pasqyra e shlyerjeve të detyrimeve tatimore për biznesin e vogël; vërtetim për bazën e vlerësueshme të personit fizik “B. K.”, për periudhën 1.3.2005 – 31.12.2008; ekstrakt historik i studios ligjore “***” sh.p.k.; vendim nr. *** i asamblesë së ortakëve të shoqërisë studio ligjore “***”; vërtetim nr. ***, datë 28.10.2016, nga ISSH-ja, vërtetim nr. ***, datë 28.10.2016, nga ISSH-ja.

¹³ Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

¹⁴ Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat si person fizik “Avokate” (Dhoma e Avokatisë Kavajë), në shumën bruto 2.200.000 lekë dhe në shumën neto 2.150.000 lekë.

¹⁵ Në DIPP/2004, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga avokatia në shumën 2.000.000 lekë dhe 100.000 përkthime.

¹⁶ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 3.7.2017 (hetimi i ILDKPKI-së); (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2017 (paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*); (iii) shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2023 (hetimi i Komisionit).

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2023.

¹⁸ Paguar në datat 28.3.2003 dhe 20.8.2003.

¹⁹ Paguar në datat 31.3.2004 dhe 20.8.2004.

1.8. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja ka punuar dhe punon si avokate e licencuar që nga viti 2003 dhe si asistente avokate që prej vitit 1999, për një periudhë 5-vjeçare (1999 – 2003) ka punuar si asistente avokate e palicencuar dhe ka siguruar gjatë kësaj periudhe të ardhura sipas deklarimeve. Ai ka sqaruar se deri në vitet e fundit nuk deklarohet fitimi, por vetëm xhiroja e realizuar, e cila në totalin e saj ishte pothuajse e gjitha e ardhur, për arsye se shpenzimet e këtij lloj aktiviteti janë minimale.

1.9. Në mungesë të informacionit, Komisioni, me qëllim përcaktimin e fitimit neto të realizuar, iu referua jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁰ dhe aplikoi një marzh prej 80% mbi xhiron e realizuar.

1.10. Në përfundim, Komisioni pasqyroj në analizën financiare të ardhura totale në shumën 3.400.000 lekë, të realizuara nga aktiviteti me NIPT ***, për periudhën 2003 – 2004.

*b) Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti si person fizik “B. K.” me NIPT ***, Durrës (periudha 29.3.2005 – 30.4.2013)*

1.11. Sipas dokumentacionit të administruar nga QKB-ja²¹, referuar ekstraktit historik personi fizik “B. K.” është regjistruar në datën 29.3.2005, me veprimtari “Avokati”, vendi i ushtrimit të aktivitetit Durrës, Lagjia Nr. ***, rruga “****”, përballë Gjykatës së Rrethit. Në datën 1.10.2010, ky subjekt është pezulluar dhe është bërë aktiv më 4.2.2011. Më tej, është pezulluar përsëri në datën 30.4.2013 dhe më 4.9.2013 figuron me status çregjistruar.

1.12. Lidhur me të ardhurat e realizuara për periudhën 2005 – 2013, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* një shumë totale prej 16.381.160 lekësh²², ndërsa në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar një shumë totale prej 13.905.427 lekësh²³.

1.13. *Për sa i përket të ardhurave të realizuara për periudhat 2005 – 2006 dhe 2009 – 2013, DRT Durrës²⁴ ka përcjellë informacion lidhur me të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit për subjektin tregtar, person fizik “B. K.”, me NIPT ***, për vitet në vijim: viti 2005, qarkullimi 1.500.000 lekë; viti 2006, qarkullimi 3.000.000 lekë; viti 2009, qarkullimi 1.950.000 lekë; viti 2010, qarkullimi 1.500.000 lekë; viti 2011, qarkullimi 1.605.440 lekë; viti 2012, qarkullimi 2.045.000 lekë; viti 2013, qarkullimi 780.720 lekë.*

Lidhur me vitin 2007, DRT Durrës informon se qarkullimi deklarohet në bashki, ndërsa për vitin 2008, sipas ligjit, të ardhurat nën 2 milionë lekë nuk ishin të detyrueshme të deklaroheshin.

²⁰ Vendim nr. 12-2020 (JR), datë 6.7.2020, subjekti P. Gj., paragrafi 82: “Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë ka përllogaritur fitimin e realizuar nga subjekti në masën 80% të qarkullimit vjetor për çdo vit [...]”.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

²² Subjekti ka deklaruar: për vitin 2005 shumën 1.500.000 lekë; për vitin 2006 shumën 3.000.000 lekë; për vitin 2007 shumën 2.000.000 lekë; për vitin 2008 shumën 2.000.000 lekë; për vitin 2009 shumën 1.950.000 lekë; për vitin 2010 shumën 1.500.000 lekë; për vitin 2011 shumën 1.605.440 lekë; për vitin 2012 shumën 2.045.000 lekë; viti 2013 të ardhura nga aktiviteti privat si person fizik “Avokate” në shumën 780.720 lekë.

²³ Subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP/2005, të ardhura të bashkëshortes nga veprimtaria private avokati dhe përkthime, në shumën 1.000.000 lekë; (ii) në DIPP/2006, të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti privat (avokati dhe përkthime), në shumën 3.000.000 lekë; (iii) në DIPP/2007, të ardhura të bashkëshortes nga veprimtaria private avokati dhe përkthime, në shumën 2.500.000 lekë; (iv) në DIPP/2008, shumën 1.500.000 lekë; (v) në DIPP/2009, shumën 1.435.624 lekë; (vi) në DIPP/2010, shumën 1.315.516 lekë; (vii) në DIPP/2011, shumën 1.561.440 lekë; (viii) në DIPP/2012, shumën 812.127 lekë; (ix) në DIPP/2013, të ardhura nga aktiviteti privat “Avokat” person fizik, në shumën 780.720 lekë.

²⁴ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017 (paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*); (ii) shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2023.

1.14. Për sa i përket të ardhurave të realizuara për periudhën 2007 – 2008, Bashkia Durrës²⁵, ndër të tjera, ka përcjellë deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor për vitet 2008 – 2009, ku specifikohet qarkullimi faktik i viteve paraardhëse, konkretisht shuma e qarkullimit faktik për vitin 2007 ka qenë 1.780.000 lekë dhe shuma e qarkullimit faktik për vitin 2008 ka qenë 1.500.000 lekë²⁶. Sa rezulton, Komisioni konstaton se për periudhën 2005 – 2013 (përveç vitit 2012), disponohet informacion vetëm mbi qarkullimin dhe jo mbi fitimin e realizuar.

1.15. Në mungesë të informacionit, Komisioni, me qëllim përcaktimin e fitimit neto të realizuar, iu referua jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁷ dhe aplikoi një marzh prej 80% mbi xhiron e realizuar.

1.16. Në përfundim, Komisioni pasqyroj në analizën financiare të ardhura totale në shumën 10.892.928 lekë, të realizuara nga aktiviteti për periudhat mars 2005 – 2011 dhe janar – prill 2013.

1.17. Lidhur me fitimin në vitin 2012, Komisioni vëren se për këtë vit qarkullimi ka qenë më i lartë se 2.000.000 lekë e, për rrjedhojë, në zbatim të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, personi fizik ka paraqitur pasqyra financiare (mikronjësitë)²⁸, sipas të cilave qarkullimi ka qenë 2.045.000 lekë, shpenzimet 1.190.873 lekë, tatimi 85.413 lekë dhe fitimi neto ka qenë 768.714 lekë.

1.18. Më tej, referuar pasqyrave financiare, në zërin “Tërhequr nga pronari”, në seksionin e Pasivitetit të Bilancit, pasqyrohet shuma 154.779 lekë. Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. *** “Mbi parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare nga mikronjësitë ekonomike”, në zbatim të të cilit janë hartuar pasqyrat financiare të sipërpërmendura – në zërin “Tërhequr nga pronari” pasqyrohet vlera e tërheqjeve të kryera nga pronari gjatë periudhës. Për pasojë, rezulton se gjatë vitit 2012 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr vetëm shumën 154.779 lekë nga fitimi i realizuar, shumë e cila u pasqyrua në seksionin e të ardhurave të analizës financiare të subjektit dhe personave të lidhur.

1.19. Në përfundim, Komisioni pasqyroj në analizën financiare të ardhura totale në shumën 11.047.707 lekë²⁹, të realizuara nga aktiviteti me NIPT ***, për periudhën mars 2005 – prill 2013.

*c) Të ardhurat e realizuara nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, studio ligjore “***”³⁰ me NIPT ***, Durrës (periudha 1.4.2013 e në vazhdim)*

1.20. Referuar informacionit të përcjellë nga DPT-ja³¹ dhe QKB-ja³², rezulton se shtetasja B. K. është aksionere me 100% të kuotave të aksioneve që nga themelimi dhe administratore që nga data 2.8.2019 e shoqërisë “***” me NIPT ***, themeluar në datën 1.4.2013, me objekt “Aktivitete juridike”, forma ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2017 (hetimi i ILDKPKI-së).

²⁶ Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, të lëshuar nga Bashkia Durrës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për aktivitetin e subjektit “B. K. (P.)” si avokate, e cila për vitet 2007 dhe 2008 është klasifikuar si subjekt me nivel xhiro 2.000.000 lekë.

²⁷ Vendim nr. 12-2020 (JR), datë 6.7.2020, subjekti P. Gj., paragrafi 82: “Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë ka përllogaritur fitimin e realizuar nga subjekti në masën 80% të qarkullimit vjetor për çdo vit [...]”.

²⁸ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të DRT Durrës (hetimi i ILDKPKI-së).

²⁹ Totali i shumës 10.892.928 lekë (mars 2005 – 2011 dhe janar – prill 2013) dhe shumës 154.779 lekë (viti 2012).

³⁰ Ndryshuar emri në datën 23.6.2016 në “***”.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021.

³² Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

Ndërkohë, nëna e bashkëshortes së subjektit, shtetasja E. P., figuron të ketë qenë administratore në shoqërinë studio ligjore “***”, larguar në datën 2.8.2019.

1.21. DRT Durrës³³ informon se sipas të dhënave në sistemin C@ATS rezulton se nuk ka shpërndarë dividend.

1.22. Lidhur me të ardhurat e realizuara për periudhën 2014 – 2016, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* një shumë totale prej 8.585.199 lekësh³⁴, ndërsa në deklaratat periodike vjetore një shumë totale prej 8.405.485 lekësh³⁵. Këtu nuk përfshihen të ardhurat e përfituara nga punësimi pranë kësaj shoqërie, të cilat janë pasqyruar në vlerën e tyre neto si zë i veçantë në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur.

1.23. DRT Durrës³⁶ ka përcjellë dokumentacion lidhur me të ardhurat dhe fitimin e realizuar nga subjekti tregtar person juridik, studio ligjore “***” sh.p.k., me NIPT ***, për vitet 2013³⁷ – 2016. Bashkia Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2017, konfirmon se shtetasja B. K. figuron e regjistruar pranë sistemit informatik me NIPT ***, me objekt aktiviteti “Avokati”. Subjekti i ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Durrës deri në datën 2.10.2017.

1.24. Komisioni administroi pasqyrat financiare (mikronjësitë), të hartuara nga kjo shoqëri, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2017 (ku pasqyrohen edhe të dhënat e vitit paraardhës – viti 2016)³⁸. Gjithashtu, u administruan vendimet e asamblesë së ortakëve lidhur me destinimin e fitimit të viteve ushtrimore, konkretisht: (i) vendimi datë 27.1.2014³⁹ për tërheqjen gjatë vitit 2013 të fitimit të realizuar në vitin 2013, në shumën 418.546 lekë, vendim ky i reflektuar edhe në pasqyrat financiare; (ii) vendimi datë 30.6.2015⁴⁰ për tërheqjen nga pronari gjatë muajit korrik 2015 të fitimit të krijuar në vitin 2014, në shumën 2.216.471 lekë, vendim ky i reflektuar edhe në pasqyrat financiare; (iii) vendimi datë 30.6.2016⁴¹, ku është vendosur kalimi për rezerva të periudhave të ardhshme të fitimit të realizuar në vitin 2015, në shumën 2.962.293 lekë, vendim ky i pereflektuar në pasqyrat financiare, pasi referuar atyre të viteve 2015 – 2016 fitimi i realizuar në vitin 2015 nuk ka kaluar për rritjen e rezervave, por duket të jetë tërhequr vitin pasardhës⁴².

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2023.

³⁴ Subjekti ka deklaruar: për vitin 2014 të ardhura nga studio ligjore “***”, në shumën 2.396.185 lekë; për vitin 2015 të ardhura nga studio ligjore “***”, në shumën 2.962.293 lekë; për vitin 2016 të ardhura nga studio ligjore “***”, në shumën 3.226.721 lekë.

³⁵ Subjekti ka deklaruar: në DIPP/2014 të ardhura nga aktiviteti privat “Avokati”, ortak i vetëm në studion ligjore “***”, në shumën 2.216.471 lekë; në DIPP/2015 të ardhura nga aktiviteti privat “Avokati”, studio ligjore “***” (fitimi pas tatimit), në shumën 2.962.293 lekë; në DIPP/2016 të ardhura nga aktiviteti privat “Avokati”, ortak i vetëm, ndryshuar emri në “***”, në shumën 3.226.721 lekë.

³⁶ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga DRT Durrës (paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*); (ii) shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2023, nga DRT Durrës (hetimi i Komisionit); (iii) shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2017, nga DRT Durrës (administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁷ Subjekti nuk ka deklaruar për vitin 2013 të ardhura të realizuara nga shoqëria me NIPT ***.

³⁸ PF 2013 (mikronjësitë) u administruar me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të DRT Durrës (hetimi i ILDKPKI-së); PF 2014 (mikronjësitë), shkarkuar nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie në faqen zyrtare të QKB-së; PF 2015 (mikronjësitë) dhe 2016 (mikronjësitë) u administruan me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të DRT Durrës (hetimi i Komisionit).

³⁹ Shkarkuar nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie në faqen zyrtare të QKB-së.

⁴⁰ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të DRT Durrës (hetimi i Komisionit).

⁴¹ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të DRT Durrës (hetimi i Komisionit).

⁴² Nëse analizojmë të dhënat e pasqyrave financiare 2015 – 2016 dhe përlogarisim gjendje likuiditetesh në fillim të vitit + fitim vjetor neto – diferenca e të drejtave (të arkëtueshme) + diferenca e detyrimeve (të pagueshme) – gjendje e likuiditeteve në fund të vitit, shuma e rezultuar përkon me fitimin e vitit ushtrimor paraardhës.

1.25. Sa më lart, duket se bashkëshortja e subjektit: (a) ka tërhequr 418.546 lekë në vitin 2013, përkundrejt deklaramit në vlerën 0 (zero) në deklaratën *Vetting*⁴³; (b) nuk ka tërhequr fitim në vitin 2014, përkundrejt deklaramit të saj në deklaratën *Vetting* se të ardhurat e realizuara për këtë vit kanë qenë në shumën 2.396.185 lekë; (c) ka tërhequr 2.216.471 lekë në vitin 2015, përkundrejt deklaramit të saj në deklaratën *Vetting* se të ardhurat e realizuara për këtë vit kanë qenë 2.962.293 lekë; (ç) ka tërhequr 2.962.293 lekë në vitin 2016, përkundrejt deklaramit të saj në deklaratën *Vetting* se të ardhurat e realizuara për këtë vit kanë qenë në shumën 3.226.721 lekë, si dhe në kundërshtim me vendimin e asamblesë së ortakëve datë 30.6.2016, ku është vendosur rritja e rezervave.

1.26. Komisioni vëren se fitimi i tërhequr nga bashkëshortja e subjektit nga kjo shoqëri është në trajtën e dividendit dhe, si i tillë, konsiderohet si e ardhur e tatueshme, për shkak se: Shoqëria tregtare “***” ka formë ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku parashikohet se: *“Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme”*; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1, parashikon se: *“Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi”*; Në ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Personi juridik duhet të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se data 30 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividendit”*.

1.27. Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkua të deklarojë nëse janë paguar detyrimet tatimore për fitimin e tërhequr (tatimi mbi dividendin), shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, si dhe të shpjegojë se përse nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2016 vendimi i asamblesë së ortakëve datë 30.6.2016, lidhur me rritjen e rezervave.

1.28. Në përgjigje, në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, subjekti shpjegoi se shoqëria “***” sh.p.k., me NIPT ***, nuk është shoqëri aksionere, por shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “sh.p.k.” dhe nuk ndan “dividendë”, por kryen “ndarje të fitimeve”. Nga ana e administratës tatimore vendore DRT nuk ka pasur një qëndrim të qartë dhe nuk është kërkuar asnjëherë që subjektet me formë ligjore “sh.p.k.” të trajtuara si biznes i vogël pa tatimfitimi duhet të deklarojnë dhe paguajnë tatimin mbi ndarjet e fitimeve brenda afateve të nenit 33/1 të ligjit nr. 8438, vijoi subjekti. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 20.4.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Më tej, subjekti sqaroi se nuk i janë shmangur

⁴³ Për vitin 2013 nuk janë deklaruar të ardhura nga aktiviteti për këtë NIPT, por janë deklaruar vetëm të ardhurat nga pagat bruto në shumën 450.000 lekë.

detyrimeve tatimore dhe se, pas kërkesave për interpretim administrativ dhe gjyqësor, ndarjet e fitimeve të viteve 2015 – 2020 u paguan në vitin 2021.

1.29. Lidhur me fitimin e vitit 2013, të padeklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegoi se të ardhurat e krijuara në vitin 2013 nuk janë tërhequr nga ortakut në vitin 2013, por janë transferuar nga zëri “Fitime të vitit të tërhequra” në zërin tjetër “Detyrime që shoqëria ka ndaj ortakut”, “Kreditorë të tjerë, shuma 342.884 lekë” dhe se mosdeklarimi është lapsus.

1.30. Pas verifikimit të pasqyrave financiare të vitit 2013, Komisioni vëren se në zërin “Kreditorë të tjerë”, me shënimin “Pronari”, të seksionit “Pasivi”, është pasqyruar shuma 342.884 lekë. Në vitin 2014, ky zë paraqitet me vlerë zero.

1.31. *Për sa i përket detyrimeve tatimore për fitimin e vitit 2013*, subjekti shpjegoi se tatimi mbi ndarjet e fitimit është deklaruar dhe paguar për vitin 2013 dhe se TAPBV ka qenë tatim përfundimtar për këto të ardhura⁴⁴.

1.32. Për rrjedhojë të sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2013 të ardhura nga aktiviteti në shumën 75.662 lekë, si diferencë midis shumës 418.546 lekë të pasqyruar si tërheqje të pronarit dhe shumës 342.884 lekë të reflektuar si kontribut pronari në zërin “Kreditorë të tjerë”.

1.33. Lidhur me fitimin e realizuar gjatë vitit 2014 – i cili referuar pasqyrave financiare nuk rezulton të jetë tërhequr gjatë vitit 2014, por një vit më pas – subjekti konfirmoi se tërheqja e bërë në vitin 2015 ka të bëjë me fitimet e deklaruara për vitin 2014.

1.34. *Për sa i përket detyrimeve tatimore për fitimin e vitit 2014*, subjekti shpjegoi se është deklaruar ndarja e fitimeve me deklaratën e tatimit në burim, periudha 15.7, dhe se është paguar. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti formularin e deklarimit dhe të pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, të shoqërisë “***”, për periudhën korrik 2015, ku në kutinë “Ndarjet e fitimit” është pasqyruar shuma 2.216.471 lekë dhe tatimi në burim në shumën 332.471 lekë (15%). Komisioni vëren se nga informacioni i përcjellë nga DRT Durrës⁴⁵ edhe në DIVA-n e vitit 2015 (plotësuar nga bashkëshortja e subjektit)⁴⁶ është paraqitur kjo e ardhur dhe tatimi përkatës.

1.35. Për rrjedhojë të sa më lart, Komisioni paraqiti të ardhura nga aktiviteti në analizën financiare të vitit 2014 vetëm shumën 342.884 lekë, si shumë e kthyer pronari nga kontributi i një viti më parë. Ndërsa në analizën financiare të vitit 2015 u paraqitën të ardhura në shumën 2.216.471 lekë, referuar pasqyrave financiare.

1.36. Lidhur me fitimin e realizuar gjatë vitit 2015 – i cili referuar pasqyrave financiare dukej sikur ishte tërhequr në vitin 2016, në kundërshtim me vendimin e asamblesë – subjekti shpjegoi se nuk është marrë vendim për shpërndarjen e fitimeve, por kalimin e tyre në rezerva. Mospasqyrimi i këtij vendimi në pasqyrat financiare ka qenë një gabim, i cili është evidentuar më

⁴⁴ Referuar deklaratës DIVA të vitit 2013: *Kutia 14. Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto, të tjera të cilat nuk janë të përfshira në të ardhurat e sipërshtënuara. [14/1] Kjo kuti plotësohet edhe në rastin kur individë realizon të ardhura nga kuotat e pjesëmarrjes në një shoqëri të regjistruar si person juridik, tatimpagues subjekt i taksës vendore mbi biznesin e vogël. E ardhura personale kur personi juridik është subjekt i TAPBV (të ardhurës personale për biznesin e vogël) është rezultati i dalë nga kutia [18] të formularit TAPBV 35/1 Tatimi mbi të ardhurat e tjera plotësohet kutia [35/1] për tatimin e paguar lidhur me të ardhurat e paraqitura në kutinë [14/1].*

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2023.

⁴⁶ Data e deklarimit e paraqitur në formular është 27.4.2016.

pas dhe është rivendosur në rezerva, të cilat janë reflektuar në PF-në e vitit 2018 bashkë me shënimet shpjeguese, sqaroi subjekti. Më tej, deklaroi se: *“Konstatimi se në deklaratën Vetting për vitin 2016 të ardhurat kanë qenë 3.226.721 lekë, është në përputhje me fitimin e realizuar në PF-në e vitit 2016. Tërheqja në vitin 2016 për vlerën 2.962.293 lekë, që i përkon fitimeve të vitit 2015, nuk është bërë. Konstatimi është korrekt që nuk është mbartur fitimi i vitit 2015 në PF-në e vitit 2016. Ky ka qenë një gabim material në paraqitjen e PF-së së vitit 2016. Në momentin e konstatimit është bërë edhe korrigjimi, është rivendosur në rezerva, të cilat janë pasqyruar në PF-në e vitit 2018 dhe janë dhënë shënimet shpjeguese për këtë situatë”*.

1.37. Lidhur me fitimin e realizuar gjatë vitit 2016, nga analizimi i pasqyrave financiare konstatohet se gjatë këtij viti është realizuar një fitim neto në shumën 3.226.721 lekë, ndërsa zëri “Tërhequr nga pronari” nuk paraqitet me vlerë. Me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, datë 31.7.2017⁴⁷, pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe depozitimit të këtij vendimi pranë organeve përkatëse, është vendosur kalimi për rezerva të periudhave të ardhshme të fitimit të realizuar në vitin 2016, në shumën 3.926.721 lekë. Kjo konfirmohet edhe nga analizimi i pasqyrave financiare të viteve 2016 dhe 2017⁴⁸, ku vërehet se fitimi i realizuar në vitin 2016 është në shumën 3.226.721 lekë dhe në vitin 2017 zëri “Rezerva” paraqitet pikërisht me këtë vlerë. Pra, fitimi i vitit 2016 nuk është tërhequr, por ka kaluar për rritjen e zërit “Rezerva”.

1.38. Për rrjedhojë të sa më lart, Komisioni nuk paraqiti të ardhura nga aktiviteti në analizën financiare të vitit 2016, pasi: (i) referuar vendimit të asamblesë datë 30.6.2016, fitimet e vitit 2015 janë destinuar për rritjen e rezervave (konfirmuar edhe nga shpjegimet e subjektit); (ii) referuar vendimit të asamblesë datë 31.7.2017 dhe pasqyrave financiare, fitimet e vitit 2016 janë destinuar për rritjen e rezervave.

1.39. Në përfundim, Komisioni pasqyroj në analizën financiare të ardhura totale në shumën 2.635.017 lekë, të realizuara nga aktiviteti me NIPT ***, për periudhën prill 2013 – dhjetor 2016.

*d) Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në pyetësin nr. 2 – kontrata huaje të lidhura ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. (ish-studio ligjore “****”), me NIPT ****

1.40. Në pyetësin nr. 2⁴⁹, subjekti ka paraqitur edhe 2 kontrata huaje, me data 1.12.2014 dhe 1.12.2016, të lidhura midis palës kreditore E. P., në cilësinë e administratores së shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës debitore B. K., në cilësinë e ortakes së vetme të shoqërisë “****” sh.p.k.

1.41. Komisioni vëren se këto kontrata nuk janë nënshkruar përpara noterit publik dhe ato nuk janë përmendur në shpjegimet e pyetësin nr. 2. Referuar këtyre kontratave, shoqëria i jep hua ortakes së saj të vetme, znj. B. K., shumën 1.000.000 lekë në datën 1.12.2014 dhe shumën 1.500.000 lekë në datën 1.12.2016. Në këto kontrata parashikohet se shumat e sipërcituara administratori i shoqërisë në cilësinë e kreditorit i jep pa interes dhe se data e kthimit do të jetë

⁴⁷ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të DRT Durrës (hetimi i Komisionit).

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, të DRT Durrës, ka përcjellë pasqyrat financiare të vitit 2017, ku pasqyrohen të dhëna edhe për vitin paraardhës (2016).

⁴⁹ Përgjigje nr. *** prot., datë 30.11.2023.

koha kur ortaku i vetëm i shoqërisë – njëkohësisht në cilësinë e palës debitore – të ketë mundësi kthimi, pa e kushtëzuar me ndonjë afat për kthimin e huas.

1.42. Komisioni konstaton se këto hua nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare⁵⁰ të viteve të cilëve u referohen kontratat e mësipërme (2014 dhe 2016). Po kështu, as në pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2017, 2018 dhe 2019 nuk gjendet gjurmë e këtyre huave apo të ndonjë korigjimi.

1.43. Vetë subjekti në pyetësonin nr. 2 ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2020, ku në zërin “Të tjera aktive afatshkurtra” të periudhës raportuese viti 2020 dhe të periudhës paraardhëse viti 2019 evidentohet shuma 2.500.000 lekë (totali i huave të mësipërme). Po kështu ka paraqitur edhe pasqyrat financiare të korigjuara të viteve 2014 dhe 2016 (jo të njehsuara nga organet tatimore), ku janë kryer shënimet korigjuese, duke saktësuar zërin “Kërkesa të arkëtueshme”, konkretisht shtimin e këtij zëri me shumën 1.000.000 lekë në vitin 2014 dhe 1.500.000 lekë të tjera në vitin 2016 dhe nga ana tjetër duke zvogëluar zërin “Arka”. Korigjimi ka vijuar edhe më tej në pasqyrat financiare të viteve 2017, 2018 dhe 2019.

1.44. Komisioni vëren se pasqyrat financiare të paraqitura nga subjekti për periudhën ushtrimore 2020, si edhe pasqyrat financiare me zërat e korigjuar për vitet 2014 – 2019 nuk janë të njehsuara nga organet tatimore, por në çdo rast korigjimi nuk është kryer përpara datës 21.2.2021 (datë në të cilën është përcjellë informacioni nga DRT Durrës).

1.45. Në analizë të sa më lart, edhe pse subjekti nuk ka pasqyruar pretendime lidhur me këto hua në shpjegimet shoqëruese në pyetësonin nr. 2, por vetëm ka paraqitur dokumentacionin e cituar më lart, Komisioni vëren se këto hua nuk janë deklaruar as në DIPP-të vjetore (sipas kërkesave ligjore) dhe as në deklaratën *Vetting*.

1.46. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës parashtroi shpjegimet e tij si në vijim:

1.47. *Së pari, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga zhvillimi i aktivitetit me NIPT ****, subjekti pretendoi se përveç fitimit neto të realizuar në periudhën janar – prill 2013, në analizën financiare duhet të përfshihet edhe fitimi i patërhequr që ka mbetur nga viti ushtrimor 2012, pakësuar me vlerën kontabël të aktiveve afatgjata materiale. Për sa kohë në vitin 2012 nuk është përfshirë i gjithë fitimi neto, por vetëm vlera e pasqyruar në shumën 154.779 lekë, pjesa e mbetur e fitimit është tërhequr gjatë vitit 2013. Referuar informacionit të përcjellë nga QKB-ja, rezulton se personi fizik figuron me status çregjistruar në datën 4.9.2013 e, për rrjedhojë, fitimi i patërhequr gjatë vitit 2012 është tërhequr i gjithi gjatë vitit 2013, shpjegoi subjekti, dhe kërkoi që të ardhurave të vitit 2013 t’u shtohet shuma 286.838 lekë⁵¹.

1.48. *Së dyti, lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja nga studio ligjore “***” sh.p.k., me NIPT ****, subjekti i rivlerësimit fillimisht theksoi se ai ka deklaruar si në deklaratën *Vetting*, ashtu dhe në deklaratat periodike vjetore, fitimin neto të realizuar nga aktiviteti i bashkëshortes regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

⁵⁰ Përcjellë nga DRT Durrës në datën 21.2.2021.

⁵¹ Si diferencë midis shumës 633.348 lekë (fitimi/kapitali në PF 2012) me 346.510 lekë (shuma e aktiveve afatgjata materiale).

1.49. Më tej, subjekti parashtroi shpjegimet e tij për të mbështetur deklarin e tij se subjektet që janë biznes i vogël nën 8.000.000 lekë nuk kanë detyrim për pagesën e dividendit, referuar dispozitave ligjore të ligjit nr. 8438 dhe në qëndrimin të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

1.50. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005, detyrimi i personit juridik për të derdhur në llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin jo më vonë se data 30 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, është për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, ose thënë ndryshe shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që konsiderohen si biznes i madh me xhiro vjetore mbi 8.000.000 lekë dhe jo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo të tatimit mbi biznesin e vogël.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që kanë të ardhura nën 8.000.000 lekë nuk janë subjekte të tatimit mbi fitimin, por subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël dhe më pas të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk rregullohet sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, por sipas ligjit nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ku në kreun III përcaktohet “Tatimit i thjeshtuar mbi fitimi për biznesin e vogël”, që rregullohet nga neni 10 e në vazhdim i ligjit. Gjithashtu, QKB-ja për subjektet e biznesit të vogël, qoftë në formën ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nuk kërkon depozitim të vendimit të ortakëve të shoqërisë për miratimin e pasqyrave financiare dhe destinimin e fitimit.

1.51. Gjithashtu, subjekti referoi qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 41, datë 31.10.2022, ku në paragrafët 101 - 102⁵² përcaktohet se: *“Kolegji vlerëson si të pabazuar në ligj edhe konkluzionin e Komisionit se është forma ligjore e shoqërisë ajo që përcakton mënyrën e tërheqjes së fitimit të realizuar. Nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se ndarja e përgjegjësisë tatimore, pra nëse një shoqëri do të jetë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo i tatimit mbi fitimin, bëhet jo sipas formës juridike të shoqërisë, por sipas xhiros vjetore që realizon shoqëria, si dhe nga fakti nëse është ose jo subjekt i TVSH-së [...]”*.

1.52. Më tej, subjekti vijoi shpjegimet e tij lidhur me zërat e bilancit për vitet 2014 – 2016. Konkretisht, ai shpjegoi se referuar pasqyrave financiare rezulton se në fund të vitit 2014 gjendja e arkës së shoqërisë është në shumën 2.073.664 lekë. Në fund të vitit 2015, gjendja e arkës është në shumën 1.058.800 lekë. Ndërsa referuar pasqyrave financiare për vitin 2016 rezulton se zëri “Kërkesa të arkëtueshme” është në shumën 3.764.000 lekë, krahasuar me vitin 2015 rezulton që ky zë bilanci ka qenë 0 (zero) lekë, çka tregon nga leximi i pasqyrave financiare se rritja e klientëve gjatë vitit 2016 është në shumën 3.764.000 lekë, kur ndërkohë shitjet pa TVSH gjatë vitit 2016 janë në shumën 6.620.002 lekë. Duket qartësisht se këto pasqyra financiare të vitit 2016 paraqesin anomali, pasi nuk mund të rezultojë që 50% e klientëve të mos kenë paguar gjatë vitit 2016. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk ka nevojë për një gjendje arke në shumën 2.073.664 lekë, pasi pagesat në cash janë relativisht në vlera të vogla dhe kjo gjendje arke nuk i përgjigjet

⁵² “[...] Nga nenet 32/1 dhe 33/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe nga udhëzimi nr. ***/2006 i ministrit të Financave, rezulton se shpërndarja e dividendit dhe pagesa e tatimit mbi dividendin realizohet vetëm nga shoqëritë tregtare që ishin subjekt i tatimit mbi fitimin, pra për shoqëritë që realizonin xhiro vjetore mbi 8.000.000 lekë. ... [...] ...Duke marrë në konsideratë se edhe dividendi përfaqëson një tatim mbi të ardhurat personale, nuk mund të prezumohej që i njëjti subjekt t’i nënshtronte dy herë tatimit mbi të ardhurat personale, duke paguar si tatimin e të ardhurave nga biznesi i vogël, ashtu edhe, siç arsyetonte Komisioni, tatimin mbi dividendin”.

aktivitetit të shërbimit të avokatisë të kryer nga bashkëshortja. Rezulton qartësisht e dukshme se fitimi i realizuar është vendosur gjendje arke si rrjedhojë e dyzimit, nëse shoqëria me përgjegjësi të kufizuar duhet të paguajë ose jo tatim mbi dividendin, kontabilisti i miratuar A. A. nuk ka pasqyruar tërheqjen e fitimit nga gjendja e arkës nëpërmjet huas së marrë nga shoqëria në vitin 2014, por ka paraqitur gjendjen në arkë në shumën 2.073.664 lekë, përfundoi subjekti i rivlerësimit.

1.53. Subjekti solli në vëmendje se, në një rast të ngjashëm me situatën e tij, Kolegji në vendimin nr. 31, datë 12.10.2021 (paragrafët 31.1 - 31.8), ka mbajtur qëndrimin se deklarimi gabim i gjendjes së arkës, për sa kohë nuk passjell ndikim tatimor negativ për shtetin dhe nuk prodhon asnjë efekt tatimor i cili mund të shmangej nëpërmjet deklarimit të saj prej subjektit, çka ka bindur trupin gjykues se gjendja e arkës së evidentuar në pasqyrat financiare nuk ekziston realisht. Sipas arsyetimit në këtë vendim, pretendimi për mosekzistencën reale të gjendjes “Arka”, sipas deklarimeve në pasqyra financiare, është i besueshëm dhe, për pasojë, njësia familjare nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim në vitet kur ai është pasqyruar si i tillë.

1.54. Në vijim, subjekti dha shpjegime lidhur me dy kontratat e huas, të datave 1.12.2014 dhe 1.12.2016, lidhura midis palës kreditore E. P., në cilësinë e administratores së shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës debitorë B. K., në cilësinë e ortakës së vetme të shoqërisë “****” sh.p.k., hua të cilat, sipas subjektit, janë bërë pjesë e llogarisë “Arka” dhe zërit “Kërkesa të arkëtueshme”, zëra të cilët janë pasqyruar gabim në pasqyrat financiare të viteve përkatëse.

1.55. Subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2024, të lëshuar nga DRT Durrës, e cila ka përcjellë pasqyrat financiare të njehsuara për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, si dhe shpjegoi se: *“Nëse analizojmë pasqyrat financiare të korigjuara, të cilat duhet të pranohen nga Komisioni bazuar edhe në qëndrimin e Kolegjit në një rast të ngjashëm, evidentohet se: Në vitin 2014 është tërhequr huaja e lidhur ndërmjet shoqërisë dhe ortakut në shumën 1.000.000 lekë, duke sistemuar gjendjen në arkën e shoqërisë, që paraqitet shumë e lartë dhe nuk paraqet situatën real-ekonomike të shoqërisë në fund të vitit 2014. Në vitin 2016 është tërhequr shuma 1.500.000 lekë, që i përket huas së marrë nga ortakut i vetëm, si dhe tërheqja e pronarit nga arka e shoqërisë po të shumës 1.500.000 lekë, duke pasqyruar tërheqjen në shumën gjithsej 3.000.000 lekë për vitin 2016. Pasqyrat financiare të vitit 2016 kanë një gabim material në paraqitjen e tyre, pasi nuk mund të rezultojnë në asnjë rast me llogarinë e arkëtueshme në shumën 3.764.000 lekë. Është bërë korigjimi i pasqyrave financiare duke korigjuar klientët në vlerën reale që janë për t’u arkëtuar në fund të vitit 2016 në shumën 1.692.000 lekë dhe në shumën 4.000.000 lekë, që rezultojnë tërheqjet e ortakut dhe dy huat e marra. Deklarimi i fitimit të shoqërisë çdo vit është deklaruar si në deklaratën Vetting ashtu edhe në deklaratimet periodike vjetore.*

Për këto arsye, tërheqjet e fitimit neto të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duhet të pasqyrohen në analizën financiare, përkatësisht 1.000.000 lekë në vitin 2014 dhe 3.000.000 lekë në vitin 2016 (huaja dhe tërheqja e pronarit)”.

1.56. Gjithashtu, subjekti paraqiti një raport të analizës financiare, të përgatitur nga audituesi ligjor O. V..

1.57. *Së treti*, subjekti pretendoi se në të ardhurat e vitit 2013 duhet të përfshihet edhe paga e marrë në shoqëri sipas konfirmimeve të listëpagesave mujore, në të cilat rezulton se bashkëshortja ka pasur një pagë bruto në shumën 50.000 lekë dhe neto në shumën 39.400 lekë, në total në shumën 354.600 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.58. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.59. *Për sa i përket pretendimit të subjektit për të përfshirë tek të ardhurat nga aktiviteti tregtar me NIPT *** edhe shumën prej 286.838 lekësh gjatë vitit 2013*, Komisioni e vlerëson të drejtë dhe paraqiti në analizën financiare të vitit 2013 një shtesë prej 286.836 lekësh tek të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si person fizik, pasi: (i) nga analizimi i pasqyrave financiare të vitit 2012 evidentohet një fitim total prej 788.127 lekësh, aktive afatgjata materiale në shumën 346.510 lekë dhe fitim i tërhequr në shumën 154.779 lekë dhe, për rrjedhojë, një fitim i patërhequr në shumën 286.838 lekë⁵³; (ii) nuk disponohen pasqyra financiare për vitin 2013, për aktivitetin me NIPT ***, të cilat do të qartësonin destinacionin e fitimit të mbetur pa tërhequr nga viti 2012. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja nga studioja ligjore “****” sh.p.k., Komisioni arsyeton si në vijim.

1.59.1. Për sa i përket detyrimit të shoqërisë studio ligjore “****” sh.p.k. për të paguar dividend, Kolegji i Posaçëm i Apelit⁵⁴ ka vlerësuar se ndarja e përgjegjësisë tatimore, pra nëse një shoqëri do të jetë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo i tatimit mbi fitimin, bëhet jo sipas formës juridike të shoqërisë, por sipas xhiros vjetore që realizon shoqëria, duke u shprehur se: *“Për sa më sipër, Kolegji vlerëson si të pabazuar në ligj edhe konkluzionin e Komisionit se është forma ligjore e shoqërisë ajo që përcakton mënyrën e tërheqjes së fitimit të realizuar. Nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se ndarja e përgjegjësisë tatimore, pra nëse një shoqëri do të jetë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo i tatimit mbi fitimin, bëhet jo sipas formës juridike të shoqërisë, por sipas xhiros vjetore që realizon shoqëria, si dhe nga fakti nëse është ose jo subjekt i TVSH-së. Shoqëria “{****}” sh.p.k., si biznes i vogël i peregjistruar në TVSH, nuk ka qenë subjekt i tatimit mbi fitimin, nuk ka shpërndarë dividend dhe, rrjedhimisht, nuk ka pasur detyrim për pagesë të tatimit mbi dividendin”.*

1.59.2. Pavarësisht sa më sipër, Komisioni vlerëson të theksojë se konkluzioni në rezultatet e hetimit u bazua në zërat e pasqyruara në pasqyrat financiare – në versionin e tyre të pakorrigjuar – që kishin të bënin me destinacionin e përdorimit të fitimit dhe ky konkluzion ishte rezultat i

⁵³ Përlllogaritur: 788.127 lekë minus 346.510 lekë minus 154.779 lekë.

⁵⁴ Vendimi nr. 41-2022 (JR), datë 31.10.2022, subjekti E. K., paragrafi 101 - 102.

prezumimit të vërtetësisë së të dhënave të raportuara fillimisht nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit pranë autoriteteve tatimore.

1.59.3. Megjithatë, Komisioni vlerëson se qëllimi i kryerjes së analizës ekonomiko-financiare synon në radhë të parë verifikimin e vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit mbi ekzistencën e burimeve të ligjshme të të ardhurave dhe mjaftueshmërisë së tyre për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe krijimin e pasurive të deklaruara.

1.59.4. Në kushtet që fitimi nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, neni 3, pika 19 dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme, Komisioni analizoi rrethanat si në vijim:

1.59.5. *Së pari*, siç pretendohet edhe nga subjekti, konstatohet se ka ekzistuar një dilemë ndër vite lidhur me pasjen apo jo të detyrimit për të shpërndarë dividend, çka provohet edhe vendimin nr. ***, datë 20.4.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me datë regjistrimi 6.12.20019. Në këtë vendim, ndër të tjera citohet se pala paditëse/shoqëria “****” sh.p.k. i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve Tiranë me kërkesë me shkrim⁵⁵ për interpretim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, duke i kërkuar nëse ka detyrim ligjor për të depozituar vendim për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit. Në përgjigje⁵⁶, DPT-ja ka shpjeguar se detyrimi i shoqërive tregtare për të depozituar vendimin e miratimit të rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit nuk lidhet me përgjegjësinë tatimore të subjektit tregtar, por me formën e tij të organizimit dhe krijimit. Pra, referuar përgjigjes së administratës tatimore, pavarësisht përgjegjësisë tatimore, shoqëria mbart detyrimin për pagesën e dividendit nëse është miratuar shpërndarja e fitimit.

1.59.6. Siç shpjegohet edhe në raportin financiar të paraqitur nga subjekti, kjo situatë duket të ketë shkaktuar një frikë nga penalizimi për mospagimin e dividendit, çka ka ndikuar paraqitjen në mënyrë të pasaktë në zërat e bilancit.

1.59.7. *Së dyti*, përveç shpjegimit të subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e gabuar në zërat e arkës dhe të llogarive të arkëtueshme, të cilat paraqiten në shuma të paarsyeshme dhe jo logjike për llojin dhe volumin e aktivitetit të zhvilluar nga ana e bashkëshortes së subjektit, Komisioni konstaton se një zë tjetër i bilancit tek i cili është “ngarkuar” fitimi është zëri i rezervave.

1.59.8. Referuar Standardit Kombëtar i Kontabilitetit nr.*** – Paraqitja e Pasqyrave Financiare – rezervat përbëhen nga: (i) rezerva statusore – rezerva të krijuara nga aksionerët në bazë të statutit të njësisë ekonomike raportuese dhe akteve të themelimit; (ii) rezerva ligjore – rezerva të krijuara në përputhje me kërkesat e ligjit për shoqëritë tregtare ose me ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm; (iii) rezerva të tjera – të ardhurat dhe shpenzimet e porealizuara që në përputhjet e SKK-të nuk regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve [për shembull, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (SKK 5), rezerva që rrjedhin nga diferencat e kursit të këmbimit në rastin e konsolidimit të njësisive të huaja të kontrolluara në përputhje me SKK 9 etj.].

1.59.9. Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në nenin 127 parashikon që nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur

⁵⁵ Me kërkesën nr. ***, datë 8.8.2019.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 2.9.2019.

shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5% të kësaj vlere, *derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë*, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

1.59.10. Në kushtet që kapitali i regjistruar i shoqërisë është vetëm 100.000 lekë, duket i pashpjegueshëm kalimi për rezerva të periudhave të ardhshme të fitimit të realizuar në vitin 2016, në vlerën 3.926.721 lekë, pra shumë herë më e lartë se 10% të kapitalit të regjistruar, për sa kohë që në statutin e shoqërisë⁵⁷ nuk përcaktohet një përqindje më e lartë.

1.59.11. *Së treti*, Komisioni vëren se gjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit të bashkëshortes së subjektit si avokate, fitimi i realizuar është përdorur rregullisht duke u vënë në dispozicion të ekonomisë familjare, çka e bën të palogjikshëm mospërdorimin e fitimit në vitet 2014 dhe 2016 për të njëjtin qëllim. Kjo mbështetet edhe nga deklaratimet në DIPP-të vjetore, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 2.216.471 lekë në DIPP/2014 dhe shumën 3.226.721 lekë në DIPP/2016.

1.59.12. Në përfundim, për sa më lart analizuar, për sa kohë të ardhurat nga aktiviteti si avokate i plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme, Komisioni, me qëllim arritjen e një vendimmarrjeje sa më të drejtë për çështjen, çmoi të arsyeshme të marrë në konsideratë pasqyrat financiare të korigjuara, të njehsuara nga administrata tatimore, dhe paraqiti në analizën financiare të subjektit të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes si avokate shumën 1.342.884 lekë në vitin 2014 dhe shumën 3.000.000 lekë në vitin 2016.

1.60. *Në lidhje me pretendimin për të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2013*, Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar nga hetimi⁵⁸, e çmon të drejtë pretendimin e subjektit dhe paraqiti në analizën financiare të vitit 2013 të ardhura nga pagat e subjektit në shumën 354.600 lekë.

2. Gjendja cash

2.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat familjare, gjendje *cash* në banesë datë 25.1.2017, në shumën 1.300.000 lekë. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore u konstatua se gjatë periudhës 2003 – 2009 subjekti nuk ka kryer deklarime në DIPP-të vjetore lidhur me kursime të mundshme në formën e likuiditeteve *cash* gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, vërehet se në DIPP-të e viteve 2010 – 2015 subjekti ka deklaruar shtesa të kursimeve, ndërsa në DIPP/2016, dorëzuar në datën 15.3.2017 (pra, pas deklaratës *Vetting*), ka deklaruar gjendje të kursimeve *cash*.

2.2. Ndërkohë që ILDKPKI-ja⁵⁹ ka përcjellë procesverbalet e mbajtura ndër vite, ku konstatohet se deklaratimet e subjektit në këtë procesverbal nuk përputhen me deklaratimet e kryera në DIPP-të vjetore.

2.3. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI në datën 18.7.2016, subjekti ka dhënë sqarime lidhur me likuiditetet *cash*, të cilat duket se i referohen dy periudhave:

⁵⁷ Shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2021, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021, e DPT-së.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2023.

i) Periudha 2003 – 2009 – ILDKPKI-ja i ka kërkuar sqarime subjektit lidhur me likuiditetet e kësaj periudhe, konkretisht: *“Bashkëlidhur DPV/2009 keni dërguar një deklaratë sqaruese, ku shpjegoni se nga të ardhurat tuaja personale në vite keni kursyer gjendjen 3.200.000 lekë nga paga si prokuror dhe bashkëshortja si avokate. Këto kursime në vite kanë shërbyer për shlyerjen e pjeshme të kredisë në ISP, konkretisht në vitin 2009 shlyer 23.341 euro. Jepni shpjegime pse është marrë kjo kredi nga ana juaj kur ju paskeni pasur kursime gati 3.200.000 lekë, të cilat nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga ana juaj në asnjë nga deklaratat e pasurisë për periudhën 2003 – 2009”*. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se i qëndron deklaramit dhe informacionit shtesë bashkëlidhur deklaramit të vitit 2009. Në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja ndodhet kopje e deklaratës së sipërcituar, me emërtimin “Deklaratë sqaruese”, e nënshkruar nga subjekti deklarues Madrid Kullolli, pa datë nënshkrimi dhe pa numër protokolli. ILDKPKI-ja⁶⁰ informon se mund të evidentojnë se kjo deklaratë sqaruese është paraqitur në vitin 2010 dhe i është bashkëngjitur deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, por ndodhen në pamundësi për të përcaktuar datën e saktë të dorëzimit.

Në këtë deklaratë sqaruese subjekti ka deklaruar: *“[...] Pas konsultimit me zyrën tuaj lidhur me deklaratën e plotësuar për vitin 2009, kam konstatuar se veç deklaramit të të ardhurave, shtesave dhe pakësimeve të pasurisë, më duhet të saktësoj edhe vlerën e gjendjes cash të likuiditeteve të mia. Nisur nga sa më sipër, ju deklaroj se nga të ardhurat e mia familjare kam kursyer ndër vite gjendjen 3.200.000 lekë, kursime këto të krijuara nga paga ime si prokuror dhe të ardhurat e bashkëshortes sime si avokate. Këto likuiditete të kursyera në vite më kanë shërbyer për shlyerjen e pjeshme të kredisë së marrë nga Banka Amerikane dhe aktualisht kam gjendje në datën 31.12.2009 gjendjen cash në shumën 1.600.000 lekë [...]”*.

Subjekti ka bashkëlidhur një tabelë të përmbledhur të pasqyrës financiare të të ardhurave, shtesave dhe pakësimeve të pasurisë së tij familjare, përgjatë periudhës 1998 – 2009. Komisioni analizoi tabelën e paraqitur nga subjekti, ku u konstatua se ai ka përfshirë të ardhurat nga paga e tij, duke filluar që nga viti 1998, pagat e bashkëshortes që nga viti 2000, si dhe të ardhurat e bashkëshortes nga zhvillimi i aktivitetit si person fizik. Në fund të vitit 2003, subjekti ka paraqitur një gjendje cash në shumën 2.600.000 lekë⁶¹. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti, pasi ka renditur të ardhurat dhe shpenzimet e kryera për blerje pasurie/pagesë këstesh, ka paraqitur gjendje cash në shumën 1.600.000 lekë në fund të vitit 2009.

ii) Periudha 2010 – 2015 – Në përgjigje të pyetjes nr. 7, subjekti ka shpjeguar se: *“Lidhur me shtimin e gjendjes cash ka rezultuar se gjatë viteve, nisur nga konfuzioni që paraqet kërkesa ligjore për deklaramin e gjendjes cash, rezulton se në fund të çdo viti pas vitit 2009 kam deklaruar gjendjen cash në banesë, e cila ka vijuar me ulje e ngritje sipas shpenzimeve të kryera nga ana ime dhe familja. Sqaroj se në deklaramet e gjendjes cash kam pasur parasysh gjendjen në fund të vitit dhe jo shtesën për vitin deklarues”*. Më tej, në përgjigje të pyetjes nr. 14, ku i është kërkuar të deklarojë gjendjen cash në datën 31.12.2014, subjekti ka deklaruar se gjendja në këtë datë ka qenë në vlerën 3.250.000 lekë.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.1.2024.

⁶¹ Në tabelën e dorëzuar në fund të vitit 2003 pasqyrohet shënimi “2.600.000 lekë banesë”.

2.4. Sa më lart, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar me qëllim mbajtjen e një qëndrimi lidhur me mënyrën e paraqitjes së likuiditeteve *cash* në analizën financiare.

2.5. Lidhur me kursimet prej 2.600.000 lekësh – të deklaruara në deklaratën sqaruese të vitit 2009 si kursime deri në fund të vitit 2003 – Komisioni vëren se: *Së pari*, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 kursime në formën e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, sipas kërkesave të ligjit nr. 9049/2003. *Së dyti*, duket e dyshimtë ekzistenca e këtyre kursimeve *cash* në datën 31.12.2003 – pra disponimi i likuiditeteve të lira – pasi: (i) në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se në vitin 2004 ka marrë hua shumën 1.000.000 lekë, të cilat i ka shlyer brenda vitit; (ii) në vitin 2006, subjekti ka marrë një kredi në shumën 35.000 euro; (iii) subjekti ka deklaruar se këto kursime kanë shërbyer pikërisht për shlyerjen e pjeshme të kredisë në vitin 2009. *Së treti*, nga analiza financiare e kryer për periudhën 1998 – 2003, duket se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë. Në rast se në këtë analizë do të përfshiheshin kursimet e pretenduara në shumën 2.600.000 lekë, subjekti dhe personat e lidhur do të gjendeshin me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar këto kursime. *Së katërti*, Komisioni vëren se deklarata sqaruese nuk është cituar në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 7.12.2012⁶² – i mbajtur më afër në kohë me vitet e pretenduara të ngjarjeve – por është përmendur rreth 4 vite më vonë, në procesverbalin e datës 18.7.2016. Për rrjedhojë, duke iu referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁶³ lidhur me deklaratimet e likuiditeteve *cash* (konkretisht në deklaratën e pasurisë së vitit 2003), kursimet prej 2.600.000 lekësh nuk u përfshinë në analizën financiare.

2.6. Lidhur me kursimet prej 1.600.000 lekësh – të deklaruara në deklaratën sqaruese të vitit 2009 si gjendje në datën 31.12.2009 dhe që presupozohet se rrjedhin nga periudha 2004 – 2009, Komisioni vëren se: *Së pari*, subjekti nuk ka deklaruar në asnjë prej deklaratave të viteve 2004 – 2009 kursime në formën e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, sipas kërkesave të ligjit nr. 9049/2003. *Së dyti*, subjekti ka paraqitur gjendjen e mbetur në fund të vitit 2009, duke prezumuar një analizë në vijimësi të të ardhurave dhe shpenzimeve/blerjes së pasurive për periudhën 2004 – 2009⁶⁴, duke mos e përcaktuar shumën e kursyer për secilin prej këtyre viteve. Kjo mënyrë përlllogaritjeje është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003⁶⁵, ligjit nr. 84/2016⁶⁶ dhe

⁶² Në këtë procesverbal janë kërkuar sqarime lidhur me disa transaksione të identifikuara pranë Unionit Financiar Tiranë – të kryera nga ana e subjektit dhe bashkëshortes – për të cilat subjekti ka deklaruar se nga totali i shumave të marra nëpërmjet Unionit Financiar, shuma prej 5.000 euro është mbajtur gjendje *cash*, për t'u përdorur në vitin 2011 për pagesën e kështit të dytë të apartamentit në Durrës.

⁶³ Vendim nr. 31-2022 (JR), datë 27.7.2022, subjekti Gj. K.

⁶⁴ Pra, duke mbartur edhe balancat pozitive të krijuara në vitet paraardhëse.

⁶⁵ Bazuar në nenin 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose valutë të huaj” dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “Në deklarinin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë [...]”. (Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014).

⁶⁶ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm të Apelimit.

praktikës së Kolegjit dhe, si e tillë, nuk mund të konsiderohet nga Komisioni. Për rrjedhojë, kursimet *cash* prej 1.600.000 lekësh nuk u përfshinë në analizën financiare.

2.7. Lidhur me mënyrën e deklarimit të kursimeve në DIPP-të e viteve 2010 – 2015 (shtesë apo gjendje)⁶⁷, Komisioni vëren se: *Së pari*, në procesverbalin e mbajtur në datën 7.12.2012 subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim për sa i përket paqartësive lidhur me deklarimin e shtesave apo gjendjeve të këtyre likuiditeteve, të paktën për vitet 2010 dhe 2011, por këto shpjegime janë dhënë në procesverbalin pasardhës, i mbajtur rreth 4 vite më vonë, në datën 18.7.2016, që daton në një kohë të afërt dhe me lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit. *Së dyti*, në DIPP-të e viteve 2010 – 2015, subjekti ka deklaruar qartësisht shtesa të likuiditeteve *cash*, duke specifikuar se shuma e deklaruar i shtohet kursimeve familjare të deklaruara në vitet paraardhëse. Për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni i konsideroi shumat e deklaruara nga subjekti si shtesa të kursimeve, në përputhje me deklarimet e tij në DIPP-të vjetore.

2.8. Referuar analizës financiare, duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve përgjatë periudhës 2010 – 2016, në shumën totale -6.888.444 lekë.

2.9. Komisioni vëren se edhe nëse analiza financiare do të kryhej bazuar në deklarimin e subjektit se ka deklaruar *gjendje* të kursimeve *cash*, subjekti i rivlerësimit do të gjendej me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale 3.553.894 lekë, për periudhën 2010 – 2016, konkretisht: (i) 226.005 lekë në vitin 2011; (ii) 725.512 lekë në vitin 2014; (iii) 2.602.377 lekë në vitin 2016⁶⁸.

2.10. Më tej, Komisioni analizoi llogaritë bankare për të verifikuar gjendjen e kursimeve *cash* prej 1.300.000 lekësh të deklaruara në datën 25.1.2017 (në fund të vitit 2016 gjendja e deklaruar ka qenë 1.000.000 lekë).

2.11. Pas analizimit të llogarive bankare gjatë periudhës 1.1.2017 – 25.1.2017, gjendja e likuiditeteve *cash* në datën 25.1.2017 përllogaritet në shumën 927.220 lekë, përkundrajt shumës 1.300.000 lekë të deklaruar nga subjekti, pra 372.780 lekë më pak.

2.12. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet se: (i) *Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare gjatë periudhës 2010 – 2016: (a) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën totale 6.888.444 lekë për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shlyerjen e detyrimeve, përgjatë periudhës 2010 – 2016; (b) edhe në rastin e një varianti hipotetik, në të cilin analiza financiare do të kryhej bazuar në deklarimin e subjektit se ka deklaruar gjendjen e kursimeve cash, subjekti dhe personat e lidhur do të kishin mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale 3.553.894 lekë, për periudhën 2010 – 2016, konkretisht: 226.005 lekë në vitin 2011; 725.512 lekë në vitin 2014; 2.602.377 lekë në vitin 2016; (ii) Ka mospërputhje midis shumës së likuiditeteve cash të deklaruar në deklaratën Vetting*

⁶⁷ Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash*.

⁶⁸ E paraqitur e detajuar me zëra, në aneksin nr. 1 – Analiza financiare, në faqen me emërtimin “Tabela nr. 5 dhe paragrafi 2.11”.

në datën 25.1.2017 (1.300.000 lekë) dhe shumës së rezultuar nga përlllogaritjet (927.220 lekë); (iii) Subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 175.000 lekë për shtesën prej 300.000 lekësh të likuiditeteve cash gjatë periudhës 1.1.2017 – 25.1.2017 (diferenca e shtesës me tërheqjet nga llogaria e pagës).

2.13. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se shkresa nr. *** prot., datë 9.1.2024, e ILDKPKI-së⁶⁹, përbën një akt të zyrtar me fuqi të plotë provuese, që provon faktin se në vitin 2010 ka paraqitur krahas DIPP/2009 edhe një dokument me emërtimin “Deklaratë sqaruese”, ku ka sqaruar gjendjen *cash* për periudhën 2003 – 2009. Pra, nëpërmjet këtij akti provohet fakti se ka vënë në dijeni institucionin kompetent mbi pasaktësitë e plotësimit të deklaratave periodike vjetore. Pas kësaj deklarate subjekti sqaron se nuk është pyetur në vitin 2012 nga ILDKPKI-ja për këtë fakt, pasi sipas kësaj të fundit kjo çështje ishte sqaruar tashmë. Ky institucion në kohën kur është pyetur në vitin 2012 për çështje të tjera e dispononte deklaratën sqaruese që në vitin 2010, prandaj, nëse do ta çmonte të rëndësishme, do t'i drejtonte pyetje edhe lidhur me gjendjen *cash* për periudhën 2003 – 2009, sikurse u pyet në vitin 2016. Subjekti pretendoi se deklaratat e pasurisë për vitet 2003 – 2009 duhet të vlerësohen bashkë me shpjegimet e dhëna në vitet 2009 dhe 2016, pasi këto shpjegime në kuptim të ligjit konsiderohen pjesë integrale e deklaratave tashmë të korrigjuara për shkak të plotësimit të gabuar.

2.14. Në lidhje me kursimet prej 2.600.000 lekësh të deklaruara në deklaratën sqaruese të vitit 2009 si kursime deri në fund të vitit 2003, subjekti sqaroi se kjo vlerë i referohet blerjes së apartamentit të deklaruar në DPV/2003. Përshkrimi në tabelën përmbledhëse “2.600.000 lekë banesë” i referohet deklarimit të apartamentit në shumën 2.600.000 lekë. Për këtë arsye, në tabelën përmbledhëse nuk ka deklaruar kursime *cash* në shumën 2.600.000 lekë në fund të vitit 2003, pasi këto kursime nuk mund të ekzistojnë në kurrsesi. Mungesa e likuiditetit dhe kursimeve gjatë vitit 2003 solli për rrjedhojë edhe nënshkrimin e kontratës së shitblerjes në datën 11.5.2004 të apartamentit me sip. 70 m². Subjekti deklaroi se asnjëherë nuk ka pretenduar se në vitin 2003 ka pasur gjende *cash* këtë shumë. Kjo shumë është pasqyruar në rubrikën “Shpenzime” dhe tregon vlerën e apartamentit të porositur, por kurrsesi gjendjen *cash*.

2.15. Në lidhje me kursimet e deklaruara në shumën 3.200.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga dhe të ardhurat e bashkëshortes si avokate, subjekti deklaroi se sipas analizës financiare për periudhën 2005 – 2008 ka pasur mundësi financiare të kursejve shumën 3.200.000 lekë. Kjo shumë, sikurse edhe në shpjegimet shoqëruese të dhëna në DPV/2009, shërbeu si burim krijimi për shlyerjen e kredisë së marrë pranë Bankës Amerikane (sot ISPA). Kursimet për vitet 2005 – 2008 nuk janë deklaruar, por nuk ka logjikë ekonomike që fitimi i vitit 2006, i realizuar nga bashkëshortja në shumën 2.400.000 lekë, të jetë shpenzuar po në këtë vit, e njëjta situatë edhe për vitet vijuese. Për këtë arsye, korrigjimin e deklaratave periodike vjetore sipas shkresës sqaruese të vitit 2009 Komisioni duhet ta konsiderojë provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

⁶⁹ Me lëndë “Kthim përgjigje” drejtuar Komisionit, ku thuhet shprehimisht se: “Deklarata sqaruese e subjektit, z. Madrid Kullolli, e cila mban datën 26.3.2012, është dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.3.2012 së bashku me deklaratën e interesave privatë periodike vjetorë për vitin 2011. Për sa i përket deklaratës tjetër sqaruese të dorëzuar nga z. Kullolli, mund të evidentojmë se është paraqitur në vitin 2010 dhe i është bashkëngjitur deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, por ndodhemi në pamundësi për të përcaktuar datën e saktë të dorëzimit në ILDKPKI”.

Sa rezulton, bazuar në sqarimet e dhëna me deklarinimin e vitit 2009, duhet të përfshihen në analizën financiare kursimet *cash* në vitin 2005 në shumën 500.000 lekë, në fund të vitit 2006 kursime në shumën 2.150.000 lekë, në vitin 2007 gjendja *cash* paraqitet e pandryshuar dhe në vitin 2008 kursimet *cash* kanë qenë në shumën 550.000 lekë, duke disponuar në fund të vitit 2008 shumën prej 3.200.000 lekësh.

2.16. *Lidhur me kursimet prej 1.600.000 lekësh të deklaruara në deklaratën sqaruese të vitit 2009 si gjendje në datën 31.12.2009* dhe që presupozohet se rrjedhin nga periudha 2004 – 2009, subjekti pretendoi se është deklaruar gabim, për arsye se, pasi ishte konsultuar me bashkëshorten për gjendjen e likuiditeteve *cash*, ajo e kishte informuar se kishin gjendje shumën 1.600.000 lekë. Në fakt kjo gjendje *cash* prej 1.600.000 lekësh ka qenë një pjesë e kursimeve të prindërve të bashkëshortes, që rezultonin nga të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 4.4.2006. Sikurse ka deklaruar në pyetësorin standard, nga muaji mars 2004 deri në prill 2015 kanë jetuar me prindërit e bashkëshortes dhe gjyshen e saj, por me shpenzime të ndara, dhe bashkëshortja përdorte ndonjëherë për lehtësi veprimi kursimet e prindërve të saj. Kjo shumë e deklaruar i referohet pikërisht kursimeve të tyre. Subjekti sqaroi se kjo është një pasaktësi në deklarinimin e tabelës përmbledhëse dhe se nuk rezulton në asnjë rast që të ketë pasur mundësi të kursente shumën 1.600.000 lekë në fund të vitit 2009.

2.17. *Lidhur me gjendjen cash për periudhën 2010 – 2015*, subjekti shpjegoi se në deklarinimet e gjendjes *cash* ka pasur parasysh gjendjen në fund të vitit dhe jo shtesën për vitin deklarues. Sikundër ka deklaruar gjatë hetimit, gjendja *cash* në datën 31.12.2014 ka qenë në vlerën 3.250.000 lekë. Subjekti pretendoi se deklarimi në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, se kursimet e krijuara nga viti 2010 e në vazhdim nuk janë shtesa në kursimet në *cash*, por janë gjendje të kursimeve në fund të çdo viti, duhet të konsiderohet si provë në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016. Ky sqarim dhe deklarim është dhënë para se të fillonte procesi i rivlerësimit dhe ka qenë pikërisht sqarimi dhe qëndrimi i të dhënave të deklaruara në DIPP, të cilat do të shërbenin për deklarinimin dhe dorëzimin e deklaratës *Vetting*. Pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 9.300.000 lekë në fund të vitit 2016, nuk është i saktë dhe nuk paraqet situatën reale të këtij viti dhe se në asnjë rast nuk ka deklaruar si burim apo përdorim burimet në *cash* sipas metodologjisë së përlllogaritjes nga Komisioni. Subjekti pretendoi se për periudhën 2010 – 2015 gjendja e kursimeve *cash* duhet të përfshihet në analizë sipas sqarimeve të dhëna në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, nga ku rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme vetëm në vitin 2011, me një balancë negative në shumën 226.005 lekë. Ndërkohë që në vitet e tjera, rezultojnë me balancë pozitive.

2.18. *Lidhur me barrën e provës për gjendjen cash në shumën 1.300.000 lekë, deklaruar në deklaratën Vetting*, subjekti shpjegoi se në analizën e kryer nga Komisioni përgjatë kësaj periudhe nuk është marrë në konsideratë mundësia financiare e tërheqjeve të kryera nga shoqëria “***”. Gjendja e arkës së shoqërisë në datën 31.12.2016, referuar pasqyrave financiare të korrigjuara, është në shumën 915.577 lekë. Kjo shumë monetare e mbajtur në arkë, por dhe arkëtimet nga shërbimet e kryera gjatë muajit janar 2017, kanë krijuar mundësinë financiare për të pasur gjendje *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* shumën prej 1.300.000 lekësh. Depozitimet e kryera nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank në shumat 1.000 euro dhe 60.000 lekë kanë pasur si burim krijimi pikërisht të ardhurat nga aktiviteti, duke tërhequr shumat monetare nga shoqëria me

përgjegjësi të kufizuar. Sipas subjektit, arsyetimi i Komisionit se fitimi i realizuar nga aktiviteti në vitin 2016 ka kaluar për shtimin e rezervave dhe nuk është tërhequr nga bashkëshortja, nuk qëndron, pasi në fillim të vitit 2017 apo në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të tërhequr nga arka apo nga xhiroja e muajit janar shumë prej 372.780 lekësh.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.19. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancën dëgjimore, arsyeton se:

2.20. *Në lidhje me ekzistencën e kursimeve cash në shumën 2.600.000 lekë në fund të vitit 2003*, për të cilat subjekti shpjegoi se nuk i ka pasur gjendje *cash*, por me këtë shumë – të cituar në tabelën përmbledhëse bashkëlidhur deklaratës sqaruese – i është referuar blerjes së apartamentit, Komisioni thekson se në rezultatet e hetimit është përshkruar dhe trajtuar deklarimi i subjektit në tabelën përmbledhëse të deklaratës sqaruese dhe është arritur në konkluzionin që këto kursime nuk kanë ekzistuar në fund të vitit 2003, sikurse pretendon edhe subjekti. Kursimet prej 2.600.000 lekësh nuk janë përfshirë në analizën financiare të rezultateve të hetimit⁷⁰ dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur ndikim në analizën financiare të periudhës 1998 – 2003⁷¹.

2.21. *Në lidhje me kursimet në shumën 3.200.000 lekë*, bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë dhe, sa rezulton, në analizë të këtyre deklaratimeve u analizuan dy elemente përbërëse, vërtetësia e deklaratimeve dhe verifikimi i burimit të ligjshëm për krijimin e këtyre likuiditeteve. Lidhur me elementin e parë, vërehet se subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim në shpjegimet e dhëna në prapësime, sikundër deklaratimet e dhëna në shpjegimet shoqëruese të DIPP-së së vitit 2009. Lidhur me elementin e dytë, pas kryerjes së analizës financiare për vitet 2005 – 2008, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit mbi saktësimin e kursimeve ndër vite dhe vendosi t'i marrë në konsideratë kursimet e deklaruara në shumën 3.200.000 lekë, përgjatë periudhës 2005 – 2008.

2.22. *Në lidhje me pretendimin e subjektit sa i përket ekzistencës së kursimeve cash në shumën 1.600.000 lekë, në datën 31.12.2009* – të cituar në tabelën përmbledhëse bashkëlidhur deklaratës sqaruese – Komisioni nuk i gjen bindëse shpjegimet e tij se këto kursime janë deklaruar gabim nga ana e tij dhe se ato i përkasin prindërve të bashkëshortes, pasi: (i) as në deklaratën sqaruese dhe as në tabelën përmbledhëse shoqëruese nuk evidentohen deklarime lidhur me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, që të mund të justifikonin deklarin e subjektit; (ii) për sa kohë që Komisioni pranoi si provë deklaraten sqaruese bashkëlidhur DIPP/2009, edhe shpjegimet e dhëna në përmbajtjen e tij duhen pranuar në tërësi dhe jo në mënyrë të përzgjedhur, siç pretendon subjekti.

⁷⁰ Paragrafi 2.7 i relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁷¹ Referojuni tabelës së detajuar të paraqitur në aneksin nr. 1, bashkëlidhur relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, ku qartësisht nuk evidentohet asnjë pasuri në likuiditet *cash* në shumën 2.600.000 lekë (zëri “Ndryshim likuiditete” paraqitet me vlerën zero).

Për rrjedhojë, në analizën financiare të subjektit u paraqit shuma prej 1.600.000 lekësh si gjendje e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2009.

2.23. Lidhur me mënyrën e deklarimit të likuiditeteve *cash* gjatë periudhës 2010 – 2015, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim në shpjegimet e dhëna në prapësime sikundër deklarimeve të dhëna në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI në datë 18.7.2016 (para deklaratës *Vetting*), duke shpjeguar se në deklarimet e gjendjes *cash* ka pasur parasysh gjendjen në fund të vitit dhe jo shtesën për vitin deklarues. Pra, kursimet e krijuara nga viti 2010 e në vazhdim nuk janë shtesa në kursimet në *cash*, por janë gjendje të kursimeve në fund të çdo viti.

Komisioni vëren se, në rastin e përlogaritjes së kursimeve *cash* gjatë periudhës 2010 – 2015 si shtesa, krijohet një situatë të palogjikshme në vitin 2016, për shkak të ndryshimit të gjendjes së likuiditeteve nga 10.500.000 lekë (datë 31.12.2015) në 1.000.000 lekë (datë 31.12.2016). Gjithashtu, në skenarin e përlogaritjes së likuiditeteve *cash* si gjendje në fund të vitit, sikurse pretendon subjekti, gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2016 përputhet me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit dhe për efekt të analizës financiare i përlogaritit shumat e deklaruara në DIPP-të e viteve 2010 – 2015 si gjendje në fund të çdo viti kalendarik.

2.24. Lidhur me mospërputhjen e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* me atë të datës 31.12.2016, Komisioni verifikoi gjendjen e zërit “Arka” në pasqyrat financiare të korrigjuara, në datën 31.12.2016, e cila rezultoi në shumën 915.577 lekë⁷². Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit është bindës dhe ka pasur mundësi të krijojë shumën 300.000 lekë gjatë periudhës 1.1.2017 – 25.1.2017.

2.25. Në konkluzion të sa më lart arsyetuar, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarimin e gjendjes së likuiditetit *cash*, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” (sipas leximit *acontrario*) të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, kjo pasaktësi nuk konsiderohet nga Komisioni se afekton vlerësimin e burimeve të ligjshme të krijimit të gjendjes *cash* dhe, për rrjedhojë, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin.

3. Tokë truall me sip. 243 m², në Lagjen Nr. *, Sarandë, në vlerën 116.640 lekë**

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.12.2000, tokë truall me sip. 243 m², ndodhur në z. k. ***, Lagjja Nr. ***, Sarandë. Vlera: 116.640 lekë. Pjesa takuese: 100% familjare. Me burim krijimi pagat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁷³.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se subjekti ka deklaruar truall me sip. 243 m², vlera në milion 0.15 lekë, ndodhur në z. k. ***, Lagjja Nr. ***, Sarandë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak e KRRTSH-së. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet

⁷² E detajuar tek shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të korrigjuara të vitit 2016.

⁷³ Vërtetim hipoteke datë 25.8.2008, vendim i Bashkisë Sarandë datë 16.10.1999, për investim në sheshin e ndërtimit me sip. 243 m² nga investitori Madrid Kullolli; kontratë shitjeje trualli datë 14.12.2000; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.12.2000; pagesa/dokumenti bankar nr. ***, datë 14.12.2000.

familjare. Në deklaratën *Vetting*, ndër të tjera, subjekti ka paraqitur vërtetimin hipotekor datë 25.8.2008, për truallin me sip. 243 m², zona ***, Sarandë, ku është shënuar se ky truall do të përdoret për banesë private⁷⁴.

3.3. ZVRPP Sarandë⁷⁵ konfirmon se z. Madrid Kullolli ka të regjistruar pasurinë truall me sip. 243 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Sarandë. Nga dokumentacioni i administruar⁷⁶ konstatohet se: (i) Bashkia Sarandë, me vendimin datë 16.10.1999, ka miratuar lejen për investim në sheshin e ndërtimit me sip. 243 m² nga investitori Madrid Kullolli. Sipas projektit, objekti që do të ndërtohet do të ketë 2-3 kate mbi tokë. Sipas planimetrisë së objektit “Banesë private, blloku nr. ***, parcela ***”, kati I dhe II ka sipërfaqe ndërtimi 120 m², ndërsa bodrumi ka sipërfaqe ndërtimi 101 m². Gjithashtu janë përcjellë pamje nga ana kryesore e godinës, anësore dhe lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë, në datën 18.4.1999 ka dhënë leje për ndërtim të përkohshëm për *Objekt i përkohshëm “Rrethim truall”*, me investitor Madrid Kullolli. Leja e ndërtimit jepet me kusht që të ndërtohet me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton arme, blloqe betoni, muraturë ose soleta. Shkelja e kushteve të kësaj lejeje e bën atë të pavlefshme; (ii) Në datën 1.6.2000 është nënshkruar kontratë ndërtimi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “****” Sarandë, për ndërtimin e objektit “banesë private” sipas projekt zbatimit të paraqitur dhe planimetrisë së miratuar nga organet kompetente. Konkretisht, shoqëria do të kryejë punime gërmimi dhe ndërtimi në vëllim dhe në lloje sipas preventivit bashkëlidhur kontratës. Vlera e punimeve të objektit është 5.890.745 lekë. Afati i ndërtimit të objektit është 6 muaj. Subjekti duhet të dorëzojë brenda datës 2.6.2000 lejen e ndërtimit, planimetrinë shesh ndërtimi dhe projekt zbatimin. Marrëdhëniet financiare midis palëve do të mbahen si vijon: brenda datës 15.6.2000 do të arkëtohet në arkën e shoqërisë 30% dhe brenda datës 15.12.2000 do të arkëtohet 70% e vlerës. Bashkëlidhur preventiv punimesh për objektin “Banesë Blloku *** parcela ***”, në shumën 1.582.682 lekë; (iii) Me anë të procesverbalit datë 12.9.2000, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, zyra e Urbanistikës së Bashkisë Sarandë ka kryer piketimin e parcelës ***; (iv) Në datën 14.12.2000 është lidhur kontratë shitjeje, me palë shitëse Bashkia Sarandë dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, referuar së cilës trualli me sip. 243 m², që do të përdoret për banesë private, është shitur në vlerën 116.640 lekë⁷⁷. Shitja bazohet në ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995, në vendimin e KRT-së së Bashkisë nr. ***, datë 25.8.1999, vendimin e Bashkisë nr. ***, datë 28.8.1999 dhe në sheshin e ndërtimit që individualizon truallin që është objekt shitje. Nga hetimi janë administruar dy mandatarkëtime pranë ish-Bankës së Kursimeve, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht: (a) mandatarkëtimi datë 14.12.2000, shuma 116.873 lekë⁷⁸, me përshkrimin “Blerje truall nga bashkia”; (b) mandatarkëtimi datë 14.12.2000, shuma 36.035 lekë, me përshkrimin “Leje ndërtimi nga bashkia”; (v) Në datën 15.12.2000 është hartuar kontrata noteriale e shitblerjes nr. ***, për

⁷⁴ Origjina e regjistrimit të pasurisë nr. hip. ***, datë 15.12.2000.

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2017, lëshuar nga ZQRPP-ja, drejtuar ILDKPKI-së (fillimisht ZVRPP Sarandë me shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2017, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka pasur të regjistruar pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit truall me sip. 243 m², regjistruar me nr. *** dok., transkriptuar në favor të shtetasit P. G. me nr. ***. E pyetur përsëri nga ILDKPKI-ja, ZVRPP Sarandë, me *email*-in e datës 7.11.2019, ka konfirmuar se subjekti ka të regjistruar këtë pasuri, ku mbi këtë truall nuk ka asnjë objekt dhe me *email*-in e datës 8.11.2019 ka përcjellë kartelën e pasurisë, ku figuron vetëm trualli me sip. 243 m² dhe nuk rezulton të jetë pasuri e transkriptuar apo të ketë qenë në pronësi të shtetasit P. G.).

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2017, lëshuar nga ZQRPP-ja, drejtuar ILDKPKI-së.

⁷⁷ Pagesa e truallit është bërë me dokumentin bankar nr. ***, datë 14.12.2000.

⁷⁸ Çmimi i kontratës 116.640 lekë dhe komision bankar 233 lekë.

truall me sip. 243 m² në vlerën 116.640 lekë dhe po në këtë datë subjekti ka bërë kërkesë për regjistrimin e pasurisë truall për ndërtim me sip. 243 m², blerë nga shteti.

3.4. ZVRPP Sarandë, me anë të postës elektronike, i ka konfirmuar ILDKPKI-së se mbi këtë truall nuk ka asnjë objekt. Komisioni vëren se, referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se subjektit i është dhënë kjo pasuri shtet nga Bashkia Sarandë me anë të kontratës së shitjes datë 14.12.2000 dhe kontratës noteriale nr. ***, datë 15.12.2000, në shumën 116.640 lekë dhe do të përdoret për ndërtimin e një banese private 2-3 kate, sipas projektit të paraqitur nga subjekti.

3.5. Me anë të pyetësorit nr. 1⁷⁹, subjektit iu kërkua të deklarojë gjendjen aktuale të kësaj prone, nëse mbi të është ndërtuar/investuar apo dhënë më qira deri më tani, duke vendosur në dispozicion koordinatat gjeografike të kësaj prone në *google maps*. Më tej, iu kërkua shpjegime se përse mbi këtë pronë nuk është ndërtuar/investuar sipas kushteve në kontratën e shitjes datë 14.12.2000 dhe kontratës noteriale nr. ***, datë 15.12.2000. Në përgjigje⁸⁰, subjekti deklaroi se mbi këtë pronë nuk është ndërtuar dhe ajo nuk është dhënë asnjëherë me qira. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2023, të lëshuar nga Bashkia Sarandë, ku rezulton se pas verifikimit nga inspektorët e IVMT-së, në adresën e kërkuar për parcelën nr. *** në Bllokun nr. *** në zonën ***, kjo pronë rezulton hapësirë e pandërtuar, duke bashkëlidhur ortofotot e marra nga ASIG-u dhe një fotografi ilustruese e gjendjes aktuale të pamjes në terren, në datën 10.11.2023. Më tej, subjekti deklaroi se sheshi i ndërtimit është dhënë nga Këshilli i Rrethit Sarandë për shkak se rezultonte i pastrehë, ndërkohë që në këtë shesh nuk kishte asnjë rrjet infrastrukturor (rrugë, ujë, energji, kanalizime etj.), sikurse vijon aktualisht. Në fund të vitit 2000 është transferuar për të ushtruar funksionin në një rreth tjetër, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Skrapar dhe nevoja për banim ndryshoi e, në këto kushte, kjo pronë nuk u zhvillua.

3.6. Nga këqyrja e ortofotove të paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 1, si dhe atyre të administruara gjatë hetimit nga ASIG-u (ortofotot e viteve 2007 dhe 2015)⁸¹, vërehet se mbi këtë sipërfaqe toke nuk është ndërtuar dhe investuar nga ana e subjektit. Gjithashtu, rezulton e provuar se në datën 7.12.2000 subjekti është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Skrapar, çka përputhet me deklaratimet e tij. Me anë të pyetësorit nr. 3⁸², subjektit iu kërkua sërish të vendosë në dispozicion koordinatat gjeografike të kësaj prone në *Google Maps*. Në përgjigje⁸³, subjekti deklaroi se koordinatat gjeografike janë 502223.71 dhe 4413390.6, referuar plan-rilevimit të paraqitur.

3.7. Në vijim, referuar burimit të krijimit (paga dhe kursimet familjare), Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 16.1.1998 – 14.12.2000, për të pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, duke konsideruar: (i) të ardhurat e subjektit nga paga⁸⁴; (ii) shpenzimet e jetesës⁸⁵; (iii) pagesat e kryera pranë ish-Bankës së Kursimeve për blerjen e tokës

⁷⁹ Email datë 17.11.2023, ora 12:41.

⁸⁰ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.11.2023.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2023, ASIG.

⁸² Email datë 19.1.2024, ora 10:01.

⁸³ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.1.2024.

⁸⁴ Vërtetim nr. ***, datë 26.4.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

⁸⁵ Shpenzimet e jetesës u përllogaritën si në vijim: (i) për periudhën 1997 – 1999, në kuadër të arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (vendim nr. 15-2021, datë 18.6.2021, paragrafët 21.40 - 21.42), 30% të të ardhurave të subjektit (pagë vjetore mbi 800 USD); (ii) bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, për periudhën 2000 – 2016 (në mungesë të të

dhe lejen e ndërtimit⁸⁶, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e truallit në Sarandë.

3.8. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me faktin se përse nuk është realizuar qëllimi për të cilin është përfituar kjo pasuri nga bashkia, pra ndërtimi i një banese.

3.9. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se në fund të viti 2000, për nevoja të punës (pa dëshirën e tij), është transferuar me detyrë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Skrapar, duke bërë të pamundur realizimin e qëllimit për ndërtimit e banesës, pasi ideja për të jetuar në Sarandë pas transferimit ishte e pamundur.

3.10. Në përfundim, Komisioni vëren se bazuar në faktet e sipërpërmendura përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit për sa i përket kësaj pasurie.

4. Apartament me sip. 70 m², në rrugën “**”, Tiranë, në vlerën 3.066.000 lekë**

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me sip. 70 m², i ndodhur në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, shkalla nr. ***, Tiranë. Kontrata nr. ***, datë 11.5.2004, me vlerë 3.066.000 lekë. Pjesa takuese: 100% familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁸⁷.

4.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar banesë me sip. 70 m², në vlerën 2.600.000 lekë, rruga “****”. Burimi i krijimit: kursimet familjare. Pjesa takuese: 50%. Në DIPP/2004, subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram lidhur me këtë apartament. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 1.10.2001, sipërmarrës shoqëria “****” sh.p.k., porosites subjekti i rivlerësimit, për apartament 1+1 me sip. 70 m², rruga “****”, në vlerën 26.000 USD, nga të cilat 10.000 USD do të paguheshin me nënshkrimin e kontratës dhe 16.000 USD sipas një grafiku të caktuar nga të dyja palët. Kontrata e shitjes nr. *** është nënshkruar në datën 11.5.2004, kundrejt çmimit 3.066.000 lekë, shumë e cila është likuiduar e tëra *cash*. Sipas vërtetimit të hipotekës nr. ***, ky apartament deri në datën 30.9.2003 figuronte i regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. Më pas, referuar vërtetimit të hipotekës nr. ***, datë 4.6.2004, apartamenti është regjistruar në emër të subjektit Madrid Kullolli dhe personit të lidhur B. P..

dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit pasardhës, ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, së INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

⁸⁶ Bashkëlidhur dokumentacionit të administruar me shkresën e ZQRPP-së nr. *** prot., datë 9.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së, janë administruar dy mandatarkëtime pranë ish-Bankës së Kursimeve, konkretisht: (i) mandatarkëtimi datë 14.12.2000, shuma 116.873 lekë, me përshkrimin “Blerje truall nga bashkia”; (ii) mandatarkëtimi datë 14.12.2000, shuma 36.035 lekë, me përshkrimin “Leje ndërtimi nga bashkia”.

⁸⁷ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 1.10.2001; kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme apartament nr. ***, datë 11.5.2004; vërtetim hipoteke në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.; harta treguese të regjistrimit; planimetria, vërtetim hipoteke në emër të z. Madrid Kullolli dhe znj. B. P., shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit.

4.3. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së⁸⁸, konfirmohet pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 70 m², në emër të shtetasës B. P.⁸⁹. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti është pyetur lidhur me faktin se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar vlerën 2.600.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti, ndërkohë që referuar dokumentacionit të administruar rezultojnë në shumën 3.066.000 lekë. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se vlera e apartamentit është shënuar 2.600.000 lekë, pasi në datën e dorëzimit të deklaratës, 31.3.2004, nuk ishte përpiluar ende kontrata e shitblerjes. Ndërkohë që në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 1.10.2001, ishte paracaktuar çmimi në shumën 26.000 USD. Nisur nga fakti se në momentin e deklarimit në vitin 2004 kursi i këmbimit të lekut me dollarin ishte 1 me 1 dhe nisur nga fakti që në deklaratë ishte rubrika në milion/lekë, është bërë shënimi 2.6 milionë lekë, duke marrë për bazë vlerën e kontratës së sipërmarrjes, ndërkohë që kontrata e shitblerjes mban datën 11.5.2004, në vlerën 3.066.000 lekë.

4.4. Shoqëria “****” sh.p.k.⁹⁰ përcolli pranë Komisionit kontratën e sipërmarrjes nr. *** dhe kontratën e shitjes nr. ***, ndërsa lidhur me dokumentacionin provues të pagesës së çmimit sqaroi se nuk e disponon për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

4.5. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2001⁹¹ (vitin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes) në qytetin e Tiranës, nga ku rezultoi se çmimi ka qenë në shumën 56.306 lekë/m². Për pasojë, apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 3.941.420 lekë⁹², përkundrejt çmimit prej 3.681.080 lekësh të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes⁹³.

4.6. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike, FSHU-ja⁹⁴ bën me dije se në emër të subjektit është regjistruar kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. ***⁹⁵, kategoria “Familjare”, me adresë “****, ***, **”, Tiranë, e regjistruar në datën 10.3.2003. Lidhur me kontratën e furnizimit me ujë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁹⁶, subjekti paraqiti fotokopje të faqes së parë të librezës së furnizimit me ujë nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me nr. ***, e regjistruar në emër të tij.

4.7. Për sa i përket momentit të fillimit të banimit në këtë apartament, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti deklaroi se për herë të parë në këtë banesë ka jetuar një periudhë të shkurtër 4-5 mujore në fillim të vitit 2006. Komisioni vëren se kjo adresë është deklaruar: (i) si adresë banimi në deklaratat e viteve 2003 – 2006, 2013 – 2014, vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) si adresë e gjendjes civile në deklaratat e viteve 2007 – 2012 dhe të vitit 2015.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2021.

⁸⁹ Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, me shkresën nr. *** prot., datë 30.8.2017, në të dhënat e kartelës së pasurisë, datë 25.2.2021, ky apartament figuron i regjistruar në emër të dy bashkëshortëve Madrid Kullolli e B. P., regjistruar në datën 30.9.2009.

⁹⁰ Shkresë datë 10.11.2023, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 13.11.2023.

⁹¹ Udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001, i Këshillit të Ministrave.

⁹² Sip. 70 m² x 56.306 lekë = 3.941.420 lekë.

⁹³ Çmimi 26.000 USD, vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e nënshkrimit të kontratës, 1 USD = 141,58 lekë.

⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁹⁵ Konfirmuar edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

⁹⁶ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.11.2023.

4.8. Lidhur me shpenzimet e arredimit/mobilimit, në përgjigje të pyetësorit standard⁹⁷, subjekti deklaroi se ka shpenzuar 200.000 lekë gjatë vitit 2005 dhe 200.000 lekë gjatë vitit 2006 dhe se nuk ka ruajtur dokumentacion.

4.9. Nga hetimi i Komisionit⁹⁸ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “***” sh.p.k.⁹⁹.

4.10. *Analiza e datave të kryerjes së pagesës* – Komisioni vëren se në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 1.10.2001, është parashikuar se nga çmimi total prej 26.000 USD shuma 10.000 USD do të paguhej me nënshkrimin e kontratës dhe 16.000 USD sipas një grafiku të caktuar nga të dyja palët.

4.11. Me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰⁰, subjektit iu kërkua të specifikojë datën e kryerjes së pagesës/pagesave për shumën 16.000 USD (data e pagesës së shumës 10.000 USD është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes), shoqëruar me dokumentacion ligjor provues. Në përgjigje¹⁰¹, subjekti deklaroi se në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes është kryer një pagesë në shumën 3.000 USD, në vitin 2003 janë paguar 7.000 USD dhe pagesa e fundit është kryer në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes në vitin 2004, në shumën 16.000 USD. Pagesat janë kryer *cash* dhe nuk ka ruajtur mandatpagesa, por vetëm kontratën. Subjekti sqaroi se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, gabimisht nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj ndërtuesit, por vetëm vlerën e plotë të kontratës së sipërmarrjes për shkak të paqartësive që ka pasur në lidhje me plotësimin e saj.

4.12. Sa më lart, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues të datës së pagesës (mandatarkëtim/mandat bankar), Komisioni, për efekt të analizës financiare, përcaktoi datat e kryerjes së pagesave si në vijim: (i) Për shumën 10.000 USD u konsiderua që pagesa është kryer në datën 1.10.2001, referuar parashikimit në kontratën e sipërmarrjes të datës 1.10.2001; (ii) Për shumën 16.000 USD u konsiderua që pagesa është kryer më 31.12.2003, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 (vit në të cilin është deklaruar kjo pasuri) subjekti nuk ka deklaruar detyrim të mbetur pa paguar, çka nënkupton që pagesa është kryer plotësisht e gjithashtu, referuar shpjegimeve të dhëna në procesverbalin e ILDKPKI-së, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 subjekti ka deklaruar vlerën e plotë të kësaj pasurie. Po kështu, deklarimi i subjektit në pyetësorin nr. 1 se në vitin 2004 janë paguar 16.000 USD, nuk mbështetet me deklarinë në DIPP/2004, pasi në këtë të fundit nuk është kryer asnjë deklarim lidhur me këtë apartament.

4.13. *Burimi financiar i krijimit* – Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet familjare. Ndërkohë që në pyetësorin standard¹⁰² subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës që kishte porositur këtë banesë në vitin 2001, vëllai i tij i ka dërguar (dhuruar) me Western Union afërsisht

⁹⁷ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 1.2.2021.

⁹⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

⁹⁹ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

¹⁰⁰ Email datë 17.11.2023, ora 12:41.

¹⁰¹ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.11.2023.

¹⁰² Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 1.2.2021.

2.000 euro dhe, më tej, në vitin 2002, kur ka ardhur në Shqipëri, i ka dhënë (dhuruar) 1.000 euro *cash*.

4.14. Duke qenë se ky burim nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike, me anë të pyetësorit nr. 1 subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion provues nga Western Union lidhur me dërgesat e përmendura, si dhe deklaratë konfirmuese nga dhuruesi, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues lidhur me të ardhurat e vëllait që kanë shërbyer si burim për dhurimin e deklaruar. Në përgjigje, subjekti deklaroi se është interesuar pranë Western Union dhe e kanë informuar se nuk disponojnë dokumentacion për një kohë kaq të gjatë. Ky burim nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*, për shkak se është harruar si veprim dhe se në vitet 2001 – 2002 nuk kishte deklarata periodike për deklarimin e pasurisë, shpjegoi subjekti¹⁰³. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.10.2021, të lëshuar nga vëllai G. K., i cili ka deklaruar se për banesën e porositur i ka dërguar subjektit në vitin 2001 shumën 2.000 euro me Western Union dhe në vitin 2002 – kohë në të cilën ka ardhur në Shqipëri – i ka dhuruar sërish shumën 1.000 euro, duke e ndihmuar të plotësonte pagesën e kësteve. Më tej, deklaroi se në vitin 2004 i ka dhënë hua një shumë prej 1.000.000 lekësh, për të cilat ai kishte nevojë për pak muaj, të cilën ia ka kthyer sërish brenda vitit 2004. Për të provuar të ardhurat e vëllait, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor justifikues (me vulë apostile) nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në shtetin italian (INPS) për shtetasin G. K. dhe bashkëshorten e tij G. C., si dhe ekstrakt të aktit të martesës së këtyre të shtetasve (data e lidhjes së martesës 1.10.2002).

4.15. Nga analizimi i deklarimeve dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se: (i) Për herë të parë deklarimi i një dhurimi si burim për blerjen e kësaj pasurie është bërë në pyetësin standard, në datën 1.2.2021, ndërkohë që subjekti i rivlerësimi i ka pasur të gjitha mundësitë që ta shpjegonte këtë situatë së paku në deklaratën *Vetting* 2017, sipas kërkesave ligjore lidhur me deklarimin e burimit të pasurive; (ii) Subjekti nuk paraqiti dokumentacion për të provuar deklarimin e tij lidhur me dërgimin e shumës 2.000 euro në vitin 2001 nga vëllai, nëpërmjet Western Union; (iii) Periudha e parë e punësimit e vëllait të subjektit në shtetin italian i përket periudhës 1.1.2001 – 31.12.2001, ku janë realizuar të ardhura bruto në shumën 223 euro, ndërkohë që shpenzimet e jetesës për vitin 2001, sipas të dhënave statistikore¹⁰⁴, kanë qenë 6.240 euro/person. Më tej, në vitin 2002 ka realizuar të ardhura bruto në shumën 3.729 euro, ndërkohë që shpenzimet e jetesës përllogariten në masën 7.210 euro/person¹⁰⁵. Kjo situatë financiare nuk duket të ketë qenë e favorshme për dhurimin e një shume prej 3.000 euro. Ndërsa të ardhurat e shtetasve G. C. nuk u konsideruan në këtë analizë, pasi lidhja e martesës daton më 1.10.2002.

4.16. Për rrjedhojë të sa më lart, ky dhurim i deklaruar *nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si burim për blerjen e këtij apartamenti*.

4.17. Në vijim, *lidhur me këstin e parë prej 10.000 USD*, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 15.12.2000 – 1.10.2001, duke konsideruar: (i) balancën pozitive të rezultuar nga analiza

¹⁰³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti paraqiti në cilësinë e provës komunikimet elektronike më anë të *email*-it me qendrën e shërbimit të klientit, duke kërkuar t'i vendosej në dispozicion një kopje e mandat transferues së kryer. Në përgjigje është bërë me dije nga Western Union se nuk disponohet informacioni i kërkuar.

¹⁰⁴ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01_custom_9087093/default/table?lang=en

¹⁰⁵ Në mungesë të të dhënave për vitet 2002 dhe 2003 u konsiderua mesatarja e të dhënave për vitin 2001 (viti paraardhës për të cilin disponohen të dhëna) dhe vitit 2004 (viti pasardhës për të cilin disponohen të dhëna).

financiare për periudhën 16.1.1998 – 14.12.2000; (ii) të ardhurat e subjektit nga paga¹⁰⁶; (iii) shpenzimet e jetesës¹⁰⁷; (iv) pagesa e këstit të parë prej 10.000 USD¹⁰⁸, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 440.370 lekë.

4.18. Në vijim, *lidhur me këstin e dytë prej 16.000 USD*, Komisioni vëren se në datat 6.10.2003 dhe 12.12.2003, pra përpara pagesës së këtij kësti, subjekti ka kryer dy pagesa për blerjen e njësisë në Tiranë, pasuri kjo e trajtuar në pikën 5 të këtij vendimi.

4.19. Në kushtet që nga analiza e periudhës tetor 2001 – nëntor 2003¹⁰⁹ rezultoi një balancë negative, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën vijuese, pra për muajin dhjetor 2003, ku u konsideruan: (i) të ardhurat e subjektit nga paga¹¹⁰; (ii) të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si person fizik, në mënyrë përpjesëtimore për 1 muaj¹¹¹; (iii) shpenzimet e jetesës¹¹²; (iv) pagesa e këstit të parë prej 16.000 USD¹¹³, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 1.399.220 lekë.

4.20. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën totale prej 1.839.590 lekësh për pagesën e kësteve prej 26.000 USD për blerjen e apartamentit në Tiranë.*

4.21. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, pretendoi që të merren në konsideratë shpjegimet që ka dhënë gjatë hetimit lidhur më mënyrën e likuidimit të apartamentit, duke sqaruar së në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 gabimisht nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj ndërtuesit, por vetëm vlerën e plotë të kontratës së sipërmarrjes, për shkak të paqartësive që ka pasur në lidhje me plotësimin e saj. Subjekti deklaroi se me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes është kryer një pagesë prej 3.000 USD, ndërkohë që pjesa tjetër është likuiduar në dy këste të tjera, 7.000 USD gjatë vitit 2003 dhe pagesa e këstit kryesor prej 16.000 USD është kryer në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes datë 11.5.2004. Parashikimi në kontratë lidhur me pagesën e këstit të parë është për shkak të “Kontratës tip”, e cila është përdorur nga subjekti “***” si “Kontratë model”, me qëllim grumbullimin e një pjese të mirë të vlerës së kontratës që në fillim të marrëveshjeve të sipërmarrjes, por që nuk ishte detyruese për palët deri në momentin që mes

¹⁰⁶ Vërtetim nr. ***, datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁰⁷ Shpenzime e jetesës u përllogaritën: (i) për një person për vitin 2000 (në mënyrë përpjesëtimore për 0,5 muaj); (ii) për 2 persona për periudhën janar – shkurt 2001 (subjekti dhe bashkëshortja) dhe për 3 persona për periudhën mars – shtator 2001 (subjekti, bashkëshortja, vajza) – bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. ***, datë 4.3.2019.

¹⁰⁸ Shuma prej 10.000 USD u vlerësua me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 1.10.2001, kursi i këmbimit 1 USD = 141,58 lekë.

¹⁰⁹ Në kushtet që burimi i deklaruar “*Të ardhura dhe kursime familjare*” është i njëjtë për të gjithë këto pagesa, Komisioni fillimisht kreu analizën financiare për periudhën tetor 2001 – nëntor 2003, referuar pagesave për blerjen e njësisë në Tiranë.

¹¹⁰ Vërtetim nr. ***, datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹¹¹ 1 muaj x 1.800.000 lekë/9 muaj total aktivitet për këtë vit.

¹¹² Shpenzime e jetesës u përllogaritën për 3 persona për periudhën dhjetor 2003 (subjekti, bashkëshortja, vajza) – bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹¹³ Shuma prej 16.000 USD u përllogarit si diferencë e çmimi të përcaktuar në kontratën e shitjes (3.066.000 lekë) me shumën e këstit të parë (1.415.800 lekë).

tyre ekzistonte marrëveshja dhe vullneti për realizimin e kontratës, sikurse edhe nga vetë kontrata rezulton klauzola se pagesat do kryhen sipas një grafiku të hartuar midis palëve.

4.22. Subjekti deklaroi se: *“Komisioni gjendet vërtet në “dyshim të bazuar” kur citon DIPP/2003, deklaratë e cila është plotësuar në dy faza. Këto dy faza shpjegohen edhe nga shënimet e ndryshme të gjendura në DIPP/2003, ku në datën 14.3.2004 me makinë shkrimi unë, në cilësinë e subjektit deklarues, kam hartuar dhe dorëzuar deklaratën DIPP me shënimin e vetëm të një pasurie, atë të “parcelë 243 m² gjendur në Sarandë”, shiko faqen 3 të DIPP/2003 (duke iu referuar vetëm pasurive të regjistruara në ZRPP). Ndërkohë, kujtoj që nga ana e institucionit (ish) ILDKPKI janë paraqitur përfaqësues të tyre në ambientet e punës (pra në Prokurorinë e Rrethit Durrës) dhe kanë kryer saktësimin e deklaratave për të gjithë deklaruesit, duke na kërkuar që të shtonim ose korrigjonim pjesë të deklaratës lidhur me shtimin për shembull në rastin tim të çdo pasurie të fituar para vitit 2003, ose për të cilën ishin përmbyllur marrëveshjet e sipërmarrjes deri në datën që bëhej saktësimi etj. Sikurse ishte edhe rasti për banesën time, apartamentin 70 m² në rrugën “***”, Tiranë. Në kohën që unë i shpjegoj inspektorit se kam lidhur një marrëveshje sipërmarrjeje për një apartament në vitin 2001 dhe nuk e kam shënuar banesën time në deklaratë, pasi në vitin 2003 nuk e kam fituar pronësinë mbi banesën për arsye se nuk e kisha paguar çmimin e saj dhe nuk është lidhur kontrata e shitjes së pronës, por nga ana tjetër në momentin që kam diskutuar me inspektorin ishin kryer të gjitha pagesat. Kujtoj se inspektori më ka orientuar që është saktësisht momenti për ta shtuar si pasuri të vitit 2003. Nisur nga përvoja e pakët në plotësimin e deklaratës, nisur nga fakti se ligji sapo kishte hyrë në fuqi, kam plotësuar me shkrim dore tashmë, në prani të inspektorit, mbi deklaratën e hartuar më herët “Banesë 70 m²”, lidhur me çmimin, është vendosur shënimi 2.6, duke argumentuar mbi çmimin e porositur, pasi kontratën e shitjes nuk e kisha fizikisht për të parë se sa kishte rezultuar konvertimi i saj në lekë dhe nga ana e inspektorit orientohem se USD është i barabartë me lekun, kështu që jemi në rregull nëse deklarojmë shumën 2.6 lekë [...]”* Subjekti deklaroi se të njëjtat shpjegime ka dhënë edhe në procesverbalin e mbajtur në datën 18.7.2016 pranë ILDKPKI-së.

4.23. Në cilësinë e provës paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.2.2024, të lëshuar nga shtetasi G. K., administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., i cili deklaroi se në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes subjekti ka paguar një shumë modeste prej 3.000 USD dhe u vonua në kryerjen e pagesës prej 16.000 USD, sikurse ishte parashikuar në kontratë, dhe përbushjen e detyrimit. Për shkak të vonesës në përbushjen e pagesës së detyrimit të mbetur, kontrata përfundimtare e shitblerjes u nënshkrua midis palëve në maj të vitit 2004, pasi u shlye plotësisht detyrimi kontraktor. Subjekti sqaroi se ka shlyer fillimisht pagesat për blerjen e njësisë me sip. 40 m² në datën 6.10.2003, në shumën 25.000 USD dhe në datën 12.12.2003, në shumën 11.000 USD. Pasi ka likuiduar vlerën e njësisë, në kushtet kur shoqëria “***” sh.p.k. kërkonte likuidimin e shumës 16.000 USD, i është drejtuar vëllait duke i kërkuar hua shumën monetare prej 8.000 USD.

4.24. *Lidhur me burimin e krijimit*, subjekti pretendoi që në analizën financiare për periudhën 16.1.1998 deri në fund të vitit 2003 duhet të përfshihen këto të ardhura: (a) Dy depozitat në llogarinë bankare të bashkëshortes pranë ABI Bank në monedhën drahami, konkretisht 775.000 GRD në datën 4.9.2000 dhe 400.000 GRD në datën 3.12.2000 (tërhequr në datat 30.1.2001 dhe 16.8.2001). Këto të ardhura janë depozituar në bankë përpara se subjekti të lidhte martesë ligjore me bashkëshorten. Ndërsa në momentin e tërheqjes këto fonde janë përdorur për nevoja familjare

(shihni Sevdari, §88). (b) Të ardhurat e bashkëshortes për periudhën 20.3.2000 – 25.12.2000. Për të vërtetuar marrëdhënien e punësimit, subjekti paraqiti në cilësinë e provës shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2024, të Drejtorisë Vendore ASHK Sarandë¹¹⁴ dhe librezën e punës së bashkëshortes. Për sa i takon pagesës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat personale, deklaroi se ky është detyrim i punëdhënësit. (c) Shumat e dhuruara *cash* nga vëllai në vitin 2001 prej 2.000 euro dhe në vitin 2002 prej 1.000 euro, të deklaruara në pyetësin standard. Subjekti shpjegoi se vëllai G. K. ka lidhur martesë ligjore me shtetasen italiane G. C. në datën 1.10.2002, por ndërkohë përpara kësaj periudhe kanë qenë të fejuar dhe kanë jetuar së bashku, duke pasur një ekonomi familjare. Në cilësinë e provës paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.2.2024, të lëshuar nga shtetasja italiane G. C.¹¹⁵ dhe të ardhurat e realizuara nga kjo shtetase, për periudhën 1990 – 2003.

4.25. Në përfundim, subjekti kërkoi që shuma 16.000 USD të pasqyrohet si shpenzim në vitin 2004 dhe jo në vitin 2003 dhe se deri në fund të vitit 2003 rezulton me një balancë negative në shumën 449.063 lekë, balancë e cila vjen si rrjedhojë e aktivitetit të bashkëshortes si asistente avokate që prej vitit 1999 deri në momentin e regjistrimit si person fizik (për periudhën 1999 - 2003 ka punuar si asistente avokate e palicencuar dhe ka siguruar gjatë kësaj periudhe të ardhura sipas deklarimeve).

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.26. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.27. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues lidhur me datat e kryerjes së pagesave, Komisioni iu referua parashikimeve në kontratën e sipërmarrjes dhe deklarimeve të subjektit në DPV-në e viteve 2003 dhe 2004¹¹⁶. Por, vërehet se gjatë hetimit dhe në përgjigje të prapësimeve subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me këstet për pagesën e apartamentit, duke deklaruar se në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në vitin 2001 ka kryer pagesën prej 3.000 USD, në vitin 2003 ka paguar 7.000 USD dhe se pagesa e fundit prej 16.000 USD është kryer në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, në vitin 2004.

¹¹⁴ Drejtoria Vendore ASHK Sarandë informon se gjatë vitit 2000 rezulton se paga mujore e një specialisti jurist për periudhën 1.1.2000 – 31.12.2000 pranë ish-ZVRPP Sarandë, është në shumën 13.300 lekë.

¹¹⁵ E cila deklaron se është fejuar me bashkëshortin G. K. në pranverën e vitit 2000 në ***, Itali. Pasi janë njohur kanë bashkëjetuar për rreth dy vite dhe në fund të vitit 2002 kanë lidhur martesë. Gjatë kohës që kanë bashkëjetuar kanë mbajtur një ekonomi të përbashkët dhe kanë jetuar në një banesë që i përkiste në pronësi familjes së saj. Në këtë periudhë kujton se G. dëshironte t'i dërgonte vëllait të tij Madrid Kullollit në Shqipëri një sasi modeste parash dhuratë dhe një pjesë si hua. Deklaron se është në dijeni se G. i ka dërguar rreth 2.000 euro me transfertë dhe se më pas ka ardhur në Shqipëri dhe siç i ka thënë i ka dhuruar 1.000 euro të tjera, gjithsej 3.000 euro dhuratë dhe ndërkohë, në vitin 2004, ka dijeni se kanë pasur një marrëdhënie huaje për gjatë atij viti, pasi nevojiteshin për të kryer pagesën e një banese, të cilat janë kthyer brenda vitit dhe huaja e dhëna nga G. ka qenë në shumën 8.000 euro. Shtetasja G. C. deklaron se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të jetuar me bashkëshortin edhe gjatë fejesës, sikurse ai punonte gjatë gjithë kohës herë si i siguruar edhe herë si i pasiguar.

¹¹⁶ Në DIPP/2004 nuk është kryer asnjë deklaram lidhur me shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj ndërtuesit për blerjen e këtij apartamenti.

Duke marrë në konsideratë: (i) deklaratimet e administratorit të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., i cili konfirmoi pretendimet e subjektit lidhur me pagesat e kryera¹¹⁷; (ii) faktin se në kontratën e sipërmarrjes ka qenë e përcaktuar se vlera 16.000 USD do të paguhej sipas një grafiku të caktuar nga të dyja palët dhe nuk ka qenë e cituar se do të paguhej në vitin 2003; (iii) gjithashtu në kontratën e shitjes nuk ka përcaktime lidhur me datat e pagesave; dhe se (iv) kontrata e shitjes është lidhur në datën 11.5.2004 dhe jo në vitin 2003 – Komisioni vlerëson të konsiderojë shpjegimet e subjektit lidhur me pretendimet se pasaktësitë në plotësimin e deklaratave kanë ardhur si rezultat i paqartësive në lidhje me plotësimin për herë të parë të deklaratës se pasurisë së vitit 2003 dhe se gabimisht ka deklaruar vlerën e plotë të kontratës së sipërmarrjes dhe nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj ndërtuesit.

4.28. Sa rezulton, Komisioni vendosi që për efekt të analizës financiare të përlllogarisë datat e kryerjes së pagesave sipas deklaratimeve të subjektit dhe administratorit të shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., pra, në vitin 2001 pagesa në shumën 3.000 USD, në vitin 2003 pagesa në shumën 7.000 USD dhe në vitin 2004 pagesa në shumën 16.000 USD.

4.29. Për sa i përket burimit të krijimit, Komisioni vlerëson sa vijon:

i) Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit sa i takon justifikimit të burimit të të ardhurave nga emigracioni i bashkëshortes në Greqi, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se ato mbeten në kuadrin deklarativ dhe të pambështetura në prova. Kolegji tashmë ka jurisprudence të konsoliduar në drejtim të fakteve të cilat do të duhet të provohen, me qëllim që të justifikohen si të ardhura të ligjshme dhe, për rrjedhojë, të shërbejnë si burim i ligjshëm. Gjithashtu, në zbatim të nenit 32 të pikës 1 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 21 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016¹¹⁸, përcaktohet se: *“Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaratimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”*.

Sa rezulton, këto të ardhura nuk u shoqëruan me dokumentacionin justifikues ligjor nga shteti grek, si dhe nuk provohet se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar as qëndrimi në shtetin grek, të ardhurat e përfituara dhe pagesa e detyrimeve tatimore. Për rrjedhojë, Komisioni vendosi të mos i konsiderojë të ardhurat e pretenduara nga emigracioni në shumën 452.448 lekë.

ii) Komisioni vendosi të përlllogarisë të ardhurat e bashkëshorte së subjektit të realizuara nga paga për periudhën e punësimit 20.3.2000 – 25.12.2000, duke qenë se subjekti arriti të vërtetojë marrëdhënien e punësimit pranë Drejtorisë Vendore ASHK Sarandë. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti librezën e punës së bashkëshortes dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2024, të lëshuar nga Drejtoria Vendore ASHK Sarandë¹¹⁹. Komisioni vlerëson se përgjegjësia ligjore për

¹¹⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.2.2024, lëshuar nga shtetasi G. K., administrator i shoqërisë “***” sh.p.k.

¹¹⁸ “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹¹⁹ Drejtoria Vendore ASHK Sarandë informon se gjatë vitit 2000 rezulton se paga mujore e një specialisti jurist për periudhën 1.1.2000 - 1.12.2000 pranë ish-ZVRPP Sarandë është në shumën 13.300 lekë.

përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e taksave/tatimeve është detyrim i punëdhënësit¹²⁰ dhe nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi personin e lidhur. Sa rezulton, Komisioni vendosi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat në shumën 121.416 lekë¹²¹ dhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, në shumën 81.000 lekë¹²².

iii) Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit lidhur me dhurimin e shumës 3.000 euro nga vëllai i subjektit mbeten në kuadrin deklarativ dhe të pambështetura në prova dhe, sikundër rezultoi edhe gjatë hetimit administrativ: (a) për herë të parë ky deklaram është bërë vetëm në pyetësonin standard, në datën 1.2.2021, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit i ka pasur të gjitha mundësitë që ta shpjegonte këtë situatë së paku në deklaratën *Vetting* 2017, ku iu është dhënë mundësia të gjithë subjekteve të rregullojnë/korrigjojnë/saktësojnë deklaratimet e bërë ndër vite; (b) subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij, pasi në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar se si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet familjare, pra nuk është deklaruar si burim krijimi edhe dhurimi; (c) mungon dokumentacioni ligjor për të provuar dërgimin e shumës 2.000 euro në vitin 2001 nga vëllai, nëpërmjet Western Union.

Sa rezulton, dhurimi i shumës 3.000 euro nuk u përfshi në analizën financiare të Komisionit si burim për blerjen e këtij apartamenti.

iv) Komisioni, më tej, analizoi pretendimet e subjektit lidhur me huan e vëllait në vitin 2004, në shumën 8.000 euro/1.000.000 lekë. Në mbështetje të deklaratimeve të tij ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.10.2021, lëshuar nga vëllai G. K., deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.2.2024, lëshuar nga bashkëshortja e vëllait, shtetasja italiane G. C.¹²³, si dhe dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e tyre në shtetin italian.

Sa më lart, duke konsideruar se kjo hua sipas deklaratimeve është marrë dhe kthyer brenda vitit, Komisioni e vlerësoi bindës shpjegimin e subjekti dhe kreu analizën financiare për të verifikuar mundësitë financiare të huadhënësit/vëllait të subjektit për dhënien hua të kësaj shume në datën 11.5.2004, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 1 – Analiza financiare janar 2003 – prill 2004, për huadhënësin

Viti	Përshkrimi	Të ardhura	Shpenzime	Gjendje
2003	Të ardhura vëllai	9,028.76 €		9,028.76 €
2003	Të ardhura shtetasja G. C.	12,806.00 €		21,834.76 €
2003	Shpenzime jetese 2 persona		14,419.00 €	7,415.76 €
Janar – prill 2004	Të ardhura vëllai	3,313.10 €		10,728.86 €
Janar – prill 2004	Të ardhura shtetasja G. C.	4,819.14 €		15,548.00 €
Janar – prill 2004	Shpenzime jetese 2 persona		5,452.67 €	10,095.33 €
	Hua subjektit		8,000.00 €	2,095.33 €
	TOTAL	29,967.00 €	27,871.67 €	2,095.33 €

¹²⁰ Bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 7703, date 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 6 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në fuqi në kohën e ekzistencës së marrëdhënies së punës së bashkëshortes së subjektit, si dhe nenin 8/a të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

¹²¹ Përlllogaritur për periudhën 20.3.2000 – 25.12.2000.

¹²² Përlllogaritur për 9 muaj.

¹²³ E cila deklaron se: “[...] ka dijëni se kanë pasur një marrëdhënie huaje për gjatë atij viti, pasi nevojiteshin për të kryer pagesën e një banese, të cilat janë kthyer brenda vitit dhe huaja e dhëna nga G. ka qenë në shumën 8.000 euro [...]”.

Sa më lart, rezulton se huadhënësi ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huas në shumën 8.000 euro, në datën 11.5.2004 dhe, për rrjedhojë, Komisioni e konsideroi si burim për pagesën e kështit prej 16.000 USD për blerjen e apartamentit.

4.30. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni kreu analizën financiare në datën 1.10.2001 për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit në shumën 3.000 USD, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare, periudha 15.12.2000 – 1.10.2001

Periudha	Përshkrimi	Të ardhura	Shpenzime/pasuri	Gjendje progresive
	<i>Tepricë pozitive e mbartur nga periudha e mëparshme</i>	613,313		613,313
15.12.2000 – 31.12.2000	Të ardhura nga pagat subjekti	48,908	-	662,221
15.12.2000 – 31.12.2000	Shpenzime jetese (1 person)	-	4,500	657,721
20.3.2000 – 25.12.2000	Të ardhura bashkëshortja pranë ZRPP-së	121,416	-	779,137
20.3.2000 – 25.12.2000	Shpenzime jetese bashkëshortja në Sarandë	-	81,000	698,137
Janar – shtator 2001	Të ardhura nga pagat subjekti	513,258	-	1,211,396
Janar – shtator 2001	Të ardhura nga pagat bashkëshortja	-	-	1,211,396
Janar – shtator 2001	Shpenzime jetese	-	195,550	1,015,846
2001	Dhuruar vëllai (2.000 euro)	-		1,015,846
1.10.2001	Pagesë kështi i parë 3.000 USD	-	424,740	591,106
	TOTAL	1,296,896	705,790	591,106

4.31. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare në datën 31.12.2003¹²⁴ për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit në shumën 7.000 USD, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 3 – Analiza financiare, periudha dhjetor 2003

Periudha	Përshkrimi	Të ardhura	Shpenzime/pasuri	Gjendje progresive
Dhjetor 2003	Të ardhura nga pagat subjekti	74,446	-	74,446
Dhjetor 2003	Të ardhura nga aktiviteti bashkëshortja	200,000	-	274,446
Dhjetor 2003	Shpenzime jetese (3 persona - 1 muaj)	-	23,466	250,980
31.12.2003	Pagesë kështi i dytë 7.000 USD	-	760,830	-509,850
	TOTAL	274,446	784,296	-509,850

¹²⁴ Referuar analizës financiare për periudhën tetor 2001 – nëntor 2003 (paraqitur në tabelën nr. 6 të këtij vendimi), balanca në fund të periudhës ka rezultuar negative e, për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare për periudhën vijuese (dhjetor 2013), zëri “Tepricë pozitive e mbartur nga periudha e mëparshme” paraqitet me vlerë zero.

4.32. Gjithashtu, Komisioni kreu analizën financiare në datën 11.5.2004 për të ardhurat, pasuritë, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e këstit në shumën 16.000 USD, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 4 – Analiza financiare, datë 11.5.2004

Përshkrimi	Shuma
Apartament me sip. 70 m ² , në lagjen “****” (kësti 16.000 USD) ¹²⁵	1,715,200
Shtesë e llogarive bankare ¹²⁶	122,859
Total pasuri	1,838,059
Hua 8.000 euro vëllai	1,000,000
Total detyrime	1,000,000
Të ardhura subjekti nga pagat ¹²⁷	343,670
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik ¹²⁸	580,000
Total të ardhura	923,670
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	102,077
Total shpenzime	102,077
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	-16,467

4.33. Për sa i përket kthimit të huas, Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2004, për të ardhurat, pasuritë, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 5 – Analiza financiare, viti 2004

Përshkrimi	Shuma
Apartament me sip. 70 m ² , në lagjen “****” (kësti 16.000 USD)	1,715,200
Shtesë e llogarive bankare	620,917
Total pasuri	2,336,117
Hua 8.000 euro vëllai (marrë dhe kthyer brenda vitit)	0
Total detyrime	0
Të ardhura subjekti nga pagat	944,232
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	1,600,000
Total të ardhura	2,544,232
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	281,592
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	38,022
Total shpenzime	319,614
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime – pasuri - shpenzime)	-111,499

4.34. Në përfundim, rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -526.317 lekë¹²⁹ për blerjen e apartamentit me sip. 70 m², në lagjen “****”; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë

¹²⁵ Shuma 16.000 USD, e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën 11.5.2004, 1 USD = 107,2 lekë.

¹²⁶ Llogari Intesa Sanpaolo Bank, subjekti/bashkëshortja, në USD, nr. ***.

¹²⁷ (i) Vërtetim nr. ***, datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; (ii) vërtetim datë 13.10.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹²⁸ Në mënyrë përpjesëtimore për 4.35 muaj.

¹²⁹ Totali i shumës 509.850 lekë me shumën 16.467 lekë.

burimesh të ligjshme financiare në shumën -111.499 lekë për kthimin e huas prej 8.000 euro në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Njësi me sip. 40 m², bulevardi “**”, Tiranë (shuma 40.000 USD)**

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje për ambient nr. ***, datë 6.10.2003, me sip. 40 m², në blv. “****”, Tiranë. Likuiduar shuma 36.000 USD, pa likuiduar shuma 4.000 USD. Pjesa takuese: 100 % familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹³⁰.

5.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje për ambient zyre, nr. ***, datë 6.10.2003, me adresë blv. “****”, Tiranë, me sip. 40 m², vlera 40.000 USD, paguar në vitin 2003 shuma 36.000 USD dhe shtojca do të paguhet me marrjen në dorëzim. Deri në datën 31.12.2004 nuk është marrë në dorëzim. Pjesa takuese: 100%. Data e krijimit të pasurisë viti 2003, detyrimi i papaguar shuma 4.000 USD. Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat personale. Në DIPP-në e vitit 2007 dhe më tej DIPP-në e viteve 2012 – 2018, subjekti ka deklaruar se vazhdon detyrimi prej 4.000 USD ndaj shoqërisë “****”, i deklaruar në vitet paraardhëse, me të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes së ambientit zyrë¹³¹.

5.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 6.10.2003, me sipërmarrës “****” sh.p.k. dhe palë porositëse B. P., për ambient zyrë me sip. 40 m², në blv “****”, në vlerën 40.000 USD. Në kontratë përcaktohet se pagesa do të bëhet sipas kësteve, si vijon: 25.000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës, 6.10.2003; kësti i dytë 11.000 USD në datën 10.12.2003 dhe në datën 31.1.2004 do të bëhet dorëzimi i objektit dhe do të paguhet diferenca prej 4.000 USD¹³².

5.4. Subjekti ka paraqitur depozitimet bankare të kryera pranë Tirana Bank në shumën 25.000 USD, në datën 6.10.2003 dhe në shumën 11.000 USD, në datën 12.12.2003, me përshkrimin “B. P., shlyerje kontratë sipërmarrjeje nr. ****”.

5.5. Në përgjigje të pyetësorit standard¹³³, subjekti ka deklaruar se nuk është shlyer ende detyrimi i shumës 4.000 USD ndaj shoqërisë “****”. Kjo shumë do të likuidohet në momentin që do të lidhet kontrata përfundimtare e shitjes. Nga hetimi i Komisionit pranë ASHK-së kjo pasuri nuk figuron e regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit.

5.6. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti është pyetur lidhur me faktin se përse nuk është deklaruar kjo pasuri në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, në kushtet që në vitin 2003 ishte likuiduar vlera 36.000 USD. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se deklarimi

¹³⁰ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 6.10.2003; planimetria e ambientit; konfirmë bankare datë 6.10.2003 në Tirana Bank; konfirmë bankare e pagesës së shumës 11.000 USD, datë 12.12.2003, në Tirana Bank; vërtetim nga arkivi nr. *** i njësishë me origjinalin të dokumenteve kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 6.10.2003; planimetria e objektit.

¹³¹ Në DIPP/2007, subjekti deklaroi se vazhdon detyrimi 4.000 USD ndaj kontratës së sipërmarrjes për ambientin e zyrës, deklaruar në vitin 2005. Në DIPP-të e viteve 2012, 2013, 2014, 2016, 2017, 2018 subjekti deklaroi se vazhdon detyrimi prej 4.000 USD ndaj shoqërisë “****”, i deklaruar në vitet paraardhëse me të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes së një ambientit zyre.

¹³² Vërtetim nga arkivi nr. *** i njësishë me origjinalin të dokumenteve kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 6.10.2003.

¹³³ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 1.2.2021.

i kësaj pasurie është kryer në DIPP-në e vitit 2004, te rubrika konfidenciale, dhe në datën 1.12.2006 janë kryer saktësimet gjatë procesit të kontrollit paraprak lidhur me vlerën e shlyer dhe detyrimin e mbetur pa likuiduar. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka qenë për shkak të moskuptimit të drejtë të ligjit nëse duhej kryer deklarimi edhe pse nuk ishte lidhur kontratë shitblerjeje apo jo. Burimi është nga të ardhurat familjare të subjektit dhe bashkëshortes. Kjo njësi nuk është e regjistruar ende dhe nuk disponon certifikatë pronësie, përfundoi subjekti.

5.7. Me anë të pyetësorit nr. 1¹³⁴ subjektit iu kërkua të sqarojë nëse deri më sot është paguar detyrimi financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 4.000 USD, nëse është lidhur kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, si edhe nëse kjo pasuri është regjistruar në emrin e subjektit apo personave të lidhur. Në përgjigje¹³⁵, subjekti deklaroi se shuma 4.000 USD nuk i është paguar ende shoqërisë “****” sh.p.k., pasi objekti deri më tani nuk është regjistruar (as hipotekuar e as nuk është realizuar kontrata e shitjes), për rrjedhojë nuk është plotësuar kushti i vendosur për pagesën e detyrimit të mbetur. Kjo pasuri nuk ka pësuar ndryshime që pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, sqaroi subjekti. Shoqëria “****” sh.p.k.¹³⁶ konfirmoi dy pagesat e kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe se detyrimi i mbetur prej 4.000 USD do të paguhet në momentin e kalimit të pronësisë nga ana e shoqërisë, që nuk është realizuar ende.

5.8. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike, referuar përgjigjes së administruar nga FSHU-ja¹³⁷, në emër të personit të lidhur B. K. rezultoi e regjistruar kontrata e furnizimit me energji elektrike, kategoria “Privat”, kabina “****”, me adresë blv. “****”, Tiranë. Kontratë e regjistruar në datën 10.3.2006. Lidhur me kontratën e furnizimit me ujë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti shpjegoi se është në pritje të përgjigjes së Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë lidhur me kontratën dhe kohën e lidhjes së saj.

5.9. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2003¹³⁸ (vitin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes) në qytetin e Tiranës, nga ku rezultoi se çmimi për apartamentet ka qenë 53.450 lekë/m². Komisioni vëren se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 2 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit në Bashkinë Tiranë, referencë e cila është përdorur edhe më tej lidhur me metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme¹³⁹. Për pasojë, njësia e porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 4.276.000 lekë¹⁴⁰, përkundëjt çmimit prej 4.723.200 lekësh të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes¹⁴¹.

¹³⁴ Email datë 17.11.2023, ora 12:41.

¹³⁵ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.11.2023.

¹³⁶ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 11.1.2024.

¹³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

¹³⁸ Udhëzim Nr. 1, datë 8.5.2003, i Këshillit të Ministrave.

¹³⁹ VKM Nr. 132, datë 7.3.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa [...]”: “Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë”.

¹⁴⁰ Sip. 40 m² x 53.450 lekë x 2 = 4.276.000 lekë.

¹⁴¹ Çmimi prej 40.000 USD u vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, 1 USD = 118,08 lekë.

5.10. Nga hetimi i Komisionit¹⁴² në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “***” sh.p.k.¹⁴³.

5.11. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.10.2001 – 30.11.2003, ku u konsideruan: (i) të ardhurat e subjektit nga paga¹⁴⁴; (ii) të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si person fizik, në mënyrë përpjesëtimore për secilën periudhë; (iii) shpenzimet e jetesës¹⁴⁵; (iv) pagesa e dy kësteve¹⁴⁶ – nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 1.473.681 lekë.

5.12. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 1.473.681 lekë për pagesën e dy kësteve prej 36.000 USD për blerjen e njësisë në blv. “***”, Tiranë.*

5.13. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, sqaroi se mosdeklarimi i ambientit (40 m²) 37 m² në blv. “***” Tiranë, ishte si rezultat i orientimit gabim lidhur me plotësimin e deklaratës së parë në vitin 2003. Sipas subjektit, ky orientim i gabuar se deklarata mund dhe duhet të plotësohet deri në datën e saktësimit të saj (në rastin e subjektit në datën 26.5.2004), mbështetur në faktin se ishte hera e parë për subjektet në Republikën e Shqipërisë që plotësonin DIPP, ka sjellë edhe mosdeklarimin e kësaj pasurie. Në analizën financiare të paraqitur në prapësime, subjekti pretendon se nëse i referohemi kësteve të paguara në datën 6.10.2003 në shumën 25.000 USD, analiza financiare paraqitet me balancë pozitive në shumën 718.080 lekë. Në momentin e pagesës së kështit të dytë në shumën 11.000 USD, në datën 12.12.2003, analiza financiare paraqitet me balancë pozitive në shumën 21.920 lekë, duke deklaruar në përfundim se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare për të blerë me të ardhura të ligjshme këtë pasuri.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.14. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

¹⁴² Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁴³ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

¹⁴⁴ Vërtetim nr. **, datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁴⁵ Shpenzime e jetesës u përlogaritën për 3 persona, bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. **, datë 4.3.2019.

¹⁴⁶ Vlerësimi u kryer bazuar në kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë, konkretisht shuma prej 25.000 USD u vlerësua me kursin e datës 6.10.2003, kursi i këmbimit 1 USD = 118,08 lekë dhe shuma prej 11.000 USD u vlerësua me kursin e datës 12.12.2003, 1 USD = 108,92 lekë.

5.15. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë referuar parashikimeve të shkronjës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, si pasojë e mosdeklarimit të porositjes së kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2003.

5.16. Në vijim të arsyetimit lidhur me elementet e analizës financiare, trajtuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kësteve, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për këstet 25.000 USD dhe 11.000 USD

Periudha	Përshkrimi	Të ardhura	Shpenzime/pasuri	Gjendje progresive
	<i>Tepricë pozitive e mbartur nga periudha e mëparshme</i>	591,106		591,106
Tetor – dhjetor 2001	Të ardhura nga pagat subjekti	102,652	-	693,757
Tetor – dhjetor 2001	Të ardhura nga pagat bashkëshortja	-	-	693,757
Tetor – dhjetor 2001	Shpenzime jetese (3 persona tetor – dhjetor 2001)	-	70,398	623,359
	Tërheqja e dhrahmive			623,359
2002	Të ardhura nga pagat subjekti	764,999	-	1,388,358
2002	Të ardhura nga pagat bashkëshortja	-	-	1,388,358
2002	Dhurrar vëllai (1.000 euro)	-	-	1,388,358
2002	Shpenzime jetese (3 persona)	-	281,592	1,106,766
Janar – shtator 2003	Të ardhura nga pagat subjekti	670,013	-	1,776,779
23.3.2003 – 30.9.2003	Të ardhura nga aktiviteti bashkëshortja	1,200,000	-	2,976,779
Janar – shtator 2003	Shpenzime jetese (3 persona-9 muaj)	-	211,194	2,765,585
6.10.2003	Pagesë kësti 25.000 USD	-	2,952,000	-186,415
Tetor – nëntor 2003	Të ardhura nga pagat subjekti	148,892	-	-37,524
Tetor – nëntor 2003	Të ardhura nga aktiviteti bashkëshortja	400,000	-	362,476
Tetor – nëntor 2003	Shpenzime jetese (3 persona-2 muaj)	-	46,932	315,544
12.12.2003	Pagesë kësti 11.000 USD	-	1,198,120	-882,576
	TOTAL	3,877,660	4,760,236	-882,576

5.17. Në përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -882.576 lekë për blerjen e njësisë me sip. 40 m², blv. “****”, Tiranë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

6. Apartament me sip. 69 m², në Durrës, në vlerën 28.000 euro

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti me nr. ***, datë 12.12.2011, me sip. 69 m², në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës. Likuiduar shuma 18.000 euro, pa likuiduar shuma 10.000 euro. Pjesa takuese: 100% familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarameve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹⁴⁷.

6.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 12.12.2011, për blerje apartamenti në Lagjen Nr. ***, Durrës, me shumën 28.000 euro. Pagesa prej 10.000 euro është sqaruar në deklaratën bashkëlidhur, shuma 8.000 euro pagesë e kryer në momentin e lidhjes së kontratës dhe 10.000 euro do likuidohet në momentin e hipotekimit dhe dorëzimit të apartamentit”. Në DIPP-në e viteve

¹⁴⁷ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 12.12.2011, për blerje apartamenti në Durrës, në vlerën 28.000 euro.

2011 – 2018, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar se vazhdon detyrimi financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 10.000 euro.

6.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 12.12.2011, të lidhur ndërmjet sipërmarrësit, shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorja P. B., dhe porositësit B. K., për blerje apartamenti me sip. 69 m², në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës, me vlerë 28.000 euro. Në këtë kontratë parashikohet se: (i) kësti i parë prej 10.000 euro është parapaguar nga porositësi tek shoqëria ndërtuese në vitin 2008; (ii) kësti i dytë prej 8.000 euro është paguar jashtë zyrës noteriale; (iii) kësti i tretë prej 10.000 euro do të paguhet në momentin e realizimit të kontratës së shitblerjes noteriale midis palëve.

6.4. Për sa i përket regjistrimit të kësaj prone, referuar kërkimeve të sistemin multifunksional të ASHK-së, të kryera nga ILDKPKI-ja¹⁴⁸, konfirmohet një apartament me sip. 60 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, me adresë rruga “****”, në pronësi të shtetases B. K., regjistruar me nr. ***, datë 30.7.2020.

6.5. Në përgjigje të shpjegimeve të kërkuara nga ILDKPKI-ja, subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për apartamentin objekt të kontratës së sipërmarrjes nr. *** të vitit 2011 dhe se ndryshimi në emërtimin e rrugëve është bërë për shkak të emërtimit të ndryshëm që i bëjnë institucionet (objekti ndodhet midis rrugëve A. G. dhe S. E.). Sipërfaqja në kontratën e sipërmarrjes është vendosur nga shitësi së bashku me hapësirat e përbashkëta sipas përcaktimit të tij dhe, më tej, pas matjeve ekzakte të kryera nga zyra e ALUIZNI-t rezulton se sipërfaqja është 60 m². Subjekti ka paraqitur lejen e legalizimit nr. ***, datë 30.1.2020, genplanin e pasurisë, planimetrinë, si dhe certifikatë për vërtetim pronësie¹⁴⁹.

6.6. Në pyetësin standard, subjekti konfirmoi se, pasi shoqëria nuk realizoi regjistrimin e objektit, banorët kryen aplikime individuale dhe regjistrimi përfundimtar i pronës është kryer me anë të procesit të legalizimit nga agjencia shtetërore e ALUIZNI-t. Në këtë moment është kryer edhe pagesa përfundimtare për shoqërinë ndërtuese. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti urdhërshkrimin bankar nga llogaria bankare e bashkëshortes pranë Raiffeisen Bank në favor të noteres A. S., në shumën 10.000 euro, datë 14.7.2020, me përshkrimin “Lik. kësti fundit dhe përfundimtar sipas kont. me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2011”¹⁵⁰.

6.7. Lidhur me pagesën e kësteve, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti bashkëlidhur procesverbaleve të mbajtura pranë ILDKPKI-së¹⁵¹, është administruar një depozitim bankar në datën 14.7.2008, në shumën 10.000 euro, në llogarinë bankare të shtetases P. B., me përshkrimin “B. K. për P. B., likuidim këst apartamenti”. Nga këqyrja e ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.p.k. në QKB rezulton se shtetasja P. B. figuronte ortak me 100% të kuotave në datën e nënshkrimit të kontratës.

¹⁴⁸ Procesverbal i mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 3.6.2021, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2023.

¹⁴⁹ Numër serie ***, datë 30.7.2020, për pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 60 m², sipërfaqe e përbashkët 3.9 m², ndodhur në rrugën “****”, hyrja ***, apartamenti ***, Durrës.

¹⁵⁰ Referuar dokumentacionit të administruar nga noteri publik A. S., shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.11.2023, rezulton që shtetasja P. B. ka lëshuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.7.2020, ku ka deklaruar se është likuiduar totalisht lidhur me blerjen e këtij apartamenti dhe nuk ka asnjë lloj pretendimi ndaj blerësit.

¹⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.8.2023.

6.8. Për sa më lart, me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuan shpjegime se përse pagesa prej 10.000 euro është depozituar në llogarinë e administratores së shoqërisë (dhe jo në llogarinë e shoqërisë ndërtuese) dhe arsyen se përse kjo pagesë është kryer më shumë se 2 vite përpara lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Në përgjigje, subjekti deklaroi se pagesa është kryer në numrin e llogarisë së dhënë nga ana e sipërmarrësit sipas porosisë së saj, me qëllim rezervimin e apartamentit (garsonieres). Mosrealizimi i kontratës së sipërmarrjes në atë kohë ka ardhur për shkak të problemeve që patën ortakët e shoqërisë, pasi njëri prej tyre ndërroi jetë në atë periudhë. Për sa i përket datës së kryerjes së pagesës për këstin e dytë prej 8.000 euro, subjekti deklaroi se ajo është realizuar *cash* në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes datë 12.12.2011, por nuk paraqiti dokumentacion justifikues.

6.9. Më tej, Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2011¹⁵², në qytetin e Durrësit, nga ku rezultoi se çmimi ka qenë 74.540 lekë/m². Për pasojë, apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 37.000 euro¹⁵³, përkundrejt çmimit prej 28.000 euro të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes. Lidhur me diferencën e sipërcituar, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti sqaroi se çmimi është fiksuar në vitin 2008 dhe janë mbajtur parasysht disa kushte jo të favorshme si pamja, kati teknik, vështirësitë e aksesit nga rruga etj. Më tej, ai shpjegoi se çmimi i referencës është çmim mesatar dhe jo çmim minimal dhe se në varësi të zonave çmimet variojnë më lirë ose më shtrenjtë se çmimi referues.

6.10. Komisioni vëren se janë paraqitur 3 kontrata të nënshkruara nga shoqëria “****”, të cilat nuk janë lidhur në të njëjtin objekt dhe në të njëjtën periudhë kohore, pasi kontratat e paraqitura nga subjekti janë lidhur në vitin 2004 – 2005 në mesin të 2-6-10 katëshe të ndodhur në rrugën “****”, Lagjja Nr. ****, Durrës¹⁵⁴, ndërkohë që subjekti e ka lidhur kontratën e sipërmarrjes në vitin 2011, në mesin të 4-6-8-10 katëshe të ndodhur në rrugën “****”, Lagjja Nr. ****, Durrës, për pasojë, këto kontrata nuk përbëjnë relevancë për Komisionin.

6.11. Gjithashtu, edhe pasi u verifikuan të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2008¹⁵⁵ në qytetin e Durrësit (referuar deklaramit të subjektit se çmimi i shitblerjes së apartamentit ishte fiksuar në këtë vit), rezultoi se apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën rreth 35.000 euro¹⁵⁶, përkundrejt çmimit prej 28.000 euro të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, çka tregon se përsëri kemi një diferencë prej 7.000 euro.

6.12. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike, referuar përgjigjes së administruar nga FSHU-ja¹⁵⁷, në emër të personit të lidhur B. K. rezultoi e regjistruar kontrata e furnizimit me energji elektrike, kategoria “Familjare”, kabina “****”, me adresë “L. Nr. ****,****”, Durrës¹⁵⁸.

¹⁵² Udhëzimi nr. 4, datë 23.11.2011, i Këshillit të Ministrave.

¹⁵³ Sip. 69 m² x 74.540 lekë = 5.143.260 lekë (kursi i këmbimit 139,03 lekë).

¹⁵⁴ Kontratë datë 7.10.2004, me çmim 380 euro/m²; kontratë datë 12.8.2004, me çmim 400 euro/m²; kontratë datë 22.4.2005, me çmim 430 euro/m².

¹⁵⁵ Udhëzim nr. 1, datë 20.8.2008, i Këshillit të Ministrave.

¹⁵⁶ Sip. 69 m² x 70.586 lekë = 4.870.434 lekë (kursi i këmbimit 139,03 lekë).

¹⁵⁷ Shkresë nr. **** prot., datë 15.2.2021.

¹⁵⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti konfirmoi se kontrata është lidhur në emër të porositësit B. K. në vitin 2012, CEZ Shpërndarje, me nr. ****.

Kontratë e regjistruar në datën 1.3.2012. Lidhur me kontratën e furnizimit me ujë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se kontratat e furnizimit me ujë është lidhur në emër të porositësit B. K. në vitin 2012, kontrata me UKD-në nr. ***, por nuk paraqiti dokumentacion justifikues.

6.13. Për sa i përket përdorimit të këtij apartamenti, sipas shpjegimeve të subjektit në pyetësorë, nuk rezulton që të jetë përdorur për banim nga ana e tij por, nga ana tjetër, sipas informacionit të përcjellë nga DPGJC-ja¹⁵⁹, kjo adresë rezulton si adresë e gjendjes civile që prej datës 17.4.2013 e në vijim. Në DIPP-të vjetore kjo adresë nuk është deklaruar as si adresë e gjendjes civile dhe as si adresë banimi. I pyetur nga Komisioni me anë të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se nuk ka përfutuar të ardhura nga shfrytëzimi i këtij apartamenti për periudhën 2008 – 2016.

6.14. Lidhur me shpenzimet e arredimit/mobilimit, në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se për këtë apartament janë shpenzuar 300.000 lekë në vitin 2012.

6.15. Nga hetimi i Komisionit¹⁶⁰ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “***” sh.p.k.¹⁶¹.

6.16. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Nga analizimi i fakteve dhe deklarimeve të mësipërme rezulton se pagesat për apartamentin janë kryer si në vijim: (i) pagesa e parë prej 10.000 euro është kryer në datën 14.7.2008, me anë të depozitimit bankar të shumës 10.000 euro; (ii) pagesa e dytë prej 8.000 euro është kryer në datën 12.12.2011 – referuar parashikimit në kontratën e sipërmarrjes datë 12.12.2011 se ky këst është shlyer, si dhe deklarimit të subjektit në DIPP/2011 dhe në pyetësorin nr. 1 se ky këst është shlyer në datën e lidhjes së sipërmarrjes; (iii) pagesa e fundit prej 10.000 euro është kryer në datën 14.7.2020 nëpërmjet llogarive bankare.

6.17. Lidhur me burimin e këstit të parë prej 10.000 euro, paguar në datën 14.7.2008, fillimisht Komisioni konstaton se në DIPP/2008 subjekti nuk ka kryer deklarime lidhur me këtë pagesë. Më tej, në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, kjo e fundit i ka kërkuar sqarime subjektit lidhur me këtë çështje, konkretisht: “Në DPV/2011 keni deklaruar kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 12.12.2011, për blerje apartamenti në Durrës me vlerë 28.000 euro, në emër të bashkëshortes. Bashkëlidhur deklarimit keni paraqitur edhe një deklaratë sqaruese, ku thoni se pas saktësisë të kursimeve tuaja keni vërejtur se nuk keni deklaruar një pakësim të pasurisë për vitin 2008 në shumën 10.000 euro si rezervim për blerjen e apartamentit. Arsyeja është neglizhenca dhe besimi se mund ta kryenit në momentin e lidhjes së kontratës. Pra, pagesa prej 10.000 euro është likuiduar në vitin 2008 në momentin e rezervimit, 8.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës në vitin 2011 dhe 10.000 euro me dorëzimin e apartamentit”. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se i qëndron sqarimeve shtesë të dërguara pranë ILDKPKI-së dhe lidhur me burimin ka sqaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes, pagës së tij dhe kursimet e mëparshme. Në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja ndodhet kopje e deklaratës së sipërcituar, me emërtimin “Deklaratë sqaruese”, e nënshkruar nga subjekti deklarues

¹⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.8.2023.

¹⁶⁰ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁶¹ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

Madrid Kullolli, me datë nënshkrimi 26.3.2012 dhe pa numër protokollit. Gjithashtu, kjo deklaratë ndodhet edhe në dosjen *Vetting* të ILDKPKI-së¹⁶².

ILDKPKI-ja¹⁶³ bën me dije se kjo deklaratë sqaruese është paraqitur në datën 29.3.2012, së bashku me DIPP/2011. Konstatohet se ILDKPKI-ja nuk ka përcjellë numrin e protokollit, siç kërkohet në shkresën e dërguar nga Komisioni. Në këtë deklaratë sqaruese subjekti ka deklaruar: “[...] Në vitin 2010 kam qenë në proces kontrolli nga institucioni juaj, i thirrur gjatë këtij kontrolli, për shkak se lidhur me deklarinimin e vitit 2009 rezultojta me mosmbulim për atë vit të shpenzimeve, kjo ardhur si rrjedhojë e faktit se unë nuk kisha pasqyruar në deklarinimet e mija të viteve të mëparshme kursimet, pasi kisha menduar se ILDKPKI-ja bën vetë mbledhjen aritmetike të kursimeve që deklaroja për çdo vit. Pas saktësimit të kursimeve të mija, të cilat rezultojnë se kisha akumuluar të ardhura të cilat mbulonin plotësisht shpenzimet e kryera në vitin 2009, vërej se nuk kam deklaruar një pakësim të pasurisë për vitin 2008 në shumën 10.000 euro si rezervim për blerjen e një apartamenti të kryer nga bashkëshortja ime. Këtë mosdeklarim e kam kryer nisur nga neglizhenca dhe besimi se mund ta kryeja në momentin e lidhjes së kontratës me subjektin ndërtues [...]”.

6.18. Komisioni vëren se në një procesverbal të mëparshëm, të mbajtur në ILDKPKI në datën 7.12.2012, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim për sa i përket kësaj pagese apo kësaj deklarate sqaruese. Shpjegimet lidhur me këtë pakësim janë dhënë në procesverbalin pasardhës, i mbajtur rreth 4 vite më vonë, në datën 18.7.2016, ku citohet për herë të parë edhe ekzistenca e deklaratës sqaruese. Gjithashtu, siç është trajtuar në seksionin e likuiditeteve *cash*, subjekti nuk ka deklaruar kursime në formën e likuiditetit *cash* në DIPP-të e viteve të mëparshme e, për këtë arsye, edhe sikur të konsiderohej shpjegimi i subjektit që mosdeklarimi i pakësimit ka ndodhur nga neglizhenca, Komisioni vëren se nuk mund të pakësohen kursime që rezultojnë në vlerën zero.

6.19. Për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2008 – 14.7.2008, ku u konsideruan: (i) pagesa e kryer për apartamentin në shumën 10.000 euro¹⁶⁴; (ii) shtesa e gjendjes së llogarive bankare¹⁶⁵; (iii) të ardhurat e subjektit nga paga¹⁶⁶; (iv) të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si person fizik, në mënyrë përpjesëtimore për 7,5 muaj; (v) të ardhurat nga interesat bankarë; (vi) shpenzimet e jetesës¹⁶⁷; (vii) shpenzimet për shkollimin e vajzave¹⁶⁸; (viii) shpenzimet për studimet pasuniversitare të bashkëshortes në ***¹⁶⁹; (ix) shpenzimet për shlyerjen

¹⁶² Aneks nr. ***, dosje ILDKPKI, ku ndër të tjera subjekti ka deklaruar: “Nuk kam deklaruar një pakësim të pasurisë në vitin 2008 në shumën 10.000 euro, si rezervim për blerjen e një apartamenti (garsoniere) të kryer nga bashkëshortja ime. Këtë mosdeklarim, e kam kryer nisur nga neglizhenca dhe besimi se mund ta kryej në momentin e lidhjes së kontratës me subjektin ndërtues. Ndërkohë, në vitin 2011, bashkëshortja ime ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me subjektin ndërtues dhe ka parashikuar në këtë kontratë edhe detajet e pagesave”.

¹⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.1.2024.

¹⁶⁴ Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e depozitimit bankar, datë 14.7.2008, 1 euro = 121,96 lekë.

¹⁶⁵ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare në datën 14.7.2008, me gjendjen e datës 31.12.2007.

¹⁶⁶ Paga të kredituara në llogarinë bankare pranë Bankës Raiffeisen për periudhën 1.1.2008 – 14.7.2008.

¹⁶⁷ Shpenzime e jetesës u përlogariten në mënyrë përpjesëtimore për 6,5 muaj për 3 persona, për periudhën 1.1.2008 – 14.7.2008, (subjekti, bashkëshortja, vajza) – bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. ***, datë 4.3.2019.

¹⁶⁸ Përlogaritur 1/2 e shpenzimeve vjetore të vitit 2008 (39.000/2), bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2023, shkolla 9-vjeçare jopublike “V. P.”.

¹⁶⁹ Përlogaritur 1/2 e shpenzimeve vjetore të deklaruara nga subjekti (1/2 x 2.400 euro/3 vite = 400 euro), bazuar në përgjigjen e pyetësorit nr. 2, ku subjekti deklaroi se shuma e këtyre shpenzimeve për periudhën 2007 – 2009 ka qenë 2.400 euro.

e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank¹⁷⁰; (x) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS¹⁷¹ – nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 834.397 lekë.

6.20. Lidhur me burimin e këstit të dytë prej 8.000 euro, paguar në datën 12.12.2011, Komisioni kreu analizën financiare në fund të vitit 2011¹⁷², duke konsideruar: (i) pagesën e kryer për apartamentin në shumën 8.000 euro¹⁷³; (ii) shtesën e kursimeve në formën e likuiditeteve *cash*¹⁷⁴; (iii) shtesën e gjendjes së llogarive bankare¹⁷⁵; (iv) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes nga paga¹⁷⁶; (v) të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si person fizik; (vi) të ardhurat nga interesat bankarë; (vii) të ardhurat nga qiraja¹⁷⁷; (viii) shpenzimet e jetesës¹⁷⁸; (ix) shpenzimet për shkollimin e vajzave¹⁷⁹; (x) shpenzimet për shlyerjen e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank¹⁸⁰; (x) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS¹⁸¹ – nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 1.476.005 lekë.

6.21. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën totale prej 2.310.402 lekësh për pagesën e kësteve prej 18.000 euro për blerjen e apartamentit me sip. 69 m² në Durrës, si dhe për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.*

6.22. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se me anë të deklaratës sqaruese të paraqitur në vitin 2010, me iniciativën e tij ka vënë në dijeni ILDKPKI-në mbi pasaktësitë e plotësimit të deklaratave periodike vjetore. Pas kësaj deklarate nuk është pyetur në vitin 2012 nga ILDKPKI-ja për këtë fakt, pasi kjo çështje ishte sqaruar tashmë. Më tej, deklaroi se në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016 ka dhënë sqarime dhe ka konfirmuar deklarinimin dhe informacionin shtesë bashkëlidhur DIPP/2009. Bazuar në nenet 24 dhe 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, deklaratat e pasurisë korrigjohen nëpërmjet shpjegimeve që jepen në ILDKPKI. Në rastin konkret, DIPP-të nga viti 2003 e në vijim konsiderohen të korrigjuara mbi bazën e shpjegimeve të dhëna në vitet 2009 dhe 2016.

¹⁷⁰ Pagesa në vlerën totale 2.683,20 euro për interesa, principal, shpenzime të tjera të lidhura me kredinë – të evidentuara në lëvizjet e llogarisë bankare – periudha 1.1.2008 – 14.7.2008.

¹⁷¹ Shpenzimet e përlllogaritura për periudhën 1.1.2008 – 14.7.2008.

¹⁷² Në kushtet që nuk mund të përcaktohet me saktësi të plotë shumata e kursyer në *cash* për secilin muaj të vitit dhe data e pagesës së këstit është pranë datës së fundit të vitit.

¹⁷³ Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e kontratës së sipërmarrjes, datë 12.12.2011, 1 euro = 139,03 lekë.

¹⁷⁴ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2011, me gjendjen e datës 31.12.2010.

¹⁷⁵ Diferenca midis gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare në datën 31.12.2011, me gjendjen e datës 31.12.2010.

¹⁷⁶ (i) Vërtetim datë 25.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (ii) tabelë përmbledhëse e UAMD, paraqitur në deklaratën *Vetting*.

¹⁷⁷ Sipas trajtimit në pikën 14 të këtij vendimi.

¹⁷⁸ Shpenzime e jetesës u përlllogaritën për 4 persona bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. *** prot, datë 4.3.2019.

¹⁷⁹ Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2023, shkolla 9-vjeçare jopublike “V. P.”.

¹⁸⁰ Pagesa për interesa, principal, shpenzime të tjera të lidhura me kredinë – të evidentuara në lëvizjet e llogarisë bankare.

¹⁸¹ Shpenzimet e përlllogaritura për periudhën 1.1.2008 – 14.7.2008.

6.23. Subjekti shpjegoi se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, nisur nga koha e shkurtër dhe shpejtësia e përgjigjeve, nuk ka dalluar qartë që kontratat e ngjashme të dërguara nuk bëjnë fjalë për të njëjtin objekt. Sa rezulton, paraqiti një “Raport vlerësimi të pasurive të paluajtshme”, si dhe pesë kontrata të ngjashme, të cilat referojnë çmime të përafërta me atë të përfituar nga subjekti. Sipas këtij raporti rezulton se në përcaktimin e çmimit ka ndikuar: fakti se blerja është bërë ndërmjet blerësit dhe shoqërisë ndërtuese, duke shmangur tarifat e reklamimit në agjenci imobilare; në periudhën 2008 – 2011, sektori i ndërtimit pati një rritje të ndërtimeve por një ulje të kërkesës për blerje, duke bërë që çmimet të kishin një luhatje me tendencë në ulje dhe të kishte një diferencë me çmimet referencë rreth 20-30%; objekti nuk ishte i pajisur me certifikatë regjistrimi etj.

6.24. Për sa i përket analizës financiare të vitit 2008, subjekti deklaroi se nuk janë marrë në konsideratë kursimet e krijuara në periudhën 2005 – 2008. Nëse në analizën financiare do të përfshihen kursimet *cash* në shumën 3.200.000 lekë, rezulton se ka të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë në shumën 10.000 euro. Deri në fund të vitit 2007, gjendja *cash* është në shumën 2.650.000 lekë, çka tregon se këto kursime mbulojnë pagesën e kështit.

6.25. Në lidhje me analizën financiare të kryer në vitin 2011, subjekti pretendoi se nëse merret në konsideratë gjendja e likuiditeteve *cash* sipas shpjegimeve të dhëna në procesverbalin e ILDKPKI-së, në datën e pagesës 12.12.2011, do të rezultojë me mungesë burimesh financiare në shumën 226.005 lekë.

6.26. Më tej, në datën 15.3.2024, lidhur me transfertën bankare prej 2.000 euro nga shtetasi A. S. – sipas deklaramit për pagesën e qirasë së njësisë me sip. 40 m², blv. “****”¹⁸² – subjekti, me anë të postës elektronike, paraqiti formularin DIVA për vitin 2011 dhe urdhërpagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale, duke kërkuar që të merret në konsideratë kjo provë e sjellë nga ana e tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.27. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.28. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2008, bazuar në parashikimet e shkronjës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, si pasojë e mosdeklaramit të të drejtave reale mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 69 m², duke qenë se pagesa prej 10.000 euro ishte kryer që në vitin 2008.

6.29. Lidhur me vlerën e tregut të këtij apartamenti, Komisioni vëren se subjekti ka dorëzuar 5 kontrata të ngjashme¹⁸³ të lidhura në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 nga shoqëria “****” sh.p.k.,

¹⁸² Trajtuar në paragrafët 14.19 dhe 14.20 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁸³ (i) Kontrata nr. ***, datë 8.9.2006, për apartamentin me sip. 127.9 m², në vlerën 63.940 euro, çmimi për metër katror 500 euro; (ii) kontrata nr. ***, datë 7.9.2006, për apartamentin me sip. 69 m², në vlerën 36.100 euro, çmimi për metër katror 523 euro; (iii) kontrata datë 16.8.2007, për apartamentin me sip. 120 m², çmimi për metër katror 517 euro, shuma totale 62.000 euro; (iv) kontrata datë 14.5.2008, për apartamentin me sip. 161 m², çmimi për metër katror 500 euro; (v) kontrata e sipërmarrjes datë 8.1.2009, për apartamentin me sip. 161 m², në vlerën 55.000 euro, çmimi për metër katror 342 euro.

në zonën ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës. Nga analizimi i kontratave të ngjashme rezulton se çmimi mesatar i shitjeve përllëgaritet në vlerën 476 lekë/m², përkundër vlerës prej 405 euro për metër katror të kontraktuar nga subjekti, çka nuk paraqet ndonjë diferencë të konsiderueshme në çmimin e përfutur nga ana e subjektit.

6.30. Për sa i përket kështit të parë prej 10.000 euro, në vijim të arsytimit lidhur me likuiditetet *cash*, trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni reflektoi në analizën financiare shumën 550.000 lekë në zërin “Ndryshimi i likuiditeteve *cash*” dhe – në kushtet që nuk mund të përcaktohet se cilëve muaj të vitit i përket ky kursim – vijoi me kryerjen e analizës financiare për të gjithë vitin 2008, paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare për vitin 2008

Përshkrimi	Vlera
Pagesë kësti për apt. 69 m ² , rruga “****”, Durrës (10.000 euro)	1,219,600
Shtim/pakësim <i>cash</i>	550,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	-877,008
Total pasuri	892,592
Të ardhura subjekti nga pagat	990,189
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	1,200,000
Të ardhura nga interesat bankarë	18,111
Total të ardhura	2,208,300
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	409,860
Shpenzime për shkollimin e vajzave	39,000
Shpenzime për studimet pasuniversitare të bashkëshortes në ***	98,546
Shpenzim për shlyerjen e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank	662,510
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	68,061
Total shpenzime	1,277,977
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	37,730

6.31. Për sa i përket kështit të dytë prej 8.000 euro, Komisioni analizoi dokumentacionin e përcjellë lidhur me pagesën e qirasë dhe u konstatua se në formularin DIVA të vitit 2011 janë paraqitur të ardhura bruto nga qiraja në shumën 308.733 lekë dhe detyrime tatimore në shumën 30.873 lekë. Në formularin e urdhërpagesës së tatimit mbi të ardhurat personale evidentohen pagesat e detyrimeve tatimore, gjobave dhe e interesave, në shumën totale 67.301 lekë.

6.32. Në kushtet që pagesa e shumës 2.000 euro është kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore, Komisioni e përfshiu shumën 2.000 euro si të ardhur nga qiraja gjatë vitit 2011.

6.33. Në vijim të arsytimit lidhur me likuiditetet *cash*, trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni reflektoi në analizën financiare shumën 150.000 lekë në zërin e ndryshimit të likuiditeteve *cash* dhe shtesën prej 2.000 euro të të ardhurave nga qiraja, si dhe vijoi me kryerjen e analizës financiare për vitin 2011, paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 8 – Analiza financiare për vitin 2011

Përshkrimi	Shuma
Pagesë kësti për ap. me sip. 69 m ² , rruga “****”, Durrës (8.000 euro)	1,112,240
Shtim/pakësim <i>cash</i>	150,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	610,160
Total pasuri	1,872,400
Të ardhura subjekti nga pagat	1,515,048
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	1,284,352
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë UAMD	560,716
Të ardhura nga qiraja e ambientit me sip. 40 m ² tek blv. “****”	407,847
Të ardhura nga bashkia për llogari bebe (S. K.)	5,000
Të ardhura nga interesat bankarë	15,124
Total të ardhura	3,788,086
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	546,480
Shpenzime për shkollimin e vajzave	54,000
Shpenzim për shlyerjen e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank	896,042
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	368,570
Total shpenzime	1,865,091
Balanca e fondeve (të ardhura-pasuri-shpenzime)	50,595

6.34. Në përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit me sip. 69 m², në Durrës.

6.35. Në konkluzion të analizimit të kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP-në e vitit 2008, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” (sipas leximit *acontrario*) të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

7. Apartament (papafingo) me sip. 140 m², në *, në vlerën 35.000 euro**

7.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.4.2015, për blerje apartamenti (papafingo) me sip. 140 m² (100 m² apartament dhe 40 m² verandë). Vlera e apartamentit është 35.000 euro, nga të cilat janë likuiduar 29.000 euro dhe pjesa tjetër prej 6.000 euro nuk është likuiduar ende. Pjesa takuese: 100% familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹⁸⁴.

7.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti (papafingo) me sip. 140 m² (100 m² apartament + 40 m² verandë) gjendur në strukturën 3 kt-N/çati, në parcelën nr. ***, ***, sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 24.1.2005, dhe shitës shoqëria “****” sh.p.k. Vlera e apartamentit është 35.000 euro, nga të cilat janë likuiduar 19.000 euro dhe pjesa tjetër sipas kontratës nr. ***, datë 20.4.2015”. Pjesa takuese: 100%. Në seksionin konfidencial subjekti ka deklaruar detyrimin financiar ndaj

¹⁸⁴ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.4.2015; konfirmë bankare nga Credins Bank datë 21.4.2015; konfirmë bankare nga Raiffeisen Bank datë 18.1.2016.

shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 16.000 euro. Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar likuidim kësti për kontratën e sipërmarrjes së blerjes së apartamentit (papafingo) në shumën 10.000 euro. Në seksionin konfidencial subjekti ka deklaruar detyrimin financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 6.000 euro. Në DIPP/2017, subjekti ka deklaruar likuidimin e këstit prej 6.000 euro në datën 24.3.2017, pagesa nga llogaria nr. *** në Raiffeisen Bank, me përdorues B. K..

7.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 20.4.2015, për apartament papafingo me sip. 140 m², në ***, të lidhur ndërmjet investitorit, shoqëria “****” sh.p.k. dhe porositësit subjekti dhe bashkëshortja e tij. Në kontratë është përcaktuar se vlera e apartamentit është 35.000 euro, nga të cilat 19.000 euro do të likuidoheshin nëpërmjet numrit të llogarisë së noterit dhe do të tërhiqet nga znj. S. Q., për shkak të revokimit të kontratës nr. ***, datë 20.4.2015¹⁸⁵, ndërsa shuma 16.000 euro do të likuidohet me pajisjen me certifikatën e pronësisë së apartamentit.

7.4. *Për sa i përket datës së pagesës së kësteve*, bashkëlidhur subjekti ka paraqitur mandatin e depozitimit të shumës 19.000 euro në llogarinë e noteres M. Sh. pranë Credins Bank, në datën 21.4.2015, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin “Kont. nr. *** rep., nr. *** kol., Madrid dhe B. Kullolli kontratë sipërmarrje”. Gjithashtu, ka paraqitur urdhërshkrimin në shumën 10.000 euro, në datën 18.1.2016, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit pranë Raiffeisen Bank, në favor të noteres M. Sh., me përshkrimin “Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., B. K.”, ndërsa pagesa e fundit prej 6.000 euro është kryer në datën 24.3.2017 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit pranë Raiffeisen Bank, në favor të noteres M. Sh..

7.5. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja¹⁸⁶, kjo pasuri figuron në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij. Referuar materialit bashkëlidhur, u konstatua se fillimisht ky apartament i ishte shitur shtetasit A. Q., me anë të kontratës nr. ***, datë 16.9.2005, me çmimin 30.000 euro, kontratë e cila është revokuar në datën 20.4.2015 (kontratë nr. ***, datë 20.4.2015). Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja figurojnë aplikues me anë të formularit nr. ***, datë 17.4.2015 dhe janë pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 30.9.2020, për kalimin e të drejtës së pronësisë së truallit të përfutur me kontratën nr. ***, datë 30.9.2020. Pasuria nr. ***, z. k. ***, adresa: zona e stimuluar “****” sh.p.k., ***, Kavajë, sipërfaqja takuese e parcelës ndërtimore 41,45 m², sipërfaqja takuese e ndërtimit 94,22 m², kondicione të veçanta takuese shkallë 15,47 m², verandë 42,12 m². Më pas, rezulton të jetë lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 30.9.2020, “Për kalimin e pronësisë pas procesit të legalizimit”, me shitës ASHK dhe blerës Madrid e B. Kullolli, sipas së cilës është bërë kalimi në pronësi i truallit me sip. 41,45 m². Blerësi ka paguar çmimin 73.491 lekë (vlera e truallit të njësisë së ndërtuar) dhe 1.244 lekë (vlera e tarifës së përditësimit të pronës), paguar përpara lidhjes së kësaj kontrate¹⁸⁷.

7.6. Sa më lart, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij figurojnë aplikues me anë të formularit nr. ***, datë 17.4.2015, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes për blerjen e këtij apartamenti (papafingo) është nënshkruar në datën 20.4.2015 (3 ditë më vonë). Lidhur me sa konstatohet, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti deklaroi se bisedat për blerjen e

¹⁸⁵ Nga hetimi i Komisionit rezulton se ky apartament me anë të kontratës nr. ***, datë 16.9.2005, i ishte shitur shtetasit A. Q., me kontratën nr. ***, datë 20.4.2015, me çmimin 30.000 euro, më pas kjo kontratë është revokuar.

¹⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2021.

¹⁸⁷ Referuar mandatpagesave në Credins Bankën, këto pagesa janë kryer në datën 24.9.2020.

këtij apartamenti kanë vijuar disa javë, nisur nga vështirësitë që kishte lidhur me realizimin e kontratës, pasi objekti ishte i paregjistruar. Meqenëse ishte ende në fuqi afati për aplikim për leje legalizimi, është bërë aplikimi për të kryer regjistrimin në përfundim në emër të blerësit.

7.7. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike dhe me ujë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti deklaroi se janë regjistruar në emër të porositësit të parë, personit që u ka shitur apartamentin, pra në emër të shtetasit A. Q., dhe se kontratat nuk janë ndryshuar për neglizhencë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti paraqiti në cilësinë e provës përgjigjen e lëshuar nga FSHU-ja me nr. *** prot., datë 24.1.2024, e cila konfirmon se kjo kontratë vijon të jetë e regjistruar në emër të shtetasit A. Q. dhe se pagesat e energjisë elektrike figurojnë prej datës 2.7.2014 e në vijim. Subjekti rideklaron se ndryshimi i emrit të kontratës nuk është bërë për shkak të neglizhencës.

7.8. Për sa i përket momentit të fillimit të banimit në këtë apartament, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë banesë në periudhën 2015 – 2017 e në vijim. Lidhur me shpenzimet e arredimit/mobilimit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ky apartament është mobiluar në vitin 2015 dhe mobilimi ka kushtuar afërsisht 250.000 lekë, pasi e kanë blerë të mobiluar.

7.9. Më tej, Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2015¹⁸⁸ – viti i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes – në qytetin e Kavajës, nga ku rezultoi se çmimi ka qenë në shumën 56.384 lekë/m². Për pasojë, apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës – duke e konsideruar verandën me 50% të çmimit llogaritet në shumën 7.372.207 lekë¹⁸⁹, përkundrajt çmimit 4.907.700 lekë të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes¹⁹⁰.

7.10. Për sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të pyetësorit nr. 1, i cili në përgjigje deklaroi se çmimi i blerjes është vlerësuar i përshtatshëm nga palët dhe janë mbajtur parasysht disa kushte që kishte objekti sikurse është fakti se nuk është apartament i rregullt, por papafingo, çka e bën të pashfrytëzueshme një pjesë të sipërfaqes për shkak të pjerrësisë së çatisë. Gjithashtu, infrastruktura rrugore, ujore dhe ajo energjetike linte për të dëshiruar në atë moment, katet e para të bodrumit ishin në kushte shumë të rënduara sikurse vijnë ende etj. Subjekti paraqiti kontrata të ngjashme lidhur me shitjen e pasurive në atë zonë. Komisioni vëren se janë paraqitur dy kontrata të lidhura në të njëjtin objekt, konkretisht: (i) nr. ***, datë 31.3.2006, apartament me sip. 140 m², me çmim 37.800 euro, çmimi për metër katror karabina 270 euro; (ii) nr. ***, datë 21.3.2007, papafingo me sip. 160 m², vlera e apartamentit në karabina 30.000 euro. Konstatohet se këto kontrata janë përcaktuar për apartamente në fazën karabina dhe jo në fazë përfundimtare sikurse është blerë apartamenti nga ana e subjektit, si dhe në periudhë kohore rreth 8-9 vite para lidhjes së kontratës nga ana e subjektit, për pasojë nuk mund të merren si referencë nga ana e Komisionit.

¹⁸⁸ Udhëzimi nr. 4, datë 30.9.2015, i Këshillit të Ministrave.

¹⁸⁹ Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja, ky apartament ka sipërfaqe banimi 94,22 m² dhe sipërfaqe shkalle takuese 15,47 m². Ndërsa sipërfaqja e verandës është 42,12 m². Përlllogaritur si total: (i) sip. 109,69 m² (banimi dhe sipërfaqe shkalle takuese) x 56.384 lekë = 6.184.760 lekë; (ii) 42,12 m² (veranda) x 56.384 lekë/m² = 1.187.447 lekë.

¹⁹⁰ Çmimi prej 35.000 euro, vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e nënshkrimit të kontratës, 1 euro = 140,22 lekë.

7.11. Nga hetimi i Komisionit¹⁹¹ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “***” sh.p.k.¹⁹²

7.12. Pavarësisht sa më lart, referuar parashikimit ligjor në nenin 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 86/2012, datë 8.9.2012, përcaktohet se: “*Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij nga një individ, person fizik ose juridik privat*”. Gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se çmimi më i favorshëm në përfitimin e këtij apartamenti vjen për shkaqe të tjera objektive e të arsyeshme që nuk kanë lidhje me detyrën e tij.

7.13. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime pasi sa rezulton, duket se vërtetohet kushti ligjor i parashikuar nga neni 23, pika 1, për ta trajtuar blerjen e këtij apartamenti si një trajtim preferencial në kuptim të këtij ligji, duke qenë se trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar atë gjendje.

7.14. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. *Lidhur me pagesën e këstit të parë,* depozitimi në llogarinë bankare të noterës, shuma 19.000 euro, datë 21.4.2015, Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar si burim të ardhurat dhe kursimet familjare nga ku rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 614.115 lekë. *Lidhur me pagesën e këstit të dytë,* transferta në llogarinë bankare të noterës, shuma 10.000 euro, datë 18.1.2016, Komisioni analizoi lëvizjet e llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit pranë Raiffeisen Bank dhe konstatoi se burim i kësaj transferte janë të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit, të trajtuara në pikën 13 të këtij vendimi.

7.15. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: (i) *Duket e dyshimtë blerja e këtij apartamenti në një vlerë prej 2.464.507 lekësh më lirë përkundrejt çmimit të referencës të përcaktuar në tregun e lirë për shitjen e apartamenteve në vitin 2015;* (ii) *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 614.115 lekë për pagesën e këstit prej 19.000 euro për blerjen e apartamentit në ***, Durrës, si dhe për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.*

7.16. Subjekti i rivlerësimit në shpjegime e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se bazuar në nenin 23/1 të ligjit nr. 9367/2005 dhe nenit 2, pika 10 e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve

¹⁹¹ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁹² Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, parashikohet¹⁹³ se trajtimi preferencial duhet të plotësojë në mënyrë kumulative këto kushte: (i) subjektit të deklarimit duhet t’i jepen shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme, të cilat mund të jenë edhe në përdorim të tij; (ii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t’i jepen subjektit të deklarimit për shkak të detyrës së tij; (iii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t’i jepen subjektit të deklarimit pa shpërblim. Subjekti deklaroi se nga hetimi i Komisionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e tij në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “****” sh.p.k. Kjo do të thotë se vendosja e çmimit në kontratë ka qenë një vullnet i lirë i palëve, pa u ndikuar nga pozicioni i punës. Gjithashtu, marrëdhënia juridiko-civile është një marrëdhënie me shpërblim. Ndodhur në këto kushte, nuk jemi përpara një trajtimi preferencial në kuptim të ligjit.

7.17. Gjithashtu, subjekti paraqiti një raport vlerësimi të pasurive të paluajtshme, duke pretenduar se në përcaktimin e çmimit të këtij apartamenti ka ndikuar: zona ku ndodhet prona objekt vlerësimi, me karakter vetëm rezidencial/banimi sezonal; ambientet e këtij objekti plotësojnë kushtet minimale standarde¹⁹⁴; nisur nga gjendja e objektit dhe pozicionimit, apartamenti nuk e ka të gjithë sipërfaqen të shfrytëzueshme pasi vetë struktura e papafingos nuk e bën të pamundur një gjë të tillë, pra është e shfrytëzuar vetëm rreth 60% e sipërfaqes; çmimi i papafingos është dakordësuar të llogaritet sa vlera 60% e çmimit për sipërfaqe banimi, duke qenë se nuk është e shfrytëzueshme; blerja drejtpërdrejt ndërmjet blerësit dhe shoqërisë ndërtuese ka shmangur tarifën e reklamimit në agjenci imobilare; në vitin 2015, sektori i ndërtimit pati një rritje të ndërtimeve, por një ulje e kërkesës për blerje bëri që çmimet të kishin një luhatje me tendencë në ulje dhe të kishte një diferencë me çmimet referencë rreth 20%; në zonën ku ndodhet apartamenti janë marrë në konsideratë disa kontrata shitblerjeje ku çmimi mesatar i shitjeve në bazë të kontratave rezultoi të jetë 292 euro/m².

7.18. *Lidhur me burimet e ligjshme për blerjen e këtij apartamenti*, subjekti sqaroi se për pagesën prej 19.000 euro, në datën 21.4.2015, ka pasur mundësi financiare si nga të ardhurat e siguruar gjatë vitit, pakësimin e gjendjes *cash* nga viti i kaluar, por edhe nga vetë gjendja *cash* e disponuar në datën e kryerjes së pagesës. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë pakësimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* nga 3.250.000 lekë në fund të vitit 2014 në shumën 1.000.000 lekë në fund të vitit 2015. Në momentin e kryerjes së pagesës ka pasur kursime *cash*, duke sjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

¹⁹³ Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në ligj: “Trajtime preferenciale” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në asetet, shërbimet, mallrat ose përfitime të tjera të ngjashme që i jepen ose janë në përdorim nga personi, pa shpërblim, si pasojë e detyrës, marrëveshjeve ose kontratave”.

¹⁹⁴ Mungesa e termoizolimit të objektit, mungesa e ashensorit. Dyshemeja është e shtruar me pllaka qeramike, dyert janë material imitim druri, tamburat, dritaret janë duralumini, ambienti i tualetit është me ndriçim dhe ajrim artificial. Objekti nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, në objekt nuk janë të vendosura sistemi i zjarrit, shkallët e emergjencës, etj. Objekti nuk ishte i pajisur me certifikatë regjistrimi (hipoteke). Godina ku ndodhet apartamenti ka një rrjet furnizimi me ujë, i cili vijon me mjete rrethore (mbushje e depozitave me kohë të pjesshme ose me vetë furnizim të jashtëm). Edhe rrjeti i jashtëm i shkarkimeve e kanalizimeve ka pasur problematika, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje në asnjë moment.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.19. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

7.20. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur 4 kontrata të lidhura në të njëjtën godinë, konkretisht: (i) kontrata nr. ***, datë 26.6.2014, apartament me sip. 140 m² në vlerën 37.800 euro, çmimi për metër katror 270 euro; (ii) kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 11.1.20013, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit A. B., për apartamentin me sip. 160 m² në vlerën 56.000 euro, çmimi për metër katror 350 euro; (iii) kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 9.3.2006, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit E. T., për apartamentin me sip. 59 m² në vlerën 17.700 euro, çmimi 300 euro/m²; (iv) kontrata e sipërmarrjes datë 5.3.2006, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit F. A., për apartamentin me sip. 59 m² në vlerën 17.700 euro, çmimi për metër katror 300 euro. Konstatohet se dy prej kontratave të paraqitura datojnë në periudhë kohore rreth 9 vite para lidhjes së kontratës nga subjekti, për pasojë nuk mund të merren si referencë nga ana e Komisionit. Ndërkohë që referuar dy kontratave të tjera të ngjashme, çmimi mesatar i shitjeve përlllogaritet në vlerën 310 lekë/m², përkundër vlerës prej 250 euro për m² të kontraktuar nga subjekti. Sipas këtij krahasimi, konstatohet se ka pasur shitje të apartamenteve me çmime më të larta, se ai i përfutur nga subjekti i rivlerësimit. Nën dritën e këtij arsyetimi, duke qenë se në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në vitin 2015 u provua edhe gjatë hetimit se subjekti nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në raport me shoqërinë “****” sh.p.k., trupi gjykues arriti në konkluzionin se nuk gjenden elemente që e kualifikojnë këtë rrethanë si një trajtim preferencial lidhur me çmimin për përfitimin e apartamentit, në kuptim të situatës faktike e parashikimeve ligjore në fuqi.

7.21. Në përfundim, ky konkluzion, i cili mbështetet edhe në një interpretim logjik të të gjitha të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi, e bëjnë diferencën në çmimin e shitjes krahasuar me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë, pa relevancë për nxjerrjen e ndonjë konkluzioni që mund të çonte në ndonjë kualifikim ligjor me pasojë për procesin e rivlerësimit lidhur me këtë rrethanë.

7.22. Në vijim të arsyetimit lidhur me likuiditetet *cash*, trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni reflektoi në analizën financiare shumë -2.250.000 lekë në zërin “Ndryshimi i likuiditeteve *cash*” dhe vijoi me kryerjen e analizës financiare në datën 21.4.2015, paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 9 – Analiza financiare datë 21.4.2015

Apartament me sip. 151,4 m ² , ***	4,897,450
Tokë bujqësore sip. 1.000 m ² , ***, Durrës	221,000
Shtim/pakësim <i>cash</i>	-2,250,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	5,353,332
Total pasuri	8,221,782
Detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për ap. papafingo, ***, Durrës	2,236,120
Total detyrime	2,236,120
Të ardhura subjekti nga pagat	533,755
Të ardhura subjekti nga mësimdhënia në Shkollën e Magjistraturës	0
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	2,216,471
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë studios ligjore	81,696
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë UAMD	216,671
Të ardhura nga qiraja e ambientit me sip. 40 m ² tek bly. “****”	170,000
Të ardhura nga shitja e ap. me sip. 148 m ²	5,186,882
Të ardhura nga interesat bankarë	2,257
Total të ardhura	8,407,732
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	276,607
Shpenzime për shkollimin e vajzave	132,144
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	69,100
Total shpenzime	477,851
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	1,944,219

7.23. Në përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në ***.

7.24. Në konkluzion të analizimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit dhe ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

8. Tokë bujqësore me sip. 1.000 m², në *, Durrës, në vlerën 221.000 lekë**

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje tokë bujqësore me nr. kontrate ***, datë 17.2.2015, me sip. 1.000 m², në ***, Durrës, z. k. ***. Vlera: 221.000 lekë. Pjesa takuese: 100% familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹⁹⁵.

8.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar blerje tokë bujqësore me sip. 1.000 m², ndodhur në ***, Durrës, z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në favor të shtetasve Madrid dhe B. Kullolli, me kontratën nr. ***, datë 17.2.2015, vlera 221.000 lekë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 17.2.2015, ku subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasit F. dhe J. B. tokë bujqësore me sip. 1.000 m², ***, Durrës, në

¹⁹⁵ Kontratë shitblerjeje nr. *** datë 17.2.2015, certifikatë për vërtetim pronësie datë 24.8.2015, për tokë bujqësore me sipërfaqe 1.000 m², ***, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelën e pasurisë.

vlerën 221.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë datë 24.2.2015, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

8.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja¹⁹⁶, Drejtoria Vendore Durrës konfirmon se në emër të shtetasve Madrid dhe B. Kullolli është e regjistruar pasuria tokë arë me sip. 1.000 m², ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, ***, Durrës.

8.4. *Lidhur me origjinën e pasurisë* – referuar kartelës së pasurisë bashkëlidhur përgjigjes së administruar nga dosja e ILDKPKI-së, rezulton se kjo pronë në vitin 2014 ka qenë e regjistruar në emër të familjes bujqësore D. të përbërë nga 4 anëtarë, më pas me dëshmi trashëgimie ka kaluar në favor të 7 anëtarëve të familjes me mbiemër D.. Më pas, kjo pasuri është regjistruar në favor të shtetasve F. e J. B. me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 27.11.2014, shuma e paguar 221.000 lekë.

8.5. Bazuar në Vendimin nr. 514, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”¹⁹⁷, vlera reale e tregut për tokë bujqësore në zonën ***, qarku Durrës, përlllogaritet 221 lekë/m², në total për 1.000 m² çmimi i kësaj pasurie shkon 221.000 lekë, e njëjtë me vlerën e përcaktuar në kontratë.

8.6. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë gjendjen aktuale të kësaj prone, nëse mbi të është investuar apo është dhënë me qira deri më tani, si dhe të vendosë në dispozicion koordinatat gjeografike të kësaj prone në *Google Maps*. Në përgjigje, subjekti deklaroi se në këtë pasuri nuk janë kryer investime dhe as nuk është dhënë me qira ndonjëherë. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti përgjigjen nr. *** prot., datë 21.11.2023, të IVMT-së Durrës.

8.7. Komisioni vëren se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Durrës bën me dije se kjo pronë rezulton hapësirë e pandërtuar, duke bashkëlidhur ortofotot dhe fotografite ilustruese të gjendjes aktuale në terren në datën 21.11.2023, nga ku shihet se nuk rezulton të jetë investuar nga ana e subjektit. Me anë të pyetësorit nr. 3¹⁹⁸, subjektit iu kërkua sërish të vendosë në dispozicion koordinatat gjeografike të kësaj prone në *Google Maps*. Në përgjigje¹⁹⁹, subjekti deklaroi se koordinatat gjeografike janë 461539.851 dhe 4598195.416, referuar gjeoportalit të paraqitur.

8.8. Nga hetimi i Komisionit²⁰⁰ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit e kësaj prone²⁰¹.

8.9. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Nga analizimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit pranë Raiffeisen Bank²⁰², konstatohet se në datën 18.2.2015 është kryer një depozitim në shumën 221.000 lekë, me përshkrimin “Derdhje në llogari” dhe në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në favor të noteres A. S., me përshkrimin “Kontratë shitjeje nr. ***

¹⁹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.4.2021.

¹⁹⁷ Shfuqizuar me vendimin nr. ***, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (vlera reale e tregut për tokë bujqësore në zonën ***, qarku Durrës përlllogaritet 273 lekë/m²).

¹⁹⁸ *Email* datë 19.1.2024, ora 10:01.

¹⁹⁹ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 29.1.2024.

²⁰⁰ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

²⁰¹ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

²⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

rep., nr. *** kol.”. Analiza financiare për blerjen e kësaj pasurie është e përfshirë në analizën e datës 21.4.2015, në përlllogaritjen e këstit 19.000 euro, për blerjen e pasurisë apartament papafingo me sip. 140 m², në ***.

8.10. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri, ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe se nuk konstatohen problematika të tjera, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

9. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, viti i prodhimit 2006, në vlerën 750.000 lekë**

9.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz ***”, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.5.2013. Vlera: 750.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues²⁰³.

9.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar blerje automjeti tip “Mercedes-Benz ***”, me kontratën nr. ***, datë 1.5.2013, vlera 750.000 lekë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 1.5.2013, sipas së cilës shtetasja B. K. ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” në vlerën 750.000 lekë, vit prodhimi 2006. Referuar certifikatës së pronësisë datë 3.5.2013 dhe lejes së qarkullimit, ky automjet me targë *** figuron i regjistruar në emër të shtetasës B. K..

9.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja²⁰⁴, referuar deklaratës doganore nr. ***, datë 14.4.2013, ky mjet është blerë nga shtetasi B. I. në shumën 7.390 euro, ndërsa shpenzimet doganore kanë qenë në shumën 211.123 lekë, pra në total ky automjet ka kushtuar 1.245.058 lekë²⁰⁵, pa përfshirë shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës.

9.4. Komisioni vëren se subjekti e ka blerë këtë automjet 2 javë më vonë, për një çmim rreth 495.000 lekë më të ulët²⁰⁶. Nga hetimi rezultoi se shtetasi B. I. është i regjistruar në QKB në datën 24.11.2009, me NIPT ***, me aktivitet “Tregti automjetesh”. Sa rezultoi, subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të pyetësorit nr. 1 dhe, në përgjigje, deklaroi se shitësi e kishte sjellë automjetin sipas një porosie tjetër, por për shkak të defektit në kamio, të ndodhur gjatë rrugës së kthimit, blerësi nuk pranoi ta merrte automjetin. Pasi u interesua pranë një servisi (të një të njohuri të tij), i cili mori përsipër riparimin e kamios, ranë dakord me shitësin për ta blerë automjetin sipas çmimit të kontratës dhe kostoja e riparimit të kamios ka qenë 250.000 lekë (janë të njohura defektet në kamio automatike te mjetet e llojit B Class), shpjegoi subjekti.

9.5. Në vitin 2018, ky automjet i është shitur babait të bashkëshortes së subjektit, shtetasit B. P., me anë të kontratës nr. ***, datë 31.1.2018, me çmim 400.000 lekë.

²⁰³ Kontratë nr. ***, datë 1.5.2013; leje qarkullimi në emër të shtetasës B. K.; certifikatë pronësie e automjetit me targë *** në emër të shtetasës B. K..

²⁰⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

²⁰⁵ Referuar kursit të këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 139,91 lekë.

²⁰⁶ Diferenca midis kostonë së blerjes (1.245.058 lekë) dhe çmimit të shitjes (750.000 lekë).

9.6. Nga hetimi i Komisionit²⁰⁷ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësin e këtij automjeti²⁰⁸.

9.7. Referuar analizës financiare në datën 1.5.2013, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

9.8. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri, ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

10. Automjet tip “Volkswagen”, me targë *, viti i prodhimit 2008, në vlerën 800.000 lekë**

10.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “Volkswagen ***”, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.10.2016. Vlera: 800.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues²⁰⁹.

10.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar kontratën nr. ***, datë 20.10.2016, për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”, viti i prodhimit 2008, me vlerë 800.000 lekë. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 20.10.2016, me palë shitëse shtetasi B. H., për blerjen e automjetit tip “Volkswagen”, në vlerën 800.000 lekë, me targë ***, viti i prodhimit 2008. Referuar certifikatës së pronësisë datë 4.11.2016 dhe lejes së qarkullimit, ky automjet me targë *** figuron i regjistruar në emër të shtetasit Madrid Kullolli. Po ashtu edhe sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja²¹⁰, ky automjet rezulton i regjistruar në emër të subjektit.

10.3. Referuar deklaratës doganore nr. ***, datë 14.11.2015, ky mjet është blerë nga shtetasi B. H. në shumën 7.000 euro, ndërsa shpenzimet doganore kanë qenë në shumën 202.227 lekë, pra në total automjeti ka kushtuar 1.176.487 lekë²¹¹, pa përfshirë këtu dhe pa llogaritur shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës. Komisioni vëren se subjekti e ka blerë këtë automjet 11 muaj më vonë, për një çmim rreth 376.000 lekë më të ulët²¹². Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se kontrata për blerjen e automjetit është lidhur me shitësin pas rreth një viti nga hyrja e tij dhe në blerjen e automjetit janë mbajtur parasysh amortizimi²¹³ i automjetit, disa defekte mekanike dhe xhenerike që automjeti kishte në momentin e blerjes, kilometrat e përshkuar nga automjeti, si dhe viti i prodhimit të tij 2008 etj.

²⁰⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

²⁰⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

²⁰⁹ Kontratë nr. ***, datë 20.10.2016, leje qarkullimi dhe certifikata e pronësisë së automjetit me targë *** në emër të shtetasit Madrid Kullolli.

²¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

²¹¹ Referuar kursit të këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 139,18 lekë.

²¹² Diferenca midis kosos së blerjes (1.176.487 lekë) dhe çmimit të shitjes (800.000 lekë).

²¹³ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 22 “Amortizimi”: “4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara, llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind; 5. Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje, si më poshtë: a) Kompjutera, sisteme informacioni, produkte “softëare” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind. b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20%”.

10.4. Nga hetimi i Komisionit²¹⁴ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësin e këtij automjeti²¹⁵.

10.5. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 20.10.2016, duke mos konsideruar pakësimin e likuiditeteve *cash*, bazuar në vendimin nr. 07-2019 (JR), datë 5.4.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas të cilit, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike²¹⁶.

10.6. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.741.428 lekë, në datën 20.10.2016, për blerjen e pasurive, shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.*

10.7. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se në analizën financiare nuk është marrë në konsideratë fitimi i realizuar gjatë vitit 2016 dhe i tërhequr prej tyre dhe duhet të përfshihet shuma 3.000.000 lekë që i përket huas së marrë nga ortaku në shumën 1.500.000 lekë dhe tërheqjeve të kryera gjatë vitit 2016 po në shumën 1.500.000 lekë. Vlera e tërhequr nga ortaku gjatë vitit 2016 është reflektuar në pasqyrat financiare të korigjuara. Në përfundim, subjekti deklaroi se nëse në analizën financiare do të përfshihet sa pretendohet, atëherë në datën e pagesës do të rezultojë me mundësi financiare në shumën 258.572 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

10.9. Në vijim të arsytimit në pikën 1 të këtij vendimi, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti, në kushtet që nuk mund të përcaktohet data e saktë e tërheqjes së shumës 3.000.000 lekë, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për vitin 2016, paraqitur në tabelën vijuese.

²¹⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

²¹⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

²¹⁶ Vendim nr. 07-2019 (JR), datë 5.4.2019.

Tabela nr. 10 – Analiza financiare viti 2016

Përshkrimi	Vlera
Automjet tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2008, targë ***	800,000
Shtim/pakësim <i>cash</i>	0
Shtim/pakësim likuiditete bankë	1,168,835
Total pasuri	1,968,835
Të ardhura subjekti nga pagat	1,604,485
Të ardhura subjekti nga mësimdhënia në Shkollën e Magjistraturës	24,575
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	3,000,000
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë studios ligjore	234,744
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë UAMD	677,722
Të ardhura nga qiraja e ambientit me sip. 40 m ² tek blv. “****”	510,000
Të ardhura nga interesat bankarë	65,046
Total të ardhura	6,116,572
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	940,368
Shpenzime për shkollimin e vajzave	818,275
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	596,671
Pagesë kësti prej 10.000 euro shoqërisë “****” sh.p.k.	1,394,800
Total shpenzime	3,750,114
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	397,623

10.10. Sa më lart, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”, shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2016.

10.11. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri, ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe se nuk konstatohen problematika të tjera, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

11. Automjete të tjera

11.1. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, prodhim i vitit 1991**

11.1.1 Në DIPP/2005, subjekti ka deklaruar autoveturë, prodhim i vitit 1991, blerë në vitin 2005 me të ardhurat nga paga, në shumën 400.000 lekë, me pjesë takuese 100%. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti paraqiti kontratën nr. ***, datë 4.1.2005. Më tej, në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar shitje automjeti tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1991, me kontratën nr. ***, datë 20.1.2009, në shumën 4.800 euro. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti ka paraqitur kontratën nr.***, datë 20.1.2009, sipas së cilës ky automjet i është shitur shtetasit E. T., në shumën 4.800 euro.

11.1.2 Komisioni vëren se subjekti e ka shitur këtë automjet rreth 200.000 lekë²¹⁷ më shumë pas rreth 4 vitesh përdorimi dhe, për këtë arsye, me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë konstatim. Në përgjigje, ai shpjegoi se çmimi i blerjes ka qenë rrjedhojë

²¹⁷ Diferenca midis çmimit të shitjes (4.800 euro x 124.98 lekë = 599.904 lekë) dhe çmimi të blerjes (400.000 lekë).

e çmimit okazion, ndërsa çmimi i shitjes si rezultat i vlerës së tregut për shkak edhe të mirëmbajtjes së automjetit.

11.1.3 *Për sa i përket të ardhurave të realizuara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2009*, Komisioni vëren se pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference (detyruese) për shitblerje automjetesh, shitja e këtij automjeti në vlerë më të lartë është jashtë logjikës, sipas së cilës një mjet që përdoret amortizohet. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk paraqitit dokumentacion ligjor justifikues për të provuar shpenzimet e mirëmbajtjes, referuar jurisprudencës së KPA-së²¹⁸. Për rrjedhojë, konsideroi si të ardhura të ligjshme një shumë të barabartë me atë të blerjes, pra 400.000 lekë (përkundrajt 4.800 euro të përcaktuar në kontratën e shitjes).

11.1.4 *Lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme financiare*, Komisioni vëren se në DIPP/2005, për blerjen e këtij automjeti në datën 4.1.2005, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga. Në kontratën e blerjes nr. ***, datë 4.1.2005, parashikohet se çmimi është likuiduar në dorë nga blerësi, jashtë zyrës noteriale.

11.1.5 Komisioni konstaton se nëse do të ishin krijuar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, ato do të duhet të ishin deklaruar në DIPP-në e vitit përkatës në përputhje me kërkesat ligjore, konkretisht referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë”.

11.1.6 Në vijim të sa më lart, Komisioni verifikoi lëvizjet e llogarive bankare gjatë periudhës 1.1.2005 – 4.1.2005 dhe konstatoi se tërheqja e parë e vitit daton më 5.1.2005, në shumën 40.000 lekë, nga llogaria e pagës së subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank, pra pas datës së lidhjes së kontratës. Për rrjedhojë, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

11.1.7 **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 400.000 lekë për blerjen e automjetit në datën 4.1.2005.*

11.1.8 **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës**, deklaroi se objekti i këtij hetimi nga ana e Komisionit janë vetëm ato pasuri që kanë ekzistuar ditën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, që kanë qenë në pronësi, posedim apo mbi të cilat subjekti ka pasur të drejta reale, ku futet dhe përdorimi. Ndërkohë për pasuri të tjera që kanë ekzistuar, por që nuk janë më, nuk janë objekt i hetimit dhe, për

²¹⁸ Vendimin nr. 23 datë 23.09.2019 të KPA

rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për një pasuri që nuk e ka. Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka qenë në pronësi, posedim apo përdorim nga ana e subjektit dhe personave të lidhur dhe se nuk është pyetur nga ana e Komisionit në lidhje me burimet e krijimit që shërbyen për blerjen tij. Sikurse ka deklaruar dhe në pyetësorin standard, duke filluar nga marsi 2004 deri në prill 2015 ka jetuar me prindërit e bashkëshortes. Në momentin e blerjes së automjetit në datën 4.1.2005 ka përdorur kursimet e prindërve të bashkëshortes dhe gjatë vitit 2005 u ka rikthyer shumën e marrë. Në kushtet e marrëdhënies së posaçme familjare dhe bashkëjetesës me ta nuk është dokumentuar dhe nuk është nënshkruar asnjë dokument për shumën e marrë dhe të kthyer. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk duhet të kufizojë analizën financiare vetëm mbi të ardhurat e familjes së subjektit, por edhe mbi mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes në datën 4.1.2005.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.1.9 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.1.10 Komisioni nuk ka kërkuar shpjegime nga ana e subjektit lidhur me faktin se përse nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* ky automjet i blerë në vitin 2005 dhe i shitur në vitin 2009, për sa kohë subjekti nuk e ka pasur në pronësi/përdorim gjatë kohës së plotësimit të kësaj deklaratë. Gjithashtu, çmon të theksojë se ligji nr. 84/2016 në nenin 32, pika 5 parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit bazohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit në deklaratën e rivlerësimit krahasuar me deklaratimet periodike, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete).

11.1.11 Lidhur me burimin e krijimit, Komisioni vlerëson se në DIPP/2005 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga paga, ndërkohë që vetëm pas kalimit të barrës së provës pretendoi se në momentin e blerjes se këtij automjeti si burim krijimi kanë shërbyer kursimet *cash* të prindërve të bashkëshortes.

11.1.12 Për rrjedhojë, për sa kohë që subjekti e ka deklaruar qartësisht burimin e krijimit në DIPP/2005, Komisioni çmon se pretendimi i tij është i pabazuar dhe mbetet i pandryshuar rezultati se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -400.000 lekë për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në datën 4.1.2005.

11.1.13 Për sa rezulton më lart, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin lidhur me burimin e krijimit të këtij automjeti dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme

për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11.2. Automjet tip “Mercedes-Benz 211”, me targë *, prodhim i vitit 2002**

11.2.1 Në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar blerje automjeti tip “Mercedes-Benz 211”, prodhim i vitit 2002, me kontratën nr. ***, datë 12.2.2009, në shumën 9.500 euro, me burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip ***, plus të ardhura familjare. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti është pyetur lidhur me automjetin e deklaruar në vitin 2009, targat e këtij automjeti dhe kontratën e blerjes. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se automjeti i blerë në vitin 2009 me kontratën nr. ***, datë 12.2.2009, ka pasur targën *** dhe më pas i ndryshuar në ***. Subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 12.2.2009, sipas së cilës ka blerë nga shtetasja Nexhmije Rusi automjetin tip “Mercedes-Benz”, Daimler Chrysler ***, me targë ****, në shumën 9.500 euro. Për sa i përket shitjes, në DIPP/2013 subjekti ka deklaruar shitje të automjetit tip “Mercedes-Benz”, *** me targë *** me kontratën nr. ***, datë 28.3.2013, në shumën 9.000 euro, kontratë e cila është administruar edhe nga noteri publik B. Ç.²¹⁹.

11.2.2 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e këtij automjeti për periudhën 1.1.2009 – 12.2.2009, ku konstatohet një balancë negative në shumën 937.099 lekë.

11.2.3 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 937.099 lekë për blerjen e automjetit në datën 12.2.2009.*

11.2.4 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se nëse në analizën financiare të Komisionit do të përfshihet pakësimi i kursimeve *cash* në shumën 3.200.000 lekë, në momentin e blerjes së automjetit do të rezultojë me balancë pozitive. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit sipas vendimit nr. 37/2021, pasaktësitë në deklarime të pashoqëruara me pamjaftueshmëri, nuk mund ta ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.2.5 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

²¹⁹ Shkresa e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.8.2023. Blerës shtetasi E. G.. Referuar dokumentacionit të administruar nga noteri publik A. Xh., shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.8.2023, automjeti me targë *** i është shitur shtetasit M. V. me anë të kontratës nr. ***, datë 8.2.2013, në vlerën 9.000 euro, likuiduar në prezencë të noterit. Më pas, palët e kanë revokuar këtë kontratë me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 28.3.2013, duke u kthyer në gjendjen fillestare që kanë qenë para lidhjes së kësaj kontrate dhe duke likuiduar njëri-tjetrin në aspektin financiar.

11.2.6 Në vijim të arsyetimit lidhur me likuiditetet *cash*, trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni reflektoi në analizën financiare pakësimin vjetor prej 1.600.000 lekësh²²⁰ në zërin e ndryshimit të likuiditeteve *cash* dhe vijoi me kryerjen e analizës financiare për të gjithë vitin 2009, ndodhur në kushtet që nuk mund të përcaktohet me saktësi momenti i pakësimit të kursimeve të mbartura prej 3.200.000 lekësh dhe shtimi i kursimeve vjetore prej 1.600.000 lekësh.

Tabela nr. 11 – Analiza financiare, viti 2009

Përshkrimi	Vlera
Automjet tip “Mercedes-Benz 211”, vit prodhimi 2002, me targë ***	1,230,725
Shtim/pakësim <i>cash</i>	-1,600,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	212,333
Total pasuri	-156,942
Të ardhura nga pagat e subjektit	1,188,985
Të ardhura bashkëshortja nga aktiviteti si avokate, person fizik	1,560,000
Të ardhura bashkëshortja nga pagat pranë Avokaturës së Shtetit	42,069
Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes-Benz, me targë ***	400,000
Të ardhura nga interesat bankarë	5,462
Total të ardhura	3,196,516
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	409,860
Shpenzime për shkollimin e vajzave	44,000
Shpenzime për studimet pasuniversitare të bashkëshortes në ***	109,736
Shpenzim për shlyerjen e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank	3,300,881
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	390,206
Total shpenzime	4,254,683
Balanca e fondeve (të ardhura - pasuri - shpenzime)	-901,225

11.2.7 Sa më lart, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -901.225 lekë në vitin 2009, për blerjen e automjetit, shtesën e kursimeve, shlyerjen e parakohshme të kredisë dhe kryerjen e shpenzimeve.

11.2.8 Në konkluzion të analizimit të kësaj pasurie, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën 901,225 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11.3. Automjet tip “Fiat Uno”, me targë * prodhim i vitit 1984**

11.3.1 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 7.12.2012, subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me automjetin me targë ***, regjistruar në emër të bashkëshortes së tij, automjet i cili nuk është deklaruar. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë në vitin 2005 nga bashkëshortja e tij, në vlerën 50.000 lekë dhe se nuk është deklaruar për shkak neglizhence. Subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.6.2005, sipas së cilës ka blerë nga shtetasi B. M., automjetin tip “Fiat Uno”, vit prodhimi 1984, çmimi 50.000 lekë. Më tej, në procesverbalin e datës 18.7.2016, subjekti është pyetur lidhur me faktin se DPSHTRR-ja në

²²⁰ Diferenca midis gjendjes 3.200.000 lekë në fund të vitit 2008 me gjendjen 1.600.000 lekë në fund të vitit 2009.

përgjigjen e saj nuk konfirmon automjet në emër të subjektit, ndërkohë që konfirmon në emër të bashkëshortes së subjektit automjetin me targë ***, çregjistruar më 3.11.2013 dhe automjetin me targë ***. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se automjeti me targë *** është çregjistruar pasi ishte automjet i vitit 1983 dhe vlera e blerjes ka qenë 50.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.6.2005. Deri më 31.12.2014 disponojnë vetëm automjetin në emër të bashkëshortes me targë ***²²¹. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar për blerjen e këtij automjeti, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar çregjistrimin e tij. Në përgjigje, subjekti deklaroi se burimi i blerjes së automjetit janë kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat nga pagat. Për të provuar çregjistrimin e mjetit, subjekti paraqiti vërtetimin e lëshuar nga DRSHTRR-ja për çregjistrimin e automjetit në datën 11.3.2013.

11.3.2 Lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme financiare, Komisioni vëren se gjatë periudhës 1.1.2005 – 29.6.2005 subjekti ka tërhequr nga llogaria e pagës pranë Intesa Sanpaolo Bank një shumë totale prej 480.000 lekësh, e cila është e mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti me çmim 50.000 lekë.

11.3.3 Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2005 blerjen e këtij automjeti, bazuar në parashikimet e shkronjës “b” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to. Pasaktësi të cilat do të mbahen në konsideratë në vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë.

12. Llogaritë bankare (të deklaruara në seksionin “Të dhëna konfidenciale”)

12.1. Lidhur me llogaritë bankare të deklaruara në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit, duke mos përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën I të nenit 31 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se tek rubrika “Të dhëna konfidenciale”, në të cilën janë bërë shënimet në deklaratë, mungon kolona për burimin, i cili gabimisht është harruar pa u deklaruar.

a) *Llogaritë bankare të deklaruara nga subjekti*

12.2. Llogari në vlerën 28.855 lekë në Raiffeisen Bank

12.2.1 Në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në vlerën 28.855 lekë në Raiffeisen Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për gjendjen e llogarisë në datën 19.1.2017, në vlerën 28.855 lekë.

12.2.2 Raiffeisen Bank²²² konfirmon gjendjen e llogarisë të deklaruar nga subjekti. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se kjo llogari është çelur në datën 3.9.2007 dhe kreditimet vijnë nga pagat.

²²¹ Automjeti në emër të bashkëshortes fillimisht ka pasur targën *** dhe më pas me blerjen e tij me kontratën nr. *** datë 1.5.2013, targat e vendosura janë ***.

²²² Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

12.2.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.3. Llogari në vlerën 0.00 euro, në Raiffeisen Bank

12.3.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në euro me gjendje 0.00 në Raiffeisen Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për gjendjen e llogarisë në datën 19.1.2017, në vlerën 0.00 euro.

12.3.2 Raiffeisen Bank²²³ konfirmon gjendjen e llogarisë të deklaruar nga subjekti. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se kjo llogari është çelur në datën 30.11.2012 dhe përdoret për pagesat e kryera me kartë krediti *MasterCard*.

12.3.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.4. Llogari në vlerën 394,25 USD në Raiffeisen Bank

12.4.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në vlerën 394,25 USD në Raiffeisen Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për gjendjen e llogarisë në datën 19.1.2017. Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar gjendje llogarie në dollar, nr. ***, me gjendje në datën 31.12.2016 në vlerën 394,25 USD, me burim të ardhura nga paga (mësimdhënie).

12.4.2 Raiffeisen Bank²²⁴ bën me dije se gjendja e kësaj llogarie në datën 19.1.2017 ka qenë 349 USD (deklarimi i subjektit se gjendja ka qenë 394 USD duket një lapsus). Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se si burim për shumën 394 USD kanë shërbyer tri transferta, nga *US State Department* gjatë periudhës qershor – gusht 2016, transferta të cilat – referuar përshkrimit në lëvizjen e llogarisë dhe deklarimit të subjektit lidhur me udhëtimet – i përkasin pjesëmarrjes së subjektit në vitin 2016 në konferencën me temë “Për mbrojtjen e viktimave të veprës penale”.

12.4.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.5. Llogari në vlerën 40.393 lekë në Credins Bank

12.5.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në vlerën 40.393 lekë në Credins Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për

²²³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

²²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Credins Bank për gjendjen e llogarisë në datën 23.1.2017, në vlerën 40.393 lekë.

12.5.2 Credins²²⁵ Bank konfirmon gjendjen e llogarisë së deklaruar nga subjekti. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat e subjektit.

12.5.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.6. Llogari në vlerën 1.500,78 USD në Intesa Sanpaolo Bank

12.6.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në vlerën 1.500,78 USD në Intesa Sanpaolo Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar në Intesa Sanpaolo Bank për gjendjen e llogarisë në datën 23.1.2017, në vlerën 1.500,78 USD.

12.6.2 Banka Sanpaolo Bank²²⁶ konfirmon gjendjen e llogarisë të deklaruar nga subjekti. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se burim i gjendjes së deklaruar është një kreditim nga “****”, në datën 6.5.2013, në vlerën 1.503 USD.

12.6.3 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti ka deklaruar se këto janë të ardhura të përfituara si ekspert trajnues nga OPDAT-i, si dhe ka paraqitur kontratën për shërbime konsulence (dokument në gjuhën angleze me emërtim “****”), lidhur midis palëve “****.” dhe subjektit të rivlerësimit. Komisioni vëren se në këtë kontratë parashikohet se çdo detyrim tatimor lidhur me këto të ardhura janë përgjegjësi e konsulentit, pra në rastin konkret përgjegjësi e subjektit²²⁷. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë nëse për këto të ardhura janë paguar detyrime tatimore, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues. Në përgjigje, subjekti deklaroi se lidhur me këtë pagesë të gjitha detyrimet tatimore janë paguar prej donatorëve, por nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për të provuar deklaratimet e tij.

12.6.4 Komisioni vëren se – në kushtet që pagimi i tatimit ka qenë detyrim ligjor²²⁸ dhe kontraktual i subjektit – të ardhurat e përfituara nga shërbimet e ofruara nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3, fjalia 2 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore e, si të tilla, nuk u përfshinë në zërin e të ardhurave për efekt të analizës financiare të vitit 2013.

12.6.5 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e llogarisë bankare në vitin 2013, në shumën 1.500 USD (ekuivalenti*

²²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2021.

²²⁷ Në seksionin B citohet: “Any taxes payable on this compensation, shall be the responsibility of the consultant”.

²²⁸ Këto të ardhura janë përfituar nga persona juridikë në dukje të regjistruar jashtë territorit shqiptar.

153.570 lekë), pranë Intesa Sanpaolo Bank, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga konsulenca.

12.6.6 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se nuk ka qenë i vëmendshëm në lidhje me parashikimin në seksionin B të kontratës, ku përcaktohet se çdo detyrim tatimor lidhur me këto të ardhura janë përgjegjësi e konsulentit, pra në rastin konkret përgjegjësi e tij. Në dijeninë e subjektit detyrimet që lidheshin me tatimin në burim për këto të ardhura nga mësimdhënia janë mbuluar nga donatori, që organizoi edhe trajnimin. Në përfundim deklaroi se pranon detyrimet që lindin si rrjedhojë e pagesës së tatimit në burim për këto të ardhura të realizuara dhe në cilësinë e provës në datën 4.3.2024 paraqiti pagesën e tatimit për DIVA 2013 pranë Raiffeisen Bank²²⁹.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.6.7 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

12.6.8 Që një e ardhur të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, sipas dispozitave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, kërkohet të plotësohen në mënyrë kumulative elementet që dëshmojnë gjurmë të përfitimit të saj në kohën e krijimit, se është e ardhur e siguruar nga burime të ligjshme dhe se janë paguar detyrimet tatimore për të.

Trupi gjykues vendosi të marrë në konsideratë pretendimet e subjekti se nuk ka qenë në dijeni të detyrimeve që lidheshin me tatimin në burim për këto të ardhura, për sa kohë rezultoi se: (i) janë krijuar nga burime të ligjshme; (ii) subjekti ka paguar detyrimet tatimore, pasi mori dijeni për këtë rrethanë; (iii) faktin se parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës nuk e lidhin pagesën e tatimeve me një afat të caktuar.

12.6.9 Sa rezulton, pagesa e detyrimeve tatimore²³⁰ bazuar në praktikën e Kolegjit²³¹ është një rrethanë që vlerësohet se e shëron legjitimitetin e kësaj shume dhe e sjell atë në standardin e të ardhurës të ligjshme, sipas nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, u përfshinë në analizën financiare të ardhurat në shumën 1.500 USD (ekuivalenti 153.570 lekë).

12.7. Llogari në vlerën 5.872,10 lekë në Intesa Sanpaolo Bank

12.7.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari në vlerën 5.872,10 lekë në Intesa Sanpaolo Bank. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank për gjendjen e llogarisë në datën 23.1.2017, në vlerën 5.872,10 lekë.

²²⁹ Dokumentacion i protokolluar në Komision me nr. ***, datë 4.3.2024.

²³⁰ Detyrime tatimore në shumën 15.365 lekë, gjobë në shumën 8.365 lekë dhe interes në shumën 9.840 lekë.

²³¹ Vendim nr. 38/2002 (JR) i subjektit G. Xh..

12.7.2 Intesa Sanpaolo Bank²³² konfirmon gjendjen e llogarisë të deklaruar nga subjekti. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se në këtë llogari kreditohen pagesa nga ***, me përshkrimin “[...] pagesë për pjesëmarrje në konferenca [...]”.

12.7.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

b) Llogaritë bankare të deklaruara nga bashkëshortja

12.8. Banka Kombëtare Tregtare – B. K., llogaria nr. *, vlera 17.633 euro**

12.8.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari në BKT me nr. **. Si burim krijimi, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhurat nga kontrata e shitjes nr. **, datë 18.12.2014, të apartamentit në Lagjen Nr. **, Durrës, i blerë ky me anë të kredisë nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane) me kontratën e kredisë nr. **, datë 2.6.2006. Gjendja në datën 24.10.2016, në vlerën 17.633 euro. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²³³.

12.8.2 Banka Kombëtare Tregtare²³⁴ konfirmon llogarinë në emër të znj. B. K., çelur më 7.1.2015 dhe me gjendje 17.628,57 euro në datën 25.1.2017. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se në datën 21.1.2015 është transferuar shuma 17.628,24 euro nga notere A. S., me përshkrimin “Tjetërsim pasurie për B. B. K., kalim sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.12.2014”. Komisioni vëren se transfertat e mësipërme ka të bëjë me të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë apartament banimi me sip. 148 m², trajtuar në pikën 13 të këtij vendimi e, për rrjedhojë, konkluzioni për këtë pasuri të luajtshme është i lidhur me barrën e provës së kaluar në paragrafin përkatës.

12.9. Raiffeisen Bank – B. K., llogaria nr. *, vlera 16.316 euro**

12.9.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari në Raiffeisen Bank me nr. **. Si burim krijimi, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhurat nga kontrata e shitjes nr. **, datë 18.12.2014, të apartamentit në Lagjen Nr. **, Durrës, i blerë me anë të kredisë nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane) me kontratën e kredisë nr. ** datë 2.6.2006.

12.9.2 Lidhur me vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²³⁵. Raiffeisen Bank²³⁶ konfirmon llogari në emër të shtetasës B. K., çelur në datën 30.1.2015 dhe me gjendje 16.315,81 euro në datën 25.1.2017. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se gjendja e mësipërme ka si burim: (i) shumën 15.315 euro të mbetur në llogari pas transferimit të

²³² Shkresë nr. ** prot., datë 1.3.2021.

²³³ *Statement* bankar nga BKT-ja, ku gjendja e llogarisë është 17.636 euro; kontratë shitjeje e apartamentit nr. **, datë 18.12.2014; kontratë për shitblerje pasurie të paluajtshme nr. **, datë 17.5.2006; kontratë kredi bankare nga Banka Amerikane nr. **, datë 2.6.2006; kontratë hipotekimi nr. **, datë 2.6.2006.

²³⁴ Shkresë nr. ** prot., datë 27.2.2021.

²³⁵ Kontratë shitjeje e pjesës takuese të apartamentit nr. **, datë 18.12.2014, në vlerën 5.186.882 lekë; kontratë blerjeje apartamenti nr. **, datë 17.5.2006; kontratë kredi bankare nga Banka Amerikane nr. **, datë 2.6.2006; kontratë hipotekimi nr. **, datë 2.6.2006.

²³⁶ Shkresë nr. ** prot., datë 16.2.2021.

shumës 20.370 euro, në datën 18.2.2015, nga notere A. S., me përshkrimin “Çngurtësim kont. shitje, datë 18.12.2014, nr. *** rep., nr. *** kol., me palë blerëse E. B. P., shitëse B. B. K.”²³⁷; (ii) shumën 1.000 euro të depozituar nga bashkëshortja në datën 20.1.2017.

12.9.3 Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar të depozitimit të shumës 1.000 euro në datën 20.1.2017, si dhe të deklarojë burimin financiar të depozitimeve të tjera të kryera në këtë llogari gjatë vitit 2016²³⁸. Në përgjigje, subjekti deklaroi se shuma 1.000 euro ka si burim gjendjen *cash* të krijuar nga kursimet familjare dhe se depozitimet e tjera të kryera gjatë vitit 2016 janë krijuar nga kursimet familjare nga të ardhurat e tyre të mbajtura *cash* në banesë.

12.9.4 Komisioni vëren se transferta e mësipërme ka të bëjë me të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë apartament banimi me sip. 148 m², trajtuar në pikën 13 të këtij vendimi e, për rrjedhojë, konkluzioni për këtë pasuri të luajtshme është i lidhur me barrën e provës së kaluar në paragrafin përkatës.

12.10. Raiffeisen Bank – B. K., llogari page nr. *, vlera 79.451 lekë**

12.10.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari në ALL nr. *** në Raiffeisen Bank, në vlerën 79.451 lekë. Nuk ka deklaruar burim krijimi.

12.10.2 Raiffeisen Bank²³⁹ konfirmon llogari në emër të shtetases B. K., me nr. ***²⁴⁰, çelur në datën 20.3.2007 dhe me gjendje 79.450,68 lekë në datën 25.1.2017. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se si burim i kësaj gjendjeje ka shërbyer një kreditim nga paga në datën 10.1.2017, në vlerën 19.562 lekë dhe një depozitim në datën 20.1.2017, në vlerën 60.000 lekë. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e krijimit të depozitimit në shumën 60.000 lekë, i cili në përgjigje deklaroi se si burim kanë shërbyer tërheqjet nga llogaria e tij në Credins Bank.

12.10.3 Komisioni konstatoi se gjatë periudhës 1.1.2017 – 20.1.2017 subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij e pagës pranë Credins Bank shumën totale prej 110.000 lekësh, çka përputhet me deklarin e tij për origjinën e depozitimit të shumës 60.000 lekë në llogarinë e bashkëshortes pranë Raiffeisen Bank.

12.10.4 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.11. Raiffeisen Bank – B. K., nr. *, vlera 9,13 lekë**

12.11.1 Në seksionin “Të dhënave konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari ALL në Raiffeisen Bank, në vlerën 9,13 lekë.

²³⁷ Referuar trajtimit në pikën 13 të pasurisë apartament banimi me sip. 148 m², transferta e mësipërme ka të bëjë me të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme.

²³⁸ Konkretisht: shuma 2.800 euro, datë 29.2.2016; shuma 2.500 euro, datë 26.5.2016, shuma 1.000 euro, datë 25.8.2016.

²³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

²⁴⁰ Numri i llogarisë së deklaruar nga subjekti duket të jetë një lapsus.

12.11.2 Raiffeisen Bank²⁴¹ konfirmon llogarinë nr. ***²⁴², çelur në datën 8.2.2007 dhe me gjendje 9,13 lekë në datën 25.1.2017. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, Komisioni konstatoi se në datën 28.12.2007 është krijuar një depozitë me vlerë 700.000 lekë (maturuar në datën 27.6.2008) dhe se si origjinë e saj kanë shërbyer disa depozitime të kryera nga bashkëshortja e subjektit gjatë vitit 2007. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar të depozitimeve që kanë shërbyer për krijimin e depozitës, si dhe të disa pagesave të tjera të konstatuara në këtë llogari bankare. Në përgjigje, subjekti deklaroi se burimi financiar i krijimit të këtyre depozitimeve, si dhe kreditimet e pagesave, janë si pjesë e aktivitetit si person fizik.

12.11.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.12. Raiffeisen Bank – B. K., llogaria nr. *, vlera 2.096 lekë**

12.12.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari në ALL nr. *** në Raiffeisen Bank, në vlerën 2.096 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për gjendjen e deklaruar të llogarisë prej 2.096 lekësh.

12.12.2 Komisioni vëren se gjendja e llogarisë së deklaruar nga subjekti i përket datës 31.12.2008 dhe jo datës 25.1.2017. Konstatohet se kjo llogari është e njëjtë me atë të trajtuar në paragrafin 12.10.

12.12.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.13. Raiffeisen Bank – studio ligjore “**” llogaria nr. ***, vlera 187.639 lekë**

12.13.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë nr. *** “****” (ndryshuar emri në “****”), me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 187.639 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për llogarinë e klientit “****”, me gjendje 187.639 lekë.

12.13.2 Raiffeisen Bank²⁴³ konfirmon gjendjen e llogarisë së deklaruar nga subjekti në datën 31.12.2016, për “****” sh.p.k. Komisioni vëren se transaksionet në këtë llogari kanë filluar në datën 7.6.2016.

12.13.3 Komisioni vëren se kjo llogari bankare i përket një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në nenin 10 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, parashikohet se: “*Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik,*

²⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

²⁴² Numri i llogarisë së deklaruar nga subjekti duket të jetë një lapsus.

²⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë”. Referuar parimeve të kontabilitetit, efektet e transaksioneve të shitblerjes së mallrave e shërbimeve, veprimeve të arkës, bankës, inventarit dhe çdo transaksioni tjetër, pjesë e aktivitetit tregtar, reflektohen tek pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor, duke pasqyruar fitimin ose humbjen e njësisë së biznesit.

12.13.4 Për rrjedhojë, Komisioni nuk e përfshiu këtë llogari bankare në pasuritë e paraqitura në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur.

12.14. Raiffeisen Bank – studio ligjore “**”, llogaria nr. ***, vlera 0 (zero) euro**

12.14.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë nr. *** “****” (ndryshuar emri në “****”), me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 0 (zero) euro. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank për llogarinë e klientit “****”, me gjendje 0 (zero) euro.

12.14.2 Raiffeisen Bank²⁴⁴ konfirmon se “****” sh.p.k. zotëron llogari në monedhën euro. Komisioni vëren se transaksionet në këtë llogari kanë filluar në datën 16.6.2017.

12.14.3 Referuar arsytimit në paragrafin 12.13.3, Komisioni nuk e përfshiu këtë llogari bankare në pasuritë e paraqitura në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur.

12.15. ProCredit Bank – B. K., llogaria nr. *, vlera 634 lekë**

12.15.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë nr. *** në ProCredit Bank, në vlerën 634 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur *statement* bankar për llogarinë në emrin e znj. B. K., me gjendje 334 lekë (vlera prej 634 lekësh e deklaruar nga subjekti duket të jetë një lapsus).

12.15.2 ProCredit Bank²⁴⁵ konfirmon se kjo llogari është çelur në datën 18.6.2013 dhe është mbyllur në datën 19.7.2017. Gjendja e llogarisë në datën 25.1.2017 ka qenë 334 lekë. Nga analizimi i lëvizjeve në këtë llogari vërehet se në këtë llogari kreditohet paga e bashkëshortes së subjektit nga punësimi pranë “****” sh.p.k. (emri i mëparshëm ***).

12.15.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.16. ProCredit Bank – B. K., llogari kursimi nr. *, vlera 2.412,33 euro** – nga hetimi rezulton se kjo llogari i përket vajzës së subjektit, S. K., trajtuar në vijim.

12.17. Credins Bank – B. K., depozitë nr. *, vlera 3.650.204 lekë**

12.17.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar depozitë në Credins Bank, me afat 12-mujor, me nr. *** (numri i

²⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

²⁴⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 12.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 3.11.2023.

mëparshëm ***), datë 23.1.2017, në vlerën 3.650.204 lekë. Nuk është deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur *statement* bankar nga Credins Bank për gjendjen e llogarisë në shumën 3.650.203 lekë.

12.17.2 Në DIPP/2012, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në vlerën 1.000.000 lekë, në Credins Bank nr. ***, me burim paga e mësimdhënies në UAM Durrës. Në DIPP/2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në vlerën 1.450.000 lekë, në Credins Bank nr. ***, me burim paga e mësimdhënies në UAM Durrës dhe në vlerën 1.030.000 lekë, në Credins Bank nr. ***, me burim paga e mësimdhënies në UAM Durrës. Në DIPP/2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në vlerën 3.023.664 lekë, në Credins Bank nr. ***, me burim paga e mësimdhënies në UAM Durrës. Kjo shtesë vjen nga bashkimi me llogarinë nr. *** në Credins Bank dhe një pjesë nga të ardhurat nga paga e vitit 2013, plus interesat dhe një pjesë nga kursimet. Në DIPP/2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në vlerën 3.108.208 lekë, në Credins Bank nr. ***, me burim paga e mësimdhënies në UAM Durrës. Në DIPP/2016, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë me afat 12-mujor, shtuar me 333.000 lekë, në Credins Bank (ish nr. ***), me burim pagat si pedagoge. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 18.7.2016, subjekti është pyetur lidhur me deklarin e kësaj depozite me të ardhurat nga paga si pedagoge, ndërkohë që referuar vërtetimit të paraqitur të ardhurat për vitin 2012 janë 686.028 lekë. Në përgjigje, subjekti shpjegoi se të ardhurat e realizuara nga mësimdhënia e bashkëshortes kanë kaluar në llogarinë e pagës së saj dhe vendosur në depozitë, e cila në vite është shtuar progresivisht dhe në fund të vitit 2014 rezulton me gjendje në vlerën 3.023.664 lekë.

12.17.3 Credins Bank²⁴⁶ konfirmon depozitë në emër të bashkëshortes, me gjendje 3.023.664 lekë, në datën 25.1.2017.

12.17.4 Lidhur me origjinën e kësaj depozite, Komisioni analizoi transaksionet e kryera ndër vite në 11 llogari bankare në emër të bashkëshortes së subjektit pranë Credins Bank. Gjendja totale e llogarive në fund të vitit 2016 (3.956.580 lekë) i përket tri pasurive likuiditet të deklaruara në deklaratën *Vetting*, konkretisht: (i) depozita nr. ***, vlera 3.650.204 lekë; (ii) depozita nr. ***, vlera 250.000 lekë; (iii) llogaria nr. ***, vlera 110.567 lekë (56.376 lekë në fund të vitit 2016 dhe 54.191 lekë kreditim nga paga, në datën 12.1.2017).

12.17.5 Komisioni konstatoi se si burim për krijim e depozitës nr. *** kanë shërbyer kryesisht kreditimet nga paga, akumulimi i interesave bankarë dhe depozitime të kryera nga bashkëshortja²⁴⁷.

12.17.6 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

²⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁴⁷ Efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare pasqyrohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.18. Credins Bank – B. K., depozitë nr. *, vlera 250.000 lekë**

12.18.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar depozitë në Credins Bank, me afat 12-mujor me nr. ***, në datën 23.1.2017, në vlerën 250.000 lekë. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur lëvizje të llogarisë bankare nga Credins Bank për gjendjen e llogarisë në shumën 250.000 lekë. Në DIPP/2016, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë me afat nr. ***, shtuar në shumën 250.000 lekë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat si pedagoge.

12.18.2 Credins Bank²⁴⁸ konfirmon depozitë në vlerën 250.000 lekë në emër të bashkëshortes së subjektit. Komisioni konstaton se kjo depozitë është krijuar me anë të një transferimi nga llogaria e pagës në llogarinë e depozitës, në datën 9.11.2016, në vlerën 250.000 lekë²⁴⁹.

12.18.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.19. Credins Bank – B. K., llogaria nr. *, vlera 110.567 lekë**

12.19.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari pagë si pedagoge në UAMD me nr. ***, me gjendje balance në datën 23.1.2017, në vlerën 110.567 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur *statement* për gjendjen e llogarisë në shumën 110.567 lekë.

12.19.2 Credins Bank²⁵⁰ konfirmon gjendjen e llogarisë në datën 25.1.2017. Nga analizimi i kësaj llogarie konstatohet se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë universitetit “***”, Durrës²⁵¹.

12.19.3 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.20. ProCredit Bank – studio ligjore “**”, llogaria nr. ***, vlera 827.797 lekë**

12.20.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari rrjedhëse “****” (ndryshuar emri në ***), gjendja e llogarisë në lekë me nr. ***, në datën 24.1.2017, është në vlerën 827.797 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur *statement* bankar nga ProCredit Bank, për gjendjen e llogarisë në vlerën 827.797 lekë. Komisioni vëren se transaksionet në këtë llogari kanë filluar në datën 3.1.2016.

12.20.2 Referuar arsytimit në paragrafin 12.13.3, Komisioni nuk e përfshiu këtë llogari bankare në pasuritë e paraqitura në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur.

²⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁴⁹ Efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare pasqyrohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

²⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁵¹ Efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.21. Intesa Sanpaolo Bank – B. K., llogari kursimi nr. *, vlera 14.713 euro**

12.21.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari kursimi nr. ***, me gjendje 14.713 euro, në datën 24.1.2017. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur lëvizjet e kësaj llogarie për periudhën 27.4.2009 – 24.1.2017. Në DIPP/2016, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogari kursimi në Intesa Sanpaolo Bank, shtuar me 8.330 euro, me burim të ardhurat nga aktiviteti privat.

12.21.2 Intesa Sanpaolo Bank²⁵² konfirmon gjendjen e llogarisë të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit. Lidhur me origjinën e shumës së deklaruar, Komisioni analizoi transaksionet e kryera ndër vite në llogarinë bankare në emër të bashkëshortes së subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank. Një pjesë e këtyre depozitimeve kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti pranë kësaj banke dhe pjesa tjetër ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj llogarie të kursimit në shumën 14.713 euro.

12.21.3 Me anë të pyetësorit nr. 1²⁵³, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e këtyre depozitimeve, i cili në përgjigje deklaroi se burim krijimi kanë qenë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes dhe të ardhurat e kursimet familjare, një pjesë e të cilave kanë qenë gjendje *cash* në banesë, por gabimisht nuk janë deklaruar në DPV-të përkatëse. Efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.21.4 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.22. Intesa Sanpaolo Bank – I. K. (e mitur), llogari kursimi, vlera 3.003,81 euro

12.22.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari në emër të I. K. (e mitur), në Intesa Sanpaolo Bank, llogari kursimi me gjendje deri në datën 20.10.2016, në vlerën 3.003,81 euro. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur vërtetim datën 20.10.2016 nga Intesa Sanpaolo Bank për gjendjen e llogarisë në emër të I. K. në vlerën 3.004 euro. Në DIPP/2009, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në Intesa Sanpaolo Bank në emër të I. K., në vlerën 844,81 euro. Në DIPP/2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogari kursimi në Intesa Sanpaolo Bank në emër të I. K. në shumën 1.453 euro. Nuk ka deklaruar burim krijimi.

12.22.2 Intesa Sanpaolo Bank²⁵⁴ konfirmon gjendjen e llogarisë së deklaruar nga subjekti në datën 20.10.2016, ndërsa në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, datë 25.1.2017, gjendja e llogarisë ka qenë në vlerën 3.353,81 euro, për shkak se në datën 8.11.2016 – pra pas lëshimit të vërtetimit – është kryer një depozitim në vlerën 350 euro. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u

²⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

²⁵³ Pyetje nr. 25 (lapsus numri i llogarisë, është shënuar ***, duhet ***).

²⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

konstatua se kjo llogari ka si origjinë depozitimet e kryera nga bashkëshortja e subjektit në vlerën totale 3.080 euro²⁵⁵, si dhe interesat neto të përfituar 273,81 euro.

12.22.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, i pyetur në lidhje me burimin e krijimit, subjekti deklaroi se si burim për këtë llogari kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet familjare.

12.22.4 Komisioni vëren se efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.22.5 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12.23. ProCredit Bank – S. K. (e mitur), llogari kursimi nr. *, vlera 2.412,33 euro**

12.23.1 Në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë nr. ***, në ProCredit Bank në emër të S. K. (e mitur) me gjendje 2.412,33 euro, në datën 18.10.2016. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur “Vërtetim balance”, lëshuar nga ProCredit Bank, në datën 18.10.2016, për llogarinë e kursimit në emrin e S. K., me gjendje 2.412,33 euro. Në DIPP/2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogari kursimi në ProCredit Bank, në emër të S. K., në shumën 2.152 euro. Nuk ka deklaruar burim krijimi.

12.23.2 ProCredit Bank²⁵⁶ konfirmon llogari kursimi në emër të vajzës së subjektit, S. K., çelur në datën 23.4.2014, me balancë 2.412,33 euro, në datën 31.12.2016. Nga analizimi i lëvizjeve të kësaj llogarie u konstatua se kjo llogari ka si origjinë depozitimet e kryera nga bashkëshortja e subjektit në vlerën totale 2.357,92 euro²⁵⁷, si dhe interesat neto të përfituar 54.41 euro.

12.23.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, i pyetur në lidhje me burimin e krijimit, subjekti deklaroi se si burim për këtë llogari kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet familjare.

12.23.4 Komisioni vëren se efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.23.5 Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

²⁵⁵ Në vitin 2007 – 300 euro; në vitin 2008 – 500 euro; në vitin 2010 – 400 euro; në vitin 2014 – 1.030 euro; në vitin 2016 – 850 euro.

²⁵⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 12.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 3.11.2023.

²⁵⁷ Në vitin 2007 – 300 euro; në vitin 2008 – 500 euro; në vitin 2010 – 400 euro; në vitin 2015 – 1.030 euro; në vitin 2016 – 850 euro.

Konstatime të tjera lidhur me llogaritë bankare

12.24. Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Italo-Shqiptare)

12.24.1 Në deklaratën e pasurisë viti 2003, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në vlerën 2.470 USD, në Bankën Italo-Shqiptare Tiranë, me burim kursime nga paga. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 7.12.2012, subjekti është pyetur lidhur me deklarinimin e kësaj depozite, e cila nuk konfirmohet nga banka dhe përse nuk është deklaruar mbyllja e saj. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se depozita bankare e vitit 2003 me vlerë 2.470 USD është tërhequr për shpenzime konsumi deri në vitin 2006, vit në të cilin është mbyllur përfundimisht depozita.

12.24.2 Sipas dokumentacionit të administruar nga Intesa Sanpaolo Bank²⁵⁸, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur llogari pranë kësaj banke me nr. ***, të mbartur nga ish-Banka Italo-Shqiptare. Në këtë llogari, znj. B. K. ka depozituar *cash* shumën 2.500 USD, në datën 9.2.2004. Po në këtë datë, subjekti ka tërhequr 1.200 USD. Më tej, në datën 15.7.2004 znj. B. K. ka depozituar *cash* shumën 600 USD dhe në datën 14.2.2006 ka tërhequr 1.800 USD.

12.24.3 Komisioni vëren se efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.25. Llogari ProCredit në euro, nr. llogarie *, bashkëshortja**

12.25.1 Komisioni konstatoi një sërë depozitimesh të kryera në këtë llogari, për të cilat, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit që të deklarojë burimin e krijimit. Në përgjigje, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të depozitimeve kanë qenë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes dhe të ardhurat nga punësimi i tij. Subjekti shpjegoi se një pjesë e të ardhurave janë kursyer çdo vit dhe se gjatë viteve 2003 – 2009 nuk ka deklaruar kursime *cash*, pasi ka qenë i paqartë për plotësimin e deklaratës. Pas kontrollit të thelluar të kryer nga ILDKPKI-ja, iu komunikua ky gabim i bërë prej tij duke i bërë të mundur korrigjimin e këtij gabimi dhe se duke filluar nga viti 2010 ka deklaruar rregullisht gjendjen e kursimeve *cash* në fund të çdo viti, përfundoi subjekti.

12.25.2 Komisioni vëren se efekti financiar i shtesave dhe pakësimeve të llogarive bankare reflektohet në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

12.26. Llogari në ABI, bashkëshortja, në GRD (dhrakmi greke)

12.26.1 Nga analizimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit pranë ABI Bank u konstatuan dy depozitime në monedhën dhrakmi, konkretisht 775.000 GRD në datën 4.9.2000 dhe 400.000 GRD në datën 3.12.2000. Këto shuma janë kaluar në depozita dhe përfundimisht janë tërhequr në datat 30.1.2001 dhe 16.8.2001.

12.26.2 Komisioni vëren se referuar deklarinimit të subjektit dhe librezës së punës, gjatë periudhës së kryerjes së këtyre depozitimeve, shtetasja B. K. jetonte në qytetin e Sarandës, në një banesë me qira²⁵⁹. Ndërkohë që subjekti ka ushtruar detyrën në qytetin e Sarandës deri në dhjetor 2000²⁶⁰ dhe,

²⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

²⁵⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës që bashkëshortja ka punuar në Sarandë, ka marrë një banesë të vogël me qira për të cilën nuk disponojnë kontratë.

²⁶⁰ Periudha 16.1.1998 – 1.11.1998 – oficer i policisë gjyqësore në Sarandë; periudha nëntor 1998 – janar 1999 – prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; periudha janar 1999 – dhjetor 2000 – zëvendësprokuror i Rrethit Gjyqësor Sarandë.

sipas deklaramit të tij, ka banuar në ambientet e zyrave pranë Prokurorisë së Rrethit Sarandë. Lidhja e martesës daton më 13.12.2000²⁶¹.

12.26.3 Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar të krijimit të depozitimeve të kryera, të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer, si dhe të deklarojë se për çfarë janë përdorur shumat e tërhequra. Në përgjigje, subjekti deklaroi se burimi i krijimit të këtyre depozitimeve janë të ardhurat e krijuara nga puna në emigracion prej bashkëshortes në vitet 1998 – 1999. Për shkak të kohës së largët nuk disponohet dokumentacion për shumat e krijuara nga emigracioni, ndërsa lidhur me shumat e tërhequra subjekti deklaroi se janë përdorur për nevoja familjare.

12.26.4 Sa rezultoi, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar punësimin në emigracion apo shumën e të ardhurave të përfituara atje.

12.26.5 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e depozitimit të shumës 1.175.000 GRD (ekuivalenti 452.448 lekë).*

12.26.6 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se për shkak të kohës së largët nuk disponohet dokumentacion për shumat e krijuara nga emigracioni dhe se bashkëshortja i ka krijuar këto kursime përpara se të gëzonte statusin e bashkëshortes dhe aq më pak statusin e personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.26.7 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

12.26.8 Sikundër u arsyetua në pikën 4.29/(i) të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara me burim emigracionin nuk provohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, për pasojë, vendosi të mos i konsiderojë të ardhurat në shumën 452.448 lekë.

12.27. Llogari nr. * në ProCredit Bank, në lek, bashkëshortja**

12.27.1 Komisioni konstatoi se në llogarinë bankare në emër të bashkëshortes së subjektit pranë ProCredit Bank, në monedhën lekë, janë kryer disa depozitime, për të cilat – me anë të pyetësorit nr. 3, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin financiar të krijimit. Në përgjigje²⁶², subjekti deklaroi

²⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.8.2023, nga DPGJC-ja.

²⁶² Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 29.1.2024.

se si burim kanë shërbyer të ardhurat e biznesit të bashkëshortes dhe të ardhurat familjare. Kjo llogari është çelur në datën 14.4.2007 dhe në të kryhen transaksione të tilla si pagesa e sigurimeve shoqërore, taksat e bashkisë, faturat e shërbimit celular e të tjera. Ndër të tjera, në datën 18.2.2008 është depozituar shuma 1.000.000 lekë. Po gjatë vitit 2008 është tërhequr shuma 300.000 lekë, me përshkrimin “Hajrie Imeri për prokurorinë Dr. garanci pasurore” dhe, më tej, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr shumën 657.000 lekë²⁶³.

12.27.2 Sa rezulton, u konstatua se kjo llogari bankare duket të jetë në funksion të aktivitetit të biznesit dhe efektet e shtesave/pakësimeve të saj reflektohen në seksionin e pasurive të analizës financiare për secilin vit kalendarik.

13. Apartament banimi me sip. 148 m², në Durrës (pasuri e transkriptuar)

13.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 17.5.2006, me palë shitëse P. K. (pronar i vetëm) dhe palë blerëse B. dhe E. P. (vjeherri dhe vjehrra e subjektit), Madrid Kullolli dhe B. K., për apartamentin nr. ***, kati ***, shk. ***, pallati nr. ***, me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës. Apartamenti me strukturë 3+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse me sip. 148 m² është shitur në shumën 5.000.000 lekë. Pala blerëse deklaroi se të gjithë vlerën e çmimit të shitjes ia ka paguar *cash* palës shitëse jashtë zyrës noteriale, çka konfirmohet edhe nga pala shitëse. Është paraqitur kontrata nr. ***, datë 18.12.2014, me palë shitëse Madrid dhe B. K. dhe palë blerëse B. dhe E. P. (vjeherri dhe vjehrra e subjektit), ku përcaktohet se sipas certifikatës së pronësisë palët kanë në bashkëpronësi me nga ¼ pjesë secili një apartament me sip. 148 m², të ndodhur në Lagjen Nr. 1, rruga “****”, Durrës, nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***. Subjekti dhe bashkëshortja e tij, pjesën e tyre të pasurisë ia shesin palës blerëse me çmim 5.186.882 lekë.

13.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2006, subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 148 m², nr. ***, z. k. ***, me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës, blerë me kontratën nr. ***, datë 17.5.2006, në shumën 5.000.000 lekë. Pjesa takuese e subjektit: 25%. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Në seksionin “Detyrimet financiare” ka deklaruar kredi në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në shumën 35.000 euro, kontrata nr. ***, datë 2.6.2006. Në DIPP/2014, subjekti ka deklaruar kontratë shitjeje pasurie 50% e pjesës takuese prej 148 m² të apartamentit që gjendet në katin e pestë të pallatit në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës, nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve Madrid dhe B. Kullolli, me anë të kontratës nr. ***, datë 18.12.2014, në shumën 5.186.882 lekë. Vlera e shitjes është depozituar në euro në dy llogari, 20.000 euro në Raiffeisen Bank dhe 18.000 euro në BKT.

13.3. ZVRPP Durrës²⁶⁴ konfirmon se shtetasit Madrid dhe B. Kullolli kanë pasur në bashkëpronësi një apartament në z. k. ***, vol. ***, f. ***. Sipas kartelës së pasurisë, ky apartament në datën 19.5.2006 ka qenë i regjistruar në emër të shtetasve Madrid e B. Kullolli dhe B. e E. P. (vjeherri dhe vjehrra e subjektit). Në datën 23.12.2014, apartamenti figuron i regjistruar në emër të shtetasve B. e E. P., me shënimin “Kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.12.2014, shuma 5.186.882 lekë”.

²⁶³ Evidentohen tri tërheqje me një shumë totale prej 657.000 lekësh.

²⁶⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 9.8.201, dokumentacion i administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

13.4. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2006²⁶⁵, në qytetin e Durrësit, nga ku rezultoi se çmimi ka qenë në shumën 57.829 lekë/m². Për pasojë, apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 8.558.692 lekë²⁶⁶, përkundrajt çmimit 5.000.000 lekë, të përcaktuar në kontratën e shitjes, pra ky apartament është blerë 3.558.692 lekë më pak se vlera mesatare e tregut. Më tej, për të konkluduar lidhur me vlerën mesatare në treg në kohën kur ky apartament është shitur nga subjekti dhe bashkëshortja në vitin 2014, Komisioni iu referua udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”, sipas të cilit vlera mesatare e shitjes në tregun e lirë për këtë apartament përllogaritet në shumën 10.373.764 lekë²⁶⁷.

13.5. Sa më sipër, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë shitur pjesët takuese prej 1/2 në këtë apartament sipas çmimit të tregut të përcaktuar nga EKB-ja, 10.373.764 lekë/m² = 5.186.882 lekë, por e kanë blerë atë në vitin 2006, rreth 42% më lirë se vlera mesatare e shitjes në tregun e lirë.

13.6. Me anë të pyetësorit nr. 1²⁶⁸, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me sa më lart konstatohet. Në përgjigje²⁶⁹, subjekti deklaroi se çmimi i blerjes në vitin 2006 është vlerësuar nga palët dhe janë mbajtur parasysh faktorë të ndryshëm si: pozicioni i objektit, koha e ndërtimit të tij, nevoja e shitësit për të kryer shitjen, etj., duke paraqitur në cilësinë e provës kontrata të ngjashme.

13.7. Komisioni vëren se subjekti ka paraqitur kontrata të lidhura në të njëjtën godinë me nr. ***, datë 11.8.2006, të apartamentit me sip. 95 m², me çmim 3.000.000 lekë dhe kontratën nr. ***, datë 5.9.2006, të apartamentit me sip. 77 m², me çmim 1.900.000 lekë. Më tej, subjekti shpjegoi se çmimi i shitjes për pjesën takuese është vendosur sipas referencës për shkak edhe të detyrimit ligjor të kohës për pagesën e detyrimeve tatimore dhe se me prindërit e bashkëshortes kanë jetuar për një kohë të gjatë bashkërisht me shpenzime të ndara, por me kontribute të përbashkëta për jetesën familjare, kontribute të cilat janë menaxhuar nga prindërit e bashkëshortes, duke krijuar edhe kursimet përkatëse për mbarëvajtjen familjare. Shitja e pjesës takuese prindërve të bashkëshortes është kryer pasi kishin qëllim të blinin një shtëpi në plazh, qëllim, të cilin e realizuan në vitin 2015 me blerjen e apartamentit në ***, përfundoi subjekti.

13.8. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike, në përgjigjen e administruar nga FSHU-ja²⁷⁰, konstatohet se në emër të shtetasit B. P. rezulton e regjistruar kontrata e furnizimit me energji elektrike, kategoria “Familjare”, nr. ***, Cabin firma “****”, me adresë në Durrës, kontratë e regjistruar në datën 16.7.2007²⁷¹. Lidhur me kontratën e furnizimit me ujë, UK Durrës²⁷²

²⁶⁵ Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2006”.

²⁶⁶ Sip. 148 m² * 57.829 lekë/m².

²⁶⁷ Sip. 148 m² * 70.093 lekë/m².

²⁶⁸ Email datë 17.11.2023, ora 12:41.

²⁶⁹ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.11.2023.

²⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021.

²⁷¹ Konfirmuar edhe nga subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar se kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe me ujë janë regjistruar në emër të babait të bashkëshortes, shtetasit B. P., konkretisht kontrata e UKD sh.a., me nr. ***, viti 2006 dhe ajo e KESH sh.a., me nr. ***.

²⁷² Shkresë nr. ***, datë 10.1.2023.

informon se kontrata e furnizimit me ujë për këtë apartament është lidhur në emër të shtetasit B. P., vjehri i subjektit, në datën 27.2.2015.

13.9. Lidhur me shpenzimet e arredimit/mobilimit, në përgjigje të pyetësorit standard²⁷³, subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar rreth 450.000 lekë në vitin 2006 dhe 200.000 lekë në vitin 2007.

13.10. Lidhur me banimin në këtë apartament, Komisioni konstaton se në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës maj 2006 – prill 2015 ka banuar në Lagjen Nr. ***, rruga “****” (ish-rruga “****”), Durrës. Në DIPP-të vjetore 2007 – 2012, kjo adresë është deklaruar si adresë banimi. Në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, kjo adresë është deklaruar si adresë e gjendjes civile, çka nuk përputhet me informacionin e përcjellë nga DPGJC-ja²⁷⁴, sipas të cilit, adresa e gjendjes civile të subjektit dhe bashkëshortes që prej datës 17.4.2013 rezulton “Rr. “****”, nd. nr. ***, h. ***, ap. ***, Durrës”.

13.11. Në kushtet që ky apartament rezulton t’i jetë shitur prindërve të bashkëshortes në datën 18.12.2014, subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të pyetësorit nr. 1 dhe, në përgjigje, ai deklaroi se marrëdhënia me prindërit e bashkëshortes ka qenë dhe është shumë e mirë, për këto shkaqe në të shumtën e kohës kanë jetuar së bashku²⁷⁵. Megjithëse ua shitën atyre apartamentin në fund të viti 2014, me qëllimin për t’i ndihmuar në rritjen e fëmijëve etj., jetojnë bashkë në pjesën më të madhe të kohës si në apartamentin në *** dhe në apartamentin e tyre në Durrës. Subjekti deklaroi se prindërit e bashkëshortes gjatë periudhës 2000 – 2006 kanë jetuar në apartamentin e tyre në Lagjen Nr. ***, Kavajë, dhe pas vitit 2006 jetojnë në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës, dhe në ditë të veçanta (fundjava, sezon veror) jetojnë në ***.

13.12. Referuar informacionit të përcjellë nga DPGJC-ja²⁷⁶, si adresë e gjendjes civile e prindërve të bashkëshortes, që prej datës 3.8.2006 figuron adresa “Rr. “****”, nd. ***, h. ***, ap. ****”.

13.13. Nga hetimi i Komisionit²⁷⁷ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësin P. (A.) K. dhe shoqërinë “****” sh.p.k.²⁷⁸

a) Burimi i parë i krijimit – kredi pranë Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane), në vlerën 35.000 euro

13.14. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka bashkëlidhur kontratën e kredisë në Bankën Amerikane të Shqipërisë, nr. ***, datë 2.6.2006, sipas së cilës subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë marrë një kredi në shumën 35.000 euro me qëllim blerjen e një apartamenti të ri. Po në datën 2.6.2006, është lidhur kontrata e hipotekimit nr. ***, për sigurimin e kredisë mbi pasurinë apartament me sip. 148 m², në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës, nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, vërtetuar me certifikatën e pronësisë datë 19.5.2006.

²⁷³ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 1.2.2021.

²⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 15.8.2023.

²⁷⁵ Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se në periudhën mars 2004 – prill 2015 kanë jetuar me prindërit e bashkëshortes dhe gjyshen e saj, por me shpenzime të ndara.

²⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 15.8.2023.

²⁷⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

²⁷⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2023.

13.15. Sipas dokumentacionit të administruar nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane)²⁷⁹, me anë të kontratës së kredisë nr. ***, datë 2.6.2006, shtetasit Madrid dhe B. K. kanë marrë kredinë në shumën 35.000 euro, disbursuar në datën 27.6.2006.

13.16. Referuar kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 2.6.2006, rezulton se hipotekuesit Madrid e B. Kullolli dhe B. e E. P., për garantimin e kredisë, kanë vendosur si kolateral apartamentin me sip. 148 m², në Durrës, vërtetuar me certifikatën e pronësisë datë 19.5.2006.

13.17. Komisioni konstatoi se shuma e disbursuar nga kredia në shumën 35.000 euro është disbursuar në datën 27.6.2006 dhe, në të njëjtën datë, kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “Pagesë për blerjen e apartamentit të ri”.

13.18. Në DIPP-në e vitit 2006, në seksionin “Detyrimet financiare”, subjekti ka deklaruar kredi në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në shumën 35.000 euro, kontrata nr. ***, datë 2.6.2006, por pa deklaruar se ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin.

13.19. Me anë të procesverbalit datë 18.7.2016, ILDKPKI-ja ka kërkuar sqarime lidhur me vlerën e paguar nga ana e subjektit dhe burimin e krijimit për blerjen e këtij apartamenti. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se blerja e këtij apartamenti është kryer prej tij, bashkëshortja dhe prindërit e saj. Si burim për blerjen ka shërbyer kredia e marrë në Intesa Sanpaolo Bank, ish-Banka Amerikane. Në kontratën e shitjes është vendosur shuma e kredisë, e konvertuar në lekë. Në momentin e lidhjes së kontratës së kredisë shitësi i apartamentit P. K. ka marrë njoftimin zyrtar nga banka duke u garantuar për lidhjen e kredisë dhe kalimin e shumës së parave në llogarinë e tij. Kredia e shtëpisë është paguar në mënyrë solidare nga të katërt blerësit, çka e saktëson edhe kontrata e barrës hipotekore, në të cilën kanë nënshkruar të 4 pronarët e rinj të banesës. Për marrjen e kredisë pranë Intesa Sanpaolo Bank është lënë si kolateral shtëpia e blerë në Durrës.

13.20. Në vijim, subjekti është pyetur për faktin se kontrata e kredisë rezulton të jetë marrë në datën 2.6.2006 dhe shuma 5.000.000 lekë për blerjen e apartamentit është likuiduar më 17.5.2006, pra kjo shumë nuk mund të këtë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se shuma e kredisë ka shërbyer vetëm për këtë qëllim dhe kjo mund të verifikohet edhe nëpërmjet gjithë procedurës së kryer me bankën. Subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 17.5.2006, kontratën e kredisë nr. ***, datë 2.6.2006 dhe kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 2.6.2006.

13.21. Shoqëria “****” sh.p.k.²⁸⁰ përcolli pranë Komisionit kopje të kontratës nr. ***, datë 17.5.2006, ndërsa lidhur me çmimin informoi se është likuiduar në dy këste, konkretisht një shumë është likuiduar në dorë në momentin e lidhjes së kontratës dhe pjesa kryesore është likuiduar pas kalimit të kredisë që blerësi ka marrë në Bankën Amerikane të Shqipërisë në qershor të vitit 2006.

13.22. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuar të shpjegojë se përse shuma 35.000 euro, me burim kredinë e marrë ka kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., ndërkohë që shitësi i apartamentit rezulton shtetasi P. K.. Në përgjigje, subjekti deklaroi se shuma e kredisë ka kaluar në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë, sipas udhëzimeve të shitësit, i cili ishte njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë. Komisioni konstaton se në momentin e nënshkrimit të kontratës së

²⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2021.

²⁸⁰ Shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.11.2023.

shitjes, referuar ekstraktit historik në QKB të shoqërisë “***” sh.p.k., shtetasi P. K. figuronte ortak i vetëm i kësaj shoqërie, çka përputhet me deklarinimin e subjektit.

13.23. Sa më lart, edhe pse kontrata e shitblerjes së apartamentit është lidhur në datën 17.5.2006, ndërkohë që kontrata e kredisë është lidhur në datën 2.6.2006 (rreth dy javë më vonë) dhe transferta për shoqërinë “***” është kryer në datën 27.6.2006 – Komisioni e konsideroi kredinë si burim për blerjen e apartamentit, pasi: (i) transferta bankare në favor të shoqërisë është kryer menjëherë pas lëvrimit të kredisë; (ii) shoqëria konfirmoi se pjesa kryesore e çmimit është likuiduar pas kalimit të kredisë së marrë nga blerësi; (iii) shitësi P. K., në momentin e nënshkrimit të kontratës figuronte ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k.; (iv) si kolateral për sigurimin e kësaj kredie është vendosur pikërisht apartamenti me sip. 148 m², në Durrës, vërtetuar me certifikatën e pronësisë datë 19.5.2006, pra ky apartament figuronte i regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë para marrjes së kredisë.

13.24. Lidhur me shlyerjen e kredisë – nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank konstatohet se subjekti ka kryer këto pagesa për kredinë (principal, interes dhe shpenzime të tjera për kredinë): (i) në vitin 2006, shuma 3.491,17 euro; (ii) në vitin 2007, shuma 5.225,28 euro; (iii) në vitin 2008, shuma 5.378,28 euro; (iv) në vitin 2009, shuma 24.064,46 euro; (v) në vitin 2010, shuma 1.304,69 euro; (vi) në vitin 2011, shuma 6.478,97 euro.

13.25. Komisioni vëren se në vitin 2009 është shlyer një pjesë e konsiderueshme e kredisë, çka është deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2009, ku konkretisht ka deklaruar shumën 23.341 euro si shlyerje kredie dhe se shuma e shlyer ka si burim të ardhurat familjare (20.000 euro me parapagim). Komisioni konstatoi se si burim për këtë shlyerje të parakohshme kanë shërbyer depozitimet e kryera në llogari nga bashkëshortja e subjektit gjatë periudhës 5.6.2009 – 19.6.2009. Më tej, në datën 29.6.2009 është kryer transferta në shumën 20.000 euro për shlyerjen e parakohshme.

13.26. Në paragrafin 2.7 të pikës 2 të relacionit (lidhur me likuiditetet *cash*) është trajtuar shpjegimi i subjektit se deri në fund të vitit 2003 ka pasur të kursyer një shumë prej 2.600.000 lekësh (të padeklaruara në deklaratën e pasurisë së vitit 2003) dhe se së bashku me kursimet e krijuara më vonë janë përdorur për të shlyer në mënyrë të parakohshme kredinë pranë Intesa Sanpaolo Bank. Në kushtet që këto shpjegime të subjektit nuk u konsideruan, në vijim Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet – bazuar në deklarinimin e subjektit në DIPP/2009 se si burim për këtë shlyerje kanë shërbyer të ardhurat familjare.

13.27. Sipas analizës financiare të kryer për periudhën 13.2.2009²⁸¹ – 19.6.2009 (data e depozitimit të fundit që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme), rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.584.284 lekë, në datën 19.6.2009, për të kryer shlyerje të parakohshme të kredisë në shumën 20.000 euro, si dhe për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.

²⁸¹ Deri në datën 12.2.2009 është kryer për blerjen e automjetit në paragrafin 11.2.1.1 (relacioni mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

b) Paga e diferencës së çmimit të apartamentit – shuma 705.500 lekë

13.28. Komisioni vëren se çmimi i parashikuar në kontratë është 5.000.000 lekë, ndërsa ekuivalenti i shumës së transferuar shoqërisë është 4.294.500 lekë²⁸². Për rrjedhojë, në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, shlyer diferenca, e cila u përlllogarit në shumën 705.500 lekë.

13.29. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklarojë nëse prindërit e bashkëshortes kanë kontribuar financiarisht për pagesën e çmimit të apartamentit e, nëse po, të specifikojë shumën dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer si burim. Në përgjigje, subjekti deklaroi se apartamenti është blerë nga ai dhe bashkëshortja e tij, prindërit e bashkëshortes janë vendosur në kontratë në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë prej tyre në rritjen e vajtës dhe për faktin se bashkëshortja ishte fëmija i tyre i vetëm. Gjithashtu, në atë periudhë prindërit e bashkëshortes shitën apartamentin e tyre në Kavajë dhe bashkërisht menduan që të rezultojnë si bashkëpronarë në apartamentin që po blinin, megjithëse *ata nuk kontribuuan financiarisht në momentin e blerjes*, shpjegoi subjekti.

13.30. Referuar përgjigjes së shoqërisë “****” sh.p.k.²⁸³, një shumë është likuiduar në dorë në momentin e lidhjes së kontratës e, për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare në datën 17.5.2006, për pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për të kryer pagesën e diferencës së çmimit të apartamentit.

13.31. Komisioni vëren se: (i) në DIPP/2006, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (ii) subjekti është kontradiktore në deklaratimet e tij lidhur me kontributin në blerjen e këtij apartamenti, pasi në deklaratimet periodike ka deklaruar kontributin në masën 50% edhe të prindërve të bashkëshortes, ndërkohë gjatë hetimit deklaroi se në këtë pasuri kanë investuar vetëm subjekti dhe bashkëshortja e tij.

13.32. Për sa i përket shitjes së këtij apartamenti, siç u trajtua më lart, ky apartament i është shitur vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit me kontratën nr. ***, datë 18.12.2014, me çmim 5.186.882 lekë (pikërisht sa ½ e vlerës mesatare të tregut). Nga analizimi i llogarive bankare, kjo shumë është paguar: (i) në datën 21.1.2015 është transferuar shuma 17.628,24 euro nga noterja A. S., me përshkrimin “Tjetërsim pasurie për B. B. K., kalim sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2014”; (ii) në datën 18.2.2015 është transferuar shuma 20.370 euro nga noterja A. S., me përshkrimin “Çngurtësim kont. shitjeje, datë 18.12.2014, nr. *** rep., nr. *** kol., me palë blerëse E. B. P., shitës B. B. K.”, pra kalimi i fondeve është kryer në vitin 2015.

13.33. Pavarësisht se deri në këtë fazë të ardhurat nga shitja u pasqyruan në analizën financiare, Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar se i ka vendosur prindërit e bashkëshortes në kontratë në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë prej tyre në rritjen e vajtës dhe për faktin se bashkëshortja ishte fëmija i tyre i vetëm, ndërkohë që më pas ua ka shitur këtë pasuri duke fituar të ardhura.

²⁸² Shuma 35.000 euro e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e disbursimit dhe transferimit, 1 euro = 122,70 lekë.

²⁸³ Shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.11.2023.

13.34. Nga analizimi i llogarive bankare të prindërve të bashkëshortes së subjektit u konstatua se si burim për pagesat e kryera për çmimin e apartamentit ka shërbyer shumë 35.000 euro, e cila ka si origjinë: (i) dy depozitime në llogarinë e shtetasit B. P. pranë BKT-së, konkretisht 6.000 euro në datën 21.9.2010 dhe 9.000 euro në datën 21.9.2011²⁸⁴; (ii) dy depozitime në llogarinë e shtetasit B. P. pranë Raiffeisen Bank, konkretisht 10.000 euro në datën 18.5.2012 dhe 10.000 euro në datën 4.4.2014²⁸⁵, kohë gjatë së cilës subjekti dhe familja e tij jetonin me prindërit e bashkëshortes.

13.35. Sa më lart, me anë të pyetësorit nr. 3 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion provues mbi të ardhurat e vjehrrit/vjehrrës, që kanë shërbyer si burim për depozitimet bankare të sipërcituara (të cilat kanë shërbyer për likuidimin e çmimit). Në përgjigje²⁸⁶, për të provuar të ardhurat e kërkuara, subjekti paraqiti në cilësinë e provës vërtetimet e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe prova të tjera rrethore për të provuar të ardhurat e realizuara nga vjehri. *Lidhur me shtetasin B. P.*, subjekti deklaroi se ka filluar punë në vitin 1966 dhe ka dalë në pension në vitin 2011²⁸⁷. Subjekti deklaroi se të ardhurat e realizuara nga punësimi, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, janë me shumë se 5.862.307 lekë, llogaritur për vitet 1994 – 2016 (pa përfshirë të ardhurat e krijuara nga puna për periudhën 1966 – 1994). Më tej, deklaroi se ka krijuar të ardhura nga shitja e banesës së privatizuar me anë të kontratës së privatizimit në datën 2.6.1993, në shumën 2.000.000 lekë. Në cilësinë e provës, subjekti dorëzoi kontratën e shitjes nr. *** datë 4.4.2006. Subjekti, gjithashtu, deklaroi se vjehri i tij ka realizuar të ardhura edhe nga bonot e privatizimit pas likuidimit të ndërmarrjes shtetërore G. B., Kavajë, të cilat i ka këmbyer në vlerën e 80% të tyre me lekë, në një shumë të papërcaktuar saktë, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar²⁸⁸. *Lidhur me shtetasin E. P.*, subjekti deklaroi se ka punuar në Ndërmarrjen e Prodhimit të Veshjeve, Kavajë, në vitet 1974 – 1993, më pas ka dalë në asistencë sociale, duke filluar punë përsëri në vitet 2012 – 2019 dhe një periudhë tjetër në vitin 2005. Të ardhurat, për të cilat janë paguar tatimet, llogariten në shumën 1.659.856 lekë, për vitet 2004 – 2016²⁸⁹. Ka përfituar të ardhura të realizuara nga shitja e pronës private të nënës së saj, shtetases H. B. (shuma e papërcaktuar për shkak të afatit kohor), të përdorura nga ana e vjehrrës, pasi kanë jetuar së bashku me nënën e saj, si dhe ka përfituar të ardhura nga pagesa e kësteve për të dënuarit politikë dhe të pushkatuarit pa gjyq nga sistemi komunist, në shumën 250.000 lekë, në dy këste plus një këst të nënës së saj në shumën 125.000 lekë, pasi kanë jetuar së bashku.

²⁸⁴ Këto depozitime fillimisht kanë kaluar në depozita me afat dhe pas maturimit i janë transferuar noteres në datën 22.12.2014.

²⁸⁵ Këto depozitime fillimisht kanë kaluar në depozita me afat dhe pas maturimit i janë transferuar noteres në datën 19.12.2014.

²⁸⁶ Protokolluar në Komision me nr. ***, datë 29.1.2024.

²⁸⁷ i) Ka punuar si futbollist profesionist për një periudhë më shumë se dhjetëvjeçare 1964 – 1975 me ekipin e futbollit ***-Kavajë dhe ka marrë pjesë në ndeshjet e zhvilluara brenda dhe jashtë vendit nga ekipi kombëtar i futbollit; (ii) Gjithashtu ai ka punuar si mekanik në uzinën “****”, Kavajë, në vitet 1968 – 1989; (iii) Nga viti 1989 deri në momentin e daljes në pension viti 2011, ka punuar si mësues fizikulture në disa shkolla të ndryshme me një shkëputje në vitet 1994 – 1998; (iv) Nga viti 1975 që ka lënë futbollin profesionist ka vijuar punën jashtë orarit si trajner me skuadrat zinxhir deri në vitin 1994. (v) Në vitet 1994 – 1998 ka punuar si sekretar klubi i shoqërisë “****”, Kavajë; (vi) Ka punuar më pas si trajner i disa skuadrave të futbollit si, *** Kavajë 1997 – 1998, Egnatia 2001 – 2002, etj. Përgjatë viteve 1992 – 2015 ka punuar si mësues dhe trajner me grupet e të rinjve dhe para të rinjve në kurse private për lojën e futbollit, punë nga e cila krijonte të ardhura për kursimet familjare. Lidhur me të ardhurat e krijuara si trajner në kurset private në shumën mbi 3.000.000 lekë, subjekti deklaroi se nuk janë paguar detyrimet tatimore.

²⁸⁸ Për këtë, me shkresën nr. ***, datë 23.1.2024, i është kërkuar Raiffeisen Bank, e cila ka trashëguar arkivën e Bankës së Kursimeve, se sa është shuma e letrave me vlerë, që kanë përfituar shtetasit B. P. dhe E. P..

²⁸⁹ Edhe vjehra deklaroi se ka realizuar të ardhura nga puna private si qëndistare dhe rrobaqepëse, pothuajse gjatë gjithë jetës së saj dhe pas viteve 1990 – 2010 ka siguruar të ardhura (për të cilat nuk ka paguar detyrimet tatimore), të cilat arrijnë në shumën mbi 1.500.000 lekë. Të ardhura nga bonot e privatizimit pas likuidimit të Ndërmarrjes së Prodhimit të Veshjeve, Kavajë.

13.36. Në vijim të dokumentacionit të paraqitur dhe të atij të administruar nga hetimi, Komisioni kreu analizën financiare për prindërit e bashkëshortes së subjektit, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për depozitim të shumës totale 35.000 euro, e cila, së bashku me interesat bankarë të përfituar, ka shërbyer për pagesën e apartamentit, nga ku rezultoi se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit, blerjen e depozitave dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën 1.638.939 lekë.

13.37. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa konstatohet: (i) Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit duket e dyshimtë blerja në shumën 3.558.692 lekë më lirë se vlera mesatare në tregun e lirë; (ii) Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.584.284 lekë, në datën 19.6.2009, për të kryer një shlyerje të parakohshme në shumën 20.000 euro, për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) Lidhur me shitjen e apartamentit ka dyshime mbi fiktivitetin e lidhjes së kontratës së shitjes së këtij apartamenti nga ana e subjektit me qëllim gjenerimin e të ardhurave në shumën 5.186.882 lekë dhe krijimin e disponibilitetit financiar me qëllim blerjen e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vijimësi nga ana e subjektit të rivlerësimit për këto arsye: (1) Duken kontradiktore deklaratimet e subjektit se i ka bërë bashkëpronarë prindërit e bashkëshortes në shenjë mirënjohjeje, si rezultat i kontributit në rritjen e fëmijëve, ndërkohë që, më vonë ua ka shitur këtë apartament duke përfituar të ardhura; (2) Ka deklarime kontradiktore nga ana e subjektit lidhur me pjesët takuese, pasi në DIPP/2006 ka deklaruar 25% (viti i blerjes), në DIPP/2014 ka deklaruar 50% (viti i shitjes), ndërkohë që gjatë hetimit ka deklaruar që çmimi është paguar 100% nga ana e tij; (3) Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë vazhduar të jetojnë bashkërisht në këtë apartament edhe pas shitjes së tij, gjithashtu nga ana e subjektit kjo adresë është deklaruar si adresë e gjendjes civile në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*; (4) Subjekti dhe familja e tij jetonin me prindërit e bashkëshortes në kohën e kryerjes së depozitimeve bankare, që kanë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të apartamentit; (5) Prindërit e bashkëshortes nuk justifikojnë plotësisht me të ardhura të ligjshme blerjen e këtij apartamenti, krijimin e depozitave dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1994 – shtator 2014.

13.38. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore, në përgjigje të barrës së provës deklaroi se *nuk ndodhet në kushtet e një trajtimi preferencial në kuptim të ligjit, pasi nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se nuk ndodhet në konflikt interesi me shitësin e apartamentit, përcaktimi i çmimit ka qenë vullneti i lirë i palëve, pa u ndikuar nga pozicioni i punës së subjektit dhe se marrëdhënia juridiko-civile është një marrëdhënie me shpërblim.* Për të provuar vlerën e tregut të këtij apartamenti, subjekti në prapësime paraqiti një “Raport vlerësimi të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme”, duke pretenduar se në përcaktimin e çmimit kanë ndikuar këta faktorë: zona ku ndodhet prona objekt vlerësimi ka karakter vetëm rezidencial/banimi sezonal dhe konsiderohet zonë periferike e qytetit; ambientet e këtij objekti plotësojnë kushtet minimale standarde²⁹⁰; blerja drejtpërdrejt ndërmjet blerësit dhe

²⁹⁰ Dyshemeja është e shtruar me pllaka qeramike, dyert janë material imitim druri, tamburat, dritaret janë duralumini, ambienti i tualetit është me ndriçim dhe ajrim artificial. Objekti nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998,

shoqërisë ndërtuese ka shmangur tarifat e reklamimit në agjenci imobilare, tarifa të cilat shkojnë në masën 3+1% të vlerës së shitjes, e cila në këtë rast shkon 200.000 lekë; në dakordësimin e çmimit ka ndikuar edhe mënyra e pagesës, pasi shitësi ka marrë të gjithë vlerën menjëherë (disbursim kredie plus pagesa plotësuese e çmimit); në vitin 2006, sektori i ndërtimit pati një rritje të ndërtimeve, por një ulje të kërkesës për blerje, çka bëri që çmimet të kishin një luhatje me tendencë në ulje dhe të kishte një diferencë rreth 30-40% me çmimet e referencës; struktura e objektit është e tillë ku ndërtuesi ka shfrytëzuar objektin fillestar për aksesimin e hyrjes në objektin e dytë objekt vlerësimi, pra, apartamenti nuk ka shkallë dhe ashensor më vete, por shfrytëzon në mënyrë të modifikuar shkallët dhe ashensorin e objekti ngjitur; në përfundim, subjekti deklaroi se palët janë në lirinë e tyre kontraktore mbi të drejtën e shitësit dhe blerësit për të krijuar një marrëdhënie të pavesuar dhe të lirë shitjeje e blerjeje në një treg të ekonomisë së lirë e, për rrjedhojë, në një treg të lirë të pasurive të paluajtshme.

Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë, subjekti deklaroi se Komisioni duhet të marrë në konsideratë gjendjen *cash* në shumën 3.200.000 lekë, kursime këto të krijuara nga paga si prokuror dhe të ardhurat e bashkëshortes si avokate. Këto likuiditete kanë shërbyer për shlyerjen e pjeshme të kredisë së marrë nga Banka Amerikane.

Në lidhje me dyshimet mbi fiktivitetin e lidhjes së kontratës së shitjes, subjekti deklaroi se vlera e paguar në vitin 2006 është pothuajse sa çmimi që ka dashur të arkëtojë nga shitja e pasurisë. Fiktiviteti në këtë rast do të ishte nëse do të shiste këtë apartament në një vlerë më të lartë duke pretenduar se ka qenë kontributor i vetëm dhe se vlera e apartamentit është rritur nga viti 2006 në vitin 2014. Subjekti deklaroi se prindërit e bashkëshortes janë bërë bashkëpronarë në këtë pasuri pa kontribut monetar. Bazuar në dispozitat ligjore të neneve 204 dhe 208 të Kodit Civil lidhur me parablerjen dhe tjetërsim e pasurisë në bashkëpronësi, ka diskutuar me ta në lidhje me vendimin për shitjen e apartamentit dhe nëse kishin dëshirë ta blinin apo do ta shisnin të gjithë së bashku këtë pasuri. Prej tyre ka marrë dakordësinë që me kursimet që zotëronin do të blinin pjesën takuese të subjektit dhe të bashkëshortes. Në këtë transaksion nuk ka në asnjë rrethanë fiktive, veprimi në të kundërt do të ishte fiktivitet dhe do të ngrinte dyshime në lidhje me momentin e blerjes dhe kontributit të secilit bashkëpronar në vitin 2006. Subjekti shpjegoi se nëse ai dhe bashkëshortja do t'u dhuronim pjesën e tyre takuese prindërve të bashkëshortes, atëherë nga Komisioni do të konstatohej se prindërit e bashkëshortes do të kenë pasur kontribut monetar për blerjen në vitin 2006. Këta të fundit, në vitin 2014, nuk kanë pasur apartament në pronësi dhe se me kursimet e tyre dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2006 kanë blerë këtë pasuri duke mos qenë në kushtet e shtimit të një pasurie të dytë apo të tretë, kushte në të cilat mund të vlerësohej për fiktivitet.

Në lidhje me konstatimin se ka deklarime kontradiktore mbi pjesën takuese, subjekti shpjegoi se në DIPP/2006 ka deklaruar pjesën takuese të përfituar sipas kontratës, ndërsa në momentin e shitjes ka deklaruar 50% duke iu referuar kontributit të dhënë realisht në vlerë dhe faktit se nuk po arkëtonte asnjë të ardhur shtesë nga çmimi i shitjes.

“Për urbanistikën”, në objekt nuk janë të vendosura sistemi i zjarrit, shkallët e emergjencës etj. Objekti nuk ishte i pajisur me certifikatë regjistrimi (hipoteke).

*Lidhur me barrën e provës për të justifikuar burimet e ligjshme të blerësit (prindërit e bashkëshortes), subjekti deklaroi se transferata e çmimit të kontratës nga blerësit është bërë me bankë dhe po ashtu një vlerë e saj ka qenë e depozituar në bankë në vitet 2010, 2011 dhe 2012. Pra, disa vite para se të lidhej kontrata e shitjes (datë 18.12.2014), likuiditetet kanë qenë në bankë në emër të blerësve. Subjekti deklaroi se nuk duhet të ngarkohet me barrën e provës për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së blerësve në një marrëdhënie kontraktore, duke sjellë në referencë vendimet nr. 20, datë 8.9.2020, nr. 21, datë 10.9.2020 dhe nr. 4, datë 9.2.2021, të Kolegjit. Mbështetur në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti deklaroi se: *Së pari*, marrëdhënia juridiko-civile e shitblerjes nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara, në kuptim të të cilave të mund të kualifikojë prindërit e bashkëshortes si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, t’i ngarkonte ata dhe subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre. *Së dyti*, detyrimi për të provuar ligjshmërinë e pasurive të paluajtshme në pronësi të prindërve të bashkëshortes është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore. *Së treti*, Kodi Civil parashikon të drejtën e parablerjes si një detyrim ligjor për njoftimin e bashkëpronarit nëse ai dëshiron ta blejë pronën ose jo. *Së katërti*, në nenin 208 sërish Kodi Civil sjellë garanci shtesë për bashkëpronarin e sendit të paluajtshëm duke parashikuar se: “*Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve*”.*

13.39. Pavarësisht sa më sipër pretendoi, subjekti deklaroi se prindërit e bashkëshortes kanë realizuar të ardhurat nga paga, pensioni, si dhe menaxhimi i ekonomisë familjare, por nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e realizuara nga vjehtëri B. P. nga kurset private të futbollit²⁹¹, pasi ka qenë i certifikuar si trajner dhe mësues fizikulture. Nga ky aktivitet i ngjeshur dhe nga të ardhurat e tjera (si paga, honorare, sponsorizime etj.), ai ka krijuar të ardhura të mjaftueshme për jetesën e tij familjare dhe për shpenzimet e kryera. Këto të ardhura kanë qenë në shumën rreth 3.000.000 lekë, për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore. Subjekti, në cilësinë e provës, paraqiti mandatpagesën e datës 22.2.2024 në Raiffeisen Bank, për të provuar pagimin e tatimit në shumën 450.000 lekë mbi këto të ardhura²⁹², duke deklaruar se ka arritur të plotësojë të dyja kriteret ligjore, atë të burimit të ligjshëm, si dhe pagesën e detyrimit tatimor. Lidhur me pagesën e këtij detyrimi tatimor jo në kohën kur janë përfituar këto të ardhura, por gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti solli në referencë vendimin e Kolegjit nr. 26/2023²⁹³, duke përmbushur në këtë mënyrë standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

²⁹¹ Të ardhura të krijuara nga puna si *mësues fizikulture, trajner* në kurset private me të rinjtë, për një periudhë 1992 – 2015, janë në shumën mbi 3.000.000 lekë. Kurset private kanë qenë jo me pak se një orë, dy herë në javë me një mesatare më shumë se dhjetë fëmijë, nxënës, të rinj nga viti 1992 deri në vitin 2015, rreth 23 vite. Secili nga fëmijët mesatarisht ka paguar kuotën 150 lekë/ora (e cila ka ardhur duke u rritur).

²⁹² Subjekti theksoi se në deklaratën DIVA të vitit 2023 është paguar shuma 450.000 lekë ose 15% e të ardhurës së realizuar, duke paguar detyrimin tatimor jo në masën 10% sipas përcaktimeve ligjore të kohës dhe momentit të realizimit të të ardhurave, por në masën 15 sipas përcaktimeve të legjislationit aktual.

²⁹³ “[...] subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur arritën të provonin se këto të ardhura ishin krijuar nga një burim i ligjshëm i parashikuar prej nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe se pagimi me vonësë i detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, i kryer nga vjehtëri i subjektit të rivlerësimit, kalon testin e qëndrimit orientues të Kolegjit të dhënë në vendimin nr. 15/2021 (JR) e, për pasojë, plotësojnë kërkesat e ligjit për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi”.

Më tej, subjekti deklaroi se të ardhurat ndër vite të prindërve të bashkëshortes kanë shërbyer për krijimin e depozitave të tyre bankare dhe se sipas deklarimeve të tyre kanë mbajtur para *cash* deri në momentin që kanë vendosur që një pjesë t'i depozitojnë në llogari bankare, të cilat më pas kanë shërbyer për blerjen e apartamentit. Këtë apartament kanë vendosur ta blejnë meqenëse nuk kishin një pasuri të plotë të tyre, ndërkohë që kishin fonde në dispozicion.

13.40. Subjekti pretendoi se duhet të rishikohet dhe të ulet zëri “Shpenzimeve për jetesë”, pasi prindërit e bashkëshortes nuk kanë kryer shpenzime jetese të veçanta, por kanë ulur shpenzimet e tyre dhe gjithë familjes, duke kryer shpenzime të përbashkëta për 6-7 persona në një banesë. Nëse ulen shpenzimet e tyre për jetesë, të cilat këto vite realisht kanë qenë me të ulëta dhe nëse llogariten depozitat e tyre bankare, volumet e krijuara nga puna private rezultojnë me balancë pozitive.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

13.41. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

13.42. *Lidhur me vlerën e tregut të këtij apartamenti*, Komisioni vëren se subjekti ka paraqitur disa kontrata të ngjashme të lidhura nga ndërtuesi/administratori P. (A.) K. në të njëjtin objekt/pallat: (i) kontrata nr. ***, datë 16.5.2007, apartament me sip. 95 m², në vlerën 1.900.000 lekë, çmimi 20.000 lekë/m²; (ii) kontrata nr. ***, datë 5.6.2006, apartament me sip. 77 m², në vlerën 1.900.000 lekë, çmimi 24.675 lekë/m²; (iii) kontrata nr. ***, datë 24.7.2007, apartament me sip. 118 m², në vlerën 2.000.000 lekë, çmimi 17.000 lekë/m²; (iv) kontrata nr. ***, datë 8.8.2006, apartament me sip. 77 m², në vlerën 1.600.000 lekë, çmimi 20.780 lekë/m²; (v) kontrata nr. ***, datë 11.8.2006, apartament me sip. 77 m², në vlerën 1.600.000 lekë, çmimi 20.780 lekë/m².

Sa rezulton, çmimi mesatar i shitjeve në bazë të kontratave është 20.645 lekë/m², përkundrejt çmimit 33.783 lekë/m², të kontraktuar nga subjekti, pra konstatohet ta ketë blerë këtë apartament më shtrenjtë se blerësit e tjerë në të njëjtin objekt/pallat.

13.43. *Lidhur me barrën e provës për të justifikuar burimet e ligjshme të prindërve të bashkëshortes*, Komisioni kreu analizën financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit për të blerë apartamentin dhe krijuar llogaritë bankare. Gjithsesi, vlen të theksohet se nga analiza e situatës faktike nuk rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të bashkëshortes së tij të ketë një marrëdhënie biznesi në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe as një marrëdhënie huamarrjeje apo dhurimi në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por rrethanat e konstatuara e të provuara gjatë hetimit administrativ se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë vazhduar të jetojnë bashkërisht në këtë apartament edhe pas shitjes së tij, kjo adresë madje është deklaruar si adresë e gjendjes civile në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*; dhe (ii) subjekti e familja e tij jetonin me prindërit e bashkëshortes në kohën e kryerjes së depozitimeve bankare (që kanë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të apartamentit) – mund të sqaroheshin vetëm nëpërmjet një hetimi të thelluar lidhur me të ardhurat e ligjshme të prindërve

të bashkëshortes së subjektit. Mbështetur në qëndrimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit në trajtimin e çështjeve të ngjashme, Komisioni, pasi të ketë kryer një hetim të plotë të situatës faktike, do të ketë mundësi të vlerësojë nëse gjendemi në kushtet për të arritur në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasuritë, duke qenë se konflikti i interesit nuk ekziston sipas hetimit administrativ. Vetëm në këtë mënyrë trupi gjykues mund të arrijë në një përfundim të drejtë lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri të transkriptuar.

13.44. Në këto kushte, Komisioni, pasi mori në analizë ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga prindërit e bashkëshortes nga pagat, pensionet, etj., si dhe të ardhurat e realizuara nga vjehri B. P. nga kurset private të futbollit në shumën totale 3.000.000 lekë, konkludoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se janë krijuar nga burime të ligjshme dhe se pagimi me vonesë i detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga kurset private të futbollit në shumën totale prej 3.000.000 lekësh²⁹⁴, e kalon testin e qëndrimit orientues të Kolegjit e, për pasojë, plotëson kërkesat e ligjit për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi.

Për rrjedhojë, prindërit e bashkëshortes së subjektit justifikojnë me të ardhura të ligjshme blerjen e këtij apartamenti, krijimin e depozitave dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1994 – shtator 2014.

Në përfundim, pasi u shqyrtuan pretendimet e subjektit në prapësime dhe në seancën dëgjimore, Komisioni vëren se rrethanat e deklaruara prej tij rezultojnë të provuara edhe gjatë hetimit administrativ siç janë: (i) Subjekti nuk e ka shitur më shtrenjtë këtë pasuri, duke qenë se vlera e apartamentit është rritur ndjeshëm nga viti 2006 deri në vitin 2014; (ii) Bazuar në dispozitat e nenit 204 të Kodit Civil²⁹⁵, subjekti ka detyrim ligjor që në rastet e shitjes së pjesës në bashkëpronësi të pasurive të paluajtshme të njoftojë më parë bashkëpronarët e tjerë, duke mos i cenuar të drejtën e parablerjes; (iii) Nga hetimi administrativ provohet fakti se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë pasur në pronësi/zotërim/posedim pasuri tjetër të paluajtshme, përveç këtij apartamenti; (iv) Prindërit e bashkëshortes së subjektit justifikojnë me të ardhura të ligjshme blerjen e kësaj pasurie. *Për rrjedhojë*, nuk provohen dyshimet e Komisionit për fiktivitetin e kontratës së shitjes së këtij apartamenti.

13.45. *Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë*, referuar arsytimit dhe analizës financiare në paragrafët 11.2.6 - 11.2.7 të këtij vendimi, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -901.225 lekë në vitin 2009, për blerjen e automjetit, shtesën e kursimeve, shlyerjen e parakohshme të kredisë dhe kryerjen e shpenzimeve.

14. Të ardhurat nga qiratë

a) *Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë me sip. 40 m², në bulevardin “***”, Tiranë*

²⁹⁴ Mandatpagesa e datës 22.2.2024 në Raiffeisen Bank, për pagesën e tatimit në shumën 450.000 lekë.

²⁹⁵ Parashikohet se: “*Bashkëpronari, para se t’ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t’ia shesë personit të tretë. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda tre muajve se dëshirojnë të blejnë pjesën, bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë”.*

14.1. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhurat nga kontrata e qirasë për ambientin me sip. 40 m², të ndodhur në rrugën “****”, kati ***, Tiranë, deri në datën 31.12.2016, në shumën 500.000 + 600.000 + 600.000 + 600.000 = 2.300.000 lekë. Bashkëlidhur është paraqitur kontrata e qirasë nr. ***, datë 22.2.2013, ku znj. B. K. i ka dhënë me qira shtetasen A. Sh. objektin me sip. 40 m² për aktivitet privat (zyrë), me afat 1-vjeçar (22.2.2013 – 22.2.2014), me të drejtë ripërsëritjeje, me pagesë mujore 50.000 lekë. Në kontratë specifikohet se tatimi mbi qiranë do të paguhet nga qiradhënësi.

14.2. Komisioni konstaton se këto të ardhura janë deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore, konkretisht: (i) në DIPP/2013, të ardhurat nga qiraja e kësaj pasurie me anë të kontratës nr. ***, datë 22.2.2013, në shumën 500.000 lekë; (ii) në DIPP/2014, të ardhurat në shumën 600.000 lekë; (iii) në DIPP/2015, të ardhurat në shumën 600.000 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2016, të ardhurat në shumën 600.000 lekë.

14.3. Në përgjigje të pyetësorit standard²⁹⁶, subjekti ka deklaruar se sipas kontratës nr. ***, datë 22.2.2013, ka dhënë me qira ambientin zyrë pranë bulevardit “****” (ose rruga “****”), Tiranë, me vlerë 50.000 lekë/muaj bruto, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore.

14.4. Sa më lart, të ardhurat bruto në total për periudhën 22.2.2013 – 31.12.2016 përlllogariten në shumën 2.300.000 lekë, ndërsa detyrimi i tatimit mbi qiranë përlllogaritet në shumën totale 290.000 lekë²⁹⁷.

14.5. Nga analizimi i llogarive bankare konstatohet se në datën 10.8.2015, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Raiffeisen Bank është kryer një transfertë nga shoqëria “****” sh.p.k. në vlerën 90.000 lekë, me përshkrimin “Qira gusht 2015”. Me anë të pyetësorit nr. 2²⁹⁸ subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë transfertë dhe të specifikonte nëse pagesat e tjera janë kryer *cash* apo me bankë. Në përgjigje²⁹⁹, subjekti deklaroi se pagesat janë kryer në përgjithësi *cash*, në raste të rralla nëpërmjet sistemit bankar dhe në mjaft raste janë kryer me vonesë. Pagesat bëheshin sipas aftësive të qiramarrësit.

14.6. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me shlyerjen e këtij detyrimi, pra të shumës 290.000 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k. Konkretisht, është paguar shuma 50.000 lekë për vitin 2013³⁰⁰, shuma 60.000 lekë për vitin 2014³⁰¹, shuma 90.000 lekë për vitin 2015³⁰² dhe shuma 90.000 lekë për vitin 2016³⁰³. Me anë të pyetësorit nr. 2³⁰⁴ subjektit iu kërkuan shpjegime se përse pagesat e tatimit mbi qiranë

²⁹⁶ Protokolluar me nr. ***, datë 1.2.2021, në Komision.

²⁹⁷ Për vitin 2013, detyrim 50.000 lekë (10%); për vitin 2014, detyrim 60.000 lekë (10%); për vitin 2015, detyrim 90.000 lekë (15%); për vitin 2016, detyrim 90.000 lekë (15%).

²⁹⁸ Email datë 22.11.2023, ora 12:18 pm.

²⁹⁹ Email datë 30.11.2023, ora 03:32 pm, shkresa e protokolluar me nr. *** prot., datë 30.11.2023, në Komision.

³⁰⁰ Transfertë bankare nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 29.4.2014, në shumën 50.000 lekë, në favor të Degës së Tatimeve Tiranë, me përshkrimin “Tat. qira sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 22.2.2013, viti 2013”.

³⁰¹ Lëvizjet e llogarisë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., ku konstatohet një transfertë në datën 30.12.2014, në shumën 60.000 lekë, në favor të Degës së Tatimeve Tiranë, me përshkrimin “Tatim qiraje për B. K. janar – dhjetor 2014”.

³⁰² Transfertë bankare nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 6.1.2016, në shumën 90.000 lekë, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, me përshkrimin “Tatim i mbajtur në burim dhjetor 2015 për B. K.”.

³⁰³ Urdhërpaguesë e formularit të deklarimit të shoqërisë “****” sh.p.k. për periudhën dhjetor 2016, ku evidentohet pagesa e tatimit në burim në shumën 90.000 lekë, në datën 20.2.2017.

³⁰⁴ Email datë 22.11.2023, ora 12:18 pm.

janë kryer nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe jo nga qiramarrësi. Në përgjigje³⁰⁵, subjekti deklaroi se me anë të kontratës së qirasë nr. ***, datë 22.2.2013, ky objekt i është dhënë me qira shtetas A. Sh., e cila është administratore e subjektit “****” sh.p.k.

14.7. Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.p.k. pranë faqes zyrtare *online* të QKB-së, konfirmohet se shtetasja A. Sh. ka qenë në cilësinë e ortakës (50% të kuotave) dhe administratores së kësaj shoqërie gjatë periudhës së marrjes me qira.

14.8. Sa më lart, lidhur me të ardhurat nga qiraja sipas kontratës nr. ***, datë 22.2.2013, Komisioni paraqiti në analizën financiare të ardhura në shumën 450.000 lekë për vitin 2013, të ardhura në shumën 540.00 lekë në vitin 2014, të ardhura në shumën 510.000 lekë në vitin 2015 dhe në shumën 510.000 lekë në vitin 2016.

14.9. Më tej, gjatë hetimit u administrua një kontratë tjetër qiraje për këtë pasuri, konkretisht në dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja³⁰⁶, subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë nr. ***, datë 27.5.2010, për dhënie me qira të ambientit zyrë me sip. 40 m², të lidhur me palën qiramarrëse, shoqërinë “****” sh.p.k., me administratore Z. H.; afati i kontratës prej datës 1.6.2010 deri më 1.6.2012, vlera 500 euro/muaj, pagesë e cila do të bëhet në llogarinë bankare të subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank. Në kontratë parashikohet se në këtë vlerë është përfshirë tatimi në burim, që e paguan qiramarrësi për llogari të qiradhënësit si tatim mbi të ardhurat.

14.10. I pyetur nga ILDKPKI-ja se përse nuk janë deklaruar të ardhurat nga qiraja, subjekti ka deklaruar se kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës, pasi qiramarrësi nuk i ka bërë në kohë pagesat, të cilat janë kryer herë përmes sistemit bankar, herë *cash* dhe se këto të ardhura janë përdorur për shpenzime të ndryshme. Komisioni vëren se të ardhurat nga qiradhënia referuar kësaj kontrate nuk janë deklaruar as në deklaratën *Vetting*.

14.11. Nga analizimi i llogarive bankare konstatohet se në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank janë kryer këto depozitime: (i) datë 9.7.2010, shuma 500 euro, përshkrimi “Depozitim I. Z./Z. H.”; (ii) datë 3.8.2010, shuma 500 euro, përshkrimi “Depozitim I. Z. pag. qiraje Z. H.”; (iii) datë 7.3.2011, shuma 949 euro, përshkrimi “Depozitim Z. H./qira ambienti”.

14.12. Me anë të pyetësorit nr. 2 subjekti u pyet se sa kanë qenë të ardhurat neto të përfituara nga kjo kontratë dhe përse nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje, subjekti deklaroi se kjo kontratë qiraje nuk është zbatuar plotësisht nga qiramarrësi për shkak të problemeve lidhur me investimin që pretendonte të kryente. Qiramarrësi pretendonte të ndërtonte një klinikë me disa ambiente të tjera, por nuk arriti ta realizonte idenë. Për këtë arsye, është justifikuar dhe ka bërë vetëm pagesat e sipërcituara derisa kontrata u zgjidh. Të ardhurat neto nga kjo kontratë kanë qenë në shumën 1.949 euro, të paguara në bankë dhe nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* për shkak të harresës, sqaroi subjekti.

14.13. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore ka qenë i qiramarrësit. Referuar

³⁰⁵ Email datë 30.11.2023, ora 15:32, shkresa e protokolluar me nr. *** prot., datë 30.11.2023, në Komision.

³⁰⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 14.8.2023.

jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁰⁷, mospagimi i detyrimeve tatimore, të cilat sipas ligjit dhe rrethanave faktike të përcaktuara në kontratën noteriale i takojnë një personi të tretë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuptim të këtij procesi.

14.14. Më tej, nga informacioni i përcjellë prej Intesa Sanpaolo Bank, Komisioni konstatoi se në datën 21.4.2011 shtetasi A. S. ka transferuar shumën 2.000 euro në llogarinë bankare me nr. *** në emër të bashkëshortes së subjektit. I pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 3³⁰⁸ subjekti deklaroi se kjo pagesë është kryer në funksion të kontratës së qirasë nr. ***, datë 27.5.2010, për dhënien me qira të ambientit zyrë me sip. 40 m², të lidhur me palën qiramarrëse, shoqërinë “****” sh.p.k., me administratore Z. H.. Subjekti deklaroi se shtetasi A. S. ka qenë punonjës i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe në cilësinë e provës ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë (jo të hartuar para noterit publik), datë 24.1.2024, sipas së cilës shtetasi A. S. deklaroi se një grup investitorësh turq dëshironin të hapnin një spital dhe, për këtë shkak, kishin hapur edhe disa subjekte, shoqëri në Tiranë për këtë aktivitet, si “****” sh.p.k. dhe se në pranverën e vitit 2011 ka kryer pagesën në shumën 2.000 euro për ambientin e marrë me qira nga ana e kësaj shoqërie³⁰⁹.

14.15. Komisioni vëren se në rastin e transfertës 2.000 euro, në ndryshim nga rasti i përshkruar më lart, nuk konfirmohet në përshkrimin bankar qëllimi i kryerjes së pagesës dhe, po kështu, nuk provohet as lidhja e shtetasit A. S. me shoqërinë “****” sh.p.k. Për më tepër, në kushtet që të ardhurat e përfituara nga kjo kontratë nuk ishin deklaruar as ndër vite dhe as në deklaratën *Vetting*, subjekti u pyet në pyetësorin nr. 2 lidhur me totalin e të ardhurave të përfituara dhe në përgjigjen e tij nuk u përfshi shuma 2.000 euro. Për rrjedhojë, Komisioni nuk e konsideroi shumën 2.000 euro si e ardhur nga qiraja.

14.16. Në përfundim, lidhur me të ardhurat nga qiraja sipas kontratës nr. ***, datë 22.2.2013, Komisioni paraqiti në analizën financiare të ardhura nga qiraja në shumën 138.810 lekë për vitin 2010 (ekuivalenti i shumës 1.000 euro³¹⁰) dhe në shumën 131.247 lekë për vitin 2011 (ekuivalenti i shumës 949 euro³¹¹).

14.17. Gjatë prapësimeve, lidhur me transfertën bankare prej 2.000 euro, nga shtetasi A. S. – sipas deklaratës për pagesën e qirasë së njësisë me sip. 40 m², bulevardi “****”³¹² – subjekti, me anë të postës elektronike, në datën 15.3.2024 paraqiti formularin e DIVA-s për vitin 2011 dhe urdhërpagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale, duke kërkuar që të merret në konsideratë kjo provë e sjellë nga ana e tij. Ky pretendim i subjektit është analizuar në pikën 6 të këtij vendimi.

b) Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit me sip. 70 m², rruga “**”, Tiranë**

14.18. Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga qiradhënia e këtij objekti, por ka paraqitur kontratën e qirasë nr. ***, datë 26.4.2006. Referuar kësaj kontrate, subjekti i jep me qira shtetasit L. H. apartamentin me sip. 70 m² të ndodhur në Tiranë, në vlerën 30.000 lekë/muaj. Afati i qirasë është 1 vit dhe fillon në datën 1.5.2006. Komisioni vëren se në

³⁰⁷ Vendim nr. 23-2022 (JR), datë 28.6.2022, subjekti A. Sh.

³⁰⁸ Protokolluar me nr. ***, datë 29.1.2024, në Komision.

³⁰⁹ Subjekti ka paraqitur komunikimet me *email* me shtetasin A. S., ekstrakt historik i shoqërive “****” sh.p.k., *** dhe kontrata midis shoqërisë turke “****” dhe shoqërive të sipërpërmendura.

³¹⁰ Vlerësuar me kursin e këmbimit 1 euro = 138,81 lekë.

³¹¹ Vlerësuar me kursin e këmbimit 1 euro = 138,30 lekë.

³¹² Trajtuar në paragrafët 14.19 dhe 14.20 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

kontratë nuk është parashikuar se cila palë do të marrë përsipër detyrimet lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore. Në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP/2006, të ardhura nga qiraja në shumën 210.000 lekë; (ii) në DIPP/2007, të ardhura nga qiraja në shumën 360.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit standard³¹³, subjekti ka deklaruar se në vitet 2006 dhe 2007 e ka dhënë me qira këtë apartament dhe se ka përfituar 210.000 lekë në vitin 2006 dhe 360.000 lekë në vitin 2007. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se detyrimet tatimore janë paguar, por nuk ka ruajtur kopje të pagesave të kryera.

14.19. Bazuar në informacionin e përcjellë nga DRT-ja Tiranë³¹⁴, nuk rezulton që subjekti të ketë paguar detyrime tatimore për këto të ardhura. Me anë të pyetësorit nr. 2³¹⁵ subjektit iu kërkua të shpjegojë se përse këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, të specifikojë nëse pagesat janë kryer *cash* apo në bankë, si dhe të paraqesë dokumentacion provues lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore. Në përgjigje³¹⁶, subjekti deklaroi se këto të ardhura janë deklaruar në deklaratat periodike dhe janë harruar pa u deklaruar në deklaratën *Vetting*, detyrimet tatimore nuk janë paguar në kohë, por janë paguar pas verifikimeve të kryera kohët e fundit, sipas tatimit aktual 15%. Pagesat nga ana e qiramarrësit janë kryer *cash*. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti urdhërpagesën për tatimin e mbajtur në burim dhe urdhërshirimin përkatës të kryer në Raiffeisen Bank, në datën 9.11.2023, për shumën 85.500 lekë.

14.20. Komisioni vëren se në kushtet që pagesat nga ana e qiramarrësit janë kryer *cash*, nuk provohen të ardhurat nga qiraja përtej parashikimit të kohëzgjatjes 1-vjeçare të qiradhënies, siç është parashikuar në kontratë.

14.21. Si përfundim, në kushtet që: (i) është paraqitur kontrata e qirasë nr. ***, datë 26.4.2006, me afat 1 vit; (ii) si dhe në deklaratat periodike vjetore të vitit 2006 dhe 2007, Komisioni përllogarit të ardhura nga qiraja në shumën 210.000 lekë në vitin 2006 (7 muaj) dhe 150.000 lekë (5 muaj) në vitin 2007.

15. Lidhur me adresat e banimit

15.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, Durrës, dhe si adresë banimi Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Në deklaratimet periodike ndër vite, subjekti ka deklaruar këto adresa banimi: në deklaratën e pasurisë viti 2003, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Tiranë. Në DIPP-në e vitit 2004 – 2006, rruga “****”, blloku “****”, Tiranë. Në DIPP-në e vitit 2007 – 2009, adresa e gjendjes civile Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Adresë banimi: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës (adresa e pasurisë së transkriptuar). Në DIPP-në e viteve 2010 – 2012, adresa e gjendjes civile Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Adresë banimi: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, pallati nr. ***, Durrës (adresa e pasurisë së transkriptuar, rruga “****” është ish-rruga “****”). Në DIPP-në e vitit 2013, adresa e gjendjes civile Lagjja Nr. ***, rruga “****”, pallati nr. ***, Durrës. Adresë banimi: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Në DIPP-në e vitit 2014, adresë banimi Lagjja Nr. ***, rruga

³¹³ Protokolluar me nr. ***, datë 1.2.2021, në Komision.

³¹⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 6.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 12.10.2023.

³¹⁵ Email datë 22.11.2023, ora 12:18 pm.

³¹⁶ Email datë 30.11.2023, ora 03:32 pm, shkresa e protokolluar me nr. *** prot., datë 30.11.2023, në Komision.

“****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Në DIPP-në e vitit 2015, adresa e gjendjes civile Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë. Në DIPP-në e vitit 2016, adresa e gjendjes civile Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, Durrës. Adresë banimi: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, blloku “****”, pallati nr. ***, Tiranë.

15.2. Në përgjigje të pyetësorit standard³¹⁷, subjekti ka deklaruar se detyrën e prokurorit e ka marrë në datën 1.11.1998, emëruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Periudha 1998 – 2000, adresa e banimit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Lagjja Nr. ***, Sarandë (ambientet e zyrave te Prokurorisë); periudha 2001 – mars 2004, adresa e banimit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, *** (ambientet e zyrave te Prokurorisë); periudha mars 2004 – maj 2006, adresa e banimit Lagjja Nr. ***, Kavajë (shtëpia e prindërve të bashkëshortes);p maj 2006 – prill 2015, adresa e banimit Lagjja Nr. ***, rruga “****” (ish-rruga “****”), Durrës; periudha 2015 – 2017 e në vijim, adresa e banimit lagjja “****”, ***, Kavajë.

15.3. Subjekti ka deklaruar se është ndarë nga trangu familjar në datën 1.4.1998 dhe është martuar në datën 13.12.2000. Për të gjithë periudhën e deklarimit, 2003 – 2016 dhe në vijim, ka jetuar me bashkëshorten B. K. (P.) dhe dy vajzat pas lindjes së tyre sipas viteve respektive – 28.3.2001, I. K. dhe 3.11.2010, S. K.. Shpenzimet e jetesës janë paguar nga kursimet e përbashkëta familjare. Gjatë periudhës mars 2004 – prill 2015 kanë jetuar me prindërit e bashkëshortes dhe gjyshen e saj, por me shpenzime të ndara.

15.4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile³¹⁸ informon se subjekti i rivlerësimit në datën 23.8.1996 ka ndryshuar emrin nga Mirdit në Madrit. Në datën 16.11.1992 transferohet në ZGJC ***, fshati ***. Sipas informacionit të marrë në ZGJC ***, Sarandë, për subjektin rezultojnë gjurmë paralele dhe deri diku informacione kontradiktore. Referuar ZGJC ***, rezulton që subjekti ka ardhur familjarisht në regjistrin themeltar “****” 1/151 në datën 10.3.1997 nga ZGJC ***, në këtë regjistër rezulton të ketë ndryshuar edhe emrin në datën 15.4.1997.

15.5. Në datën 20.10.1997, familja transferohet në ZGJC ***, Elbasan, ndërkohë që sipas ZGJC ***, familja rezulton të ketë ardhur në datën 18.9.1998. Më tej rezulton se në datën 20.10.2004 subjekti është transferuar në ZGJC ***, nga ku rezulton se në datën 10.4.1998 transferohet në ZGJC Sarandë, ku si pasojë e trazirave të vitit 1997 një pjesë e arkivave është dëmtuar.

15.6. Subjekti rezulton të ketë lidhur martesë në datën 13.12.2000 dhe më 16.2.2005 transferohet familjarisht në regjistrin themeltar “****” ref., Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë. Në datën 21.1.2010 ndryshon emrin nga Madrit në Madrid. Në datën 17.4.2013 transferohet në Njësinë Administrative Rajoni nr. ***, Durrës, ku aktualisht është banor në adresën rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Durrës. Bashkëshortja e subjektit B. P.³¹⁹ në datën 20.8.1999 kalon në gjendjen civile Lagjja Nr. ***, Kavajë, në datën 16.2.2005 transferohet familjarisht në ZGJC Nr. ***, “****”, nr. *** ref., Tiranë. Në datën 17.4.2013 transferohet familjarisht në ZGJC Rajoni Nr. ***,

³¹⁷ Protokolluar me nr. ***, datë 1.2.2021, në Komision.

³¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 15.8.2023.

³¹⁹ Në datën 14.8.1998 ndryshon/korrigjon emrin nga B. në B., në datën 28.12.1998 ndryshon mbiemrin nga P. në T., në datën 20.8.1999 divorcohet dhe rimerr mbiemrin e vajzërisë P.. Me akt martese në datën 13.12.2000, mbajtur në ZGJC Sarandë, ndryshon mbiemrin nga P. në K..

Durrës. Vjehri dhe vjehra e subjektit në datën 3.8.2006 transferohen nga ZGJC Kavajë në ZGJC Rajoni Nr. ***, Durrës, me adresë rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ****.

15.7. Me anë të pyetësorit nr. 1 subjekti u pyet lidhur me disa mospërputhje në adresat e banimit, ku deklaroi se adresat e banimit janë ato të paraqitura në përgjigjet e pyetësorit standard dhe fakti i vendosjes së adresës rruga “****”, blloku “****”, Tiranë, ishte për shkak të gjendjes civile, e cila ka qenë fillimisht në Tiranë pas transferimit nga Saranda dhe ajo ka sjellë një konfuzion nëse në deklaratë duhej vendosur adresa në të cilën ishte gjendja civile apo adresa në të cilën jetonte faktikisht. Kjo adresë pastaj është kopjuar në vijimësi nëpër deklaratat periodike vjetore. Më tej, duke qenë se në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës mars 2004 – maj 2006 ka banuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes, me anë të pyetësorit nr. 1 subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar pronësinë e kësaj banese nga ana e prindërve të bashkëshortes, si edhe dokumentacionin ku të jetë e specifikuar data e kryerjes së pagesës së çmimit të blerjes së kësaj prone. Në përgjigje, subjekti deklaroi se në banesën e prindërve të bashkëshortes ka jetuar për periudhën mars 2004 deri në fund të vitit 2005. Kjo banesë është fituar me anë të privatizimit sipas ligjit nr. 7652, datë 13.10.1992 “Për privatizimin e banesave”, vërtetuar me anë të kontratës së shitjes datë 17.1.1994 midis palës shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa dhe palës blerëse, shtetasve B. P. e E. P.. Komisioni vëren se provohen deklaratimet e subjektit me dokumentacione paraqitur. I pyetur lidhur me periudhën ku ka jetuar bashkëshortja gjatë kohës së punësimit të saj në qytetin e Sarandës³²⁰, subjekti deklaroi se ajo ka banuar në një banesë të vogël të marrë me qira, për të cilën nuk disponojnë kontratë, por ka paguar një shumë prej 3.000 lekësh në muaj. Ndërsa gjatë periudhës 2003 – 2004, referuar deklaratimeve të subjektit, bashkëshortja e ka ushtruar aktivitetin në Kavajë dhe punonte më së shumti nga shtëpia.

15.8. Sa më lart, konstatohet se subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 2001 – mars 2004 ka banuar në ambientet e zyrave pranë Prokurorisë së Rrethit Skrapar dhe, nga ana tjetër, ka deklaruar se për të gjithë periudhën e deklaratimit, nga viti 2003 – 2016 dhe në vijim, ka jetuar me bashkëshorten dhe vajzat.

15.9. Lidhur me shpjegimin e subjektit se ka pasur konfuzion lidhur me deklaratimin e adresave dhe se ato janë kopjuar në vazhdimësi, Komisioni vëren se për sa i përket deklaratimit në DIP të apartamentit në Tiranë si adresë banimi dhe si adresë të gjendjes civile, duket bindës shpjegimi, pasi ky apartament rezulton të jetë dhënë me qira gjatë viteve 2006 – 2007; vajza e subjektit ka ndjekur mësimin në një shkollë jopublike me vendndodhje në Durrës; DPGJC nuk e konfirmon këtë adresë si adresë zyrtare të gjendjes civile.

15.10. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

16. Analiza financiare

16.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet: (i) për periudhën 1998 – 2000 për subjektin e rivlerësimit; (ii) për periudhën 2001³²¹

³²⁰ Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Paga si juriste në ZVRRP Sarandë mars – dhjetor 2000 në shumën 90.000 lekë”.

³²¹ Subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në datën 13.12.2000, ndërsa vajza I. K. ka lindur në datën 28.3.2001.

– 2016 për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, duke i vendosur në dispozicion subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1, me emërtimin “Analiza financiare” dhe aneksin nr. 2, me emërtimin “Metodika e analizës financiare”.

16.2. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës³²², me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 17.852.494 lekë për blerjen e pasurive, shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1998 – 2016³²³, e detajuar në vijim, për të cilat barra e provës ka kaluar në paragrafët përkatës: (i) Për periudhën 1998 – 2003: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën totale prej 1.839.590 lekësh për pagesën e kësteve 26.000 USD për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe 1.473.681 lekë për pagesën e dy kësteve 36.000 USD për blerjen e njësisë në bulevardin “***”, Tiranë; (ii) Për vitin 2005: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 400.000 lekë për blerjen e automjetit në datën 4.1.2005; (iii) Për vitin 2008 dhe për vitin 2011: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën totale prej 2.310.402 lekësh për pagesën e kësteve prej 18.000 euro për blerjen e apartamentit me sip. 69 m² në Durrës, si dhe për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve; (iv) Për vitin 2009: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 937.099 lekë për blerjen e automjetit në datën 12.2.2009 dhe mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.584.284 lekë në datën 19.6.2009, për të kryer një shlyerje të parakohshme të kredisë në shumën 20.000 euro, për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve; (v) Për vitin 2012: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 1.297.149 lekë për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shlyerjen e detyrimeve; (vi) Për vitin 2013: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 885.409 lekë për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shlyerjen e detyrimeve dhe mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e llogarisë bankare në vitin 2013, në shumën 1.500 USD (ekuivalenti 153.570 lekë) pranë Intesa Sanpaolo Bank, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga konsulenca; (vii) Për vitin 2014: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 2.525.512 lekë për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shlyerjen e detyrimeve; (viii) Për vitin 2015: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 704.369 lekë për shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shlyerjen e detyrimeve; (ix) Për vitin 2016: mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 2.471.428 lekë në datën 20.10.2016 për blerjen e pasurive, shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve.

16.3. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se në lidhje me mungesat e burimeve financiare në momentin e krijimit të pasurive, shtimit të likuiditeteve apo përballimit të shpenzimeve, bazuar në

³²² Subjekti u informua se analiza financiare do të ndryshojë në varësi të provave që do të sjellë në përgjigje të barrës së provës.

³²³ Në këtë shumë nuk është përfshirë konstatimi i paragrafit nr. 2.16, pika (iii) – *subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 175.000 lekë për shtesën prej 300.000 lekësh të likuiditeteve cash gjatë periudhës 1.1.2017 – 25.1.2017 dhe i paragrafit nr. 12.26.6 – ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e depozitimit të shumës 1.175.000 GRD, ekuivalenti 452.448 lekë.*

shpjegimet e dhëna më lart, faktet dhe provat e paraqitura, vlerëson se ka kundërshtuar dhe provuar të kundërtën e barrës së provës.

16.4. Në përfundim të analizave konkluduese të shprehura në këtë vendim, tabela financiare e përmbledhur paraqitet në tabelën vijuese:

Tabela nr. 12 – Analiza financiare 1998 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit	Balanca negative në momentin e krijimit të pasurisë /shpenzimit
1998-2003	5,913,410	0	0	5,238,776	461,080	1,178,872	-1,392,426	-1,392,426	-1,392,426
2004	1,715,200	0	620,917	2,544,232	0	319,614	-111,499	-111,499	-127,966
2005	450,000	500,000	501,753	2,046,579	0	582,589	12,237	0	-400,000
2006	5,000,000	2,150,000	-807,359	3,460,080	4,294,500	1,410,539	1,400	0	
2007	0	0	884,526	2,473,205	0	1,510,388	78,291	0	
2008	1,219,600	550,000	-877,008	2,208,300	0	1,277,977	37,730	0	
2009	1,230,725	-1,600,000	212,333	3,196,516	0	4,254,683	-901,225	-901,225	-901,225
2010	0	-350,000	78,742	2,962,655	0	1,056,147	2,177,765	0	
2011	2,502,540	150,000	610,160	3,788,086	1,390,300	1,865,091	50,595	0	
2012	0	200,000	770,205	2,329,510	0	1,256,454	102,851	0	
2013	750,000	200,000	1,668,737	5,722,373	0	1,594,037	1,509,599	0	
2014	0	1,450,000	1,328,562	4,877,672	0	1,824,621	274,488	0	
2015	5,118,450	-2,250,000	5,349,963	10,570,905	2,236,120	2,042,982	2,545,631	0	
2016	800,000	0	1,168,835	6,116,572	-1,394,800	2,355,314	397,623	0	
TOTAL	24,699,925	1,000,000	11,510,366	57,535,461	6,987,200	22,529,308	4,783,062	-2,405,149	- 2,821,616

16.5. Në përfundim, referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive, trajtuar në seksionin përkatës të pasurive, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me një vlerë totale prej 2.821.616 lekësh për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16.6. Në konkluzion të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet për çdo pasuri dhe analizën financiare për të gjithë periudhën, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

17. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar për subjektin e rivlerësimit një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.12.2023, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

18. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli.

19. Komisioni me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.10.2023, ka kërkuar përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponohen deri aktualisht. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga AKSIK-ja me anë të shkresës nr. *** prot., datë 13.12.2023, rezulton se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin e rivlerësimit, çka nuk e ndryshon konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

20. Gjatë hetimit administrativ, nga analizimi i deklaratës së kontrollit të figurës, konstatohet se subjekti në pyetjen a keni pasur emër tjetër më parë, është përgjigjur po dhe ka shpjeguar se: *“Emri i mëparshëm ka qenë “Mirdit”, i ndryshuar me vendim të Këshillit të Komunës ***, Elbasan, në “Madrid”.* Ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezulton se në vitin 1974 është bërë korigjimi i emrit të subjektit nga “Mirediti” në “Mirdit”, në vitin 1996, ndryshon përsëri emrin nga “Mirdit” në “Madrit”, dhe më pas nga “Madrit” në “Madrid”. Subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të pyetësorit nr. 2 , ku në përgjigje deklaroi se lidhur me ndryshimin e emrit në vitin 1974 nuk ka asnjë dijeni dhe se gjatë gjithë jetës është njohur me emrin Madrid dhe në jo pak raste ai ndryshonte në shqiptim në Madrit. Për shkak se Gjendja Civile në kohën kur ka lindur nuk bënte regjistrimin e emrit në Madrid, i ati ia ka vendosur emrin Mirdit. Ndërkohë që në dokumentet personale dhe shkollore e ka pasur emrin Madrid (ose Madrit). Sipas vërtetimit të Njësisë Administrative ***, Elbasan, në vitin 1996, organi administrativ me vendimin nr. ***, datë 23.8.1996, ka bërë ndryshimin zyrtarisht të emrit nga Mirdit në Madrid. Megjithëse ka ndryshuar emrin, në kohën që ka bërë regjistrimin e shkëputjes nga trangu familjar, Gjendja Civile Sarandë me vendimin nr. ***, datë 10.4.1998, vendos emrin Madrit, me “t”, gjë e cila ndryshohet dhe reflektohet përfundimisht me anë të vendimit të organit administrativ nr. ***, datë 21.1.2010, të Bashkisë Tiranë, ku bëhet edhe korigjimi i shkronjës “t” në “d”. Sa rezultoi, subjekti nuk ka deklaruar në formularin e kontrollit të figurës ndryshimin e ndodhur në vitin 2010 për korigjimin e shkronjës “t” në “d”. Megjithatë, hetimet e Komisionit janë orientuar në të dy emrat e subjektit, Madrit dhe Madrid Kullolli dhe nuk kanë rezultuar fakte apo rrethana të cilat ndikojnë në rivlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli.

21. **Në konkluzion**, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, **duke konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.**

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

22. Subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli gjatë periudhës: 16.1.1998 – 1.11.1998 ka ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Sarandë; nëntor 1998 – janar 1999 ka ushtruar detyrën prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; janar 1999 – dhjetor 2000 është emëruar zëvendësprokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; dhjetor 2000 – mars 2004 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Skrapar; mars 2004 – maj 2008 ka ushtruar detyrën prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; nëntor 2008 – tetor 2010 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë; tetor 2010 – qershor 2013 ka qenë zv. prokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; qershor 2013 – nëntor 2016 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme; nëntor 2016 e në vijim ushtron detyrën prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

23. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar një raport të hollësishëm të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Aftësitë profesionale

24. *Njohuritë ligjore* – Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka identifikuar dhe analizuar normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit, duke respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.

25. *Arsyetimi ligjor* – Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje, si dhe i kushtohet rëndësi pasqyrimit të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre dhe tregimin e rrethanave të faktit.

Aftësitë organizative

26. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – Konstatohet se gjatë periudhës së rivlerësimit prokurori Madrid Kullolli ka trajtuar gjithsej 334 çështje penale. Subjekti në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

27. *Aftësia për të administruar dosjet* – Dosjet gjyqësore konstatohet se janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit dhe disponimin e gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

28. Etika në punë – Nga aktet e vëzhguara ka rezultuar se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

29. Integriteti – Konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

30. Paanësia – Gjatë hetimit nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese, si dhe nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

31. Aftësitë e komunikimit – Komunikimi rezulton në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

32. Gatishmëria për t'u angazhuar – Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë periudhës së rivlerësimit është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare/trajnime) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Hetimi i kryer nga Komisioni

33. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara dhe ankesat e paraqitura, duke kërkuar informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë³²⁴, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë³²⁵ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij nga periudha 2006 e deri më sot, si dhe Prokurorisë së Përgjithshme³²⁶ e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar³²⁷ lidhur me të gjitha procedimet penale, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

34. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 12.2.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, rezultoi se nuk janë evidentuar të dhëna/ankesa të paraqitura nga palë të treta për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli.

35. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 8.2.2021, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, rezultoi se nuk janë evidentuar të dhëna/ankesa të paraqitura nga palë të treta për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli. Komisioni i është drejtuar përsëri Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë³²⁸, për të marrë informacion të përditësuar me të dhëna deri më sot. Pas administrimit të shkresës *** prot., datë 30.10.2023, rezultoi se ndaj subjektit janë depozituar 4 ankesa: ankesa e shtetasit K. H. e vitit 2022 dhe ankesa e shtetasit I. H. e vitit 2022, të cilat janë në fazën e shqyrtimit fillestar, si dhe ankesa e shtetasit G. P. e vitit 2020 dhe ankesa e shtetasit A. Q., për të cilat është vendosur arkivimi i tyre. Pasi u analizuan në mënyrë me të detajuar ankesat e paraqitura, vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

³²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2021.

³²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2021.

³²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2021.

³²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 28.7.2023.

³²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.10.2023.

36. Pas administrimit të shkresës *** prot., datë 8.6.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se: (i) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³²⁹ informon se ndaj subjektit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 3.9.2019, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është mosfilluar në datën 19.9.2019; (ii) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë³³⁰ informon se ndaj subjektit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2020, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin është vendosur mosfillimi.

37. Pas administrimit të shkresës *** prot., datë 18.3.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezultoi se në emër të subjektit janë regjistruar këto procedime penale: (i) kallëzimi penal nr. *** në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të cilin është vendosur mosfillimi; (ii) materiali kallëzues me kallëzues shtetasin Y. D., i cili është vendosur t’i dërgohet për vlerësim Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë; (iii) materiali kallëzues me kallëzues shtetasin K. H., i cili është vendosur t’i dërgohet për vlerësim Prokurorisë së Përgjithshme; (iv) materiali kallëzues me kallëzues shtetasit Y. Sh. dhe A. Sh., i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nga hetimi i Komisionit gjithashtu rezultoi një tjetër material kallëzues, për të cilin në datën 4.5.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit ndaj subjektit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; (v) materiali kallëzues me kallëzues shtetasin K. H., i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (vi) materiali kallëzues, me kallëzues shtetasin Y. D., për të cilin në datën 19.9.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit ndaj subjektit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

38. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 27.10.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezultoi se në emër të subjektit janë regjistruar këto materiale hetimore: (i) nr. ***, datë 2.3.2022³³¹, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 15.3.2022, (ii) nr. ***, datë 15.3.2022³³², për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 23.3.2022.

39. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 13.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezultoi se në emër të subjektit janë regjistruar këto materiale hetimore: (i) nr. ***/2019³³³, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 19.9.2019; (ii) nr. ***/2022³³⁴, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 29.7.2022; (iii) nr. ***/2022³³⁵, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 27.12.2022; (iv) nr. ***/2023³³⁶, për të cilin është vendosur mosfillimi i

³²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2021.

³³⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2021.

³³¹ Kallëzues shtetasi K. H., ndaj subjektit Madrid Kullolli, E. K., P. D., B. G. dhe P. C. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

³³² Kallëzues shtetasi K. H., kundër shtetasve E. K., P. D. dhe Madrid Kullolli për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

³³³ Kallëzues shtetasi Y. D., ndaj subjektit Madrid Kullolli, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

³³⁴ Kallëzues shtetasi K. H., kundër shtetasve E. K., P. D. dhe Madrid Kullolli për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

³³⁵ Kallëzues shtetasi I. H., ndaj subjektit Madrid Kullolli, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

³³⁶ Kallëzues shtetasi K. H., ndaj subjektit Madrid Kullolli, E. K., dhe P. D., për veprën penale “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

procedimit në datën 18.4.2023; (v) nr. ***/2023³³⁷, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 2.6.2023.

40. Gjatë hetimit është evidentuar se të gjithë kallëzuesit e këtyre procedimeve penale paraqiten edhe në cilësinë e denoncuesve pranë Komisionit, në këto kushte janë administruar dhe analizuar të gjithë fashikujt penalë përkatës. Në përfundim të hetimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale, trajtuar në vijim.

DENONCIME

41. Pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit Madrid Kullolli janë administruar 16 denoncime nga publiku. Në 14 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: denoncimet nr. *** prot., datë 21.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2018, të shtetases A. N.; denoncimi nr. *** prot., datë 21.3.2018, i shtetases O. D.; denoncimi nr. *** prot., datë 30.7.2018 i shtetasit F. A.; denoncimet nr. *** prot., datë 15.2.2022; nr. *** prot., datë 9.5.2022; nr. *** prot., datë 18.11.2022; nr. *** prot., datë 20.12.2022; nr. *** prot., datë 27.12.2022; nr. *** prot., datë 20.4.2023; nr. *** prot., datë 6.10.2023; nr. *** prot., datë 24.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 24.11.2023, të shtetasit K. H.; denoncimi nr. *** prot., datë 22.11.2023, i shtetasit G. R. Ndërkohë që Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet sa vijon:

42. Denoncimi nr. * prot., datë 20.2.2023, i shtetasit I. H.,** i cili ankohet për zvarritjen e hetimeve të disa funksionarëve të IMT-së Bashkia Durrës, të akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

42.1 Rrethanat e faktit – Në datën 5.11.2022, shtetasi I. H. kallëzon se ka njoftuar me shkresë zyrtare IMT-në Bashkia Durrës në lidhje me një ndërtim të paligjshëm që po kryhej në çatinë e objektit të ndërtesës ku ai banon, në Lagjen Nr. *** (pronë në bashkëpronësi). Personat që kanë kryer ndërtimin, i kanë vjedhur atij dhe bashkëpronarëve (kushërinjve të tij) çatinë ekzistuese. Nga ana e IMT-së Durrës janë konstatuar shkelje (kryerja e punimeve pa leje përkatëse dhe duke e kthyer çatinë e pashfrytëzueshme në çati të shfrytëzueshme pa leje), si dhe është nxjerrë urdhër ekzekutimi nr. *** prot., datë 20.10.2022, për prishjen e ndërtimit pa leje³³⁸. Ekzekutimi nuk u krye, pasi ndërtimi ndodhet në katin e fundit në objektin në lartësi dhe, për të bërë të mundur prishjen, kërkohen mjete të specializuara dhe punëtorë. Për të bërë të mundur prishjen e ndërtimit pa leje, u është bërë kërkesë institucioneve të tjera në varësi të Bashkisë Durrës. Kallëzuesi deklaroi se nuk është kryer asnjë veprim fizik për ekzekutimin e prishjes së objektit dhe, si pasojë e mosveprimit nga ana e IMT-së, atij i është dëmtuar banesa, e cila ndodhet një kat më poshtë objektit pa leje. Sa rezulton, ky shtetas ka bërë kallëzim penal kundër punonjësve të IMT-së Durrës për mosveprimin në zbatim të detyrës dhe për shpërdorim detyre.

³³⁷ Kallëzues shtetasi K. H., ndaj subjektit Madrid Kullolli, E. K., P. D., B. G. dhe P. C., për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal.

³³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2022, IMT-ja Durrës ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën e kallëzuesit, e gjithashtu me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2022, IMT-ja Durrës ka kthyer përsëri përgjigje.

42.2 Në datën 9.11.2022, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar materialin kallëzues nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në datën 17.10.2022, bazuar në neni 290/1, pika “ç”, dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal për këto arsye: *së pari*, lidhur me kryerjen e ndërtimit pa leje, shtetasi I. H. ka paraqitur kallëzim dhe mbi bazën e këtij kallëzimi është regjistruar procedimi penal në datën 22.8.2022, më pas ka bërë sërish kallëzim penal lidhur me të njëjtin objekt dhe çështja është bashkuar sërish me këtë procedim penal; *së dyti*, kallëzimi ndaj punonjësve të IMT-së Bashkia Durrës nuk është i bazuar në fakte dhe prova; *së treti*, vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, me qëllim që ajo të ekzistojë, kërkon si elemente bazë dashje në mospërbushjen e detyrës sipas ligjit dhe përfitimin e paligjshëm ose sjelljen e pasojave për palët, e cila në rastin konkret nuk provohet.

42.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shfuqizimin e vendimit penal për mosfillimin e hetimeve, regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara në vendim. Gjykata arsyeton se shtetasi I. H. ka bërë disa kallëzime penale dhe për faktet e pretenduara rezulton se çështja është në shqyrtim në një procedim tjetër penal të regjistruar³³⁹, por nisur nga fakti se kallëzuesi ka bërë kallëzim, mund të kryhen disa veprime hetimore, siç janë pyetja e inspektorëve, analizimi i shkaqeve se pse nuk është ekzekutuar prishja e ndërtimit pa leje, dhe përcaktimi i shkallës së dëmtimeve të banesës së shtetasit I. H.

42.4 Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me sa më sipër konstatohet dhe subjekti në prapësime dhe në seancë gjyqësore deklaroi se: *“Kjo çështje është në shqyrtim e sipër dhe nuk është marrë një vendim i formës së prerë. Pas verifikimit të ankimit³⁴⁰ rezulton se nuk është shqyrtuar ende nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*.

42.5 Vlerësimi ligjor – Komisioni çmon se e gjithë veprimtaria e prokurorit gjatë procesit të hetimit paraprak është në kontroll të plotë të gjykatës dhe çdo vendim lidhur me përfundimet e hetimit paraprak vlerësohet nga gjykata. Gjatë hetimit është konstatuar se subjekti në datën 13.2.2023 ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, ku ka parashtruar se *“vetë gjykata e ka pranuar faktin se kallëzimi është i përsëritur, i mbivendosur në pretendime dhe kërkime”*, por sërish urdhëron të kryhen hetime për një çështje, e cila është regjistruar si procedim penal e vazhdon të ndiqet në dinamikë në një hetim tjetër procedural. Subjekti parashtron se gjykata argumenton në mënyrë të gabuar kur urdhëron të kryhen disa veprime hetimore, të cilat janë duke u kryer nga një hetim tjetër dhe, nëse nuk janë duke u kryer, mund të kryhen në hetimet e nisura. Gjithashtu, gjykata pranon faktin se nga ana e IMT-së është kryer detyra funksionale duke kallëzuar veprën penale. Ndërkohë që duke përfituar nga mundësia që ligjvënësi nuk e tarifton kryerjen e kallëzimit penal, shtetasi I. H. ka paraqitur të paktën 9 kallëzime penale³⁴¹ për të njëjtin

³³⁹ Në vendimin e gjykatës citohet se: *“Rezulton se shtetasi I. H. në datën 9.9.2022, në Komisarriatin e Policisë Durrës ka bërë një kallëzim penal tjetër për këtë ndërtim të paligjshëm dhe, në datën 22.8.2022, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedim penal për veprat penale “Shkatërrimi i pronës”, “Ndërtimi i paligjshëm”, “Dhënie ndihmë për ndërtim të paligjshëm” dhe “Vetëgjyqësia”, që parashikohen nga nenet 150, 199/a-3, 199/b e 277 të Kodit Penal. Sipas urdhrit të prokurorit D. P., del se për shtetasin A. T. (babai i S. P.) dyshohet se ka kryer veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a-3 i Kodit Penal e se shtetasi F. N. dyshohet për veprën penale, e parashikuar nga neni 199/b i Kodit Penal.”*

³⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

³⁴¹ Për periudhën gusht 2022 – janar 2023 janë bërë këto kallëzime nga ana e shtetasit I. H.: Në hetim: (1) Procedimi nr. ***, regjistruar më 25.8.2022, mbi kallëzimin e shtetasit A. P. ndaj shtetasit I. H., i cili është në hetim nga prokurori D. P., për nenin 150, 199/a të Kodit Penal është bashkuar me procedimin nr. ***. (2) Kallëzimi nr. ***, regjistruar më 26.8.2022 mbi kallëzimin e

objekt hetimi dhe se kallëzimi ndaj IMT-së është duke u hetuar në procedimin penal nr. ***/2022, i cili është në shqyrtim e sipër. **Sa rezultoi**, gjenden bindëse shpjegimet e subjektit dhe arsyetimi i tij se *gjykata në rastin konkret duhet të kujdeset në mosndërhyrjen dhe moskonfondimin e çështjeve midis shumë hetimeve.*

42.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se janë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme lidhur me këtë procedim penal, si dhe nuk janë cenuar të drejtat e asnjë pale në proces. Sa rezulton, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

43. Denoncimi nr. * prot., datë 14.12.2023, po nga shtetasi I. H.**, i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë mbi mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2023.

43.1 Në datën 17.7.2023 është regjistruar materiali kallëzues nr. *** mbi bazën e kallëzimit të personit juridik “***” sh.p.k., me administrator shtetasin I. H., nëpërmjet të cilit ka kallëzuar Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës dhe shtetasen A. K., punonjëse pranë kësaj drejtorie për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

43.2 Rrethanat e faktit – Në vitin 2021, shtetasi I. H. në cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare “***” sh.p.k. është paraqitur pranë DRT-së Durrës, për të kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë tatimore. Ai është takuar në këtë institucion me shtetasen A. K., punonjëse pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve në DRT-në Durrës, ku ka kërkuar informacion në lidhje me këtë çështje. I është thënë që duhej të dërgonte një formular në portalin e tatimeve e-filling C@ts. Në datën 1.11.2021 ka dërguar formularin për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit, ku ka kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë tatimore, kalimin nga përgjegjësia tatimore tatim i thjeshtëzuar për biznesin e vogël në tatim mbi fitimin. DRT Durrës ka bërë datën e ndryshimit të kësaj përgjegjësie tatimore më 1.12.2021. Si pasojë e këtij ndryshimi ka pasur një rritje artificiale të kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin për vitin 2022 dhe nuk është marrë asnjë masë për heqjen e detyrimit të deklarimit të thjeshtëzuar mbi fitimin për vitin 2022, duke u justifikuar me faktin që nuk mund të ndërhyjë në sistem. Për shkak të këtyre gabimeve të bëra nga punonjësit e DRT-së Durrës, subjektit tregtar i është shkaktuar një dëm financiar në vlerën 453.227 lekë gjoba për mospagimin në afat të kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin për vitin 2022 dhe mosdeklarim të tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin për vitin 2022, që për këtë të fundit nuk kishte

shtetasen A. P. ndaj shtetasit I. H., i cili është në hetim nga prokuror D. P., për nenin 150 të Kodit Penal është bashkuar me procedimin nr. ***. (3) Procedimi nr. ***, regjistruar më 11.9.2022 mbi arrestimin e shtetasit I. H., i cili është në hetim nga prokurori D. P., për nenin 199/a, 150 të Kodit Penal. (4) Procedimi nr. ***, regjistruar më 28.9.2022 mbi kallëzimin e shtetasit I. H., i cili është në hetim nga prokurori S. N., për nenin 186/a të Kodit Penal. (5) Procedimi nr. ***, regjistruar më 28.9.2022 mbi kallëzimin e shtetasit I. H., i cili është në hetim nga prokurori S. N., për nenin 186/a të Kodit Penal. Në fazën e verifikimit: kallëzimi i shtetasit I. H. me nr. ***, regjistruar në datën 17.1.2023, i cili ndiqet nga prokurorja E. Xh., është në fazën e verifikimit. Pushim: Procedimi nr. ***, regjistruar më 25.7.2022 mbi kallëzimin e shtetasit I. H., ndjekur nga prokurori N. T., regjistruar për nenin 150, 199/a të Kodit Penal, pushuar në datën 1.2.2023. Mosfillim: (1) Kallëzimi i shtetasit I. H. nr. ***, regjistruar më 5.1.2023, ndjekur nga prokurori B. B., regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 16.1.2023. (2) Kallëzimi i shtetasit I. H. nr. ***, regjistruar më 6.10.2022, ndjekur nga prokurorja F. R., regjistruar për nenin 305 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 20.10.2022. (3) Kallëzimi i shtetasit I. H., nr. ***, regjistruar më 9.11.2022, ndjekur nga prokuror Madrid Kullolli, regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 17.11.2022. (4) Kallëzimi i shtetasit I. H. me nr. ***, regjistruar më 10.11.2022, ndjekur nga prokuror B. B., regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 21.11.2022. (5) Kallëzimi i shtetasit I. H. nr. ***, regjistruar më 12.12.2022, ndjekur nga prokuror A. Sh., regjistruar për nenin 250 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 15.12.2022. (6) Kallëzimi i shtetasit I. H., nr. ***, regjistruar më 20.12.2022, ndjekur nga prokurori B. B., regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 19.12.2022. (7) Kallëzimi i shtetasit I. H. nr. ***, regjistruar më 28.12.2022, ndjekur nga prokurori B. B., regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, mosfilluar në datën 28.12.2022.

përgjegjësi tatimore për të deklaruar. Sa rezulton, kallëzuesi ka bërë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila ka vendosur pranimin pjesor të ankimit, të cilin duhet ta ankimojë në Gjykatën Administrative. Ndërkohë që Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit Tiranë ka dalë në konkluzionin se është një gabim i punonjësve të DRT-së Durrës.

43.3 Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor rezulton se subjekti ka kryer këto veprime hetimore: (i) në datën 20.7.2023 ka nxjerrë urdhrin për marrjen e dokumenteve të dorëzuara nga kallëzuesi; (ii) në datën 20.7.2023 ka marrë deklarin nga kallëzuesi; (iii) në datën 31.7.2023 ka marrë deklarin nga shtetasja A. K. dhe po në këtë datë ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili i është njoftuar kallëzuesit me anë në shkresës nr. *** prot., datë 15.9.2023³⁴². Subjekti ka arsyetuar se problematikave tatimore të parashtruara i është dhënë zgjidhje nëpërmjet Drejtorisë së Apelimit Tatimor dhe, bazuar në nenin 109, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kallëzuesi mund ta kundërshtonte këtë vendim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për të³⁴³. Nga verifikimi paraprak i kryer në funksion të kallëzimit, rezultoi se kallëzuesi e ka ankuar vendimin e DAT në Gjykatën Administrative të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për pasojë, ndodhemi përpara një çështjeje administrative, pasi veprimet dhe mosveprimet e punonjësve të DRT-së Durrës nuk përbëjnë elemente të veprës penale, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe, si rrjedhojë, kallëzuesi ka të drejtë të ndjekë pretendimin e tij në rrugë administrative, në Gjykatën Administrative.

43.4 Vendimi mbi mosfillimin e hetimeve të procedimit penal është ankimuar nga kallëzuesi. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës³⁴⁴ ka vendosur pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e vendimit të mosfillimit, regjistrimin e procedimit dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Komisioni vëren se janë lënë këto detyra për organin e akuzës: (1) Të kryhen hetime lidhur me veprimet ose mosveprimet e kryera nga shtetasja A. K., si punonjëse e

³⁴² Në vendimin e mosfillimit, subjekti arsyetoi se nga deklarin e shtetasës A. K. rezultoi se aplikimi për ndryshimin e përgjegjësiave tatimore është bërë në datën 15.2.2022 në mënyrë elektronike, në e-filling, duke kërkuar shtimin e përgjegjësisë së tatimit nga data 1.11.2021, kjo kërkesë është pasqyruar në sistem në datën 16.2.2022. Subjekti tregtar plotësonte kushtet për ndryshim përgjegjësie nga muaji tetor i vitit 2021 dhe duhej të kërkonte ndryshimin e përgjegjësisë brenda 15 ditëve nga data e plotësimit të kushteve, pra nga data 1.10.2021 deri në datën 15.10.2021. Në momentin që ka ardhur ky aplikim, brenda ditës ajo ka bërë hapjen e çështjes në sistem dhe shtimin e përgjegjësisë së tatimit për vitin 2021, nga data 1.12.2021, për t'i krijuar mundësinë subjektit për të deklaruar tatimitin e vitit 2021, sepse, nëse do të bëhej në datën 1.11.2021 që ka kërkuar subjekti, do të ngarkohej me penalitete për deklarime të vonuara të ndryshme tatimore. Në të gjitha rastet e aplikimeve të vonuara ose jashtë afatit ata ndiqnin këtë procedurë, pasi nuk kishin të drejtë dhe tagër që të detyronin subjektin të bënte kërkesë gjatë periudhës kohore ligjore 1.10.2021 – 15.10.2021, pasi deklarimet në sistemin tatimor bazohen në vetëdeklarimin e subjektit. Pasi ka bërë shtimin e përgjegjësisë së tatimit, e ka njoftuar subjektin *online*, ku i ka cilësuar se regjistrimi në tatimit u krye nga data 1.12.2021. Pas këtij njoftimi ka përfunduar detyra e saj funksionale.

³⁴³ Komisioni vëren se Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur refuzimin e ankimit ndaj njoftim-vlerësimeve, shfuqizimin e aktit administrativ të detyrimeve tatimore për gjobën në masën 10.000 lekë për deklarimin e vonuar të deklaratorit të thjeshtuar mbi fitimin periudha 22-A, ndryshimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet. Referuar raportit të hartuar nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, ndër të tjera është arritur në konkluzionin se DRT-ja Durrës nëpërmjet zyrtarit tatimor ka vepruar gabim në përcaktimin e një afati të ndryshëm nga ai i kërkuar, duke shmangur ndryshimin e datës nga 1.11.2021 në 1.12.2021, pavarësisht pasojave në detyrimet tatimore që i lindnin tatimpaguesit dhe se detyrimet e lindura për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2022, gjeneruar nga sistemi, nuk mund të qëndrojnë, por një e drejtë e tillë fitohet duke ndjekur rrugën ligjore të ankimit sipas procedurave në ligjin mbi tatimet. Lidhur me pretendimet e kallëzuesit se nuk u është kthyer përgjigje kërkesave të tij, u gjet e provuar se DRT-ja Durrës ka kthyer përgjigje në çdo rast, qoftë në rrugë elektronike, qoftë në rrugë shkresore nëpërmjet shërbimit postar, ndërkohë që tatimpaguesi nuk kishte deklaruar një adresë të saktë dhe këto përgjigje janë kthyer mbrapsht. Është detyrë e tatimpaguesit të saktësojë/korrigjojë/plotësojë adresën e deklaruar pranë QKB-së. Gjithashtu, nuk provohet fakti që të jetë paraqitur fizikisht në DRT-në Durrës dhe të ketë kërkuar tërheqjen dorazi të akteve “Njoftim vlerësimi të detyrimeve”.

³⁴⁴ Vendimi nr. ***, datë 6.11.2023.

DRT-së Durrës, në raport me shoqërinë “****” sh.p.k.; (2) A duhet të vepronte punonjësi i DRT-së Durrës në datën 1.11.2021, datën kur tatimpaguesi ka kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë tatimore? (3) Të hetohet nëse i është shkaktuar dëm shoqërisë për periudhën 1.11.2021 – 1.12.2023 nga veprimi dhe mosveprimi i punonjës në datën e kërkuar nga tatimpaguesi për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore.

43.5 Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me sa më sipër konstatohet dhe subjekti në prapësime dhe në seancë gjyqësore deklaroi se: *“Në një afat 15-ditor të përcaktuar nga ana e ligjvënësit për fillimin ose mosfillimin e hetimeve, nuk mund të kryhen hetime të thelluara, por mund të kryhet një verifikim i fakteve të kallëzuara, provave, mbi bazën e të cilave duhet të mbështeten këto fakte, si dhe ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale. Në rastin konkret, sikurse në shumë raste të tjera, kallëzuesit e veprave penale ngatërrojnë lëndën, fushën e caktuar që rregullon marrëdhënien juridike, ose qëllimisht kërkojnë involvimin e organit të procedimit në përfshirjen e marrëdhënieve të tjera juridike, duke pretenduar se mund të gjejnë një zbatim më të shpejtë të kërkesave të tyre, kur kanë paraqitur një kallëzim penal etj. Për shkak se kërkesa e kallëzuesit është një kërkesë e cila gjen zbatim në një marrëdhënie tjetër juridike, sikurse është ajo administrative, është vendosur se nuk gjendemi në kushtet për fillimin e hetimeve.³⁴⁵ Vetëm pas shqyrtimit të rastit në rrugë administrative, kallëzuesi legjitimohet të kryejë kallëzim penal, nëse pas këtij shqyrtimi do konstatoheshin shkelje ligjore të administratës tatimore apo të së kallëzuarës, shkelje të cilat do ishin konstatuar nga ana e organit kompetent, në rastin konkret Gjykata Administrative, vetëm atëherë mund të ekzistonin dyshime se ishte kryer veprë penale dhe patjetër që do të fillonin hetimet”*. Në përfundim, subjekti deklaroi se kallëzuesit nuk i është prekur dhe cenuar asnjë e drejtë ligjore apo procedurale.

43.6 Vlerësimi ligjor i Komisionit – Bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor. Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

43.7 Lidhur me vendimin e dhënë nga subjekti për mosfillimin e këtij procedimi penal, Komisioni ka në vëmendje vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku arsyetohet se prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer dhe, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, më tej verifikon nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal.

43.8 Gjatë hetimit rezultoi se subjekti ka apeluar vendimin e gjykatës, duke arsyetuar se gjykata nuk ka argumentuar në asnjë moment se cilat janë ato shkaqe që përlligjin ekzistencën e faktit penal, por mjaftohet vetëm duke lënë tri detyra, nga të cilat dy të parat janë verifikimi i punës së administratës dhe e treta nëse i është shkaktuar dëm ose jo subjektit, pikë e cila është sqaruar nga

³⁴⁵ Vetëm organet që kontrollojnë veprimtarinë e administratës tatimore mund dhe duhet t’u japin një përgjigje zyrtare kërkimeve të kallëzuesit dhe jo organi i procedimit, i cili nga ana e tij nuk është i specializuar në fushën e marrëdhënieve tatimore e administrative, për sa kohë kjo fushë mbulohet më së miri nga organet e posaçme administrative, bazuar në ligjin përkatës.

ana e organit administrativ DAT. Lidhur me veprimet e kryera nga ana e punonjësës së DRT-së Durrës, në vendim subjekti ka arsyetuar se ajo nuk ka pasur asnjë qëllim apo dashje për të sjellë pasoja, çka mund ta ngarkonte punonjësën në fjalë me përgjegjësi disiplinore në punë dhe jo penale, në rast gabimi gjatë procedurës së regjistrimit në sistemin tatimor. Hollësitë e aplikimit për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore, njoftimit të regjistrimit, regjistrimit, njoftim-vlerësimit, mundësisë së ankimit, riparimit të pasojave etj., nuk janë kompetencë e organit të procedimit, por janë kompetencë e organeve të specializuara të administratës tatimore. Për sa kohë nga organet tatimore nuk u është dhënë një zgjidhje problematikave të parashtruara në kallëzim, bazuar në nenin 109, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kallëzuesi ka të drejtë të ndjekë pretendimet e tij në rrugë administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative.

43.9 Në përfundim, Komisioni vendos të marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, duke pasur parasysh se qasja dhe arsyetimi i tij në vendimin e dhënë ka të bëjë me faktin se sipas vlerësimit dhe bindjes së tij kjo nuk është një çështje e juridiksionit penal, por është në kompetencë të Gjykatës Administrative. Trupi gjykues nuk mund të marrë attribute për të vlerësuar lidhur me themelin e çështjes apo lidhur me arsyet që kanë çuar subjektin në vendimmarrjen e tij në këtë çështje dhe se problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara më sipër nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja procedurale për palët. *Sa rezulton,* kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Riçelja e hetimit

44. Pranë Komisionit u administrua në rrugë elektronike, në datën 3.3.2024, ora 12:28, një denoncim nga shtetasi S. F., protokolluar me nr. ***, datë 4.3.2024, në Komision. Trupi gjykues vendosi të kryejë disa hapa hetimorë dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit për riçeljen e hetimit administrativ kryesisht, për të analizuar pretendimet e denoncuesit lidhur me faktin se bashkëshortja e subjektit ka qenë në rolin e mbrojtësit në çështje penale, të cilat iu përkisnin prokurorëve të seksionit që drejtonte subjekti në vitin 2008, 2009 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

45. Më tej, gjatë periudhës së hetimit administrativ kryesisht mbi denoncimin e sipërpërmendur, në Komision janë administruar edhe tri denoncime të tjera: nr. *** prot., datë 11.3.2024, paraqitur nga shtetasi E. Gj; nr. *** prot., datë 13.3.2024, paraqitur nga një shtetas anonim; nr. *** prot. datë 18.3.2024, paraqitur nga shtetasi K. H.

46. Komisioni vlerëson se në denoncimin e shtetasit K. H. (nr. *** prot., datë 18.3.2024) paraqiten të njëjtat pretendime për të cilat Komisioni ka hetuar dhe janë analizuar gjatë hetimeve paraprake. Ndërkohë që kreu hetim të mëtejshëm lidhur me denoncimet sa më poshtë vijon:

47. Denoncimi i paraqitur në rrugë elektronike, në datën 3.3.2024, ora 12:28, nga shtetasi S. F., protokolluar me nr. *, datë 4.3.2024, në Komision**

47.1 Ky shtetas pretendon se: (i) subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli nëpërmjet lidhjeve me biznesmenë të fuqishëm në qytetin e Durrësit është përpjekur të ndikojë në procesin e rivlerësimit që po zhvillohet ndaj tij tek trupi gjykues; (ii) gjatë kohës që subjekti ka qenë shef i njësisë së

posaçme të hetimit në Prokurorinë e Rrethit Durrës në vitet 2008 – 2009, ka qenë në konflikt interesi, duke ndikuar në çështjet e ndjekura nga bashkëshortja e tij B. K., e cila zhvillon aktivitetin e avokatit; (iii) denoncuesi ngre pretendime mbi konfliktin e interesit dhe çmimin real të tokës bujqësore me sipërfaqe 1.000 m² në ***, Durrës, blerë nga subjekti në vitin 2015; (iv) mbi mundësitë financiare të subjektit lidhur me pasurinë njësi/ambient zyre, të blerë në vitin 2003. Pas kontrollit në regjistrin e të dhënave të Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë, Komisioni konstaton se nuk identifikohet/rezulton asnjë shtetas me emrin e denoncuesit S. F.

47.2 Referuar *indicieve të paraqitura në këtë denoncim, rezultoi sa vijon: Lidhur me pretendimet se subjekti është përpjekur të ndikojë në procesin e rivlerësimit që po zhvillohet ndaj tij*, Komisioni vëren se nuk është paraqitur asnjë provë lidhur me sa citohet në denoncim. *Lidhur me pretendimet për tokën bujqësore me sipërfaqe 1.000 m² në ***, Durrës, të blerë nga shitësit shtetasit F. dhe J. B., me kontratën nr. ***, datë 17.2.2015, në vlerën 221.000 lekë, gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar se: (i) Komisioni ka hetuar lidhur me vlerën reale të tregut për tokë bujqësore në zonën ***, Qarku Durrës³⁴⁶, e cila përlllogaritet 221 lekë/m², në total për 1.000 m² çmimi i kësaj pasurie shkon 221.000 lekë, e njëjtë me vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes; (ii) Nga hetimi i Komisionit³⁴⁷ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit e kësaj prone, shtetasit F. dhe J. B.³⁴⁸. Lidhur me pretendimet për pasurinë njësi/ambient zyre, të blerë me kontratën nr. ***, datë 6.10.2003, Komisioni ka hetuar mbi burimet e ligjshme financiare për pagesën e dy kësteve prej 36.000 USD dhe vlerën reale të tregut për këtë pasuri³⁴⁹, si dhe gjatë hetimit paraprak nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqërinë “****” sh.p.k. (trajtuar në pikën 5 të vendimit). Lidhur me pretendimet se subjekti ka qenë në konflikt interesi duke ndikuar në çështjet e përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, Komisioni kreu hetime duke kërkuar informacion nga Prokuroria³⁵⁰ dhe Gjykata³⁵¹ e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës mbi numrin e çështjeve që i janë ngarkuar shtetasës B. K. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor kryesisht dhe/ose e zgjedhur nga palët në periudhat 2008 – 2009, si dhe informacion lidhur me palët ne proces dhe prokurorin që ka ndjekur çështjen. Referuar përgjigjes së administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës³⁵², rezulton se pas verifikimit të kryer (vendimeve të pushimit dhe kërkesave për gjykim) shtetasja B. K. është ngarkuar në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, e zgjedhur nga palët*

³⁴⁶ Bazuar në vendimin nr. 514, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”.

³⁴⁷ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

³⁴⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023, nr. *** prot., datë 26.11.2023.

³⁴⁹ Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2003^[4] (vitin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes) në qytetin e Tiranës, nga ku rezultoi se çmimi për apartamentet ka qenë në shumën 53.450 lekë/m². Komisioni vëren se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 2 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit në Bashkinë Tiranë, referencë e cila është përdorur edhe më tej lidhur me metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme. Për pasojë, njësia e porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 4.276.000 lekë, përkundrejt çmimit prej 4.723.200 lekë të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes.

³⁵⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 7.3.2023.

³⁵¹ Shkresa nr. *** prot., datë 7.3.2023.

³⁵² Shkresa nr. *** prot., datë 12.3.2023.

në 5 çështje penale dhe në cilësinë e përfaqësuesit ligjor caktuar kryesisht në 13 çështje penale, të cilat janë hetuar/ndjekur nga disa prokurorë, por jo prej subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli.

47.3 Komisioni vëren se bashkëshortja e subjektit ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, e zgjedhur nga palët në procedimin penal nr. ***/2008, të zhvilluar ndaj shtetasit A. K., ndjekur nga prokurori E. K.. Shtetasi A. K. (vlen të përmendet se Komisioni ka hetuar me të dy emrat që ka pasur ky shtetas “***” dhe “P.” K.) është në cilësinë e palës shitëse në kontratën nr. ***, datë 17.5.2006, për pasurinë e transkriptuar apartament me sip. 148 m², me adresë Lagjja Nr. ***, ish-ruga “***”, Durrës (trajtuar në pikën 13 të vendimit). Kredia në shumën 35.000 euro është disbursuar në datën 27.6.2006 dhe në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k., ku shtetasi P. (A.) K. figuronte ortak i vetëm i kësaj shoqërie. **Sa rezulton**, apartamenti i mësipërm është blerë dhe shlyer nga ana e subjektit dhe personit të lidhur në vitin 2006, ndërkohë që procedimi i përfaqësuar nga bashkëshortja e subjektit është regjistruar në vitin 2008.

47.4 Nga hetimi i Komisionit, referuar vendimit të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 1.12.2011, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 25.11.2008³⁵³, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin A. K. për kundërvajtjen penale “Kanosja”, në dëm të shtetasit B. Xh., duke e dënua me 100.000 lekë gjobë, si dhe ta deklarojë të pafajshëm për kundërvajtjen penale “Kanosja” në dëm të shtetas D. Xh. dhe atë “Vetëgjyqësia”, pasi nuk provohet të jetë kryer nga i pandehuri, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 26.4.2010.

47.5 Sa më sipër rezultoi, si dhe nga hetimi i Komisionit³⁵⁴, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Tiranë, Berat dhe Sarandë nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin P. (A.) K. dhe shoqërinë “***” sh.p.k.³⁵⁵. **Për rrjedhojë**, në faktet dhe rrethanat e analizuara nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

47.6 Referuar përgjigjes së administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës³⁵⁶, rezulton se bashkëshortja e subjektit B. K. ka ndjekur 230 çështje në cilësinë e përfaqësuesit ligjor kryesisht ose të zgjedhur nga palët për periudhën 2008 – 2009. Komisioni analizoi të gjitha vendimet e paraqitura, nga të cilat 143 janë çështje penale dhe pjesa tjetër çështje civile. B. K. shfaqet në cilësinë e përfaqësueses ligjore kryesisht të caktuar nga gjykata në 37 çështje penale (nga të cilat 5 janë me objekt “Vleftësimi dhe caktimi i masës së sigurimit”) dhe në 106 çështje penale shfaqet në cilësinë e përfaqësueses ligjore të zgjedhur nga palët (nga të cilat 37 janë me objekt “Vleftësimi dhe caktimi i masës së sigurimit”).

Komisioni gjithashtu analizoi palët në gjykim dhe prokurorët që kanë ndjekur këto çështje, nga ku nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me aktivitetin e ushtruar nga bashkëshortja e tij.

³⁵³ Administruar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2023.

³⁵⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 3.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023, nr. *** prot., datë 30.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2023.

³⁵⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 26.10.2023, nr. *** prot., datë 8.11.2023, nr. *** prot., datë 31.10.2023, nr. *** prot., datë 24.11.2023, nr. *** prot., datë 26.11.2023.

³⁵⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 12.3.2023.

47.7 Në përfundim, nga hetimi kryesisht i Komisionit në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se nuk provohen pretendimet e ngritura në këtë denoncim apo ndonjë problematikë tjetër, e cila lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas ligjit nr. 84/2016.

48. Denoncimi i paraqitur në rrugë elektronike në datën 13.3.2024, ora 10:15, nga një shtetas anonim, protokolluar me nr. ***, datë 13.3.2024, në Komision.

48.1 Në këtë denoncim ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e shefit të seksionit dhe organizues i shortit brenda tij: (i) mban vetë në mënyrë preferenciale pa short çështjet që i interesojnë nga dosjet e prokurorëve të larguar dhe/ose zëvendësuar/transferuar dhe çështjet e tjerat i shorton në mënyrë të padrejtë te prokurorët e tjerë; (ii) prej muajit nëntor ky subjekt nuk merr pjesë në listën e prokurorëve të gatshëm, por ndërhyr në çështjet që janë me interes për të; (iii) i përzgjedh çështjet që do të marrë në shqyrtim me qëllim përfitimin personal.

48.2 Komisioni konstatoi se nuk është paraqitur asnjë dokument provues apo *indicie* lidhur me pretendimet që ngrihen në këtë denoncim, në këto kushte iu drejtua përsëri Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës³⁵⁷, duke kërkuar të vihet në dispozicion e gjithë praktika e hedhjes/organizimit të shortit nga ana e prokurorit Madrid Kullolli në cilësinë e shefit të seksionit, si dhe praktika e hedhjes së shortit të gatishmërisë për të gjithë periudhën që ky subjekt mban funksionin e shefit të seksionit pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

48.3 Referuar përgjigjes së administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës³⁵⁸, rezulton se subjekti është caktuar drejtues i seksionit të trafikeve dhe krimit ekonomik me urdhrin nr. ***, datë 8.2.2021 dhe drejtues i seksionit të krimeve të përgjithshme me urdhrin nr. ***, datë 20.7.2023, të drejtuesit të Prokurorisë. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të seksionit gjatë kësaj periudhe ka organizuar 52 shorte manuale. *Lidhur me praktikën e hedhjes së shortit të gatishmërisë*, evidentohet se grafiku i gatishmërisë mujore nxirret vetëm nga drejtuesi i prokurorisë dhe nuk përpilohet mbi bazën e shortit.

48.4 Komisioni vëren se seksionet në prokurori janë njësi të strukturës në prokuroritë përkatëse me jo më pak se tre prokurorë, të cilat ngrihen nga drejtuesi i prokurorisë për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme. Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ngritja e seksioneve bazohet, ndër të tjera, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale. Drejtuesi i seksionit emërohet nga drejtuesi i prokurorisë nga radhët e prokurorëve të seksionit, të cilët kanë të paktën 5 vjet përvojë si prokurorë, rezultate të mira në punë dhe aftësi organizative. Bazuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe udhëzimin nr. ***, datë 1.2.2017 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioni vëren se është përcaktuar sa vijon: *“Shpërndarja e çështjeve pranë kësaj prokurorie, si rregull realizohet me anë të shortit elektronik. Në mungesë të shortit elektronik do të përdoret*

³⁵⁷ Shkresa nr. ***, prot., datë 19.3.2023.

³⁵⁸ Shkresa nr. ***, prot., datë 21.3.2023.

shorti manual.³⁵⁹ Çështjet, përpara hedhjes në short, duhet të grupohen, për sa është e mundur, sipas përkatësisë për seksionet e ngritura në prokurori. Çështjet e grupuara u ndahen manualisht në mënyrë të barabartë grupeve me nga jo më pak se tre prokurorë, duke respektuar specializimin/ndarjen në seksione. Pas kësaj ndarjeje, bëhet ndarja me short e çështjeve që i kanë rënë çdo seksioni, ndërmjet secilit nga prokurorët, në raport të barabartë.³⁶⁰ Procedura e hedhjes së shortit duhet të jetë e monitorueshme, e dokumentuar dhe transparente, nëpërmjet njoftimit paraprak për zhvillimin e tij brenda orarit zyrtar³⁶¹.

48.5 Sa më sipër, bazuar në rregulloren e Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, pasi çështjet ndahen manualisht në seksione, bëhet ndarja e tyre me short në raport të barabartë ndërmjet prokurorëve të secilit seksion. Bazuar në nenin 53, pika 2 e ligjit nr. 97/2016, përcaktohet se rregullat e përcaktuara në pikën 1³⁶² të këtij neni parashikojnë që çështja t'u caktohet paraprakisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar të kryhet me short, në mënyrë elektronike. Sipas *indicieve* të paraqitura në këtë denoncim rezultoi se:

48.6 Lidhur me faktin se subjekti mban vetë në mënyrë preferenciale pa short çështjet që i interesojnë nga dosjet e prokurorëve të larguar dhe/ose zëvendësuar/transferuar dhe çështjet e tjerat i shorton në mënyrë të padrejtë te prokurorët e tjerë, nga analizimi i 52 procesverbaleve mbi dokumentimin e shortit manual dhe shpërndarjen e materialeve hetimore, konstatohet se janë organizuar 21 shorte lidhur me dosjet hetimore të prokurorëve, për të cilat ekzistonin shkaqe zëvendësimi. Në analizë të pretendimit të denoncuesit, nga këto 21 shorte subjekti e ka përfshirë veten e tij vetëm në 5 prej tyre, ndërkohë që materialet e tjera u janë shortuar prokurorëve të tjerë të seksionit (5-8 prokurorë). Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka përfshirë veten e tij në 16 procedura shorti.

48.7 Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimet se: *Subjekti nuk ka vepruar në zbatim të pikës 4 të udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori", ku përcaktohet se ndarja me short e çështjeve që i kanë rënë çdo seksioni, bëhet në raport të barabartë ndërmjet secilit nga prokurorët.*

48.8 Për sa më sipër, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: *"Shorti manual është ndarja e çështjeve në mënyrë përjashtimore*

³⁵⁹ Përjashtohen nga hedhja e shortit këto çështje: a) Materialet e referuara për hetim, pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare; b) Referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme; materialet e parashikuara në shkronjën "a", në parim i kalojnë për shqyrtim prokurorit të planifikuar për periudhën e gatisshmërisë nga drejtuesi i prokurorisë, por kur janë në numër të madh mund t'u nënshtrohen procedurave të shortit, rregullave të parashikuara në udhëzim; c) Çështjet e pushuara, të pezulluara apo të mosfilluara më parë, për të cilat me vonë është vendosur rifillimi i ndjekjes penale, i kalojnë, pa short, menjëherë prokurorit që e ka ndjekur fillimisht hetimin. Në raste të veçanta, kur prokurori që ka hetuar rastin ndodhet me leje, është transferuar ose heq dorë, çështja i caktohet një prokurori tjetër me short.

³⁶⁰ Drejtuesi i Prokurorisë drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës në prokurori. Në zhvillimin e këtij procesi, drejtuesi do të ndihmohet nga zëvendësdrejtuesi, drejtuesit e seksioneve dhe nga prokurori përgjegjës për mbajtjen e regjistrit dhe një sekretare.

³⁶¹ Referimet dhe kallëzimet që nuk kërkojnë veprime të menjëhershme, hidhen në short në fund të ditës së paraqitjes në prokurori ose kur kjo ditë është pushim zyrtar në ditën e mëpasme të punës. Për rastet e ushtrimit të ndjekjes penale kryesisht, nëse referimi vjen nga policia gjyqësore e seksioneve, çështja caktohet në përputhje me rregullat e përcaktuara më lart për shpërndarjen e çështjeve. Nëse ushtrimi i ndjekjes penale bëhet kryesisht nga prokurori, çështja i caktohet atij prokurori pa u hedhur në short.

³⁶² 1. Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla të detajuara për: a) procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi; b) kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve; c) rastet dhe kriteret për rishpërndarjen e çështjeve; ç) mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre.

dhe zhvillohet vetëm atëherë kur shorti elektronik nuk funksionon ose nuk gjen zbatim. Gjithashtu, shorti manual hidhet pasi drejtuesi i institucionit ka konstatuar se ekzistojnë shkaqe ligjore të nevojës për hedhjen e shortit manual, sikurse mund të jenë shkaqet ligjore të zëvendësimit të një prokurori nga çështja, të cilat sipas ligjit janë disa dhe, më konkretisht: pranimi i heqjes dorë të një prokurori nga çështja për shkaqe ligjore, largimi i një prokurori me raport mjekësor apo leje lindjeje, largimi i një prokurori me anë të transferimit në një prokurori tjetër, shkarkimit të një prokurori nga funksioni etj.

*Shorti manual, i cili hidhet nga drejtuesi i seksionit, organizohet në mënyrë transparente në prani të prokurorëve të seksionit, të cilët njoftohen paraprakisht për vendin, orën dhe datën e hedhjes së shortit nëpërmjet njoftimit nga sekretaria (nuk përjashtohet hedhja e shortit manual edhe nga drejtuesi i prokurorisë, sidomos në rastet e shkarkimit të prokurorit, shortet janë hedhur pothuajse gjithmonë nga drejtuesi). Shorti hidhet në prani të prokurorëve të seksionit të cilët, pas zgjidhjes së çështjes, në përfundim të shortit, nënshkruajnë pjesëmarrjen dhe vërejtjet, nëse kanë të tilla. Në jo pak raste drejtuesi i seksionit, sikurse dhe prokurorët e tjerë, nuk kanë mundur të marrin çështje për ndjekje dhe trajtim, pasi numri i tyre ka qenë më i vogël sesa numri i prokurorëve në shortet e kryera. Gjithashtu, mundësia e përzgjedhjes së numrave të çështjes, për shkak transparence u lihet në fillim prokurorëve dhe drejtuesi i seksionit tërheq numrin pas tyre. Nga verifikimi i 52 shorteve manuale të hedhura, rezulton se në 25 procesverbale të mbajtura, për secilin prej tyre është hedhur në short një çështje penale, ndërmjet katër, pesë ose gjashtë prokurorëve, duke përfshirë edhe drejtuesin e seksionit. Në këto 25 procesverbale rezulton se nuk ka asnjë vërejtje nga ana e prokurorëve që kanë marrë pjesë në short dhe se ndarja është kryer në mënyrë transparente dhe e verifikueshme, konform udhëzimit nr. ***, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm. Në 12 procesverbale shorti, ka rezultuar se janë hedhur nga dy deri në njëzet çështje për secilin short, në 6 prej të cilave ka rezultuar se i ka takuar shorti edhe drejtuesit të seksionit për 9 çështje. Në 15 procesverbale të hedhura pas datës 15.1.2024, drejtuesi i seksionit është përjashtuar nga shorti me urdhër të drejtuesit të prokurorisë, për shkak të rritjes së numrit të prokurorëve, për shkak të ngarkesës në punë me çështje komplekse të drejtuesit të seksionit, ngarkesës me punë organizative-koordinuese, mentoruese etj. Subjekti deklaroi se për një periudhë 7-vjeçare ka ndjekur 1166 procedime penale, në 557 raste ka vendosur mosfillimin e hetimeve, duke trajtuar në këtë mënyrë një total prej 1723 çështjesh, çka tregon jo vetëm për një ngarkesë mbi mesataren e kolegëve, por nëse merret në konsideratë edhe kompleksiteti i një sërë çështjesh, rezulton të jetë përballuar një ngarkesë pune shumë e madhe”.*

48.9 Vlerësimi ligjor i Komisionit – Për të provuar ngarkesën në punë, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. *** prot., datë 3.4.2024, të lëshuar nga Prokuroria pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku jepet informacion në lidhje me ngarkesën e punës për vitet 2018 – 2020 sipas raporteve vjetore të kësaj prokurorie, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.4.2024, me anë të së cilës provohet se me urdhrin nr. ***, datë 20.7.2023, të drejtuesit të prokurorisë, subjektit i janë caktuar çështje të shortuara elektronikisht/manualisht për shkak të vakancës në numrin e prokurorëve në organikën e Prokurorisë së Rrethit Durrës. Me urdhrin nr. ***, datë 2.10.2023, të drejtuesit të prokurorisë, është bërë përjashtimi i subjektit nga shorti elektronik për një afat të pacaktuar, për shkak se në këtë prokurori janë transferuar 6 prokurorë, të cilët janë përfshirë në short. Me urdhrin nr. ***, datë 15.1.2024, të drejtuesit të prokurorisë, është

bërë përjashtimi nga shorti manual për një periudhë të pacaktuar, për shkak të ngarkesës në punë, për sa i përket ushtrimit të detyrave si drejtues seksioni, përgatitja e analizës vjetore, përgatitja e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe Rezolutës së Kuvendit, si dhe faktit se është magjistrat udhëheqës i kandidatës B. L.. Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 3.4.2024, lëshuar nga Prokuroria pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezulton se subjekti është pjesë e trajnimeve për periudhën 2021 e në vazhdim, si dhe është pjesë e Taks-Forcës vendore për koordinimin, orientimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave vendore të ngarkuara me zbatimin e Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, analizat e përbashkëta të gjendjes, matjen dhe vlerësimin e suksesit të strukturave të ngarkuara me zbatimin e këtij plani. Gjithashtu, referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 2.4.2024, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, vërtetohet se për periudhën 2020 – 2024 subjekti është angazhuar në programin e formimit fillestar dhe në programin e formimit vazhduar.

Në lidhje me ngarkesën e pretenduar, Komisioni, referuar dokumentacionit të paraqitur dhe statistikave vjetore të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, konstaton se për vitin 2017 subjekti i rivlerësimit ka ndjekur 132 procedime penale, në vitin 2018 – 149 procedime, në vitin 2019 – 150 procedime, në vitin 2020 – 127 procedime, në vitin 2021 – 151 procedime, në vitin 2022 – 202 procedime dhe për vitin 2023 – 255 procedime penale.

48.10 Sa rezultoi, vërehet se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të seksionit ka mbajtur një ngarkesë të lartë pune dhe provohet gjithashtu fakti se ka trajtuar çështje me karakter kompleks.

48.11 Lidhur me faktin se subjekti ka që në muajin nëntor që nuk është në listën e gatishmërisë, por ndërhyrjen në çështjet që janë me interes për të, në referim të pikës 2 të udhëzimit nr. ***, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, konstatohet se grafiku i gatishmërisë mujore nxirret vetëm nga drejtuesi i prokurorisë dhe nuk përpilohet mbi bazën e shortit.

48.12 Sa rezultoi, duket se mospërfshirja në listën e gatishmërisë nuk është përgjegjësi e subjektit, por e drejtuesit të prokurorisë dhe se lidhur me ndërhyrjen e subjektit në grafikun e gatishmërisë (në çështjet që janë me interes për të) konstatohet se denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë *indicie* apo provë e cila vërteton këtë pretendim.

48.13 Lidhur me faktin se subjekti për zgjedh çështjet që do të marrë në shqyrtim me qëllim përfitimin personal, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të seksionit ka realizuar 52 shorte manuale, për të cilat nuk është e qartë dhe nuk ka informacion se përse janë përjashtuar nga shorti elektronik, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 2 e ligjit nr. 97/2016.

48.14 Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimet se: *Duket se subjekti i rivlerësimit ka organizuar vetëm shorte manuale dhe jo elektronike sipas përcaktimeve ligjore, çka ka shtuar dyshimet mbi shpërndarjen preferenciale të çështjeve, duke mos garantuar transparencën mbi paanësinë në zhvillimin e shortit brenda seksionit të drejtuar prej tij.*

48.15 Për sa më sipër, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: “Pas mbërritjes së njoftimit të veprave penale në sekretarinë e organit të procedimit, materialet bëhen hyrje në librat e protokollit dhe menjëherë i dërgohen drejtuesit të organit për të bërë përzgjedhjen e referimeve sipas grup-seksioneve të Prokurorisë. Sapo bëhet ky

studim i materialeve referuese (i cili përgjithësisht kufizohet mbi anën formale të referimit, kompetencën tokësore, lëndore etj.), i dërgohen zyrës së regjistrimit, e cila bën hedhjen fillimisht në regjistrin e kallëzimeve të veprave penale (regjistër fizik dhe elektronik) të të dhënave informuese mbi ngjarjen, kohën, vendin, të dyshuarin, viktimën etj. dhe, më pas, numri i përfituar nga regjistrimi me të dhënat e tij i nënshtrohet shortit elektronik. Pas ndarjes së çështjes elektronikisht, sipas një sistemi të certifikuar nga Prokuroria e Përgjithshme, printohet një fletë shoqëruese me të dhënat e kallëzimit penal, në të cilën rezulton edhe prokurori të cilit i është caktuar elektronikisht materiali kallëzues. Menjëherë sekretarja e zyrës së regjistrimit ndan fizikisht materialin dhe kundrejt nënshkrimit i dërgon për kompetencë materialin prokurorit të caktuar, i cili ka një afat 15-ditor për të vendosur nëse materialin do ta mosfillojë në bazë të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale apo do ta regjistrojë si procedim penal në bazë të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale.

48.16 Për shkak të nevojës për organizimin e punës në mënyrë më efikase, në urdhrat dhe udhëzimet përkatëse të drejtuesit të prokurorisë, është vendosur që në materialet referuese të cilat shoqërohen me arrestimin apo ndalimin e personit/personave, apo në ngjarje të rënda kriminale për të cilat ka ndërhyrë në vendngjarje apo me veprime të ngutshme prokurori (si përgjime, sekuestime, etj.), i kalojnë menjëherë prokurorit të gatshëm, bazuar në listën e gatishmërisë, e cila nxirret nga drejtuesi në çdo fillim muaji dhe i dërgohet për t'u njohur Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë së Policisë Kufitare, komisarivateve të policisë, afishohet në një vend të dukshëm të organit të procedimit, u njoftohet të gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore etj.

48.17 Me anë të kësaj mënyre shortimi elektronik të ndarjes së çështjeve në organin e procedimit, kryhet ndarja e pothuajse 95-98% të çështjeve dhe vetëm një përqindje shumë e vogël e çështjeve ndahet nga ana e seksioneve sipas grup-veprave që mbulojnë, në një procedurë shortimi manual të njëjtë për të gjitha seksionet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

48.18 Vlerësimi ligjor i Komisionit – Sikundër është arsyetuar edhe gjatë hetimit, bazuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe udhëzimin nr. ***, datë 1.2.2017 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përjashtohen nga hedhja e shortit këto çështje: a) materialet e referuara për hetim, pas orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare; b) referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme. Materialet e parashikuara në shkronjën “a”, në parim i kalojnë për shqyrtim prokurorit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga drejtuesi i prokurorisë, por kur janë në numër të madh mund t'u nënshtrohen procedurave të shortit, rregullave të parashikuara në udhëzim; c) çështjet e pushuara, të pezulluara apo të mosfilluara më parë, për të cilat me vonë është vendosur rifillimi i ndjekjes penale, i kalojnë pa short menjëherë prokurorit që e ka ndjekur fillimisht hetimin. Në raste të veçanta, kur prokurori që ka hetuar rastin ndodhet me leje, është transferuar ose heq dorë, çështja i caktohet një prokurori tjetër me short.

48.19 Sipas praktikës së hedhjes së shortit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezulton se vetëm një përqindje shumë e vogël e çështjeve (sipas grup-veprave që mbulojnë), ndahen nga ana e seksioneve me short manual. Referuar deklarimeve të

subjektit në prapësime, si dhe në seancë, i pyetur nga trupi gjykues, konstatohet se për ndarjen e këtyre çështjeve në seksionet përkatëse nuk është bërë e mundur nga ana teknike hedhja e një shorti elektronik. **Për rrjedhojë**, subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi lidhur me këtë praktikë, për sa kohë është në kompetencë të institucionit të prokurorisë krijimi i infrastrukturës së nevojshme sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 2 e ligjit nr. 97/2016.

48.20 Në përfundim, nga hetimi kryesisht i Komisionit në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se nuk provohen pretendimet e ngritura në këtë denoncim apo ndonjë problematikë tjetër, e cila lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas ligjit nr. 84/2016.

49. Denoncimi i paraqitur në rrugë elektronike në datën 8.3.2024, ora 14:18, nga shtetasi E. Gj., protokolluar me nr. ***, datë 11.3.2024, në Komision.

49.1 Ky shtetas pretendon se: (i) subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka qenë në rrethana të papajtueshme në hetimin/ndjekjen e çështjes penale me palë të akuzuar shtetasen O. D., pasi ka lidhje të ngushta miqësie me kallëzuesin I. H.; (ii) nuk ka hetuar lidhur me aktivitetin e kryer, burimet e ligjshme dhe mundësinë financiare të shtetasit I. H. për t'i dhënë hua shtetasen O. D. shumë e pretenduar prej rreth 1 milion euro. Pas kontrollit në regjistrin e të dhënave të Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë, Komisioni konstaton se nuk identifikohet/rezulton asnjë shtetas me emrin e denoncuesit E. Gj.

49.2 Gjatë hetimeve paraprake në Komision referuar denoncimit nr. *** prot., datë 21.3.2018, të paraqitur nga shtetasja O. D., është administruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasen O. D., pas kallëzimit të viktimës së veprës penale, shtetasit I. H..

49.3 Rrethanat e faktit – Ka rezultuar e provuar se shtetasja O. D. nga viti 2015 deri në fund të vitit 2017 ka mashtruar një numër të konsiderueshëm personash, duke u marrë atyre nëpërmjet mashtrimit shuma të konsiderueshme parash, të cilat në total arrijnë një vlerë monetare prej 2.733.049 euro, 26.100.000 lekë dhe 103.000 USD. Këto detyrime pjesërisht janë të dokumentuara me dokumente noteriale (kontratë huaje, deklarata noteriale), pjesërisht me kontrata të thjeshta huaje ndërmjet palëve, pjesërisht me dokumente të thjeshta dore, pjesërisht vetëm nga kallëzimet e të dëmtuarve dhe dokumente të tjera provuese, me anë të mandatpagesave, me kartela financiare, komunikime midis palëve, përgjime telefonike etj. Më konkretisht: (1) Kallëzuesi I. H. citon në kallëzimin dhe deklaratimet e tij se shtetasja O. D. gjatë aktivitetit të kryer ka krijuar një diferencë të madhe në para dhe për një periudhë të gjatë, rreth njëvjeçare, duke gënjyer dhe shpërdoruar besimin e tij për kthimin e këtyre shumave. Ai ka paraqitur dokumente, të dhëna dhe informacione, mbi bazën e të cilave krijohen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se e kallëzuara e ka mashtruar duke mos i kthyer shumë 935.432 euro. Nga ana e saj, e kallëzuara, e pyetur rreth kallëzimit, pranon marrëdhënien e saj me shtetasin I. H., subjektin e tij “****” sh.p.k. dhe shtetasin A. H., vëllai i kallëzuesit. Gjithashtu, ajo fillimisht ka pranuar se ka një detyrim në shumë rreth 216.000 euro, por nuk pranon shumë për të cilën pretendon kallëzuesi dhe gjithashtu pretendon se shumatat e parave do ia kthejë në momentin më të parë. Gjatë periudhës hetimore, shtetasja O. D. nuk e pranon as detyrimin prej 216.000 euro ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., por pretendon se ata i detyrohen asaj shumë prej mbi 85.000 euro. (2) Kallëzuesja D. K. ka bërë kallëzim penal për shtetasen O. D., pasi për një periudhë rreth 1-vjeçare nëpërmjet mashtrimit i ka marrë shumë prej

56.000 euro dhe 200.000 lekë. (3) Kallëzuesja E. Sh. ka bërë kallëzim penal, pasi nëpërmjet mashtrimit i ka marrë në datën 29.9.2016 shumën prej 500.000 lekësh, duke i premtuar 25.000 lekë interesa në muaj, të cilët ia ka dhënë deri në muajin maj 2017 dhe më pas nuk i ka dhënë më interesa kësaj shtetaseje dhe as i ka kthyer lekët e marrë. (4) Kallëzuesi E. Xh. ka bërë kallëzim, pasi në muajin prill 2016 nëpërmjet mashtrimit i ka marrë shumën prej 750.000 lekësh, duke i premtuar 20.000 lekë interesa në muaj, të cilët ia ka dhënë deri në muajin dhjetor 2017 dhe më pas nuk i ka dhënë më interesa këtij shtetasi. (5) Kallëzuesja G. L. ka bërë kallëzim penal, pasi shtetasja O. D. i ka kërkuar një shumë prej 150.000 lekësh, duke i premtuar se i duhen vetëm për disa ditë, por nuk ia ka kthyer paratë me gjithë kërkesën e përsëritur. (6) Kallëzuesi R. Sh. ka bërë kallëzim penal, pasi në muajin prill të vitit 2016 nëpërmjet mashtrimit i ka marrë shumën 30.000 euro, duke i premtuar 2.000 euro interes në muaj, të cilat ia ka dhënë deri në muajin dhjetor 2017, por më pas nuk i ka dhënë më interesat dhe as shumën e parave të marra hua. (7) Shtetasi V. H. ka bërë kallëzim penal, pasi duke filluar nga muaji shkurt 2016 i ka marrë shumën 200.000 euro, duke i premtuar interesa të lartë, nga të cilët ka marrë shumën prej 170.000 lekësh dhe, më pas, nuk i ka dhënë më interesa këtij shtetasi dhe as i ka kthyer paratë e marra. (8) Kallëzuesi A. S. ka bërë kallëzim penal për shtetasen O. D., pasi duke nisur nga muaji shkurt 2016 deri në muajin shtator 2016 i ka marrë nëpërmjet mashtrimit shumën 103.000 USD dhe nuk ia ka kthyer. (9) Kallëzuesit I. D., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., B. P. dhe B. T. (të tre këta persona) kanë kallëzuar në Prokurori veprimet e shtetasës O. D., e cila, sipas kallëzimit dhe provave të paraqitura prej tyre, nga muaji korrik 2016 deri nga muaji shkurt 2017, nëpërmjet mashtrimit u ka vjedhur shumën neto 840.000 euro, e cila sipas llogarive të punës dhe fitimit të shitjeve që ajo do të realizonte sipas premtimeve të bëra, do shkonin në shumën 1.157.800 euro. (10) Kallëzuesja F. M. ka shpjeguar se është mashtruar me anë të shpërdorimit të besimit dhe gënjeshtërisë nga ana e shtetasës O. D. dhe, për rrjedhojë, kjo shtetase i ka marrë shumën 30.000 euro. (11) Kallëzuesi B. D. ka kallëzuar se shtetasi a O. D. i ka kërkuar një shumë parash dhe, pasi i është lutur dhe e ka bindur se do ia kthejë shumë shpejt, i ka dhënë edhe shumën prej 35.000 euro, të cilat nuk i ka marrë më. (12) Kallëzuesja E. L. ka kallëzuar shtetasen O. D. se i ka marrë shumën prej 2.000 euro për të rregulluar dhëmbët dhe dhëmballët e nënës së saj, shtetasës S. L. dhe nuk i ka pritur dhe nuk i ka kryer asnjëherë shërbimin e kërkuar. (13) Kallëzuesi L. V. ka kallëzuar se i ka dhënë hua një shumë totale prej 240.000 euro, të cilat referuar parashikimeve që kishin vendosur në deklaratat noteriale nuk ia ka kthyer. (14) Kallëzuesja shtetasja M. H. ka kallëzuar se pas njohjes me shtetasen O. D., për shkak se vajza e saj u punësua te klinika e kësaj të fundit, hyri në një lloj marrëdhënieje premtimi për ngritjen e një biznesi të përbashkët dhe i ka dhënë shumat e parave prej 16.900.000 lekësh dhe 313.000 euro.

49.4 Me vendimin nr. ***, datë 23.2.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës caktoi masën e sigurimit “Arrest në burg” ndaj së pandehurës, e cila është hetuar nën këtë masë sigurimi gjatë gjithë periudhës hetimore nga data e ekzekutimit 25.2.2018.

49.5 Lidhur me sa rezultoi gjatë hetimeve, subjekti i rivlerësimit në datën 19.11.2018 ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018. Në vendim, subjekti arsyeton se shtetasja O. D. ka kryer veprën penale të mashtrimit më shumë se një herë, pasi me veprimet dhe mosveprimet e saj aktive ajo ka mashtruar disa persona dhe, konkretisht, kallëzuesit e veprës penale (gjithsej 14 kallëzues), duke konsumuar në këtë mënyrë veprën penale “Mashtrimi”,

parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Ndërkohë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, përveçse ka mashtruar duke gënjyer dhe shpërdoruar besimin ndaj disa personave, ajo këtë veprimtari të paligjshme e ka kryer duke i mashtruar ata në shuma të mëdha parash e duke u shkaktuar pasoja të rënda financiare dhe sociale, duke konsumuar në këtë mënyrë veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. E kallëzuara gjatë hetimit pretendon se e gjithë marrëdhënia me kallëzuesit është një marrëdhënie juridiko-civile dhe se duhet të zgjidhet nga Gjykata Civile. Ndërkohë, me veprimet e saj, rezulton se nuk kishte qëllim krijimin dhe zhvillimin e ndonjë aktiviteti tregtar apo biznesi, por kishte si qëllim final vetëm shtënien në dorë të parave të kallëzuesve me çfarëdolloj mënyre. Nisur nga sa më sipër, rezulton se në rastin konkret nuk ndodhemi para moszbatimit të detyrimeve për shkak të vështirësive ekonomike, domethënë para një konflikti civil, por hyrja në marrëdhëniet kontraktuale është bërë për të mbuluar qëllimin për të marrë në dorë në mënyrë të kundërligjshme pasurinë e tjetrit (shihni vendimin nr. ***, datë 1.7.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Elementi kryesor që e dallon krimin e mashtrimit nga krimet e tjera kundër pasurisë, si dhe nga marrëdhëniet juridike civile, është përdorimi i gënjeshtërsë ose shpërdorimit të besimit, si mjet për të hedhur në dorë pasurinë ose përfitimet e tjera pasurore.

49.6 Sa rezulton, subjekti ka kërkuar deklarin fajtore të shtetases O. D. për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 6 vite burgim; deklarin fajtore për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe dënimin me 10 vite burgim, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht me 15 vite burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata të ulë masën e dënimit me një të tretën, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën O. D. për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 143/2 dhe 143/3 të Kodit Penal me 10 vite burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 8.3.2019, ka vendosur deklarin fajtore dhe dënimin e së pandehurës me 10 vite burgim. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 26.9.2019, ka vendosur dënimin me 6 vite e 8 muaj burgim. E dënuara është liruar në datën 21.2.2022 me “Plotësim dënimi”.

49.7 Nga shqyrtimi i fashikujve hetimorë, Komisioni vëren se subjekti ka hetuar lidhur me pasuritë e regjistruara në emër të shtetases O. D. dhe familjarëve të saj duke iu drejtuar DPT, ASHK-ve, bankave, DPPP etj., nga ku ka rezultuar se e pandehura zotëronte 3 apartamente në Tiranë dhe një në Durrës, në vlerë totale 300.000 euro, pasuri të cilat janë sekuestruar nga ana e gjykatës. Në datën 19.11.2018, subjekti ka marrë vendim për ndarjen e procedimit penal nr. ***/2018 në dy procedime penale, konkretisht në procedimin penal nr. ***, datë 26.1.2018, në ngarkim të shtetases O. D., për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga nenet 143/2/3 të Kodit Penal dhe në procedimin penal nr. ***, datë 19.11.2018, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në vendim, subjekti arsyeton se nisur nga fakti se ekzistojnë dyshime të bazuara në prova se paratë e vjedhura nga ana e shtetases O. D. viktimave të veprës penale janë fshehur me qëllim përdorimin e tyre në një periudhë kohe të mëpasme dhe duke i pastruar ato si para të fituara nga burime të ligjshme, rezulton se këto veprime parashikohen si vepër penale në nenin 287/1 të Kodit Penal. Nga hetimi ka rezultuar e provuar vjedhja e një shume prej rreth tre milionë euro, por vendndodhja e këtyre parave nuk dihet, pasi e pandehura refuzon bashkëpunimin me organin e procedimit dhe kthimin

e detyrimeve kallëzuesve të veprës penale. Në këto kushte, rezulton se ekzistojnë të gjitha dyshimet e arsyeshme se paratë e vjedhura nga shtetasja O. D. janë përdorur ose janë duke u përdorur në njërin nga format e pastrimit të produktit të mashtrimit duke i transferuar paratë, fshehur, investuar në vende të panjohura për hetimin etj. Për sa më sipër dhe nisur nga fakti se për akuzën “Mashtrimi”, parashikuar nga nenet 143/2/3 të Kodit Penal, hetimi është i plotë, ndërsa për dyshimin e kryerjes së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, është i nevojshëm vazhdimi i hetimeve³⁶³.

49.8 Referuar indicieve të paraqitura në këtë denoncim, rezultoi sa vijon:

i) Lidhur me faktin se subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli ka lidhje të ngushta miqësie me kallëzuesin I. H. – Nga hetimi paraprak i Komisionit rezultoi se shtetasja O. D. ka paraqitur kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli dhe gjyqtares së hetimeve paraprake, E. K.³⁶⁴, në këtë kallëzim ngrihen edhe pretendimet e paraqitura në denoncimin nr. *** prot., datë 11.3.2024. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2018, lënë në fuqi nga gjykata. Vendimi për mosfillimin e këtij procedimi penal ka marrë formë të prerë. **Sa rezultoi**, Komisioni vëren se nuk është paraqitur asnjë provë apo *indicie* për të mbështetur këto pretendime, qëndrim ky i mbajtur edhe gjatë hetimit të procedimit penal nr. ***/2018 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

ii) Lidhur me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar sa i takon aktivitetit të kryer, burimet e ligjshme dhe mundësinë financiare të shtetasit I. H. për t’i dhënë hua shtetasës O. D. shumë e pretenduar prej rreth 1 milion euro – Komisioni vëren se vëzhguesit ndërkombëtarë me anë të shkresës nr. *** prot., datë 27.3.2024, kanë paraqitur para trupit gjykues gjetjet sa më poshtë referohet:

49.9 Sa i përket moskryerjes së hetimeve të plota ndaj I. H. dhe personave të tjerë³⁶⁵, të cilët denoncuan në faza të ndryshme O. D., sjelljet e së cilës mund të jenë tregues për kryerjen e krimeve të rënda financiare, si pastrimi i parave që përfshin një grup më të gjerë individësh, përfshirë edhe denoncuesit, vepër penale e parashikuar nga neni 170, shkronja “ç” e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Përmbajtja e Gjetjeve: (1). Vëzhguesi ndërkombëtar dëshiron t’i referohet denoncimit nr. * prot., datë 21.3.2018, të z. O. D. dhe hetimin e kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“Komisionit”) për këtë çështje. Referuar gjithashtu edhe përmbajtjes së procedimit penal nr. ***, dosjet hetimore të të cilit i janë dorëzuar Komisionit nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. (2). Nga analiza e dokumenteve që disponohen, është fakt se I. H. dhe katërmëdhjetë personat e tjerë kanë denoncuar O. D. për**

³⁶³ Në këto kushte dhe nisur nga fakti se bazuar në nenin 93 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “Ndarja e çështjeve vendoset, edhe kryesisht, vetëm kur nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve, në këto raste: kur për një a më shumë të pandehur ose për një a më shumë akuzë hetimi gjyqësor është i plotë, kurse për të pandehurit e tjerë ose për akuzat e tjera është e nevojshme të kryhen veprime të tjera, me përjashtim të rastit kur akuzë është ngritur për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, procedimi penal duhet të ndahet me qëllim kryerjen e hetimeve për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Për të grumbulluar të dhëna të nevojshme lidhur me përcaktimin e plotë të faktit dhe veprës penale, si dhe për individualizimin e përgjegjësive penale dhe personit konkret që ka kryer veprën, është e domosdoshme kryerja e hetimeve të nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale”.

³⁶⁴ Për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Grup i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 248, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, në mbështetje të nenit 327, paragrafi I i Kodit të Procedurës Penale.

³⁶⁵ Të identifikuar si D. K., E. Sh., E. Xh., G. L., R. Sh., A. S., I. D., B. P., B. T., V. H., F. M., B. D., E. L., L. V., M. H.

moskthimin e shumave të mëdha të parave të transferuara në një periudhë të caktuar kohe dhe për arsye të ndryshme. Është fakt se I. H. dhe katërbëdhjetë personat e tjerë kishin në dispozicion shuma të mëdha parash, të cilat, për një arsye apo një tjetër, ia besonin ose ia transferonin O. D.. (3). Vëzhguesi ndërkombëtar nuk i ka të qarta burimet apo origjinën e shumave të tilla dhe është fakt se një kujdes i caktuar në kryerjen e detyrave të prokurorit duhet ta kishte shtyrë subjektin e rivlerësimit të bënte një hetim të plotë për origjinën e likuiditeteve në fjalë. (4). Sipas dokumenteve që disponon vëzhguesi ndërkombëtar, është fakt i paraqitur si gjetje në këtë dokument se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një hetim të plotë mbi origjinën/burimet e likuiditeteve të vëna në dispozicion të O. D. nga denoncues të ndryshëm. Nuk mund të përjashtohet se një hetim i përshtatshëm ndaj denoncuesve mund të kishte pasur ndikim në zbulimin e skemave serioze të pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare. (5). Gjithashtu, vëzhguesi ndërkombëtar dëshiron të nënvizojë se nga analiza e dokumenteve të disponueshme në dosjen hetimore nr. *** kishte të dhëna të qarta dhe të mjaftueshme për të dyshuar se paratë e huazuara nga O. D. ishin marrë kundrejt një përqindjeje të caktuar, duke çuar kështu në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 170 “ç”³⁶⁶ i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. (6). Këto të dhëna gjenden nga përmbajtja e denoncimeve ndaj O. D., si dhe nga të dhënat e përgjuara të komunikimeve të motrës së O. D. me I. D. (një nga palët e dëmtuara) dhe komunikimi në WhatsApp mes O. D. dhe V. H.. Ky është një fakt që vëzhguesi ndërkombëtar e paraqet si gjetje. (7). Skema e sipërpërmendur duket e qartë në disa komunikime, ku V. H. pranon se marrëveshja me O. D. ishte për të siguruar një shumë të caktuar mbi të cilën interesi mujor do të ishte 10% e saj. Konkretisht, në komunikimin në WhatsApp të datës 14.10.2017, V. H. përmend se O. D. i ka kërkuar 50 mijë euro hua dhe ai do të përfitonte 5000 euro në muaj. Ky është një fakt që paraqitet si gjetje bashkë me faktet se nga komunikimi në WhatsApp i datës 17.10.2017 rezulton se V. H. kërkon 600.000 lekë në muaj si interesa të rënë dakord të huas dhe komunikimet e përgjuara ndërmjet A. V. dhe O. D. tregojnë qartë se paratë janë marrë hua kundrejt interesave të lartë.

Konkluzione: Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet si gjetje faktet e mësipërme, të cilat tregojnë qartë moskryerjen e një hetimi të përshtatshëm ndaj I. H. dhe denoncuesve të tjerë për disa vepra penale të lidhura me nenin 170 “ç” të Kodit Penal dhe për mungesën e hetimit të origjinës së shumave të mëdha të parave, të cilat nuk mund të përjashtohen të jenë pjesë e skemave të pastrimit të parave, që mbeten të pazbardhura për shkak të pasaktësisë së subjektit të rivlerësimit për të kryer hetimet e duhura. **Në përfundim**, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetimet e sipërcituara lidhur me të dëmtuarit e veprës penale.

49.10 Nga faktet e analizuarra më lart, bazuar në gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me sa konstatohet.

49.11 Subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se në periudhën që është hetuar çështja penale (por edhe më pas), nga burimet e njohura, faktet, provat dhe rrethanat e çështjes nuk kishte asnjë *indicie* që denoncuesit të cilët humbën shuma të konsiderueshme parash, të kishin para të cilat rridhnin nga aktivitete kriminale. Kallëzuesi i parë I. H. kishte një subjekt tregtar, pikë këmbimi valutor të hapur me anë të Licencës

³⁶⁶ Kryerja e veprimtarisë financiare pa licencë.

nr. ***, datë 1.10.1999, veprimtari të cilën e kryente në dy zyra. Nga hetimi rezultoi se ai kishte xhiro vjetore në shuma financiare, të cilat të linin të kuptoje se i kishte të gjitha mundësitë për të dhënë sasinë e parave që kallëzonte se i ishin vjedhur. Ndërkohë që ka paraqitur një kontratë kredie bankare nr. ***, datë 22.6.2017, nga e cila rezulton se kishte disbursuar shumën 700.000 euro, të cilën e kishte marrë me qëllim vijimin e aktivitetit. Nisur nga fakti se kallëzuesi kishte një aktivitet tregtar të regjistruar, një xhiro të lartë vjetore, po ashtu edhe nga kreditë e marra, nga ku rezulton se nuk kishte asnjë dyshim për burimin e ligjshëm të parave të tij dhe mundësinë e dhënies së shumave në periudha të ndryshme kohore autorit të veprës penale O. D. Gjithashtu edhe tre kallëzues të tjerë kishin veprimtari tregtare të licencuar si zyra të këmbimit valutor, veprimtaria e të cilëve ndiqet dhe monitorohet në mënyrë rigoroze nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave etj. Kallëzuesi i parë, I. H., kishte burime të qarta të të ardhurave, pasi kishte biznes dhe kredi bankare, të cilat nuk linin asnjë dyshim mbi origjinën e parave, gjithashtu edhe tre nga kallëzuesit e tjerë I. D., V. H. e A. S., kishin zyra këmbimi valutor dhe biznese të rregullta. Ndërkohë, kallëzuesit e tjerë nuk linin dyshime se mund të kishin para të buruara nga krimi.

49.12 Subjekti deklaroi se ishte e paarsyeshme që ai të mendonte se viktimat, përfituesit nga pastrimi i parave që mund të buronin nga veprimtari kriminale, të pastronin paratë përsëri në rrugë të paligjshme dhe të përfitonin një burim të paligjshëm, sikurse ishin interesat që mund të merreshin nga O. D., interesa këta tërësisht jashtë sistemit financiar zyrtar, pra përsëri, nëse do përfitohej një burim, ai do ishte në të zezë dhe i papastruar. Pas një verifikimi që ai i ka bërë listës së emrave të kallëzuesve të veprës penale, rezultoi se asnjë prej tyre nuk ka ndonjë dënim penal (i cili është një kusht thelbësor për të pasur *indicie* për fillimin e dyshimeve të ekzistencës së veprës penale të pastrimit të parave), përjashtojë kallëzuesin B. D., i cili ka një dënim penal të vitit 1986, për të cilin ka marrë pafajësinë, bazuar në ligjin nr. 7748, datë 29.7.1993 “Mbi pafajësinë dhe amnistinë e ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist”.

49.13 Lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale, bazuar në nenin 170/ç të Kodit Penal³⁶⁷, rezulton se disa nga personat kallëzues (I. H., I. D., V. H., A. S.) ishin kambistë të licencuar edhe sipas të dhënave të gjendura në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë³⁶⁸. Ndërkohë, viktimat e tjera të veprës penale nuk kryenin këmbim valutor, ata i jepnin para hua për arsye të ndryshme shtetas O. D..

Vepra penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare”, parashikuar nga neni 170/ç i Kodit Penal³⁶⁹, është një vepër penale e cila nuk mund të kryhet nga viktimat, ajo mund të kryhet nga ai që mbledh paratë dhe sillet si një subjekt financiar. Në rastin konkret, autori i veprës penale nuk ka vepruar si subjekt financiar, pasi nuk ka marrë kredi apo tituj financiarë dhe nuk ka dhënë

³⁶⁷ Subjekti deklaroi se është situar si vepër në Kodin Penal me anë të ligjit nr. 23, datë 1.3.2012. Shtimi i kësaj dispozite erdhi për shkak të nevojës së zhvillimit të legjislationit dhe konkretisht pas shfuqizimit që Gjykata Kushtetuese i bëri dispozitës me karakter penal në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht nenit 90 të ligjit me titull “Ushtrimi i palicencuar i veprimtarisë”. Në rastet e kambistëve pa licencë, të cilët cilësohen edhe si njëra nga pikat e errëta apo pikat e dobëta të kontrollit financiar në Republikën e Shqipërisë, ka rezultuar se organi i procedimit e ka goditur këtë veprimtari, në vijimësi sipas mundësive dhe referimeve të ardhura nga Policia Gjyqësore dhe lufta kundër këtij fenomeni vijon.

³⁶⁸ //www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_të_licencuara/Zyra_të_këmbimit_valutor/

³⁶⁹ Sipas nenit 170/ç, paragrafi i parë i Kodit Penal: “Ushtrimi i një ose disa veprimtarive financiare, të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga personat që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislationit bankar dhe/ose financiar në fuqi, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

përqindje, por thjesht ka dashur të vjedhë para nga qytetarët, duke pranuar sipas rastit edhe një formë huaje gjoja me përqindje, por kurrë nuk e ka respektuar as këtë formë marrjeje parash, megjithëse premtonte se do jepte përqindje dhe do të ktheheshin paratë, premtim i cili ishte i gënjeshtërt. Këtë qëndrim dhe argument e kanë pranuar gjykatat në të gjitha shkallët e gjykimit, duke vendosur sipas vendimeve nr. ***, datë 8.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, nr. ***, datë 26.9.2019, me deklarimin fajtor dhe dënimin e së pandehurës për veprën penale të mashtrimit.

Nisur nga fakti se huaja parashikohet si mjet i shkëmbimit civil nga legjislacioni shqiptar, se kambizmi i licencuar njihet si veprimtari financiare ligjore në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 62/2020, datë 14.5.2020 “Për tregjet e kapitalit”, etj., rezulton se nuk kishte asnjë bazë të arsyeshme për të filluar hetime në drejtim të viktimave të veprës penale, të cilët ishin kallëzues në rastin konkret.

49.14 Sipas subjektit, prokurori duhet të tregojë një kujdes të caktuar për të parë nëse kërkesat e kallëzuesit, viktimës së veprës penale, përfshihen brenda sferës së ligjshmërisë ose jo, sikurse në rastin konkret ky kujdes dhe kontroll është kryer si nga ana e tij, ashtu edhe nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake. Gjatë hetimit të kësaj çështjeje është mbajtur parasysh se një shumë e madhe parash jashtë sistemit bankar ishte përdorur nga ana e autorit, fshehur apo mund të jenë përdorur në një nga format e pastrimit të parave. Për këto shkaqe, nga procedimi penal mëmë me nr. ***/2018 u veçuan materialet dhe nisën hetimet edhe për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal në procedimin penal nr. ***, datë 19.11.2018. Ky procedim penal i ndarë nuk është regjistruar në emër të ndonjë subjekti konkret deri në këtë fazë të hetimit dhe zbulimi apo pjesëmarrja e secilit subjekt në kryerjen e veprimtarisë së pastrimit të parave nuk përjashton regjistrimin e emrit të çdo personi që mund të rezultojë i përfshirë, qoftë ai i autorit të veprës penale të mashtrimit, qoftë kallëzues apo viktimë të veprës penale, apo qofshin edhe persona apo subjekte të tjera. Gjithashtu, duke marrë shkas nga një njoftim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për këtë çështje nga ana e DPT Tiranë, është ushtruar kontroll i thelluar ndaj subjektit të së pandehurës dhe çështja është referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si prokuroria kompetente për shkak të territorit për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

49.15 Në përfundim, subjekti deklaroi se gjyqtari i seancës paraprake, si një subjekt i rëndësishëm procedural, ka kryer të gjithë kontrollin gjyqësor të çështjes dhe nuk ka konstatuar asnjë mangësi, nevojën për shtesa apo plotësim hetimesh, por e ka miratuar kërkesën e prokurorit. Nëse do të konstatohej se kishte nevojë për plotësim hetimesh, qoftë në drejtim të plotësimit të akuzës ndaj të pandehurit, qoftë në drejtim të burimit të ligjshëm të parave të viktimave të veprës penale apo qoftë edhe çfarëdolloj *indicie* apo dyshimi të ekzistencës së ndonjë vepre tjetër penale, atëherë do e kishte kthyer çështjen për plotësim hetimesh konform nenit 332/ç të Kodit të Procedurës Penale.

49.16 Vlerësimi ligjor i Komisionit – Në cilësinë e provës, në prapësime subjekti ka paraqitur vendimet gjyqësore të këtij procedimi penal, kopje të kallëzimit penal të shtetasit I. H., dokumentacion në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutator të shoqërisë “****” sh.p.k. (ku kallëzuesi I. H. rezulton ortak së bashku me vëllain dhe motrën e tij), vërtetime të gjendjes

gjyqësore të të gjitha viktimave/kallëzuesve të këtij procedimi penal, të cilët rezultojnë të padënuar më parë. Subjekti gjithashtu ka paraqitur një kontratë kredie bankare nr. ***, datë 22.6.2017, sipas së cilës në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. është disbursuar një kredi në shumën 700.000 euro³⁷⁰, si dhe vërtetimin datë 26.10.2021, të lëshuar nga Union Bank, ku konstatohet se subjekti “***” sh.p.k. prej vitit 2010 deri në vitin 2019 ka marrë rreth 9 *overdraft*-e dhe 8 kredi të ndryshme në shuma të konsiderueshme parash.

49.17 Komisioni vëren se në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, në seksionin “Mbikëqyrja e subjekteve të licencuara zyra të këmbimit valutor”, rezulton se shoqëria *** sh.p.k. renditet subjekti i parë i licencuar në këtë aktivitet me licencën nr. ***, datë 1.10.1999, me administrator shtetasin I. H., çka provon faktin se kjo shoqëri e ka filluar aktivitetin tregtar prej vitit 1999 dhe ka krijuar bindjen se ka pasur likuiditete të mjaftueshme dhe xhiro/qarkullim të lartë monetar, duke bërë të mundur dhënien e shumave shtetases O. D..

49.18 I pyetur në seancë nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, lidhur me gjetjet e konstatuara dhe veprimet e tij hetimore, subjekti dha të njëjtat shpjegime dhe qëndrime të paraqitura në prapësime, duke shtuar në fund se ndoshta edhe mund të kishte pasur një vëmendje të shtuar lidhur me hetimin e kallëzuesve/viktimave të këtij procedimi penal.

49.19 Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë me rezerva shpjegimet e dhëna dhe në analizën e kësaj çështjeje lidhur me qasjen dhe arsyetimin e subjektit limitohet të ketë parasysh faktin se ushtrimi i detyrës së magjistratit bazohet në bindjen e tij të brendshme dhe mosvlerësimin mbi bazë të themelit të çështjes.

49.20 Në konkluzion të sa më lart, Komisioni i qëndron konstatimit të bërë në rezultatet e hetimit kryesisht dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës për rrethana dhe fakte të dala nga hetimi i kësaj çështjeje, duke u gjendur në kushtet e pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale

50. Bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor³⁷¹. Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

51. Pas analizimit të denoncimeve të mësipërme, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se në procedimin penal nr. ***/2018, në ngarkim të shtetases O. D., janë

³⁷⁰ Sipas kontratës rezulton se objekti i kësaj kredie ka si qëllim të vetëm mbylljen totale të detyrimeve të disa kredive të akorduara më parë.

³⁷¹ Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

hasur disa problematika, të cilat lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, por duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara, ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me kohën e gjatë të ushtrimit të profesionit; (ii) mangësitë e konstatuara nuk janë të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale; (iii) nuk rezultoi ndonjë rrethanë apo fakt mbi të cilat të provohej qëllimi i këtyre problematikave; (iv) kërkesat e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit, në rast se plotësohen së bashku kushtet: [...] kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...] – vlerëson se gjetjet e konstatuara në rivlerësimin e aftësive profesionale, të përshkruara më lart në arsyetimin e këtij vendimi, nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në provat e administruara për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, trupi gjykues me shumicë votash arrin në përfundimin se:

- a.** Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” (sipas leximit *acontrario*) dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, çka çon në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vendos atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
- b.** Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c.** Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.4.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Lulzim HAMITAJ

Anëtar/Kundër

Sekretare gjyqësore

Resilda Bilaj